



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
MARS 2022

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i parë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2022

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 1, datë 23.07.2021
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i Bordit

Gjeneral Brigade Dr. **Albert Mullai**

Anëtarët e Bordit

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Dr. **Bajram Begaj**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Kolonel (R) Prof. Asoc. Dr. **Edmond Braneshi**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Dr. **Etleva Smaçi**

Kolonel Msc. **David Rroku**

Msc. **Blerina Vorpsi**

Përgatiti për botim

Grupi i Redaktimit dhe Publikimit

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2022 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Copyright © 2022 by the Military Scientific Research Institute of the Academy of Albanian Forces.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: mars 2022

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë.....	7
Skenarët strategjikë të vizionit NATO 2022- 2030, përballë kërcënimeve të reja (3R + 3V) Kolonel Msc. Hysni Gjergji Shef Grupi në IKSHU, AFA.....	11
Ndryshimet klimatike - një kërcënim për sigurinë dhe ndikimi i tyre në operacionet ushtarake Kolonel Msc. Irela Nebiaj Shef Grupi në IKSHU, AFA.....	35
E drejta e informimit publik dhe siguria kombëtare Gjeneral Brigade Msc. Editsen Zarka Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm, MM.....	55
Tendencat e zhvillimit të teknologjive të reja dhe sfidat në mjedisin operacional Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj Specialist në IKSHU, AFA.....	65
Sfidat e sigurisë dhe rritja e bashkëpunimit mes aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në rajonin e Ballkanit Perëndimor Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa Specialist në IKSHU, AFA.....	77
NATO 2030, e bashkuar për një epokë të re Kolonel Emëror Hajdarasi Shef Departamenti në FMS, AFA.....	95
Lufta e Zonës Gri - Doktrina Gerasimov Msc. Roland Tashi AISM.....	103
Bashkimi Evropian dhe Eskatologjia e Luftës - Rasti i Ukrainës Dr. Malvina Tema Specialiste në Ministrinë e Mbrojtjes.....	113

RUBRIKA E DYTË: Arsimimi, trajnimi, stërvitja dhe ndikimi i tyre në fushën e sigurisë e të mbrojtjes.....	121
Kohezioni i grupit dhe lidershpi	
Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi Pedagog për Udhëheqjen Ushtarake, AFA.....	123
Metoda vlerësimi për efektivitetin e personelit në Qendrën e Kontroll-Raportimit, në kohë paqe, krize dhe konflikti	
Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha Shef Shtabi në Qendrën e Kontroll-Raportimit, FAJ.....	143
RUBRIKA E TRETË: Studime historike.....	153
Roli i marrëveshjeve ushtarake Shqipëri - Bashkim Sovjetik të viteve 1957 - 1959 në institucionalizimin e Ushtrisë Popullore Shqiptare	
Dr. Eva Smaçi Zëvendësdekan i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA.....	155
Fan Noli për ushtrinë dhe xhandarmërinë shqiptare	
Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi Akademia e Sigurisë.....	169
Përmbledhje në anglisht.....	185
Kujtesë për bashkëpunëtorët.....	198

RUBRIKA E PARË

Analiza, sinteza dhe vlerësime për sigurinë

S amiti i fundit i NATO-s i 14 qershorit 2021 në Bruksel i ka simbolizuar kërcënimet, me të cilat Aleanca do të përballet, me 3R+3V. Fillim viti 2022 e vërtetoi plotësisht këtë kërcënim (R) me sulmin e Rusisë ndaj Ukrainës më 24 shkurt 2022; me kërcënimin radikalist (R) nga regjimi taleban në Afganistan; kërcënimin nga refugjatët duke shtuar (R) refugjatët ukrainas që po largohen nga agresioni rus; (V) virusin kibernetik; (V) virusin covid 19 dhe (V) valët elektromagnetike.

Aktualisht, kërcënimet e përcaktuara në vizionin NATO 2022-2030, së bashku me teknologjinë përçarëse dhe armët autonome po marrin një dimension të ri në luftën në Ukrainë. Nëpërmjet një analize të hollësishme **Kolonel Msc. Hysni Gjergji** na jep një tablo të qartë të *skenarëve strategjikë të vizionit NATO 2022- 2030, përballë kërcënimeve të reja (3R + 3V)*, duke treguar rolin e madh që NATO luan në përmirësimin e qëndrueshëm të shteteve anëtare, duke investuar në zhvillimin e teknologjisë për t'iu përgjigjur teknologjisë përçarëse në fushën e mbrojtjes, në adaptimin e ndryshimeve klimatike dhe në mbrojtjen e rendit botëror bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

Termat “mjedis i sigurisë” dhe “qasje ushtarake ndaj koncepteve të sigurisë mjedisore” trajtohen në këtë rubrikë nëpërmjet temës studimore *“Ndryshimet klimatike - një kërcënim për sigurinë dhe ndikimi i tyre në operacionet ushtarake”*, me një fokus të veçantë në kuptimin e kërcënimeve të sigurisë të shfaqura nga ndryshimet klimatike. **Kolonel Msc. Irela Nebiaj** i përshkruan

ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në operacionet e FARSH si një kërcënim jotradicional për sigurinë dhe qytetërimin modern. Duke pasur parasysh faktin se rajoni ynë kufizohet nga disa zona më të prekshme ndaj ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit, mungesës së burimeve dhe rritjes së popullsisë, fenomeni i migrimit, sfidat ekonomike dhe çështjet ndërkuftare në rajon, së bashku me paqëndrueshmërinë politike do ta bëjnë sistemin tonë të sigurisë më të cenueshëm se kurrë më parë. Në këtë drejtim, ndryshimi i klimës është një kërcënim në rritje për paqen e përgjithshme dhe sigurinë dhe, si i tillë, do të bëhet një çështje me rëndësi në rritje edhe për FARSH.

Zhvillimet demokratike dhe integrimi euroatlantik i vendit tonë janë shoqëruar me një sërë reformash dhe rritjesh standardesh në drejtim të informimit publik nga strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes. Nëpërmjet një analize të hollësishme në shkrimin e tij **“E drejta e informimit publik dhe siguria kombëtare”** Gjeneral **Brigade Msc. Editson Zarka** synon të evidentojë mënyrat, format dhe metodat e kërkesave që i drejtohen autoriteteve publike për informim. Informacioni, që mund t’i jepet publikut dhe çfarë jo, rregullohet me anë të akteve të veçanta ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë rregulla të qarta për mënyrën e kërkimit të informacionit, si dhe rastet kur refuzohet dhënia e tij. Kërkesat dhe ankesat që i drejtohen autoriteteve publike vijnë të bëhen si me anë të shkresave, ashtu edhe me metodat e reja në formatin elektronik. Zhvillimi dinamik i komunikimit elektronik kërkon përsosjen e formave të komunikimit për realizimin më praktik të së drejtës së informimit. Edhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura po i përdorin me efektivitet këto forma, duke mundësuar rritjen e gamës së kërkesë-ankesave, dhe po ashtu rritjen e përfshirjes së strukturave për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Në shkrimin **“Tendencat e zhvillimit të teknologjive të reja dhe sfidat në mjedisin operacional”** autori **Msc. Kanan Himaj** ka si qëllim të analizojë fenomenet e globalizmit, të cilat përcaktojnë ndërlidhjen midis shteteve dhe zhvillimit të teknologjisë që ka çuar në nevojën e krijimit të aleancave politiko-ushtarake në përgjigje të kostos së madhe që kanë konfliktet e armatosura. Aktualisht, mjedisi operacional po përballet me konkurrencën e ashpër globale për zhvillimin e inteligjencës artificiale dhe aftësive robotike. Pikërisht, agresioni rus ndaj Ukrainës tregon aktorët që fitojnë garën për epërsi dhe kanë shansin për të marrë epërsinë strategjike ndaj kundërshtarëve. Inteligjenca artificiale është faktori kyç që do të ndryshojë peizazhin e mjedisit operacional dhe fizionominë e konflikteve të ardhshme dhe do të lejojë sistemet autonome dhe të ndërlidhura të kryejnë analiza, të përshtaten dhe të përgjigjen në një mënyrë të pavarur nga veprimet njerëzore.

Ballkani Perëndimor si një mikro-rajon gjeopolitik është në vartësi dhe ndikim të vazhdueshëm të mjedisit të sigurisë rajonale evropiane dhe atij global.

Këtë realitet e konkretizon me studimin e tij **“Sfidat e sigurisë dhe rritja e bashkëpunimit mes aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në rajonin e Ballkanit Perëndimor” Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa**. Integrimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian është një objektiv dhe aspiratë që bashkon të gjitha vendet e rajonit, pavarësisht qasjeve, ritmit dhe pozitave specifike të secilit prej gjashtë vendeve të Ballkanit. Sfidat bashkëkohore ndaj mjedisit të sigurisë sa vijnë dhe shtohen, duke u bërë gjithnjë e më të vështira për t’u menaxhuar, duke kërkuar angazhim gjithnjë e më të madh dhe burime njerëzore, financiare e materiale në rritje për parandalimin, zbutjen apo eliminimin e shkaqeve reale, që çojnë në përkeqësimin apo degradimin e mjedisit të sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjendja mbetet problematike, duke pasur parasysh se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë kushtet bazë dhe kryesore për zgjerimin e BE-së.

Kërcënimet dhe rreziqet si, terrorizmi, sfidat e sigurisë të paraqitura nga pandemitë, ndryshimet klimatike dhe flukset migratore vazhdojnë të përbëjnë një sfidë të madhe për Aleancën. Në kushtet e zhvillimit të rivalitetit agresiv dhe rritjes së kërcënimeve dhe rreziqeve ndërkufitare, një NATO funksionale dhe e fuqishme do të jetë një aktor shumë i rëndësishëm për sigurinë dhe prosperitetin, si brenda ashtu dhe jashtë zonës euroatlantike. Asnjë aleat nuk mund të përballet me të gjitha këto kërcënime i vetëm. Aleanca ka nevojë për një kuptim të përbashkët të kërcënimeve dhe së bashku të jenë të aftë për t’u përballur me sfidat në dekadën e ardhshme. Me shkrimin **“NATO 2030, e bashkuar për një epokë të re” Kolonel Emëror Hajdarasi** kërkon të sjellë në vëmendjen e lexuesit faktorët që kanë çuar në rritjen e kërcënimeve të mjedisit të sigurisë si dhe zhvillimet e reja teknologjike, të cilat do të luajnë një rol të rëndësishëm në mjedisin e sigurisë, si në konkurrencën sistematike, ashtu edhe në rritjen e kërcënimeve ndërkufitare të sigurisë gjatë dekadës së ardhshme.

Për përgatitjen e shkrimit të tij, autori **Msc. Roland Tashi** ka shfrytëzuar dhe përkthyer artikullin **“Koncepti i Zonës Gri. Doktrina Gerasimov, qasja ruse në operacionet hibride”**. Koncepti i Zonës Gri përshkruan mjetet që një aktor mund të përdorë për të formuar mjedisin strategjik, politik, ekonomik, kulturor para fillimit të konfliktit, i cili është një tjetër element thelbësor i debatit aktual rus. “Doktrina Gerasimov” është cilësuar si një strategji ushtarake që kombinon fushën ushtarake, teknologjinë, informacionin, diplomacinë, ekonominë, kulturën dhe elemente të tjera për arritjen e objektivave strategjike dhe që përdoret për të përshkruar operacionet jo lineare të Ruisë, të cilat mbështeten te format e reja të operacioneve të përqendruara politikisht. Nocioni i Luftës në Zonën Gri përbën hapësirën midis paqes dhe luftës, zonën e errët ku veprojnë së bashku, në të njëjtën hapësirë, aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë në një paqartësi juridike.

Në këtë rubrikë vjen një tjetër artikull analitik **“Bashkimi Evropian dhe Eskatologjia e Luftës - Rasti i Ukrainës”**, i cili do të paraqesë një përpjekje për një vlerësim të përgjithshëm të rolit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian në lidhje me një situatë sfidash, të lidhura me shqetësimet e sigurisë dhe nevojat humanitare jashtë BE-së. **Dr. Malvina Tema** synon të hedhë dritë kryesisht mbi dinamikën që lidhet me rolet komplekse të Bashkimit Evropian, në ndërthurje me situatën e Ukrainës, bazuar në premisat e politikave të sigurisë dhe perspektivat e integritetit. Ukraina përbën dilemën aktuale që vë në pikëpyetje mozaikun e sistemit ndërkombëtar dhe rolin e Bashkimit Evropian, rol i cili varet mjaftueshëm edhe nga parashikimet, përcaktimet dhe nga perspektivat jashtë tij.

Në këtë këndvështrim, synohet të vihet në diskutim efektiviteti dhe kufizimet e BE-së si promovues i paqes, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, përmes 'agjendave' për vendet partnere (në Lindje), me 'instrumente të buta pushteti', ingranuar në një mekanizëm të aktivitetit ushtarak.

SKENARËT STRATEGJIKË TË VIZIONIT NATO 2022- 2030, PËRBALLË KËRCËNIMEVE TË REJA (3R + 3V)

Kolonel Msc. Hysni Gjergji
Shef Grupi në IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

NATO kishte përcaktuar deri në vitin 2013 kërcënimet me të cilat do të përballej, duke i simbolizuar në 3R dhe duke nënkuptuar “Rusinë, Radikalizmin dhe Refugjatët”. Viti 2021 dhe fillim-viti 2022 nisi me një rritje të frikshme të kërcënimit “R” nga ana e Rusisë, e cila më 24 shkurt sulmoi një vend sovran siç është Ukraina. Çmenduria e një sistemi të çmendur po vihet në funksion nga një njeri fatkeqësisht i pajisur me armë bërthamore dhe fatmirësisht i dënuar nga e gjithë bota demokratike pa përjashtim.

Kërcënimet e identifikuara dhe prezente në botë qysh nga viti 2019 rezultojnë të jenë edhe tre viruset 3V, si: 1) Virusi si kërcënim në hapësirën kibernetike dhe inteligjencën artificiale si pjesë e tij. 2) Virusi covid-19 si kërcënim më i rrezikshëm biologjik për jetën e njeriut dhe 3) Valët elektromagnetike që dëmtojnë sistemin qendror mendor dhe krijojnë pasoja të tjera në shëndetin e njeriut.

Dy kërcënimet e para “virusale” janë përcaktuar si globale jokonvencionale pa kufij shtetërorë. I pari (V) u shfaq virusi kibernetik i cili po pushton hapësirën kibernetike duke goditur ekonominë, teknologjinë, komunikimin, mbrojtjen, jetën sociale etj. Në vitet e fundit shumë shtete anëtare ose jo anëtare të NATO-s e kanë njohur dhe pranuar hapësirën kibernetike si domeni i 5-të i luftës pas tokës, detit, ajrit dhe hapësirës kozmike¹. Së fundmi,

¹ NATO në 2016 pranoi “hapësirën kibernetike” si fushën e zhvillimit të operacioneve luftarake të NATO-s, për të cilën aleanca duhet të stërvitet dhe trajnohet për të mbrojtur veten dhe anëtarët e saj, njëllëj si edhe në fushat e tjera të zhvillimit të luftës (det, tokë, ajër, kozmos).

në shkurt 2022 në Ukrainë janë identifikuar një mori sulmesh kibernetike ruse, drejtuar sistemit bankar dhe Ministrisë së Mbrojtjes në Kiev si prelud i sulmeve ushtarake të pritshme². Kërcënimi i dytë (V) u shfaq në fund të 2019 dhe vazhdon të marrë e të kërcënojë jetën e njerëzve në mbarë botën. Ky është virusi është COVID-19. Në kuptimin gjuhësor, termi “virusi kibernetik” “sëmur” dhe “vdes” komunikimin bashkë me ekonominë, financën, mbrojtjen, teknologjinë, prodhimin dhe çdo aspekt të botës materiale dhe sociale. Ngjashmërisht, viruset biologjike (V) janë ato që sëmurin, kërcënojnë dhe marrin jetën e njerëzve dhe kafshëve. Këto viruse biologjike injektojnë kodin e tyre, si në rastin e Covid 19, ADN-në ose ARN-në në një qelizë pritëse tonën, si mjet riprodhimi. Ky kod sjelljeve vepron ngjashëm edhe tek “V” kibernetik, i cili shkakton shumëzim në qelizë në shumë kopje të virusit dhe së fundi, shpërthen për t'i dërguar viruset e reja kudo në qeliza të tjera në kompjuterë, database, sisteme automatizimi etj.

Kërcënimi i tretë (V) që është shfaqur, është ai nëpërmjet përdorimit të valës elektromagnetike. Kjo luftë kryesisht është i karakterit jokonvencional dhe ka filluar të zhvillohet mes superfuqive, kryesisht mes SHBA-së dhe Rusisë. Sulmet me radiacion mikrovalësh kanë filluar në Kubë. Në shënjestër ishte ambasada amerikane dhe agjentët e CIA-s në Havana³ pas rifillimit të marrëdhënieve diplomatike mes qeverisë “Obama” dhe qeverisë kubaneze. Sulmet me valë elektromagnetike shkaktojnë pasoja të ndryshme, më kryesoret: dhimbje koke, pagjumësi dhe humbje të kujtesës. Fakti i parë dhe më dramatik i këtij sulmi të veçantë erdhi në vitin 2017, kur disa diplomatë amerikanë, agjentë dhe nëpunës të ambasadës amerikane në Kubë raportuan se dëgjonin tinguj të çuditshëm, të shoqëruar me grumbull dobësie lëngimesh që njihen që nga ajo kohë si “Sindroma e Havanës”. Ajo shoqërohej me trysni në kokë, lodhje, shikim i turbulluar, harresë, ankth dhe depresion. Rrjeti 5G dhe teknologjia kineze Huawei paraqitet i vërtetuar si kërcënim që vjen nga valët elektromagnetike dhe përdorimi i tyre për qëllime spiunazhi nga qeveria kineze.

Fjalët kyçe: kërcënim, sulm kibernetik, virus, Ballkan, rajon, Rusia, Evropa Lindore, stabilitet, Ukrainë, NATO.

² Dan Sabbagh, korrespondent i “The guardian”, më 16 shkurt 2022 nga Kiev, Ukrainë.

³ Sipas “The Times”, më 20 korrik 2015.

1. Kërcënimi rus në prioritetin e NATO-2030 për rajonin e Evropës Lindore dhe Ballkanin

Viti 2022 filloi me një rritje të kërcënimit “R” nga ana e Rusisë, e cila sulmon Ukrainën duke kërcënuar seriozisht paqen dhe stabilitetin në Evropën Lindore, Shqipërinë⁴, si dhe gjithë kufirin lindor të NATO-s. Sulmi i Moskës kundër Kievit sot po zë faqen kryesore të shtypit ndërkombëtar, por edhe aktivitetin diplomatik, politik dhe ushtarak të organizmave ndërkombëtare NATO, BE dhe OKB.

Përfundimi i Luftës së Ftohtë në 1991, shpërbërja e Traktatit të Varshavës dhe rënia e murit të Berlinit, për shumë studiues ushtarakë dhe të gjeopolitikës u deklaruan si fundi i misionit të NATO-s. U hodhën ide edhe për “shpërbërje”, pasi Aleancës së Atlantikut të Veriut i mungonte blloku ushtarak armiqësor apo shteti kërcënues për sigurinë e anëtarëve të saj. Por sulmi në Gjeorgji, pushtimi i Krimesë në 2014 dhe së fundmi sulmi kundër Ukrainës treguan që kërcënimi rus (sovjetik) ishte rizgjuar. *Këto fakte vazhdojnë të bindin çdo ditë e më shumë të gjithë skeptikët, që NATO është aleancë ushtarake që nuk kërcënon askënd por e domosdoshme, në misionin e saj të duhur, mbrojtës dhe historik edhe sot në vitin 2022. Pika e parë e axhendës së shpallur NATO 2030 është kthimi i besimit se aleanca është edhe një herë tjetër në vendin e duhur të historisë për të ndryshuar dhe u përshtatur me ndryshimet botërore.* Rusia, në strategjinë e sigurisë kombëtare të saj, deklaroi se NATO vazhdon të etiketohet si fuqia kryesore armike e sigurisë kombëtare të Rusisë, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimi iu propagandohen qytetarëve rusë si shkaktarët e vetëm të varfërisë dhe rënies së tyre ekonomike.

Por pyetja që i mundonte të gjithë deri më 24 shkurt ishte: a do të sulmohet Ukraina? Përgjigja varej vetëm nga vendimi që do të merrte lideri rus Vladimir Putin, një “Putin racional” apo një “Vladimir i çmendur”? A do të ishte Putini lider i luftës apo strateg i paqes⁵ - Duke besuar te “Vladimiri i çmendur”, analistët u nisën nga fakti i fundit i liderit rus për botimin e

⁴ Deklaratë e ministrit të Jashtëm rus Lavrov, i cili përmend edhe Shqipërinë si mbështetëse me mercenarë për Ukrainën, duke e futur automatikisht vendin tonë në listën e shteteve kundërshtarë të Moskës, më 18 shkurt 2022.

⁵ Rachman, Gideon, “Financial Times” datë 11 shkurt 2022.

eseve dhe retorikave me frymë nacionaliste. Në korrik 2021, ai shkroi “*Mbi unitetin historik të rusëve dhe ukrainasve*” dhe një ese “*Origjina e Luftës së Dytë Botërore*”, duke pretenduar se Britania dhe Franca kishin inkurajuar qëllimisht Gjermaninë të sulmonte Bashkimin Sovjetik. Putin nuk është bankier, filozof, profesor universiteti apo ekonomist. Profesionin dhe biznesin e tij personal ai ka luftën, pasi është arsimuar, trajnuar dhe stërvitur si ushtarak si dhe ka pasur karrierë në kundërspiunazhin rus, gjatë luftës së ftohtë. Ai njih shumë mirë historinë e luftërave të mëparshme, ndërsa në Luftën e Ftohtë ka qenë një drejtues i inteligjencës ruse në Gjermaninë Lindore. Lufta e Ftohtë dhe ngjarjet e saj i kanë dhënë një përvojë të konsiderueshme dhe kjo duket në mënyrën sesi ai po drejton superfuqinë ruse. Megallonomia e një lideri totalitar që udhëheq Rusinë prej 22 vitesh bashkë me formimin, egon dhe prejardhjen e tij, e bëjnë të rrezikshëm veçanërisht për rusët dhe përgjithësisht për rajonin dhe ndoshta për botën.

Pikërisht edhe në këtë fillim viti të 2022 situata ngjan si para 60 viteve, gjatë Luftës së Ftohtë, ku shtetet në konflikt nuk janë thjesht Rusi - Ukrainë, por Rusia përballë SHBA-së dhe NATO-s, ku palët janë poseduese edhe të armëve bërthamore. Ky fakt e bën konfliktin të ngjashëm, shumë të rrezikshëm nëse ndodh si dhe “çmenduri” për hir të shkatërrimit të paimagjinueshëm që do të arrihej nëse do të përdoreshin këto armë⁶.

“Moska është përpjekur të minojë institucionet demokratike të Ukrainës, ka ndërhyrë në politikën e brendshme dhe zgjedhjet e Ukrainës, ka bllokuar energjinë dhe tregtinë për të frikësuar dhe shantazhuar, ka përdorur propagandën dhe keqinformimin për të mbjellë mosbesim si dhe ka ndërmarrë sulme kibernetike⁷. Është tashmë e vërtetuar se Moska ka përdorur dhe po përdor ndërhyrjet në zgjedhjet politike të vendeve të ndryshme, me qëllim manipulimin e procesit politik të zgjedhjeve në Evropë, SHBA dhe Ballkan duke mbështetur personalitete pro rusë.

Në dhjetor të 2021, teksa trupat ruse ishin të grumbulluara pranë kufirit të Ukrainës, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky paralajmëroi vazhdimisht mbi rrezikun e një grushti të mundshëm shteti në Kiev, të planifikuar nga Moska dhe oligarkët pro-rusë në Ukrainë. Qëllimi i këtij grushti shteti është vendosja e një qeverie të re pro-ruse në Ukrainë, e cila do të kishte të drejtën të kërkonte zyrtarisht për ndërhyrje forcat e CSTO-së, siç ndodhi në Kazakistan. Ky është edhe qëllimi i vetëm i sulmit rus mbi Kiev pasi vetë Putini i drejtohet popullit ukrainas të rrëzojë qeverinë e tij⁸. Kërkesa e një qeverie pro ruse qoftë edhe “e përkohshme” për ndërhyrje nga jashtë do t’i siguronte Rusisë të drejtën

⁶ V. Putin më 27 shkurt 2022 ka kërkuar gatishmërinë e trupave bërthamore.

⁷ Deklaratë e Sekretarit të SHBA Blinken, më 1 shkurt 2022.

⁸ Deklaratë e V. Putin, 24 shkurt 2022.

për të filluar një proces pushtimi nga brenda të Ukrainës. Këtë dëshiron dhe synon Putini edhe sot duke e quajtur qeverinë e Kievit si neonaziste, tradhtarë etj.

Ka informacione në lidhje me kontaktet ndërmjet shërbimeve sekrete ruse me katër personalitete të tjera politike të Kievit, ish-kryeministri Mykola Azarov, ish-zëvendëskryeministrat Serhiy Arbuzov dhe Andriy Kluyev, si edhe ish-zëvendëshefi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare Vladimir Sivkovich, të cilët kanë qenë të gjithë në detyrë në kohën e presidentit të konsideruar pro rus, Viktor Yanukovych, larguar nga pushteti në vitin 2014. Kandidati për kryeministër i mbështetur nga Moska, në Ukrainë, është ish-deputeti, Yevhen Murayev⁹. “Presioni dhe qëllimi për të fituar pa luftë, por nëpërmjet demonstrimit të fuqisë së armëve dhe ndërhyrjes nga brenda, ka qenë synimi i të gjithë luftërave¹⁰”.

Në fund të këtyre analizave dalim në përfundimin që nuk mund të ketë një “pushtim” nga jashtë vetëm me “fuqi të ashpër” ose një luftë konvencionale në Ukrainë. “Faktorët që çojnë në fitoren e një lufte janë planifikimi, numri i ushtarëve, logjistika, morali dhe balanca e fuqisë dhe në fund fituesin e vendos Balanca e Fuqisë¹¹”. Balanca e fuqisë është politikë e një shteti ose e një grupi shtetesh që mbrohet kundër një kombi ose grupi kombesh të tjera, duke krahasuar fuqitë mes palëve. Politikën e ekuilibrit të fuqisë, shtetet mund ta ndjekin e ta zhvillojnë në dy mënyra: a. duke rritur fuqinë e tyre ushtarake dhe ndjekur garën e armatimit; b. duke i shtuar fuqisë së tyre edhe fuqitë e shteteve të tjera, përmes një politikë diplomatike dhe aleancash. NATO dhe SHBA po dërgon trupa dhe teknologji ushtarake në vendet anëtare të saj, pikërisht për të vendosur këtë ekuilibër fuqie me ushtrinë ruse të dislokuar në Rusi dhe Bjellorusi. Një leksion me përmasa aktuale që po rilexojmë këto ditë të ftohta rreth luftës së ftohtë, është “doktrina e shkatërrimit të sigurtë të palëve luftuese¹²” e cila në vitet 60-të pas krizës së raketave ruse bërthamore në Kubë, parandaloi sulmin e sigurt vdekjeprurës nga të dyja palët SHBA-BS. Në kërcënimin aktual, përveç Rusisë, edhe Bjellorusia deklaroi se është gati të lejojë armët bërthamore ruse në kufirin dhe territorin e saj. Frika e shkatërrimit të ndërsjellë dhe e një holokausti bërthamor global në vitet 60-të nga të dy palët i bëri ato më të përgjegjshme.

Për të parashikuar nëse një sulm do të ndodhë dhe një luftë do të fitohet ose jo, duhet të merren në konsideratë disa faktorë, që do të mundësonin humbjen apo fitoren, ndër të cilat më kryesore janë:

⁹ Deklaratë e Ministrisë së Jashtme Britanike, më 6 shkurt 2022.

¹⁰ Sun Tzu “Arti i Luftës”.

¹¹ Po aty.

¹² (Mutual assured destruction) Doktrinë ose simbolikisht “mad” që në anglisht do të thotë çmenduri.

a. Raporti i forcave, i cili nuk është në favor të Rusisë, pasi 150000 trupa në mësymje do të ndaloheshin vetëm nga mbi 50000 ushtarë ukrainas, sipas doktrinës së luftës frontale konvencionale. Realisht është një popull prej 40 milion banorë përballë trupave ruse.

b. Morali i trupave dhe roli i liderit, një faktor në favor të Ukrainës; i gjithë populli ukrainas është ngritur në këmbë për të mbrojtur atdheun e tyre dhe të përfshirë në trajnim për përdorimin e armëve. Presidenti dhe qeveria ukrainase është në front e luftës, në vendin që i takon një udhëheqësi në luftë.

c. Aleancat dhe mbështetja ndërkombëtare janë faktorë në favor të Kievit, pasi Rusia ka mbetur e vetme me Kinën abstenuese “*pro Rusisë dhe pro paqes*” bashkë me aleatët e CSTO; Armenia, Bjellorusi, Kazakistani, Kyrgyzstani dhe Takhikistani. NATO ndoshta për herë të parë është e bashkuar pa asnjë mëdyshje.

d. Logjistika që mbështet luftën është një barrë e rëndë për ekonominë ruse, shtuar kësaj edhe sanksionet e rënda ndërkombëtare që po vihen në çdo moment. Makinaria ushtarake është konsumatore e jashtëzakonshme dhe shumë shpejt do të japë efekt te forcat ruse.

e. Befasia e sulmit nuk është në favor të Moskës, por po i jep kohë Kievit dhe aleatëve të tij të përgatitin “*varrin rus në Ukrainë*”.

f. Mbështetja e brendshme është në rënie pasi popullsia dhe opozita ruse është në protestë. Bota po e dënon këtë luftë. Ky është një argument në disfavor të Moskës, pasi demonstratat kundër luftës sapo kanë filluar dhe gjasat janë të përshkallëzohen në varësi të ecurisë së situatës.

Si përfundim, mund të themi që nuk do të ketë një fitore konvencionale frontale në Ukrainë, por rezulton e kundërta, ky do të jetë fundi për regjimin dhe veprën e “*Vladit të çmendur*”. Luftëra të kufizuara asimetrike dhe hibride nuk do të ndalen në këtë rajon dhe nuk do të ndërpriten asnjëherë nga Moska. Lufta me inteligjencë, sajimi i “*false flag*” i sulmeve të brendshme kanë ekzistuar, po ndodhin dhe nuk do të ndërpriten për një kohë të gjatë nga rusët, jo vetëm në Ukrainë por në të gjithë perëndimin.

Kremlini thjesht kërkon të “*blejë kohë*” dhe të vazhdojë të paraqitet për popullin rus si “*mbrojtës i sovranitetit të tokave ruse*” dhe të dezinformojë për “*Ukrainën si grabitëse të trojeve ruse*”. Problemi i Putinit është se si do të mundet ai të “*shesë*” humbjen për fitore te rusët, nëpërmjet makinërisë së tij të propagandës duke fajësuar si gjithmonë të tjerët.

Siguria e ujërave dhe nënujit paraqitet të jetë një kërcënim tjetër potencial rus. Shefi i sapoemëruar i Shtabit të Përgjithshëm në Britaninë e Madhe¹³ paralajmëron se ka pasur “*një rritje fenomenale*” në aktivitetin e nëndetëseve

¹³ Deklaratë e Admiralit Sir Tony Radakin, më 3 janar 2022 se Rusia është fuqia armiqësore që ka më shumë gjasa për të gjymtuar arteriet jetike të komunikimit global nënujor.

ruse gjatë 20 viteve të fundit dhe Rusia ka rritur aftësinë për të vënë në rrezik kabllot e komunikimeve ndërkombëtare nënujore, si dhe për t'i shfrytëzuar potencialisht ato. Kabllot nënujorë janë projektuar sipas standardit “pesë nënta”¹⁴ Një anije e identifikuar si një kërcënim serioz për këtë qëllim është “Yantar”. E deklaruar nga marina ruse si një anije ‘kërkuese’, ajo mban dy mini-nëndetëse të dizajnuara për misione inxhinierike të cilat mund të ekzaminojnë zona deri në 3.75 milje nën ujë. Vetëm katër muaj pasi doli në det për herë të parë në vitin 2015, Yantar shkaktoi shqetësim në qarqet e inteligjencës kur u zbulua në brigjet e SHBA-së në rrugën e saj për në Kubë, ku kabllot nënujore dalin në tokë pranë Gjirit të Guantanamo.

Në të gjithë botën ka 436 kabllot kryesore komunikimi, që përmbajnë mes tyre më shumë se 800,000 milje fibër optike. *Çdo ditë rrjeti kabllor mbart transferta financiare në vlerë prej 10 trilion dollarësh. “Babai” i të gjithëve është “Asia American Gateway”¹⁵ e cila është 12,430 milje e gjatë. Çdo kabllot përmban nga 4 deri në 200 fibra optike – një fibër mund të transmetojë deri në 400 GB të dhëna në sekondë, ose të mjaftueshme për rreth 375 milionë telefonata. Një kabllot e vetme që përmban tetë fije fibra optike mund të transferojë përmbajtjen e Bibliotekës Bodleian të Oksfordit – e cila përmban më shumë se 12 milionë libra, revista dhe dorëshkrime – përtej Atlantikut në vetëm 40 minuta. Kabllot nënujorë janë shumë më të rëndësishme se komunikimet satelitore, pasi këta të fundit përbëjnë vetëm 3 përqind të trafikut global.*

Kërcënimi tjetër (R) vjen nga radikalizmi islamik në këtë periudhë është i njohur dhe përfaqësohet kryesisht me talibanët dhe ISIS-K në Afganistan, pas rënies pa lavdi të ushtrisë afgane. Ka të ngjarë që vëmendja ndërkombëtare tek Rusia e ka humbur disi vëmendjen nga ISIS dhe vrasja e liderit të organizatës¹⁶. Talebanët po organizojnë një batalion ushtarësh me kamikazë. Batalioni më 5 janar 2022 ka marrë zyrtarisht një emër ose kështu e quajnë militantët e tyre në Kabul: "Ishtihadi", nga arabishtja "shahid", që do të thotë martir. Me fytyra të mbuluara me uniforma të zeza, përkushtimi i tyre ndaj kauzës do të jetë total. Në thelb do të ketë pak të reja. Dëshmorët e tyre kryen masakra të frikshme kundër ushtarëve të koalicionit të udhëhequr nga SHBA-të (përfshirë dhe ushtarë shqiptarë me mision paqeruajtës¹⁷), të cilat prekën gjithashtu dhjetëra

¹⁴ Kjo do të thotë se janë të besueshëm në 99,999 për qind të rasteve, një nivel i rezervuar për armët bërthamore dhe anijet kozmike.

¹⁵ Asia America Gateway (AAG) është kabllot nënujor me fibra optikë rreth 20000 km e gjatë që lidh Azinë Juglindore me SHBA. Ajo lidh Malajzinë, Singaporin, Tailandën, Brunei Darussalam, Vietnamin, Hong Kong SAR, Philippines, Guam, Hawaii and the US West Coast, si dhe ndërlidhje me kabllot kryesorë të komunikimit që lidhin Evropën me Australinë.

¹⁶ Datë 3 shkurt 2022 nga “Shtëpia e Bardhë” jepet lajmi për vrasjen e liderit në Siri, Abu Ibrahim al-Hashimi al-Qurayshi

¹⁷ Dëshmorë i atdheut Kapiten Feti Vogli humbi jetën më 20 shkurt 2012 nga një sulm terrorist në Kandahar Afganistan.

mijëra ushtarë afganë dhe mbi të gjitha civilë.

Nuk ka asnjë shembull tjetër të një ushtrie të rregullt që përfshin në radhët e saj njësi elitare ushtarësh haptazi të gatshëm për "martirizim". Guerilët e ISIS-it kishin trajnuar grupe kamikaze dhe grupe xhihadiste të frymëzuara nga Al Kaeda. Hezbollahu libanez gjithashtu mbledh kamikazë brenda tij, ashtu si edhe nigerianët e Boko Haram-it në Afrikë. Por këto janë pikërisht lëvizje guerile apo grupe terroriste. Ndoshta është e nevojshme të kthehemi tek kamikazët japonezë në fund të Luftës së Dytë Botërore për të gjetur diçka të ngjashme me atë që po krijojnë talebanët¹⁸. Ndërsa kriza e refugjatëve është përshkallëzuar me ato refugjatë që vijnë nga Afganistani, prej frikës së hakmarrjes nga qeverisja talibane si dhe pritjet valë refugjatësh nga Ukraina gjatë vitit 2022 si rezultat i luftës me Rusinë.

2. NATO përballë kërcënimit global të sigurisë nga kërcënimi 3V

“Sulmi kibernetik kundër njërit apo disa anëtarëve të aleancës, nisur nga pasojat e njëjta që mbart me një sulm ushtarak, duhet të trajtohet si subjekt i nenit 5, duke parashikuar edhe kundërpërgjigje të strukturave të armatosura të NATO-s kundër këtij kërcënimi të shekullit¹⁹”. NATO ka përmirësuar know-how e saj në drejtim të kërcënimit kibernetik duke u trajnuar më shumë, duke ndarë praktikat dhe teknologjitë më të mira, duke punuar më ngushtësisht me aleatët, si dhe duke kërkuar mundësinë e integritetit të kapaciteteve. Në këtë drejtim ne po forcojmë kapacitetet tona për të mbrojtur rrjetet tona pasi është i qartë drejtimi i ri që NATO ka ndërmarrë. Në axhendën NATO - 3030 u hodhën disa piketa të përgjithshme që do të shërbejnë si udhëzues për të gjitha vendet anëtare, lidhur me kërcënimet e reja që ajo parashikon të përballet.

Është koha të shqetësohemi për luftën kibernetike²⁰”. Në perspektivën kombëtare është detyrë e çdo vendi të mbrojë rrjetet e veta të komunikimit, pasi NATO nuk ka kapacitete të veçanta për këtë kërcënim, por është e përbërë nga shumatorja e kapaciteteve të 30 vendeve anëtare ku Shqipëria është njëra hallkë e këtij zinxhiri sigurie²¹. Në fushën e zbulimit, spiunazhi kibernetik si pjesë e luftës kibernetike, është arti i të praktikuarit të atyre teknikave nëpërmjet të cilave vidhen informacione sekrete (të tipit sensitiv, rreth pronësisë, informacioni i klasifikuar sekret shtetëror ose i NATO-s)

¹⁸ Zabiullah Mijahid, Zëvendësministri i Informacionit dhe Çështjeve Kulturore deklaroi më 5 janar 2022.

¹⁹ Deklarimi i Sekretarit të Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në takimin me ministrat e mbrojtjes së aleancës më 28 qershor 2017

²⁰ Uashington Post në korrik 2017 i kushton një vend të rëndësishëm këtij kërcënimi të erës së re, siç e quajnë autorët Ryan Maness dhe Benjamin Jensen në shkrimin “Lufta kibernetike ka marrë një drejtim të ri”.

²¹ Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në komisionin e sigurisë kombëtare, datë 8.10.2021, ka deklaruar për ngritjen e kapaciteteve “Cyber” në FARSH.

nga individë të ndryshëm, konkurrentë, rivale, grupe si dhe qeveri armike. Informacionet e vjedhura përmes kësaj metode mund të kenë karakter politik, ushtarak ose ekonomik, sekrete këto që mund të sigurojnë avantazh në fushat e sipërpërmendura. Këto sekrete sigurohen duke përdorur metoda ilegale duke shfrytëzuar mundësitë që ofrohen nga interneti, rrjetet softuer ose edhe vetëm kompjuterët. Nisur nga misioni i inteligjencës për të mbështetur dhe ndikuar në vendimmarrjen politike të një vendi, është i domosdoshëm analizimi dhe kuptimi i përditësuar i saj në dritën e dekadave të fundit. Për të arritur këtë përditësim, duhet të evoluojë edhe përshtatja e strukturave, procedurave dhe funksioneve që inteligjenca zgjidh²².

Duke studiuar autorë dhe veteranë të inteligjencës dhe duke marrë parasysh përvojën time, gjej që *cyber* inteligjenca duhet të përcaktohet si një disiplinë e re e inteligjencës. Krahas disiplinave të tjera në fushën e komunikimeve aktuale sot është grumbullimi i informacionit të shërbimeve të inteligjencës në hapësirën kibernetike. Të mësuarit në kohë se çfarë kundërshtari përgatit, punon apo investon në këtë fushë, është thelbësore për të mbrojtur sistemet dhe gjithçka tjetër që është e ekspozuar nga kërcënimi kibernetik, e quajtur edhe si lufta e re në hapësirën *cyber*. Këto ndryshime të diktuar nga situata e ndryshueshme e kërcënimeve kërkojnë edhe adoptim të ligjeve dhe organizmave të IC, madje duke ndryshuar edhe peshën e rëndesës së disiplinave të inteligjencës nga njerëzore në teknike ku të përfshihet edhe *cyber* inteligjenca.

Rreshteri Brendly Manning²³ është një shembull i këtij transformimi të spiunazhit modern. Duke shfrytëzuar aksesin që kishte në informacionin sekret në Irak, ai arriti të zbrazë të gjithë serverët e operacioneve luftarake, Nëse këta do ktheheshin në dokumente të printuar, do të duheshin disa kamionë për t'i transportuar.

Sa i përket (V) kibernetik në ditët e sotme nënkuptohet më tepër për *malware*²⁴ dhe *spyware*²⁵ sesa për viruset. Pasi të ekzekutohet virusi, ai do të përpiqet të kopjojë veten dhe të përhapë infektim në “file-t” dhe programet tjera përmes internetit. Këto kopje të viruseve mund të jenë pak më ndryshe nga origjinali i cili shkakton vështirësi të softuerët e antivirusit për t'i eliminuar ato. Disa madje vijnë si të koduara, duke e bërë zbulimin e tyre edhe më të komplikuar. Sulmi kibernetik kundër Ukrainës më 16 janar 2022 vërtetohet se është kryer nga *malware* dhe *spyware* të drejtuara nga Bjellorusia dhe mbështet kërcënimin me armë që Moskë po i bën Kievit.

²² Mark M. Lowenthal, Seventh Edition of “Power of intelligence”, faqe 212.

²³ Analist i DIA (Zbulimit Ushtarak Amerikan) në 2004 ia dërgon vetëm në disqe tek WikiLeaks informacion sekret për operacionet në Irak dhe trajtimin e të burgosurve të dyshuar terroristë në Guantanamo.

²⁴ Malware është sistem i cili shkakton dëmtime në kompjuterin tuaj ose sistemin kompjuterik.

²⁵ Spyware është sistem i cili mundëson mbledhjen e informatave të personave ose organizatave të caktuara, pa dijeninë e tyre.

Viruset (V) kompjuterike veprojnë në mënyrë të ngjashme si parimi i viruseve në organizëm. Viruset kibernetike janë të prirur të përmbajnë pjesë të vogla të kodit që përzihen me programet ose “file” tjera dhe ato kopjohen vetëm atëherë kur kushtet janë të plotësuar. Ato mund të ekzekutohen në një datë dhe orë të caktuar duke hapur programe të caktuara madje edhe të sulmojnë ndonjë sasi të caktuar të hapësirës së memories. Për ta bërë më të thjeshtë, malware është çdo “infeksion kompjuterik”, i cili përfshin viruse dhe programe keqbërëse. Shumë malware modern si ransomware²⁶ dhe adware²⁷ janë gjithashtu programe të pavarura që mund të paraqiten dhe të ekzekutohen nga vetë përdoruesi për qëllime përfitimi, shantazhi apo “gjobëvënie”. *Spyware mund të mbledhë pothuajse çdo lloj të të dhënave, duke përfshirë informacionin personal si zakonet, kërkimet në internet, hyrje në të dhënat bankare apo kreditore të përdorueseve etj.* Spyware gjithashtu mund të ndërhyjë në kontrollin e përdoruesit të një kompjuteri duke instaluar softuer shtesë. Disa Spyware mund të ndryshojnë parametrat e kompjuterit, e cila mundet të rezultojë në shpejtësi të ngadaltë në lidhjen e internetit, ndryshime të paautorizuara në parametrat e shfletuesit apo ndryshime në parametrat e softuerë. Ndonjëherë, Spyware është i përfshire së bashku më një softuer të mirëfilltë dhe mund të vijnë nga një shitës zyrtar të softuerëve. Hidhen dyshime se kjo mund të mos jetë vepër e hakerëve, por e ndonjë shërbimi inteligjent kombëtar. Sipas Simantek²⁸, 29% e firmave nënurvejimin e këtij programi ishin ruse dhe 24% arabe.

Aktualisht, bota është e varur nga hapësira kibernetike në çdo gjë, nga tregtia deri tek komunikimi dhe ushqimi i përditshëm, duke ndryshuar në një masë të konsiderueshme mënyrën dhe zakonet tona të jetesës. Rritja e dixhitalizimit të teknologjisë në shumë fusha të jetës shoqërore dhe ekonomike ka promovuar zhvillim nga njëra anë por gjithashtu ka ngritur edhe një shqetësim të madh që lidhet me sigurinë e kësaj hapësire, të padukshme, të paprekshme dhe pa kufij të konfiguruar, siç është "hapësira kibernetike". Askush nuk ka qenë dhe nuk është imun ndaj këtyre sulmeve të cilat kanë synuar vjedhjen e të dhënave (ekonomike, financiare, ushtarake, mjekësore, biometrike), shkatërrimin e database të kundërshtarëve, vjedhjen e teknologjisë dhe informacioneve të klasifikuara sekrete kombëtare.

Lufta kibernetike nga njëra anë kërkon sigurinë kibernetike dhe nga ana tjetër kjo siguri nuk është vetëm subjekt teknik, siç thuhet rëndom, por ajo është strategji, politikë dhe fenomen social madje. Në 25 vitet e fundit, teknologjia

²⁶ Programe keqbërëse që nuk ju lejon të futeni në kompjuter përderisa të paguhet një shumë e caktuar të parave.

²⁷ Program keqbërës që automatikisht shkarkon materiale reklamuese në momentin kur shfrytëzuesi kyçet në kompjuter.

²⁸ Kompani prodhimi, instalimi dhe prodhimi të materialeve kompjuterike.

e informacionit ka përmirësuar marrëdhëniet midis njerëzve dhe shteteve duke përfshirë këtu edhe drejtimin dhe menaxhimin e luftës në përgjithësi dhe konflikteve të armatosura në veçanti. Historikisht luftërat janë zhvilluar në një rajon të caktuar gjeografik dhe në një periudhë kohe të përcaktuar. Sot natyra e luftës ka ndryshuar totalisht me njohjen e komponentit kibernetik të saj. Kufijtë nuk ekzistojnë më, fronti i luftës nuk ka më kuptim dhe aktorët ndërluftues nuk kanë rëndësi të jenë përballë njëri tjetrit dhe të kenë kontakt me njëri-tjetrin.

Tashmë ky kërcënim (V) i ri mjafton që me një numër të vogël hakerësh mund të gjunjëzohet një komb në disa minuta duke goditur infrastrukturën kritike shtetërore, centralet elektrike, komunikacionin, spitalet dhe zyrat qeveritare. E fundit është goditja masive me kibernetikë e sistemit bankar ukrainas në Kiev në ditën që trupat ruse filluan një farë tërheqje, më 16 shkurt 2022.

3. Shënjestrat e luftës (V) kibernetike

“Nedënojmë veprimtarinë e dëmshme kibernetike të krijuar për të destabilizuar dhe dëmtuar sigurinë euroatlantike dhe për të prishur jetën e përditshme të qytetarëve tanë. Duke theksuar vendosmërinë e NATO-s për të parandaluar dhe luftuar kërcënimet kibernetike se aktivitete të tilla dëmtojnë sigurinë dhe stabilitetin e hapësirës kibernetike, mirëpresim deklaratat e aleatëve si Kanadaja, Britania dhe SHBA-ja që për hakërimin e serverëve të Microsoft Exchange atribuojnë Kinën²⁹”.

Ambasada Amerikanë në Tiranë bën thirrje që Shqipëria të ketë kujdes në implementimin e rrjetit 5G e posaçërisht nga kinezët e Huawei dhe se qasja e saj nuk lidhet me konkurrencën që vjen nga Kina por me çështje të sigurisë që janë mjaft të rëndësishme dhe mjaft të mprehta. “Dhe, për sa i përket vendndodhjes gjeostrategjike të Shqipërisë, ju e dini se revolucioni 5G po vjen: ndërlidhja e rrjeteve 4G të Shqipërisë së shpejti do të përmirësohet; ndërlidhja e vendit të saj gjeostrategjik në hartë është e rëndësishme sepse ka vende si Kina që do të dëshironin të kapnin mënyrën e jetesës dixhitale të Ballkanit Perëndimor për të thithur informacione prej tyre dhe asfiksuar rrjetet e aleatëve të SHBA-së. Shqipëria tashmë po bën gjënë e duhur duke ushtruar vigjilencë në mbrojtje të rrjeteve të saj. Edhe një herë, disa gjëra në Shqipëri thjesht nuk janë për shitje³⁰”.

Një nga rastet e para të këtij lloj sulmi është regjistruar në vitin 2007, kur në periudhën e 3 javëve pati një valë masive të sulmeve kibernetike të Rusisë kundër Estonisë, të cilat çuan në paralizimin total të ministrive, bankave dhe kompanive të komunikimit të Estonisë. Më pas, në vitin 2013, Ukraina pati gjithashtu një paralizim dhe “black out” total të energjisë elektrike si rezultat

²⁹ Deklaratë e NATO-s më datë 21.02.2019 për sulmet kibernetike në hapësirën e Aleancës.

³⁰ Deklarata e datës 28 tetor 2021 të së ngarkuarës me punë, Leyla Moses-Ones në Konferencën “Politika e ShBA në Ballkanin Perëndimor”

i sulmeve kibernetike ruse³¹.

Tendenca e në rritje e incidenteve kibernetike për vitin 2019 dhe 2021 duhet të konsiderohet alarmante pasi është kaluar nga sulme kundër objektivave qeveritare drejt objektivave dhe infrastrukturës civile. Gjatë vitit të kaluar janë përhapur disa viruse kompjuterike “qëllim këqija” në hapësirën kibernetike duke shkaktuar pasoje dramatike për spitalet, aeroportet, bankat, trenat etj. Gjithashtu, sistemi politik elektoral në SHBA, Francë dhe Holandë kanë qenë të kërcënuar në vitin 2017-2020 dhe vazhdojnë të jenë tema të debateve politike dhe diplomatike ndërkombëtare.

Nga këndvështrimi i Shqipërisë si shtet anëtar i NATO-s, sulmi kibernetik nisur nga metodat që përdor dhe objektivat që përzgjedh, është së pari sabotazh. Sabotazhi është një kërcënim i cili ka për qëllim dëmtimin dhe shkatërrimin e pikave nevrologjike, ekonomike dhe jetike të kundërshtarit. Rastet e shtjelluara më lart në ish-republikat sovjetike dhe të tjera e vërtetojnë këtë tezë³².

Nisur nga rastet e analizuara dhe trendin e zhvillimit teknologjik, nevojitet një ndërgjegjësim, pikë së pari i strukturave ligjzbatuese me qëllim adaptimin nga ana e tyre të kundërmasave të nevojshme për t’i bërë ballë këtij kërcënimi të ri shumëdimensional. Shërbimet inteligjente të aleancës nisur nga “lessons learned” kryesisht në ish-republikat ruse, po bëjnë një reformim të strukturave të tyre të burimeve njerëzore në dy drejtime: së pari, është aftësimi profesional në drejtim të teknologjisë kompjuterike të personelit dhe së dyti, një vetingu rigoroz i personave që kanë akses në rrjetet e komunikimit dhe ruajtjes së informacioneve sensitive³³.

4. Dallimet ligjore të cyber krimit nga krimi i zakonshëm

Ndërhyrjet e paligjshme në hapësirën virtuale dallojnë nga ato krime të kryera në objektet reale, për disa veçori thelbësore:

- Kamuflimi dhe fshehja e krimit kompjuterik nëpërmes komunikimit global pa kufij.
- Lehtësia (komoditeti) në zhdukjen dhe ndryshimin e informacionit kompjuterik (zhdukja e gjurmëve të krimit), gjurmët e krimit të kryer në hapësirat kibernetike ruhen në memoriet e pajisjeve teknike dhe mbeten të fiksuara për një periudhë shumë të shkurtër.
- Shpejtësia dhe manovrueshmëria nga ana e keqbërësit në veprimet e

³¹ Sipas Dan Coat, Ukraina cilësohet si poligon apo si epruvetë e eksperimenteve që Rusia bën lidhur me testimin e teknologjisë së re të luftës që mendon të përdorë.

³² Nga llogaritjet e bëra nga NASA dëmi ekonomik për vitin 2017 ka qene rreth 5 miliardë dollarë dhe në vitin 2022 parashikohet të shkojë në 6 triliardë dollarë.

³³ Rasti i rrjedhjes së të dhënave të pagave në fillim të vitit 2022 tregoi se përgjegjshmëria e personave përgjegjës për sigurinë e rrjeteve vlen për t’u rivlerësuar.

interceptimit të informacionit kompjuterik dhe identifikimit të personave që merren me ruajtjen e rrjeteve kompjuterike.

Përsa i përket përcaktimit të formës, se ku duhet të kategorizohet faj i kryer (penalizimi), rezulton mjaft e qartë se ky lloj krimi (për sa kohë që kryhet nga një person teknikisht i kualifikuar që i njeh fare mirë pasojat e rrezikshme të veprimtarisë së vet dhe është në gjendje të parashikojë pasojat e dëmshme për shoqërinë e që këto veprime i bën me ndërgjegje), kualifikohet si krim i kryer me paramendim.

- Krimi kibernetik duhet distancuar pak nga një nocion i përgjithshëm i asaj që quhet krimi informatik. *Krimi kibernetik është një nënkategori e krimit informatik dhe ka të bëjë me veprimtarinë kriminale të zhvilluar në rrjet.* Një aspekt tjetër që duhet trajtuar për të kuptuar fenomenin e krimit kibernetik është dhe teknologjia e përdorur. Nga ana e tyre, prodhuesit e programeve, pajisjeve etj., nuk informojnë rregullisht përdoruesin mbi mënyrën e funksionimit dhe për të qenë koherentë, të mbrojtur e të kujdesshëm.

Imagjinojmë një pirat informatik që kryen aktin e tij kriminal nga Kina, duke sulmuar një bankë në Zvicër dhe duke derdhur shumën e vjedhur të parave elektronikisht në Gjermani. Cili institucion gjyqësor dhe cili ligj do të ishte kompetent në këtë rast? Kina, vendi nga i cili autori kreu krimin, Zvicra, vendi ku ndodhet viktima, apo Gjermania vendi ku u realizua akti? Këto tre vende të ndryshme përsa i përket vendndodhjes, kulturës dhe praktikës juridike dhe perceptimit të termit të krimit, a do të mundën të bien dakord për ndjekjen dhe gjykimin e këtij akti? Përgjigjja është tek bashkëpunimi global, pasi asnjë shtet i vetëm nuk do të kishte sukses.

Në operacionet bankare që kryhen në rrjet, siç është dhe rasti i *e-banking*, i cili po fillon të praktikohet dhe në Shqipëri, përdoruesi është i cenueshëm, pavarësisht nga forca dhe algoritmet e përdorura në *software*-t koduese të bankës.

Ka dhe një aspekt tepër të rëndësishëm që duhet theksuar: *krimi kibernetik do të kërkojë të godasë viktimën më të pambrojtur, më të papërgatitur, pra shënjestrën më të lehtë për të.* Nëse marrim në konsideratë organizmin e bankës më vete dhe faktin e *software*-ve shumë të sofistikuara, përvoja në fushën e krimit kibernetik ka treguar se mbi 70% e sulmeve kanë zanafillë të brendshme. Në këtë aspekt, kompleksiteti teknologjik nuk ndihmon shumë dhe se është struktura menaxhuese e bankës që merr një rëndësi të veçantë.

Krimi kibernetik është një fenomen kompleks global dhe e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë do të ishte një mënyrë globale e trajtimit të problemit. Për këtë duhet një bashkëpunim i gjithë ekspertëve të fushave të sipërpërmendura për të shmangur zgjidhjet segmentare.

Vendi ynë dhe veçanërisht forcat e armatosura janë duke ndjekur zhvillimet e fundit dhe vëmendjen e shtuar të NATO-s për sigurinë në hapësirën kibernetike, të cilët po punojnë, trajnohen dhe po përditësohen me këto kërcënime të reja. Por kjo nuk mjafton pasi fusha e veprimtarisë është shumë më e gjerë dhe përfshin ekonominë, rendin, financat, drejtësinë etj. Si përfundim, gjykoj se rreziku nga sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore është permanent, pasi edhe vendi ynë është futur në rrjetin global të komunikimit në shumë fusha. Për të fituar këtë sfidë të re duhet të punohet në krijimin e mekanizmave parandalues, përgatitjen e personelit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me qëllim të parandalimit të sulmeve në hapësirën kibernetike, e cila në Shqipëri është në hapat e para por me tendencë rritjeje të shpejtë.

Deri në fund të vitit 2019, u duk sikur ky ishte kulmi dhe dimensionimi më i lartë i luftës, i cili u quajt edhe dimensionimi i 5-të, ai i “luftës kundër (V) në hapësirës kibernetike”, si një realitet fiction apo fantastiko-shkencor. Në momentin që sulmet kibernetike godasin objektivat civile, me qëllim arritjen e objektivave të tyre politikë duke përhapur frikë dhe tmerre, atëherë ky plotëson kushtet e të qenit terrorist. *Një tjetër kërcënim merr formë gjatë një sulmi kibernetik kundër sistemeve të informacionit sensitiv kombëtar, duke i vjedhur, manipuluar apo shkatërruar ato. Kjo është veprimtari spiunazhi që kryesisht është drejtuar nga shërbime inteligjente armiqësore me NATO-n kundër njërës apo disa shteteve të aleancës.*

Modernizimi i teknologjisë përveç të tjerave ka ndryshuar edhe mënyrën e të bërit spiunazh ushtarak. Sot nuk është nevojë të hapësh kasaforta për të futur në dorë planet, strategjitë apo sekretet e tjera të një ushtrie kundërshtarë, por mjafton një haker i trajnuar që nga një shtet tjetër, pa asnjë kontakt fizik me dokumentet sensitive, t’i marrë, manipulojë, ndryshojë dhe përdorë këto të dhëna disa herë edhe pa lënë gjurmë. *Veprimtaria kriminale dhe armiqësore që mund të ndërmerren aktorët shtetërorë kundërshtarë të NATO, kundër anëtarëve të aleancës, mund të klasifikohet edhe si veprimtari subversive, pasi minimi dhe humbja e besimit të publikut tek qeverisja dhe institucionet e saj të sigurisë, është një nga pasojat që sjell një sulm kibernetik. NATO nga ana e saj, është duke punuar për t’u aftësuar në përballimin ndaj këtij lloji të kërcënimit dhe konfliktit i cili mund të vijë nga shtete, organizatave kriminale, hakerë ose organizatave terroriste. Në përkufizimin që NATO bën për këtë kërcënim të ri, duke e propozuar për t’u përfshirë në artikullin 5, thuhet: *Lufta kibernetike është një lloj konflikti në të cilin një shtet ose një organizatë ndërkombëtare është përfshirë në aktivitete të cilat kanë synuar, sfiduar ose dëmtuar infrastrukturën teknologjike të një shteti tjetër*³⁴. NATO dëshiron të luajë një rol me të madh në përmirësimin e qëndrueshëm të shteteve anëtare*

³⁴ Bazuar në studimet e kompanisë ndërkombëtare të sigurisë McAfee, gjatë vitit 2016 dhe në vazhdim, numri i sulmeve kibernetike kundër shteteve apo kompanive multimiliardere është rritur.

duke investuar në zhvillimin e teknologjisë për t'iu përgjigjur teknologjisë përçarëse në fushën e mbrojtjes, adaptimin ndryshimeve klimatike dhe në mbrojtjen e rendit botëror bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

5. “Armët autonome” si pjesë e kërcënimit kibernetik

Si kërcënim dhe bekim njëkohësisht, inteligjenca artificiale po ofrohet nëpërmes hapësirës kibernetike. Lehtësitë në komunikim, në shkencë, teknologji, ekonomi, mbrojtje etj., tashmë janë të prekshme dhe quhen si “bekim” nga nëna e zhvillimit teknologjik shkencor në dekadat e fundit. Por nuk është i njëjti efekt i përdorimit të teknologjisë së avancuar dhe i inteligjencës artificial në fushën e mbrojtjes dhe instrumentet e konflikteve të armatosura.

Dronët vrasës inteligjentë dhe të pavarur janë instaluar tashmë në çdo arsenal ushtrie, prandaj industritë e mbrojtjes në vende të ndryshme të botës po punojnë intensivisht për ndërtimin e mjeteve robotike tokësore dhe nënujore, duke u përpjekur të mos mbeten prapa të njëri-tjetrit. Një nga gjërat që pranohet nga palët në luftë, është dallimi midis luftëtarëve dhe civilëve. Na shqetëson fakti që një armë robotike nuk do të jetë në gjendje të bëjë dallimin mes një fëmije që ka në dorë një akulllore dhe dikujt që mban armë. *Vendimi për të eliminuar një njeri nuk duhet t'i lihet asnjëherë asnjë kompjuteri.*

Ndërsa intelektualë të shquar dhe organizata të të drejtave të njeriut bëjnë vazhdimisht thirrje për ndalimin e plotë të të ashtuquajturve “robotë vrasës”, disa thonë se tashmë është tepër vonë, pasi procesi ka filluar dhe kjo është tashmë një garë. Vetëm 26 vende kërkojnë ndalimin me detyrim të përdorimit të armëve autonome dhe mirëpritën për këtë nga shoqëria civile. Më shumë se 230 organizata dhe 3000 persona civilë kanë nënshkruar një peticion kundër armëve të tilla³⁵. Gjermania aktualisht nuk e mbështet përhapjen e armëve të tilla dhe bashkë me Francën ajo ndjek një rrugë të mesme. Edhe informaticienët dhe shkencëtarët amerikanë thonë se ende mund të pengohet një skenar i tillë sepse gara apo ka filluar³⁶.

Sot të gjitha shtetet nëpërmjet kompanive inovative hedhin në hapësirë modele të ndryshme të mjeteve ajrore pa pilot me përmasa të ndryshme. Kjo prirje po bëhet tepër serioze, sikurse shihet të hyjnë robotë gjysmautonomë në industrinë dhe biznesin e makinave komerciale, kështu që edhe teknologjia ushtarake nuk është e ndryshme nga fushat e tjera. Një automjet i vogël robotik për të gjitha terrenet modifikohet me lehtësi për të mbajtur armë vdekjeprurëse³⁷. Prodhuesi i tij thotë se roboti do të jetë i aftë të dallojë miqtë nga armiqtë dhe

³⁵ Mes tyre edhe kreu i Teslas, dhe lider në fushën e inteligjencës artificiale, Elon Musk.

³⁶ Stuart Russell, shkencëtar i cili hulumton në këtë fushë prej 35 vitesh dhe kishte idenë për filmin “Slaughterbots”

³⁷ Ky automjet robotik është ndërtuar nga prodhuesi gjerman Rheinmetall i cili ka objektiv përveç zhvillimit teknologjik por edhe eliminimin e CO2 në produktet e saj deri në vitin 2035.

se do t'u bindet komandave të operatorëve njerëzorë³⁸.

Në botën e sotme të polarizuar, vendet e ndryshme kanë shqetësim për mundësinë e shtuar të një kundërshtari, i cili do të ishte në gjendje të ndërtonte teknologji që u jep atyre avantazh në konflikt. Ekspertët thonë se përparimet në robotikë dhe në nanoteknologji mund t'i zhvendosin konfliktet në të ardhmen edhe nën ujë, prandaj po bëhen kërkime të konsiderueshme në këtë drejtim. Bota drejtohet përherë e më tepër nga mjedisi ujor për burime natyrore; po ashtu po shqyrtohet mundësia për të operuar në një mjedis ujor; kjo thjeshtohet nga anijet autonome, të cilat kryejnë një sërë veprimesh. Londra kërkon që Marina Mbretërore Britanike të jetë në ballë të mendimit teknologjik, për të realizuar sigurinë dhe mbrojtjen e nevojshme për mbështetjen e interesave britanike. Në fillim të vitit 2021, rreth 126 themelues dhe drejtorë të më tepër se 100 kompanive robotike dhe të inteligjencës artificiale nga 28 vende të botës nënshkruan një letër të hapur, ku u bëhej thirrje qeverive që të marrnin masa për ndalimin e plotë të armëve autonome. Por ende nuk janë marrë masa në këtë drejtim.

Nëse një fuqi e madhe ushtarake ecën përpara me prodhimin armëve për inteligjencën artificiale, atëherë do të kemi një garë të pashmangshme globale për armë dhe fundi i kësaj trajektoreje teknologjike është i qartë, armët autonome do të shndërrohen në kallashnikovët e së ardhmes³⁹. Ka pasur shumë argumente pro dhe kundër armëve autonome, si për shembull zëvendësimi i ushtarëve me makineri që është për mirë, pasi do të thotë më pak viktima, por nga ana tjetër do të sillte më pak arsye për fillim luftërash”, shkruhet në letrën e institutit “E ardhmja e jetës”.

Nga ana tjetër, kundërshtarët e NATO-s me anë të Rusisë dhe Kinës po ecin pa u ndalur, pa transparencë, pa u kontrolluar dhe pa dhënë shpjegime lidhur më këto armë autonome robotikë vrasëse. *Ai që do të arrijë të jetë lider në sektorin e Inteligjencës Artificiale (IA) do të ketë mundësinë të dominojë botën. “Inteligjenca Artificiale është e ardhmja, jo vetëm për Rusinë, por për të gjithë qenien njerëzore. Kjo sjell mundësi të mëdha, por edhe kërcënime që janë shumë të vështira të parashikohen. Ai që do të bëhet lider në këtë sektor do të jetë sovrani i botës⁴⁰”.* Kjo deklaratë është ekuivalente me deklaratën e De Gol në 1947 për armët bërthamore “Nuk ka shtet të pavarur pa armë bërthamore”, duke bërë ekuivalent aktualisht edhe kërcënimin që këto dy armë paraqesin. *“Nëse do të ekzistonte një subjekt apo një komb në gjendje të dominonte sektorin e IA-së do të krijohet një monopol shumë i rrezikshëm”,*

³⁸ Grupe të të drejtave të njeriut, si “Human Rights Watch” kanë shprehur prej kohësh shqetësim lidhur me rrezikun e armëve robotike autonome.

³⁹ Paralajmërimi i Hawking dhe shkencëtarëve të tjerë me anë të një letre të hapur.

⁴⁰ Presidenti rus Vladimir Putin, gjatë një takimi të zhvilluar me studentët me rastin e fillimit të vitit shkollor, viti 2019.

shtoi Putin. “Nëse ne do të bëhemi lider në këtë sektor, do ta ndajmë këtë njohuri me të gjithë botën ashtu si bëjmë me teknologjinë bërthamore”, theksoi presidenti rus.

Megjithatë, deklaratat e Putinit duhet të vendosen edhe në kontekstin aktual që Rusia nuk ka arritur të vendoset mes kombeve, të cilat mund të konsiderohen aktualisht lider në këtë sektor, si Kina dhe SHBA-ja. Kina kohët e fundit ka publikuar një plan investimesh që shpreson të arrijë të drejtojë sektorin e Inteligjencës Artificiale deri në vitin 2030. Një prej liderëve në sektorin e teknologjive të reja, Elon Musk, e ka krahasuar aktivitetin e zhvillimit të Inteligjencës Artificiale me një “demon”. Përfitimet që vijnë në shumë fusha, nga sektori industrial deri tek ai shëndetësor, vihen në rrezik nga aplikimi në fushën e armëve autonome, për të cilat Musk bashkë me 100 ekspertë të tjerë të robotikës dhe IA-së i kanë kërkuar OKB-së ta ndalojë këtë zhvillim në fushën e armatimit.

6. Kërcënimi më ri i (3V) nga virusi SAR COV-2

Sot bota është e mbërthyer nga virusi SARS COV-2, pandemia e shekullit 21-të, e cila nuk parashikohet të largohet edhe për vitin 2022. Edhe ushtritë më të mëdha të botës po e quajnë këtë virus si cenes të sigurisë kombëtare të vendit. Në këtë fillim viti ushtria amerikane merr urdhër të vaksinohen të gjithë: ushtarë aktivë, rezervistë dhe kadetë me vaksinën e tretë dhe kush nuk pranon do të largohet nga radhët e ushtrisë⁴¹. Në fillim të epidemisë meqë u shfaq për herë të parë në Wuhan të Kinës ai u quajt si “*Pneumonia Wuhan*” duke ndjekur emërtimet e pandemive të tjera të identifikuar me vendndodhjen gjeografike të epidemisë. Kështu ishin emërtuar më parë “gripi spanjoll”, “Sindroma respiratore e lindjes së mesme” dhe “Virusi Zika. Më 11 janar 2020, WHO⁴² vendosi emërtimin zyrtar COVID-19⁴³, duke mos përdorur emërtimin gjeografik, pas ankesave të Kinës për të mos u etiketuar si fillesa e kësaj pandemie.

A ka ndryshuar mjedisi i sigurisë dhe a është (Virusi Corona) një kërcënim i ri asimetrik? A ka ngjashmëri lufta asimetrike në dimensionin më të ri, atë biologjik? A është bioterrorizmi një “bioluftë⁴⁴” apo lufta e re e cila do të zhvillohet në dimensionin e 6-të të saj⁴⁵?

Në komunitetin e inteligjencës së NATO-s, MEDINT (*medical intelligence*)

⁴¹ Sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd Austin, në letrën dërguar 7 guvernatorëve më dt. 2 shkurt 2022, riafirmoi nevojën e vaksinimit të të gjithë ushtrisë amerikane dhe gardës kombëtare ose në të kundërt, do të lirohen nga shërbimi.

⁴² World Health Organization (Organizata Botërore e Shëndetësisë).

⁴³ Corona Virus disease 19- sëmundja e shkaktuar nga virusi korona zbuluar në vitin 2019.

⁴⁴ Lufta biologjike është lufta e bazuar në përdorimin e agjentëve biologjikë bakterë, viruse dhe mikrobe, për të dëmtuar jetën e njerëzve dhe kafshëve në betejë.

⁴⁵ Pesë dimensionet e luftës tashmë janë pranuar si tokësore, detare, ajrore, hapësinore dhe kibernetike.

është njëra nga agjencitë e zbulimit e cila megjithëse është më pak e njohur deri në kohën kur shpërthen një epidemi apo sëmundje tjetër infektive⁴⁶. MEDINT është disiplinë zbulimi e cila kërkon, zbulon dhe informon departamentin e mbrojtjes për arritjes e shkencës dhe kërkimeve biologjike të rrezikshme të armikut; si dhe informacionin mjedisor, i cili ka interes në planifikimin strategjik dhe mjekësor operacional ushtarak. Ky informacion i përgatitur nga MEDINT ka qëllim mbrojtjen e jetës së popullatës dhe kafshëve, të forcave dhe formacioneve luftuese të aleancës; si dhe përgatit vlerësime lidhur me kapacitetet biologjike dëmtuese kërkimore shkencore dhe mjekësore të kundërshtarit, si në aspektin civil ashtu edhe në atë ushtarak.

Përcaktimi i NATO-s për MEDINT i referohet vlerësimeve të kapaciteteve mjekësore të një shteti kundërshtar dhe me qëndrim armiqësor ndaj aleancës. Ky vlerësim përfshin (strukturën dhe infrastrukturën); analizat dinamike shëndetësore në vazhdimësi, mundësitë e shpërthimit të mundshëm të sëmundjeve, epidemive dhe pandemive si dhe mundësitë që një shtet kundërshtar i aleancës ka për të zhvilluar armë biologjike. *Qëllimi është që duke informuar në kohë leadershipin ushtarak dhe politik, të merren masa mjekësore parandaluese ndaj pasojave të armëve biologjike, epidemive, sëmundjeve etj.*

Përveç komunitetit të zbulimit në SHBA ka edhe një sistem kompleks të grumbullimit të informacionit lidhur me shëndetin dhe kujdesin mjekësor të bashkuara këto në qendrën e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve⁴⁷. *Në vitin 2018 është publikuar nga OBSH⁴⁸ edhe një listë e sëmundjeve të rrezikshme, duke përfshirë “sëmundjen x”, e cila paraqiste të dhëna të mjaftueshme për një epidemi botërore e shkaktuar nga një patogjen, aktualisht i panjohuri i cili, nëse nuk parandalohet në kohë, do të shkaktojë shumë viktima njerëzore.*

Në përkufizimin e luftës së re që po përballemi prej 2 vitesh, deri tani mungojnë palët në konflikt, pasi (V) i Covid 19 është ende pa posedues dhe armë në duart e të panjohurës. Duke qenë se së paku deri tani ka vepruar në të gjithë botën, duke mos kursyer asnjë shtet (të paktën kjo dihet deri tani) kjo “luftë e re” ngjan me konfliktin bërthamor ku si rezultat i përdorimit të ADM-së nuk ka të fituar pavarësisht palës që i përdor. Mendoj që shumë tipare

⁴⁶ MEDINT - Inteligjenca mjekësore, si pjesë e J2, përkufizohet bashkë me Inteligjencën njerëzore HUMINT, Sinjalore SIGINT, Imazhore IMINT, OSINT etj., si një kategori zbulimi e cila merret me grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe interpretimin ndaj sistemit të mjekësor shëndetësor të kundërshtarit.

⁴⁷ Ky sistem është i përbërë në rreth 100 sisteme vëzhgimi dhe hetimi të shëndetit, përfshirë këtu grumbullimin e informacionit nga zyra lokale për sëmundjet veçanërisht të rëndësishme të tilla si antrax, kolera, e bola dhe nga viti 2020, COVID 19

⁴⁸ World Health Organization është organizata lider në rrjetin ndërkombëtar të sistemit të vëzhgimit dhe investigimit të sëmundjeve dhe shëndetit botëror e cila e realizon misionin e saj nëpërmes rrjetit të kundërpërgjigjes dhe alarmit të përhapjes së epidemive.

dalluese të luftës asimetrike dhe veçanërisht të terrorizmit biologjik mbart edhe pandemia, e cila po vret njerëz, po bllokoi lëvizjen e lirë, shkatërron ekonominë, përhap panikun, rrit frikën dhe pasigurinë për jetën, si dhe ka gjunjësuar botën prej gati 2 vjet.

“Bota po ndryshon kështu që edhe NATO duhet të ndryshojë”⁴⁹ duke lënë të kuptohet kështu një adaptim të ri të NATO-s, në përshtatje të ambientit të ri të sigurisë të krijuar dhe të doktrinave dhe të strukturave të shteteve që e përbëjnë atë. *Duke studiuar llojet e terrorizmit, bioterrorizmi është formë e terrorizmit e cila përdor si armë agjentët biologjikë, viruse, baktere dhe mikrobe për arritjen e qëllimit të tij.* Përveç agjentëve (viruseve) biologjikë të zakonshëm shtete apo organizatat terroriste mund të modifikojnë dhe të ndërhyjnë në ndërtimi i tyre, me qëllim për t’i bërë ato më të rrezikshme dhe të pazbulueshme.

Shumica e agjentëve biologjikë gjenden në natyrë, por mund të prodhohen edhe në laboratorë duke bërë të mundur transmetimin nga personi në person, si dhe rritur kohën e shfaqjes së simptomave nga disa orë në disa ditë. Në këtë mënyrë, ndërhyrja me vonesë për t’u mbrojtur dhe kundërvepruar bëhet më e vështirë, ndërkohë që virusi (V) dhe vatra e infeksionit është zmadhuar në më shumë bartës dhe transmetues të sëmundjes vdekjeprurëse. Duke parë rolin dhe impaktin e zbulimit, posedimit dhe shpërndarjes së vaksinës anti-Covid 19 në paraqitjen ndërkombëtare të shteteve dhe aleancave, të duket e ngjashme me një armë apo instrument të fuqisë kombëtare që këto shtete posedojnë. *Siç edhe pritej shtetet e mëdha si SHBA, Kina, Rusia dhe Anglia ishin të parat që zbuluan këtë “kundër armë” të re dhe po e paraqesin atë me të drejtë, si element të fuqisë së tyre kombëtare.* Nuk besoj se rastësisht këto shtete janë edhe anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vetëm për faktin që zotërojnë edhe armë bërthamore si instrument dominues, frikësues, parandalues dhe balancues.

Nga fillimi i këtij shekulli është analizuar mjaftueshëm fuqia kombëtare me elementet, instrumentet dhe burimet e fuqisë kombëtare, por askush nuk ka parashikuar dhe përmendur më parë fuqinë e “kundër armës” fituese ndaj një (V) virusi pandemie botërore. Vaksina si instrument apo “armë e re”, mbart në vetvete të gjithë elementet e instrumentit të fuqisë kombëtare të aktorëve shtetërorë që e zotërojnë. Këto instrumente janë kryesisht elementë të fuqisë së ashpër siç janë siguria e jetës së qytetarëve dhe ajo ekonomike, pasi ndikimi në rënien dhe ringritjen e botës së gjunjësuar nga ky kërcënim botëror, varet prej më shumë se një viti prej shpikjes së “kundër armës”; “vaksinë”. Në vitin 2021 por edhe për 2022, gjithçka do të ketë të bëjë me vaksinat⁵⁰. Disa nga

⁴⁹ Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg më 23 tetor 2020 e deklaroi hapësirën si një fushë operacionale për NATO-n.

⁵⁰ Në fillim të 2021, Ministri i Jashtëm i Kinës, Wang Yi, ndërmori një tour vizitash në 9 vende në Afrikë dhe Azinë Juglindore, duke ofruar vaksina por edhe investime për aleatët e ardhshëm.

klientët e Kinës janë të parashikueshëm pasi bëhet fjalë për aleatë në politikë si Pakistani (22 milion doza) apo partnerë tregtarë në lulëzim si Turqia (50 milion doza)⁵¹. Rusët nuk mbeten pas në këtë lojë të madhe që po luhet me fuqinë e vaksinës. Me emrin patriotik Sputnik V, Putini ka në dispozicion një vaksinë më të mirë, që ashtu siç e tregojnë sondazhet është më e besueshme ndërkombëtarisht⁵². Edhe BE e dëshpëruar nga procesi i ngadaltë i vaksinimit – vetëm 5 përqind në krahasim me 24 përqind në Britani- u paraqit e gatshme të anashkalojë shtypjen që Putini i ka bërë së fundmi opozitës, kërcënimit të Ukrainës etj., në këmbim të vaksinës Sputnik.

Diskutohet shpesh se ndikimi në rritje i Pekinit në botë vjen deri te fuqia e fortë: tregimi i muskujve ekonomikë dhe potenciali ushtarak. Edhe pse Serbia aktualisht është në procesin e hapjes dhe përmbushjes së kapitujve për anëtarësim në BE, ajo vazhdimisht ka ndjekur një politikë të jashtme shumëdrejtimëshe, tradicionalisht përmes raporteve të afërta me Rusinë, ndërkaq në vitet e fundit duke thëlluar bashkëpunimin me Kinën. Në kuadrin gjeopolitik, këto marrëdhënie janë përdorur edhe si levë balancimi ndaj Perëndimit, sidomos përballë procesit të integritimit në BE. Këto marrëdhënie janë thëlluar gjatë procesit të pajisjes me vaksina, si pasojë duke e vendosur Serbinë në majë të listës së shteteve me vaksinimin më të lartë gjatë 2021. Në plan më të gjerë, pandemia që në fillimet e saj ka ndikuar duke e thëlluar raportin Serbi-Kinë, pasi edhe në fazën e parë të shpërndarjes së virusit kishte bashkëpunim të vazhdueshëm për teste dhe pajisje mjekësore mbrojtëse. *Fuqia diplomatike e vaksinave të Kinës gjithashtu i ka mundësuar edhe Serbisë të jetë më ambicioze në rrafshin rajonal*. Vaksina si instrument apo armë e re, mbart në vetvete të gjithë elementet e fuqisë kombëtare të aktorëve shtetërorë që e zotërojnë. Këto instrumente janë kryesisht elementë të “fuqisë së ashpër” siç janë siguria e jetës së qytetarëve dhe ajo ekonomikë, pasi ndikimi në rënien dhe ringritjen e botës së gjunjëzuar nga ky kërcënim botëror, varet prej më shumë se një viti prej shpikjes së “kundërrmës”; vaksinës dhe ka të ngjarë të na shoqërojë edhe për vitin 2022- 2023, i cili ka filluar me të njëjtin nivel infektimi dhe mutacioni.

7. Terroristi klasik, luftëtari elektronik dhe terroristi biologjik - ngjashmëritë dhe dallimi

Një organizatë apo një luftëtar terrorist deri tani është identifikuar me disa tipare që e dallojnë nga një luftëtar tradicional. Terroristi tipik operonte i padukshëm, i padallueshëm, pa tipare të kapshme nga shqisat e thjeshta. Në një ambient të zakonshëm ai (terroristi) shkrihej me turmën, nuk mbante

⁵¹ Moskë pretendon se deri tani 50 vende të botës kanë porositur rreth 1.2 miliardë doza (ky është me siguri një ekzagjerim).

⁵² Një studim i botuar në “The Lancet” zbuloi se Sputnik V është 91 për qind efikase ose po aq e mirë sa Pzifer me një efikasitet 95 përqind.

uniformë dhe shenja dalluese si luftëtarët tradicionale, që ne ishëm mësuar të identifikonim deri atëherë. *Terroristi apo “luftëtari asimetrik”⁵³ mund të ndodhet “kudo” dhe “askund” në të njëjtën kohë. i ngjashëm paraqitet sot edhe “terroristi biologjik” një mbartës apo posedues i virusit corona, i cili duke u shfaqur “kudo” por edhe “askund” shton pasigurinë, ankthin, stresin dhe frikën, njëlloj sikur të jemi para një situatë kërcënimi terrorist tradicional. Një terrorist mund të jetë “kushdo” dhe “askush” pasi nuk kishte shenjë dalluese dhe nuk mbante armatim të dukshëm, por një armë të paidentifikueshme, që mund të shkaktonte shumë viktima.*

“Luftëtari elektronik” tashmë po zë një vend gjithnjë edhe më të rëndësishëm edhe në operacionet ushtarake. Komponentëve tokësorë, detarë dhe ajrorë i është shtuar edhe komponenti elektronik, pasi vitet e fundit luftërat nuk zhvillohen më si tradicionalisht, vetëm në tokë, det apo ajër, por edhe në hapësirën kibernetike. Ushtritë e NATO-s përfshirë vendin tonë por edhe kundërshtarë të aleancës, kanë rritur kapacitetet dhe kanë ndryshuar strukturat, duke i dhënë një vend gjithnjë e më të madh “Luftëtarëve Elektronikë”.

I ngjashëm është edhe një bartësi i (V) të covid-19, i cili nuk dallohet, nuk ka tipare apo cilësi që ta bëjnë të dallueshëm, por ai zotëron ose është vetë një armë e aftë të vrasë shumë persona nëpërmes infektimit, megjithëse ndoshta në shumicën e rasteve jo qëllimisht. Më e keqja është se, mund të ndodhë teorikisht dhe shkencërisht që një shtet, organizatë terroriste apo individ, mund të ruajë dhe përdorë për infektim, materialin biologjik të COVID në kushte laboratorike të përshtatshme, duke e kthyer atë në armë të mirëfilltë biologjike. Globalizmi, e drejta e lëvizjes dhe bota pa kufij, vlerësohet të jetë një nga lehtësirat e demokracisë që është keqpërdorur nga organizatat terroriste në të shkuarën dhe të tashmen për të kryer sulme dhe transferuar kërcënimin, në çdo cep të botës.

Në fushën e legjislacionit, të mbrojtjes, rendit publik dhe të inteligjencës, një i infektuar bartës i virusit (V) duhet të trajtohet si një armë biologjike e mundshme (e qëllimshme ose jo). Shembulli i SHBA ku ka një numër të madh institucionesh dhe një degë të veçantë që merret me MEDINT tregon se të gjitha vendet nuk duhet të bëjnë përjashtim për të nxjerrë mësim dhe adaptuar sistemet e sigurisë kombëtare.

Shënjestrat dhe viktimat e terrorizmit janë pikat nevralgjike të ekonomisë, sikurse dhe politikës, pasi kështu arrihet efekt dhe friksim maksimal i shoqërisë si dhe mosbesim të strukturat shtetërore dhe të sigurisë. *Qëllimi i çdo lufte, përfshirë edhe luftën asimetrike është nxjerrja jashtë luftimit e lidhshimit dhe dobësimit i infrastrukturës jetike të kundërshtarit. Zgjedhja e këtyre objektivave*

⁵³ Është “luftëtari” që përdor taktikat terroriste, të tilla si pengmarrjen, sulmet vetëvrasëse, sepse ai tenton të përdorë dhe përfshijë një grup më të vogël dhe më të dobët kundër një kundërshtari më të fortë.

ka për qëllim, lënien e kundërshtarit pa drejtim strategjik dhe pa burime të mjaftueshme logjistike për të përballuar luftën. Nuk do kishte shënjestër më të rëndësishme për një kundërshtar, p.sh., nxjerrja “jashtë luftimit”, qoftë për pak kohë e drejtues të lartë ushtarakë, që në mars të vitit të kaluar; apo e dhjetëra e qindra ushtarakëve në gjithë operacionet me aleancën; largimi nga Shtëpia e Bardhë e presidentit të SHBA për disa ditë; rrezikimi i jetës së kryeministrit të Britanisë së Madhe, si dhe mbyllja e shumë kompanive dhe korporatave duke shkaktuar rënie ekonomike në shkallë botërore.

Agjencitë e inteligjencës në luftën asimetrike dhe tradicionale, kanë rolin dhe detyrën parësore të informojnë dhe paralajmërojnë në kohë lidhshpër politik dhe ushtarak për kërcënimet dhe rreziqet që përballen jeta e qytetarëve të çdo vendi. Në kushtet e një pandemie, si pjesë e kërcënimeve bioterroriste kombëtare të çdo vendi, agjencitë kryesore të inteligjencës kanë për detyrë që duke përdorur burimet e tyre njerëzore, teknike dhe të tjera ligjore informative, të ndjekin dhe përcaktojnë, kush është mbartësi i (V), vendin nga ku është filluar zhvillimi i pandemisë, shkaktarët, qëllimet dhe personat mbartës të saj. A kanë paralajmëruar agjencitë e inteligjencës për një pandemi të mundshme që në fillim të 2022 ka arritur të merre jetën e mbi 5,6 milionë njerëzve dhe infektimin e mbi 400 milionë të tjerëve? Siç është publikuar deri tani, këto agjenci, kryesisht amerikane kanë paralajmëruar për kërcënimin që paraqet një pandemi e panjohur më parë, në bashkësinë e kërcënimeve dhe rreziqeve që do të përballen SHBA-të në të ardhmen. “Epidemia e zbuluar në Kinë në 2019, mund të kthehet në pandemi botërore dhe ka të ngjarë të shkaktoi një numër të madh vdekjesh, pasoja të rënda në ekonomi, zvogëlimin e rezervave botërore dhe rritjen e nevojës për ndërhyrje të Kombeve të Bashkuara për ndihmë dhe mbështetje⁵⁴”.

Sfida kryesore në kushtet e një lufte të mundshme biologjike do të jetë “Çfarë do të ndodhë në vijimësi”? Ekspertët virologë dhe ato të inteligjencës janë të shqetësuar nga mundësia laboratorike e ruajtjes së materialit biologjik të infektuar me COVID 19, në kushte optimale duke ruajtur virulencën e lartë për një kohë të gjatë. Nëse ky material biologjik i infektuar me COVID 19 do të zhvillohet shkencërisht nga shtete, grupe, organizata terroriste apo individë me qëllime kriminale, vlerësohet se COVID 19 do të përdorej dhe shërbente si material fillestar për një armë e mirëfilltë biologjike. Efektshmëria e saj do të zgajtej deri në daljen e vaksinës, por që ndërkohë do të kishte sjellë dëme të jashtëzakonshme. Kjo armë tashmë në duart e një aktori shtetëror ose joshtetëror, nuk do të kishte më objektiva rastësorë, por do t’i përzgjidhte ato në varësi dhe të qëllimit të përdoruesit.

⁵⁴ Raport për kongresin amerikan nga drejtori i sigurisë kombëtare të SHBA-së, Dan Coats, i publikuar në janar 2019.

Përfundime

1. Kërcënimi konvencional bashkë me atë hibrid rus është evident në botë, Evropë, Ballkan dhe Shqipëri. Parashikohet të jetë rrezik permanent në tendencë rritje edhe sipas vizionit “NATO 2022-2030”.
2. Veprimi i Moskës për njohjen e pavarësisë së Donetsc dhe Luhansk dhe mbështetjen nga brenda të separatistëve pro rusë, tregoi koston e lartë të luftës frontale, përballë të njëjtit rezultat me anë të instrumenteve hibride.
3. Lufta, kapacitetet dhe kërcënimet kibernetike janë prioritet për NATO-2030, pasi edhe kundërshtarët e saj i barazojnë “armët bërthamore” me “inteligjencën artificiale”.
4. Dronët vrasës dhe armët autonome po zëvendësojnë njeriun si vendimmarrës me hapa të shpejtë duke dhunuar të drejtat e njeriut në vendimmarrje dhe duke udhëtuar drejt paparashikueshmërisë.
5. Rivlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve (virus kibernetik, valë elektromagnetike) që përballen NATO, është një leksion që duhet të lexohet mirë nga institucionet e sigurisë dhe të nxirren mësimet e duhura për përballim.
6. COVID-19 në të gjithë botën por edhe në vendin tonë, nuk është thjesht një sëmundje. SHBA dhe shumica e vendeve perëndimore janë duke vlerësuar këtë virus si armë të mundshme biologjike.
7. Fokusimi më i ri për Inteligjencën Mjekësore MEDINT⁵⁵ pritet dhe duhet të ndryshojë peshën specifike të disiplinave të inteligjencës në të ardhmen e NATO-s.

Bibliografia

1. “The Times”, 20 korrik 2015.
2. Samiti i NATO-s, qershor 2021.
3. Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në takim me ministrat e mbrojtjes së Aleancës, 28 qershor 2017.
4. Ryan Maness & Benjamin Jensen, “Lufta kibernetike ka marrë një drejtim të ri”, Washington Post, 21 korrik 2020.
5. Mark M. Lowenthal, “Seventh Edition of Power of intelligence”.

⁵⁵ NATO deklaroi se MEDINT, disponon kapacitete të kufizuara dhe të përqendruara MEDINT, por në kushtet e krijuara do të duhet të përdorë asetet e vendeve anëtare veçmas, duke bërë më të domosdoshëm ngritjen dhe rritjen e këtyre kapaciteteve, përfshirë këtu edhe vendin tonë.

6. Deklaratë e NATO-s për sulmet kibernetike në hapësirën e Aleancës, 21. 2. 2019.
7. Leyla Moses-Ones, deklaratë në Konferencën “Politika e ShBA në Ballkanin Perëndimor”, 28 tetor 2021.
8. Dan Coat, “Ukraina poligon apo si epruvetë e eksperimenteve që Rusia bën lidhur me testimin e teknologjisë së re të luftës që mendon të përdorë”.
9. Defense Secretary, Lloyd Austin, letra dërguar 7 guvernatorëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 2 shkurt 2022.
10. “Corona Virus disease 19”, botuar në maj 2020.
11. MEDINT; ajmedp-3 allied joint medical doctrine for medical intelligence, version 2, august 2020.
12. World Health Organization, në rrjetin ndërkombëtar të sistemit të vëzhgimit dhe investigimit të sëmundjeve dhe shëndetit botëror, 15 shtator 2021.
13. Ian Stoltenberg, deklaratë për hapësirën kibernetike si një fushë operacionale për NATO-n, 23 tetor 2020.
14. Dan Coats, raport për kongresin amerikan nga drejtori i sigurisë kombëtare të SHBA-së, publikuar më 3 prill 2020.

NDRYSHIMET KLIMATIKE – NJË KËRCËNIM PËR SIGURINË DHE NDIKIMI I TYRE NË OPERACIONET USHTARAKE

Kolonel Msc. Irela Nebiaj
Shef Grupi në IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Kjo temë studimore trajton kuptimin e termit “mjedis i sigurisë” dhe qasjen ushtarake ndaj koncepteve të sigurisë mjedisore, me një fokus të veçantë në kuptimin e kërcënimeve të sigurisë të shfaqura nga ndryshimet klimatike. Në të përshkruhen shkurtimisht ndryshimet klimatike, lidhja me mjedisin e sigurisë dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike në operacionet e FA. Ndryshimi i klimës paraqet një kërcënim jotradicional për sigurinë dhe qytetërimin modern. Përveç kërcënimit jotradicional, ndikimet e ndryshimeve klimatike janë një “shumëzues i kërcënimeve”, të cilat ndikojnë në rritjen e problemeve të sigurisë. Në këtë drejtim, ndryshimi i klimës është një kërcënim në rritje për paqen e përgjithshme dhe sigurinë dhe, si i tillë, do të bëhet një çështje me rëndësi në rritje edhe për FA. Duke pasur parasysh faktin se rajoni ynë kufizohet nga disa zona më të prekshme ndaj ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit, mungesës së burimeve dhe rritjes së popullsisë, fenomeni i migrimit, sfidat ekonomike dhe çështjet ndërkuftare në rajon, së bashku me paqëndrueshmërinë politike, do ta bëjnë sistemin tonë të sigurisë më të cenueshëm se kurrë më parë.

Këto dukuri mund të kenë efekte edhe mbi vendin tonë dhe Forcat tona të Armatosura, në pikëpamje të pjesëmarrjes në programet e zhvillimit ekonomik, menaxhimit të krizave, si dhe në mënyrën se si kryen misionin e saj. FA mund të thirret më shpesh për të mbështetur autoritetet civile dhe për të ofruar ndihmë humanitare dhe lehtësim të fatkeqësive më të shpeshta dhe më intensive natyrore. Këto ndikime rritin frekuencën, shkallën dhe kompleksitetin e misioneve të ardhshme të mbrojtjes, duke kërkuar kosto më të

larta të mirëmbajtjes së pajisjeve ushtarake dhe duke ndikuar në efektivitetin e trupave dhe pajisjeve. Por, edhe aktivitetet ushtarake mund të ndikojnë në mjedis. Është e qartë se operacionet ushtarake gjatë kohës së luftës mund të shkaktojë dëme në shkallë të gjerë mjedisore. Por ushtritë ekzistojnë edhe në kohë paqeje, kështu që jeta e përditshme e ushtarake mund të përmbajë rreziqe ekologjike dhe FA duhet të bëjnë përpjekje për zgjidhje “më ekologjike”.

Çështjet kryesore, të cilat do të trajtohen në këtë shkrim janë: ndryshimet klimatike; ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi sigurinë dhe FA; rritja e rolit të FA; operacionet ushtarake dhe mjedisi, trajnimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor në FA; NATO dhe siguria e klimës dhe në fund disa përfundime dhe rekomandime.

Fjalët kyçe: ndryshimet klimatike, mjedisi, FA, NATO, paqe, emergjencë, epidemi, fatkeqësi natyrore.

"Ndryshimi i klimës është kërcënimi ekzistencial për njerëzimin. I pakontrolluar, ai do të pjekë në të vërtetë këtë planet. Kjo nuk është hiperbolë. Është realitet. Dhe ne kemi një detyrim moral."

Joe Biden, 28 janar 2021

Hyrje

Ndryshimet politike dhe strategjike që ndodhën pas Luftës së Ftohtë kanë ndikuar/ndryshuar në mënyrë dramatike mjedisin global të sigurisë. Bota e sotme është një vend shumë më i komplikuar se më parë, kanë ndryshuar karakteristikat e sistemit të botës sonë dhe ajo është bërë më e varur nga njerëzit. Përparimi i shkencës dhe zhvillimi i teknologjisë shkaktoi një numër sfidash serioze, rreziqesh dhe kërcënimesh për njerëzit dhe mjedisin e tyre. Nëse në të kaluarën kemi qenë në gjendje të flasim për një lidhje të drejtpërdrejtë midis rritjes ekonomike dhe riprodhimit të zgjeruar të ekonomive kombëtare, tani kemi një mori marrëdhëniesh komplekse midis mjedisit, ekonomisë, bujqësisë, konsumit të energjisë, emergjencave, strategjive të zhvillimit të vendeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. "Gjatë dy dekadave të fundit, bota ka përjetuar një periudhë ndryshimesh të rëndësishme në fushat politike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, të ndikuara ndjeshëm nga zhvillimet në teknologji. Bashkimi i disa tendencave politike, social-ekonomike dhe teknologjike është ripërcaktimi i kontekstit global të sigurisë që rezulton në kompleksitet, çrregullim dhe pasiguri që është bërë një normë e re"¹.

Disa vite më parë, siguria kombëtare ishte sinonim i mbrojtjes, por sot, siguria kombëtare ka një kuptim shumë më të gjerë sesa ushtarak. Arsyeja është fakti që kërcënimet moderne janë më së shumti asimetrike në natyrë, veçanërisht, në fazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të kërcënimeve, kur është e mundur të veprohet në mënyrë parandaluese, për të ndaluar krijimin e konflikteve dhe përshkallëzimin e krizës. Duke pasur parasysh faktin se vendet vazhdimisht tentojnë të përmbushin qëllimet e tyre politike, globale ose ekonomike me përdorimin e forcës, një spektër krejtësisht i ri ka shfaqur sfidat asimetrike jotradicionale për sigurinë dhe stabilitetin. Pavarësisht se si vendet i shohin sot interesat e tyre të sigurisë në realitetin e ri global, është e nevojshme që të rivlerësohen pyetjet dhe faktorët që mund të rrezikojnë stabilitetin dhe sigurinë.

¹ U.S. Joint Staff, "JOE 2035, The Joint Force in a Contested and Disordered World", 2016, p. ii.

Sot, në fokusin e sigurisë janë edhe çështje më shoqërore, siç janë: ndryshimet klimatike, çështjet mjedisore, epidemitë, emergjencat etj., të cilat janë bërë më të shpeshta dhe të gjithanshme, me pasoja më serioze për njerëzit, infrastrukturën dhe mjedisin. Ndryshimi i klimës paraqet një kërcënim jotradicional për sigurinë globale dhe qytetërimin modern. Varfëria, uria, sëmundjet, pakësimi i rezervave ujore, zjarret në pyje, stuhitë dhe përmytjet që po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe shkatërruese do të vazhdojnë të jenë problem serioz për pjesë të ndryshme të botës në zhvillim. Ato ndikojnë ndjeshëm në rritjen e vazhdueshme të tensionit në mjedisin e sigurisë globale.

Përveç kërcënimit jotradicional, ndikimet e ndryshimeve klimatike janë një “shumëzues i kërcënimeve”² që ndikojnë në rritjen e fluksit të refugjatëve dhe të migracionit dhe, madje, veprojnë si katalizator për përhapjen e sëmundjeve, duke shkaktuar ose përkeqësuar potencialisht pandemi vdekjeprurëse. Në fund të fundit, rritja e dukurive ekstreme të motit dhe fatkeqësitë e mëdha natyrore përforcojnë rrezikun e zhvendosjes së konsiderueshme të popullsisë, duke shkaktuar probleme të mëtejshme politike dhe ekonomike. Shumë shtete i shohin ndryshimet aktuale dhe të parashikuara të klimës si kontribuuese në shqetësimet gjeopolitike. Gjithashtu, ato kanë potencial për të rritur rivalitetin në lidhje me qasjet ndaj burimeve në rajone të veçanta. Ndikimet e kombinuara të mungesës së burimeve, të migrimeve masive dhe qeveritë e dobëta kanë gjasa të rritin potencialin për konflikt të armatosur ndërmjet shteteve që kërkojnë të mbrojnë ose të marrin burime jetike edhe brenda vetë shteteve. Dështimet e sigurisë dhe konflikti, zakonisht, dalin nga ndërveprimet e shumë faktorëve.

Qëllimi kryesor i Forcave të Armatosura (FA) është të ruajnë paqen dhe sigurinë kombëtare. Në këtë kontekst, “paqja” nuk nënkupton vetëm mospasjen/mungesën e luftës, por situatën e kushteve të qëndrueshme që sigurojnë minimumin për nevojat themelore të njerëzve. Në këtë drejtim, ndryshimi i klimës është një kërcënim në rritje, në mbarë botën, për paqen e përgjithshme dhe sigurinë dhe si e tillë, do të bëhet një çështje me rëndësi në rritje edhe për FA. Këto dukuri mund të kenë efekte edhe mbi vendin tonë dhe Forcat tona të Armatosura, në pikëpamje të pjesëmarrjes në programet e zhvillimit ekonomik ose të menaxhimit të krizave. Historia e kohëve të fundit në botë dhe në rajonin tonë ka ndryshuar qëndrimin në lidhje me konceptin që FA është vetëm për të luftuar dhe se siguria është ekskluzivisht një çështje paqeje dhe luftime. Pra, ndryshimet klimatike si një “shumëzues kërcënimi”³, përkeqësojnë presionin ekzistues, duke u bërë kërcënim për paqen dhe sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe duke paraqitur sfida të reja për sigurinë.

² Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Brussels 14 June 2021.

³ Climate adaptation plan, Department of Defense, September 2021, faqe 3.

Forcat e Armatosura do të duhet të përshtaten me mjedisin në ndryshim dhe të marrin në konsideratë ndikimet e ndryshimeve klimatike në infrastrukturën dhe operacionet ushtarake. Ato gjithashtu mund të ndikohen nga kërkesat globale për të ndryshuar teknologjitë dhe për të zvogëluar emetimet e gazrave në atmosferë. Ndryshimi i klimës është një kërcënim i sigurisë së shekullit 21. Është një kërcënim për njerëzit e të gjitha klasave, kombeve, ideologjive politike, vendeve dhe më shqetësuesja, është e vështirë të parashikohet. Çështjet e vendosjes së forcave ushtarake në kushtet e ndryshuara klimatike dhe marrëdhëniet midis ndryshimeve klimatike dhe sigurisë ushtarake janë fushat që ende nuk janë hulumtuar me hollësi.

1. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në FA

Ndryshimi i klimës po ndodh në një shkallë të përsheptuar, aq sa nuk mund të kuptohen mjaftueshëm efektet në operacionet ushtarake. Pra, a është e mundur që ndryshimi i klimës, qoftë në nivel ndërkombëtar apo në atë brenda vendit, do të ndikojë në operacionet ushtarake më shumë sesa është imagjinuar ndonjëherë? Nëse po, cilat janë ndikimet në FA? A do të jenë FA-të të afta të reagojnë në mënyrë efektive ndaj krizës? Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se mosnjohja e tendencave të ndryshimeve të klimës, ngre shqetësime serioze rreth kapacitetit të vendit për të mbrojtur sigurinë e tij dhe atë të aleatëve të saj.

Ndryshimet klimatike sot janë një fakt. Askush nuk mund të thotë se nuk ekzistojnë, ato nuk kanë një ndikim vetëm mbi popullatën, por edhe mbi FA, të cilat duhet të t'i marrin në konsideratë në planifikimin dhe trajnimin e tyre. Pra, është e qartë se ekziston një lidhje mes ndryshimit të klimës dhe sigurisë dhe për më tepër, kjo do të ketë lidhje edhe me FA. Në mjedisin e sotëm të sigurisë, kompleksiteti i elementeve mjedisore bashkëkohore dhe të ardhshme dhe aktivitetet e mëvonshme ushtarake të FA-ve, kanë një ndërveprim kompleks që lidhet me: ndryshimin e klimës, lidhjen e tij me mjedisin e sigurisë dhe si do të ndikojë në operacionet e FA si pjesë e menaxhimit të përgjithshëm të krizës.

Mjedisi bashkëkohor i sigurisë është një kompleks faktorësh dhe ndikohet shumë nga regjimet politike, ndryshimet klimatike, rritja e popullsisë, globalizimi dhe industrializimi. Efektet e parashikuara të ndryshimeve klimatike gjatë dekadave të ardhshme mund të përfshijnë ngjarje ekstreme të motit, thatësi, zjarre, përmbytje, shkrirje të akullnajave, rritje të nivelit të detit, emigrim masiv, ndryshime vendbanimesh dhe përhapjen në rritje të sëmundjeve kërcënuese për jetën. Këto kushte kanë potencial për të përkeqësuar mënyrën tonë të jetesës dhe na detyrojnë marrjen e masave për sigurinë tonë. Vlen të përmendet se, nëse ndryshimi i klimës nuk është arsyeja kryesore për t'u shqetësuar për sigurinë, ai vepron si një kërcënues i

shumëfishuar për paqëndrueshmëri. Pra, mjedisi i sigurisë do të vazhdojë të jetë kompleks dhe pjesërisht i paparashikueshëm.

Nga ana tjetër, intuïta, planet afatgjata e largpamëse dhe mësimet e nxjerra janë me rëndësi jetike për FA-të, për të përshtatur dhe përmirësuar kapacitetet ekzistuese ose zhvilluar kapacitete të reja, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë sfidat e reja me të cilat do të ballafaqohet mjedisi aktual apo i ardhshëm i sigurisë. Forcat e Armatosura duhet të jenë të shqetësuara për ndryshimin e klimës, sepse është misioni i tyre për të adresuar të gjitha kërcënimet e besueshme për sigurinë e vendit të tyre. Këto kërcënime vijnë në forma të drejtpërdrejta e të tërthorta, duke përfshirë kërcënime të drejtpërdrejta për infrastrukturën ushtarake, nga rritja e nivelit të lumenjve dhe thatësira ekstreme dhe kërcënime indirekte, nëpërmjet përkeqësimit të paqëndrueshmërisë në rajonet kritike.

Megjithëse fatkeqësitë natyrore nuk janë burimi i vetëm i konfliktit apo i paqëndrueshmërisë, ato mund të shkaktojnë e përkeqësojnë kriza komplekse. Fatkeqësitë natyrore do të kenë ndikim më të madh, pjesërisht, për shkak të rritjes së frekuencës dhe ashpërsisë së ngjarjeve ekstreme të motit, por edhe për shkak të ndryshimeve të motit në zonat dhe kohët e vitit ku këto ngjarje mund të ndodhin, si dhe rritjes së madhësisë së popullatave të ekspozuara. Në këtë mënyrë, FA mund të kërkohen jo vetëm për të siguruar ndihma humanitare për lehtësimin e katastrofave, por edhe për të planifikuar dhe për të kryer të gjithë spektrin e operacioneve të përshkruara në doktrinën e NATO-s AJP 3.4.3.⁴ Një fatkeqësi në shkallë të gjerë, e shkakuar nga mjedisi brenda një kombi të NATO-s, është gjithnjë e më e mundshme që të kërkojë një përdorim të madh të FA në operacionet e ndihmave. Pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e FA në reagimin ndaj fatkeqësive, për të ndihmuar autoritetet civile, do të ketë një efekt pasues në trajnimin ushtarak, gatishmërinë dhe disponueshmërinë e forcave dhe mjeteve.

Në vitin 2007, Bordi Ushtarak Këshillues i CNA nxori një raport të titulluar “Siguria Kombëtare dhe Kërcënimi i Ndryshimeve Klimatike”, në të cilin autorët argumentuan se “ndryshimi i klimës mund të rritë shanset e konfliktit dhe të prekë sistemet e armëve, platformat, bazat dhe operacionet ushtarake”⁵. Ndërsa në një botim special *Journal MCU*, “*Climate Change and Policy*”, 2016, publikuar nga *Marine Corps University Press*, theksohet se “ne duhet të përballemi me sfidat e ardhshme nga ndryshimet klimatike për operacionet ushtarake në tre kategori: operacione, kapacitete dhe (posture) qëndrimi/ pozicionimi. Operacionet janë aktivitetet që Forcat e Armatosura kryejnë për të përmbushur misionet e tyre. Kapacitetet janë burimet dhe asetet e nevojshme

⁴ Allied Joint Publication (AJP)-3.4.3(A): Allied Joint Doctrine for the Military Contribution to Humanitarian Assistance, 2017.

⁵ Journal MCU, Climate Change an policy 2016, Impact of Climate Change on U.S. Military Operations in the Western Pacific, published by Marine Corps University Press 2017, faqe 99.

për të kryer këto operacione. Qëndrimi/pozicionimi i referohet strukturës së forcës, pozicionimit gjeografik, qasjes ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të rëndësishme për kryerjen e këtyre operacioneve”⁶.

Ndryshimi i klimës mund të ketë ndikim në tre elemente të efektivitetit ushtarak: gatishmërinë, operacionet dhe strategjinë.

Gatishmëria: Gatishmëria i referohet aftësisë së FA-ve për të kryer operacionet në kohën e duhur. Ndryshimi i klimës mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në gatishmërinë ushtarake, duke ndikuar në infrastrukturën dhe operacionet ushtarake në disa mënyra që përfshijnë: disponueshmërinë e tokës dhe të hapësirave, zvogëlimin e furnizimit me ujë, përmbytjet e mëdha, rreziqet nga zjarri dhe rreziqet nga moti për furnizimin me energji elektrike etj. Instalimet pranë brigjeve mund të kërcënohen nga erozioni bregdetar dhe rritja e nivelit të detit, duke dëmtuar infrastrukturën dhe duke reduktuar tokën në dispozicion për operacione. Valët e intensifikuara të nxehtësisë apo të të ftohtit do të paraqesin sfida për stërvitjen në terren dhe efikasitetin e trupave.

Ndryshimi i klimës, gjithashtu, mund të ndikojë në zinxhirin e furnizimeve ushtarake, mënyrën e transportit dhe të ruajtjes së tyre. Vështirësia e qasjes në burimet kryesore, infrastruktura e dëmtuar dhe migrimi masiv paraqesin sfida për të siguruar stabilitetin e rajoneve jashtë vendit, duke krijuar mjedise të përshtatshme për veprimtarinë terroriste. Shumica e vendeve tashmë e njohin kërcënimin e ndryshimit të klimës në infrastrukturën e tyre ushtarake dhe theksojnë nevojën për më shumë burime dhe sisteme monitorimi për të rritur gatishmërinë.

Operacionet: Ndryshimet e klimës ndikojnë në operacionet ushtarake, qofshin ato operacione luftarake apo misione humanitare. Për shembull, ndryshimi i klimës mund të shkaktojë vështirësi të konsiderueshme në zinxhirin e furnizimit dhe kapacitetin logjistik të FA, të angazhuara në fushën e luftimit. “Disa operacione duhet të shtyhen ose të anulohen si në luftën e Irakut, ku, për shkak të stuhive të rërës, jeta e pajisjeve teknike u zvogëlua dhe kostot e riparimit u rritën ndjeshëm. Stuhitë e rërës bënë që transporti i rezervave të ishte më i vështirë, gjë që rrezikonte kryesisht furnizimin me lëndë djegëse. Në një luftë ku nëntë milion litra karburant u zhvendosën në teatrin e luftës çdo ditë, çdo anomali moti ka rrezikuar ose rrezikon suksesin e operacioneve”⁷.

Thatësira ekstreme ose përmbytjet në zonat ku FA-të janë të angazhuar në operacione luftarake, mund të dëmtojnë linjat e furnizimit me ujë dhe kështu të kërcënojnë trupat ushtarake. Ajo gjithashtu mund të rritë gjasat për aktorët

⁶ Po aty.

⁷ National Security and the Threat of Climate Change pdf SecurityandClimate.cna.org, Direct Impacts on Military Systems, Infrastructure, and Operations 2007, faqe 37. https://www.cna.org/cna_files/pdf/national%20security%20and%20the%20threat%20of%20climate%20change.pdf.

joshtetërorë që mund të përdorin burimet e ujit si mjete kundër popullatave dhe kundërshtarëve. Një rritje në frekuencën dhe intensitetin e fatkeqësive natyrore mund t'i sforcojë kapacitetet e FA për të ofruar ndihmë humanitare dhe lehtësimin e fatkeqësive. Mjedisi i ardhshëm i sigurisë dhe kushtet operationale të formuara nga ndryshimet klimatike mund të ndikojnë më shumë në operationet detare në të gjitha nivelet - strategjike, operationale dhe taktike duke e vënë theksin në zonat detare, në operationet, në mbrojtjen e bazave dhe të instalimeve bregdetare. Pajisjet detare duhet të jenë të rëndësishme për misionet e ndihmës për emergjenca të nxitura nga klima.

Strategjia: Ndryshimi i klimës mund të ndikojë në strategjinë ushtarake duke rritur mundësinë e paqëndrueshmërisë së kushteve në rajonet e rëndësishme strategjike. Në nivelin strategjik, do të duhet të rishikohen interesat strategjike dhe llojet e misionit në pikëpamje të ndryshimit të gjeopolitikës, dinamikës së sigurisë energjetike, kufizimeve të mundshme të emetimeve të gazrave në të ardhmen, kushteve operationale, ndryshimeve në biosistemet detare dhe rritjes së lehtësimit, si dhe në angazhimet humanitare që formohen nga ndryshimet klimatike. Sigurimi i linjave të komunikimit - një faktor i rëndësishëm misionesh - do të paraqesë dimensione më të reja.

Shkrirja e akullit në Arktik mund të shoqërohet me tensionet në rritje midis Rusisë dhe kombeve të tjera të Arktikut, duke rritur gjasat e konfliktit. Në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut, efektet e ndryshimeve klimatike në sigurinë e ujit mund të rritin probabilitetin e paqëndrueshmërisë në të ardhmen. Në Azinë Qendrore, rritjet në shkrirjen akullit dhe përmytjet, së bashku me dinamikën ekzistuese të sigurisë (si terrorizmi dhe përhapja e materialeve bërthamore) mund të krijojnë një përzierje të paqëndrueshme. Në rajonin më të gjerë të Azi-Paqësorit, ndryshueshmëria e reshjeve do të ndërveprojë me një popullsi në rritje urbane dhe bregdetare, si dhe një kërkesë në rritje për energji, duke paraqitur sfida të mëdha për sigurinë në këtë pjesë gjithnjë e më të rëndësishme të botës.

Të gjitha këto rreziqe mund të rritin gjasat që FA-të të thirren për të zgjidhur konfliktet ose të japin ndihmë pas konfliktit, dinamika të cilat do të kërkonin strategji, aftësi e profesionalizëm nga ato. Misionet humanitare, ndryshimet ekstreme të motit dhe kufizimet e mundshme të emetimit të ardhshëm kërkojnë strukturën e përshtatshme të forcave dhe planifikimin e operationeve, duke parashikuar skenarët e ardhshëm, ndërkohë që balancojnë kërkesat e tanishme strategjike dhe operationale.

2. Ndryshimet klimatike dhe rritja e rolit të FA

Raporti i Vlerësimit 2021⁸ i Panelit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara

⁸ Report of International Nations Panel on Climate Change (IPCC), 2021, kapitulli I, faqe 51.

për Ndryshimet Klimatike (IPCC) thekson se, referuar trendit të ngrohjes afatgjatë që nga kohët para industriale, vëzhgimi i temperaturës mesatare të sipërfaqes (GMST) për dekadën 2006-2017 ishte 0.87°C (me gjasë midis 0.75°C dhe 0.99°C) më e lartë se mesatarja mbi periudhën 1850-1900⁹. Ngrohja globale e parashikuar po rritet aktualisht në 0.2°C (me gjasë midis 0.1°C dhe 0.3°C) për dekadë për shkak të emetimeve të kaluara dhe të vazhdueshme. Efektet e ndryshimeve klimatike mund të kenë rezultate të dobishme ose të pafavorshme për jetesën, shëndetin dhe mirëqenien, ekosistemet dhe speciet, shërbimet, infrastrukturën dhe asetet ekonomike, sociale dhe kulturore. Ndryshimi i klimës ndikon seriozisht dhe në mënyrë joproporcionale në jetët dhe mjetet e jetesës së njerëzve në vendet në zhvillim, duke rritur cenueshmërinë ndaj varfërisë dhe privimit shoqëror. Ndikimi i tij rritet nga burimet e kufizuara njerëzore, institucionale dhe financiare. Siç e kemi parë tashmë, efektet e ndryshimeve klimatike janë të njohura dhe së shpejti, mund të ndodhë një rritje e problemeve në lidhje me sigurinë dhe fatkeqësitë - veçanërisht konfliktet e migracionit dhe “luftërat e burimeve”. Prandaj, nëse pasojat e ndryshimit të klimës rriten, do të kemi kriza humanitare të reja dhe akute që mund të çojnë në paqëndrueshmëri rajonale, veçanërisht, më shumë konflikte jo vetëm midis kombeve dhe shteteve, por edhe brenda shteteve.

Kjo do të thotë që do të nevojiten operacionet e mbështetjes së paqes për stabilizimin në rajone të veçanta. Pra, jo vetëm që do të kemi “*Peace Keeping Operations*” dhe “*Peace Enforcement Operations*”, por si një sfidë për pasojat e ndryshimeve klimatike, ne gjithashtu do të duhet të përmbushim gjithnjë e më shumë Operacionet Humanitare. FA do të duhen të përqendrohen më shumë në detyrat e Deklaratës së Petersbergut¹⁰ të 19 qershorit 1992, Bon, Gjermani, në një rritje të përfshirjes në operacionet e ndihmave të mëdha të fatkeqësive. Ndërkohë që forcat ushtarake kanë rol në lehtësimin e katastrofave, ndikimi më i gjerë i ndryshimeve serioze të klimës do të kërkojë bashkëpunimin shumëkombësh dhe me shumë agjenci.

Por kjo, gjithashtu, do të thotë se ka një rol të ri për FA-të. Kjo do të kërkojë shtimin e llojeve të forcave që merren më shumë me Bashkëpunimin Civilo-Ushtarak (CIMIC), trajnime të specializuara, sidomos për operacionet e menaxhimit të fatkeqësive, ndërlidhjen dhe bashkëpunimin në operacionet humanitare si brenda dhe jashtë vendit. Sfida e re për FA është e qartë: më

⁹ Niveli aktual i ngrohjes globale është përcaktuar si mesatarja e një periudhe 30-vjeçare të përqendruar në 2017 duke supozuar se shkalla e fundit e ngrohjes vazhdon.

¹⁰ Detyrat e Petersberg janë një listë e prioriteteve ushtarake dhe të sigurisë të inkorporuar në Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian (riemëruar si Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) për Traktatin e Lisbonës). Ato janë formuluar si:

- Detyrat humanitare dhe të shpëtimit
- Detyrat paqeruajtëse

- Detyrat e forcave luftarake në menaxhimin e krizave, duke përfshirë edhe sigurimin e paqes

shumë operacionet humanitare kanë nevojë për trajnim më të specializuar në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat. Për të arritur këtë shkallë të lartë të ndërveprimit, është e nevojshme të dihet për sistemet e ndryshme dhe mundësitë e tyre të trajnimit.

Pasojat e ndryshimeve klimatike po ndryshojnë realitetet gjeostrategjike me implikime të rëndësishme të sigurisë dhe me pasojat e nevojshme për operacionet ushtarake dhe planifikimin. Ndikimi i ndryshimeve klimatike duhet të përfshihet në planifikimin ushtarak, edhe pse ato janë, në një farë mase, të panjohura dhe të ndërlikuara nga një afat kohor i pasigurt. Lidhur me këtë duhet të shtohen hulumtimet rreth ndikimeve mbi sigurinë. Por, përveç sfidave të reja për FA, duhet të përmirësohen më tej sistemet e trajnimit, të cilat janë të lidhura me Operacionet Humanitare. FA duhet të përshtatin trajnim, veçanërisht, për operacionet e ndihmave në raste fatkeqësish sipas OKB-së, BE-së dhe NATO-s. Forcat ushtarake duhet të përgatiten për këto misione të reja. Struktura e forcës, trajnimi dhe pajisjet duhet të vlerësohen përkundrejt këtyre sfidave të reja për paqen dhe sigurinë. Ndryshimi më i rëndësishëm që duhet të ndodhë është bashkëveprimi me vendet e rajonit për të zhvilluar plane dhe koordinuar përgjigjet ndaj fatkeqësive që do të vijnë, për të kufizuar ndikimet njerëzore të ndryshimeve klimatike.

FA do të duhet të zbatojnë një qasje më të fortë dhe më koherente në trajtimin e ndryshimeve klimatike. Më saktësisht, FA duhet të zhvillojnë kapacitetet e forcave për të menaxhuar krizat mjedisore të sigurisë; të përmirësojnë ndarjen e njohurive të ndërlidhura me ndryshimet klimatike; integrimin e çështjeve që lidhen me rrezikun e klimës në trajnimin dhe stërvitjet e tyre. FA kanë dëshmuar se mund të zotërojnë kërcënime tradicionale, por FA duhet të përmirësojnë dhe të përshtojnë përpjekjet e tanishme për të zhvilluar një strategji konkrete që u përgjigjet ndryshimeve klimatike si një shumëzues jotradicional i kërcënimeve e si një rrezik për sigurinë.

3. Operacionet ushtarake, ndryshimet e klimës dhe mjedisi

FA, përveçse duhet të përshtaten me ndryshimet klimatike, duhet që vetë ato të ndikojnë pozitivisht në mjedisin ku kryejnë aktivitetin e tyre. Ndikimet mjedisore të operacioneve ushtarake janë duke u bërë faktor në planëzimin dhe zbatimin e operacioneve ushtarake. FA ka një vlerësim të ri për ndërvarësisë mes misioneve ushtarake, komunitetit dhe mjedisit. Shmangia e ndikimit negativ në mjedis duhet të përbëjë një përparësi për Forcat tona të Armatosura.

Operacionet ushtarake, nga natyra e tyre, nuk janë të favorshme për mjedisin. Misioni kryesor i FA-ve është të luftojë dhe të fitojë, por kjo është shkatërruese për njerëzit dhe për mjedisin natyror. Ndikimet mjedisore të veprimeve ushtarake mund të jenë të kufizuara e të menaxhuara deri në një farë mase.

Integrimi i konsideratave mjedisore në procesin e planëzimit ndihmon për të identifikuar, parandaluar dhe zbutur kërcënimet e mundshme në mjedis (përfshirë edhe ato që ndikojnë në burimet historike dhe kulturore) dhe kërcënimet e mjedisit ndaj trupave.

Veprimtaritë ushtarake ndikojnë në mjedis jo vetëm në kohë lufte (me efektet e menjëhershme dhe afatgjata), por edhe në kohë paqeje. FA kryejnë sot veprimtarinë e tyre si brenda dhe jashtë vendit dhe përfshijnë veprimtari/operacione që kryhen në tokë, ajër dhe det. Ndotja e ajrit, e tokës dhe e ujit në kohë paqeje bëhet nga veprimtaritë që përfshijnë prodhimin dhe testimin e teknikës, armatimet, qitjet me armët e këmbësorisë, trajnimet dhe stërvitjet, krijimin e bazave dhe instalimeve ushtarake, mirëmbajtjen për gatishmërinë, aksidentet e ndryshme gjatë stërvitjeve, përdorimin e lëndëve të ndryshme (helmuese, djegëse, imituese, tymuese, etj.), hedhjen e mbetjeve, derdhjen e naftës, vajit, etj., në tokë apo det, demontimin/asgjësimin e armatimeve dhe municioneve, shfrytëzimin e tokës, ujërave etj., të cilat krijojnë probleme për mjedisin. Pra, forcat e armatosura kanë një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit.

Trajnimet dhe stërvitjet ushtarake kërkojnë vende të përhershme ose të përkohshme, të cilat duhet të plotësojnë të gjitha kushtet dhe të jenë subjekt i mbrojtjes së mjedisit. Pjesa më e madhe e dëmtimeve të mjedisit ndodh në zonat lokale dhe nga përdorimi i mjeteve të rënda të transportit. Zhurmat e ndryshme krijojnë shqetësime për jetesën e njerëzve, të kafshëve apo të shpendëve të zonës ose ndotje të ndryshme. Zonat ushtarake të stërvitjeve duhet të ndërtohen në varësi të terrenit, popullsisë së zonës, si dhe përdorimit të sasisë së burimeve ushtarake. Operacionet ushtarake apo veprimtaritë e trajnimit paraqesin sfida të ndryshme, që janë të lidhura me mjedisin që na rrethon. Edhe pse kërkesat operacionale janë të larta, integrimi i konsideratave mjedisore në të gjitha aspektet e planëzimit operacional, trajnimit dhe zbatimit është thelbësor për ruajtjen e mjedisit, shëndetit dhe mirëqenies së vetë trupave dhe popullatës. Përveç kësaj, planëzimi i hershëm i konsideratave të mjedisit dhe menaxhimi i vazhdueshëm i rrezikut janë thelbësorë për parandalimin e dëmeve të pariparueshme në vendet me rëndësi natyrore, turistike, kulturore dhe historike, të cilat degradojnë ose ndërlikojnë arritjet e përgjithshme të objektivave të misionit të forcave.

Shumica e operacioneve ushtarake karakterizohet përgjithësisht nga faza të pranuarë e të ndryshme në kohëzgjatje, në varësi të natyrës së tyre, intensitetit, dhe kompleksitetit. Në terma më të plota, këto faza mund të përkufizohen: planëzimi, para-vendosja, vendosja, ri-pozicionimi dhe pas-vendosja, duke përfshirë edhe mësimet e nxjerra. Pasi është vendosur për të marrë pjesë në një operacion ushtarak, apo stërvitje/trajnim, konsideratat mjedisore duhet të

përfshihen në çdo fazë të procesit të planëzimit.

Për informacion të mirëbesueshëm në procesin e planëzimit mbi çështjet e mjedisit, rëndësi kanë mësimet e identifikuara apo të nxjerra nga operacionet e mëparshme. Përveç kësaj, informacioni mund të mblidhet nga një shumëllojshmëri e burimeve të tjera, duke përfshirë: të dhënat e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS); dokumentet ligjore (për marrëveshjet e brendshme e ndërkombëtare, ligjet për kontributin e trupave, ligjet e vendit pritës etj.); ndërveprimet me OJF-të, autoritetet e vendit pritës ose ekspertët të fushave, grupet e bashkëpunimit civilo-ushtarak (CIMIC) etj.; të dhëna nga burime të hapura në dispozicion në internet, gazeta, revista etj.; asetet e zbulimit/inteligjencës. Përvoja e operacioneve dhe stërvitjeve ka përforcuar rëndësinë e integritit të konsideratave mjedisore në procesin e planëzimit operacional.

4. Ndryshimet klimatike, trajnimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor në FA

Integrimi i konsideratave të ndryshimeve klimatike e mjedisore në procesin e trajnimit është shumë i ngjashëm me integrimin e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes së forcës. Trajnimi është çelësi për përmbushjen e misionit. Konsideratat e ndryshimeve klimatike e mjedisore duhet të përfshihen që në planëzimin dhe zbatimin e procesit të trajnimit. Për këtë qëllim, duhet të merren parasysh dhe të zbatohen konsideratat e ndryshimeve klimatike e mjedisore gjatë gjithë ciklit të trajnimeve, siç specifikohet në manualin FM 7-1 / FM 25-101.¹¹

Edukimi/trajnimi mbi ndryshimet e klimës dhe atë mjedisor jepen drejtpërdrejt në terren. Ushtarët janë padyshim të zënë me shumë detyra, por mund të jepen udhëzime të shpejta dhe të thjeshta trajnimi mjedisor për t'i ndihmuar ata. Specifikime të veçanta në terren duhet të zhvillohen dhe t'u jepen njësisve ku t'u tregohen llojet bimore dhe shtazore ose zonat kulturore në vendin e operacionit, për të edukuar trupat në lidhje me shqetësime të tilla. Udhëzues të veçantë dhe poster edukativë për shqetësimet kryesore të klimës mjedisore rreth procedurave të përshtatshme të mjedisit, duhet të jenë në dispozicion në këtë fushë. Përveç trajnimit të përgjithshëm të edukimit e ndërgjegjësimit klimaterik e mjedisor, është i nevojshëm edhe trajnim i specializuar, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara. Trajnimi i specializuar mund bëhet përmes mësimit të integruar apo materialeve shtesë, si pjesë e programeve të vazhdueshme të trajnimit në njësi.

Trajnimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi duhet të përfshihen në programet ekzistuese individuale dhe kolektive të personelit të FA. NATO ofron një përmbledhje të shkurtër të konsideratave për trajnime rutinë dhe edukim

¹¹ Battle Focused Training, Headquarters Department of the Army Washington, DC, 15 September 2003.

mjedisor në STANAG 7141 EP.¹² “Kufizimet kryesore mjedisore dhe burimet, duke përfshirë rreziqet shëndetësore, ndryshimet klimatike, mungesën e ujit dhe nevojat në rritje të energjisë, do të formësojnë më tej mjedisin e sigurisë në fushat në interes të NATO-s dhe kanë potencial për të ndikuar ndjeshëm në planifikimin dhe operacionet e NATO-s”.¹³

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg, më 24 qershor 2021 theksoi se: “.....konsideratat e ndryshimit të klimës do të përfshihen në spektrin e plotë të punës së NATO-s, duke përfshirë planifikimin e mbrojtjes, zhvillimin e aftësive dhe gatishmërinë dhe stërvitjet civile. NATO do të nxjerrë raportin e saj të parë të Progresit të Ndryshimeve Klimatike dhe Sigurisë në Samitin e 2022 për të ndjekur progresin dhe për të rivlerësuar nivelin e ambicies”.

Trajnimi individual duhet të jetë i ndryshëm në kohëzgjatje dhe specifik, në varësi të gradës dhe përgjegjësisë të personelit. Në nivelin e komandës, trajnimi duhet të përqendrohet në atë se si ndryshimet klimatike dhe mjedisi mund të ndikojë në kryerjen e misionit, si dhe të bëhet në interes të mjedisit.

Për këtë duhet të përqendrohemi në:

- mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve natyrore;
- detyrat dhe kërkesat specifike, mjetet dhe burimet;
- krijimin e një Plani të Menaxhimit Mjedisor;
- rrjetin e burimeve në dispozicion;
- përgjegjësitë për trajnimin mjedisor të personelit.

Mjediset tona ushtarake duhet të jenë shembull i ruajtjes, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një mjedisi ekologjik të pastër, nëpërmjet zgjerimit të hapësirave të gjelbëruara. Çdo ushtarak i FA duhet të mbrojtë dhe të ruajë mjedisin natyror si një përgjegjësi individuale, duke ndërmarrë masa efektive për ruajtjen e tij gjatë gjithë veprimtarisë së FA, me qëllim që pasojat që rrjedhin nga veprimtaritë ushtarake të jenë sa më të vogla. Natyrisht, roli i Forcave të Armatosura në menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit është i rëndësishëm dhe ka ardhur në rritje. Por, statusi aktual si vend anëtar i NATO-s dhe rëndësia e ruajtjes së mjedisit nga ana e tyre kërkon përmirësime në Sistemin e Planifikimit, pra në hartimin e Planit të Përshtatjes Klimatike, duke detajuar rrugët për të arritur një gjendje përfundimtare ku FA mund të operojë në kushtet e ndryshimit të klimës, duke ruajtur aftësinë operationale dhe duke përmirësuar sistemet natyrore dhe të krijuara nga njeriu, arritjen e të gjitha standardeve që të na mundësojë një bashkëveprim dhe një koordinim sa më të mirë si për veprimtaritë, ashtu dhe për operacionet brenda vendit dhe jashtë tij.

¹² STANAG 7141/AJEPP-4 Joint NATO Doctrine for environmental protection during NATO-led military activities Edition B Version, 1 march 2018.

¹³ “Environment, climate change and security” by Secretary General Jens Stoltenberg, 22 April 2021.

5. NATO dhe siguria e klimës

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) nuk ka qenë immune ndaj kërcënimeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Kjo çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme për Aleancën, sepse ajo lidhet drejtpërdrejt me kapacitetet operacionale të NATO-s dhe reagimin ndaj sfidave të sigurisë (p.sh., përgatitja dhe reagimi ndaj fatkeqësive natyrore, përshtatja e aseteve ushtarake në një ambient/mjedis fizik armiqësor, adresimi i ndikimeve negative të ndryshimet klimatike, etj.). Aleanca ka zhvilluar politika, struktura dhe njësi të caktuara të përgjegjshme për trajtimin e ndryshimeve klimatike si një kërcënim jotradicional i sigurisë. NATO ka përfshirë implikimet gjeostrategjike të kërcënimeve të lidhura me klimën në planifikimin e saj, planifikimin e emergjencave dhe proceset e planifikimit të krizave.

NATO përcaktoi dhe i njohu sfidat mjedisore si kërcënim potencial për sigurinë në vitin 1969, duke themeluar *Committee on the Challenges of Modern Society*. Që nga ajo kohë, Aleanca ka zhvilluar disa nisma që adresuan karakterin jotradicional të kërcënimit të ndryshimeve klimatike. Në vitin 2006, NATO krijoi programin “*Science for Peace and Security*”, i cili është një mjet dhe platformë e politikës për dialog, të bazuar në kërkimin shkencor, inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive. Aleanca njohu, zyrtarisht, ndryshimin e klimës si një kërcënim në Konceptin Strategjik të vitit 2010 për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Anëtarëve të NATO-s, në të cilin theksohet: “Çështjet e mjedisit dhe kufizimi i burimeve, duke përfshirë rreziqet shëndetësore, ndryshimet klimatike, mungesën e ujit dhe nevojat në rritje për energjinë do të përcaktojnë më tej mjedisin e sigurisë në fushat në interes/shqetësuese të NATO-s dhe kanë potencial për të ndikuar ndjeshëm në planifikimin dhe operacionet e NATO-s”¹⁴.

Në të njëjtin vit, u krijua “*Emerging Security Challenges Division (ESCD)*”, në përgjigje të një game, gjithnjë e më të madhe, të rreziqeve dhe sfidave jotradicionale, ku ndryshimi i klimës ishte një prej tyre. Qëllimi i divizionit është të monitorojë dhe të parashikojë kërcënimet që dalin nga rreziqet jotradicionale dhe të nxitin/propozojnë sfidat jotradicionale të sigurisë në qendër të vëmendjes së NATO-s dhe veprimet në terren.

Për më tepër, NATO miratoi kuadrin/strukturën “*Green Defense*”, e cila, ndër të tjera, thekson gatishmërinë e NATO-s për të eksploruar energjinë e zgjuar (që do të thotë aplikimi i energjisë së rinovueshme për përdorim ushtarak në mënyrë që të reduktohen emetimet dhe të zvogëlohet ekspozimi ndaj mbështetjes së lëndëve djegëse fosile si burim energjie). “*Green Defense*”

¹⁴“Strategic Concept for the Defense and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization”, 2010

përfshin disa fusha, si: operacionet, logjistikën, inxhinierinë dhe planifikimin e mbrojtjes, si dhe një shumëllojshmëri të gjerë të aktorëve: civilë dhe ushtarakë, aleatë dhe partnerë, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat. “Aktivitetet e NATO-s, në veçanti, operacionet dhe stërvitjet, të cilat përfshijnë lëvizjen, vendosjen, qëndrueshmërinë dhe rishpërndarjen e sasive të konsiderueshme të pajisjeve dhe trupave, kanë një ndikim të rëndësishëm mjedisor”¹⁵.

NATO ka reaguar ndaj katastrofave natyrore ose emergjencave civile në të kaluarën, duke përfshirë incidentet e shkaktuara nga ngjarje ekstreme të motit. Në maj 2014, NATO testoi me sukses mekanizmin e reagimit ndaj sigurisë së klimës kur përmytjet dhe rrëshqitjet në Bosnjë dhe Hercegovinë shkaktuan dëmet më të mëdha të regjistruara në historinë e tyre, që kushtuan miliarda dollarë. Njëzet e një anëtarë të NATO-s ofruan ndihma humanitare dhe furnizime kritike në të gjithë Bosnjë-Hercegovinën. Me kërkesë të qeverisë boshnjake, NATO aktivizoi *Euro-Atlantic Disaster Response Coordination Centre (EADRCC)*, e cila zhvilloi operacione në territorin e përmytur të Bosnjës. Që nga viti 2000, EADRCC ka organizuar ushtrime natyrore të reagimit ndaj katastrofave dhe ka koordinuar operacionet e reagimit të drejtpërdrejtë, në raste të shumta - duke përfshirë disa, ku kushtet e motit ekstrem kanë luajtur rol kryesor.

Në vitin 2015, Asambleja Parlamentare e NATO-s doli me rezolutën 427 “*Climate Change and International Security*”, ku ndër të tjera theksohet se: “...rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike do të ndikojnë në sigurinë ndërkombëtare përmes fatkeqësive natyrore të shtuara; stresi/problemet mbi sigurinë ekonomike, ushqimore dhe ujore; rreziqet për shëndetin publik; migracionin e brendshëm dhe të jashtëm; konkurrenca e burimeve”; dhe se “rreziqet e ndërlidhura me ndryshimet klimatike janë shumëfishues të kërcënimeve të rëndësishme që do të formësojnë mjedisin e sigurisë në fushat që shqetësojnë Aleancën dhe kanë potencial për të ndikuar ndjeshëm në planifikimin dhe operacionet e NATO-s”¹⁶.

Edhe tek *Strategic Foresight Analysis 2017 Report (SFA)* të NATO-s, një vend të veçantë zë kreu: “Ndryshimi mjedisor dhe klimaterik dhe fatkeqësitë natyrore”, ku përfshihen ndryshimet klimatike, përshtatja ndaj klimës dhe masat zbutëse, problemet e ujit dhe ushqimit, fatkeqësitë natyrore dhe ato të bëra nga njeriu. “Zhvillimet e mjedisit të sigurisë do të rritin numrin e konflikteve bazuar në një përzjerje të tendencave dhe faktorëve të ndryshëm në kombinim me ndryshimet mjedisore dhe klimatike. Këto konflikte mund të kërcënojnë stabilitetin dhe sigurinë globale dhe prandaj mund të ndikojnë

¹⁵ Green Defense Framework, Rezoluta 427 e Asamblesë Parlamentare të NATO “Climate Change and International Security”, shtator 2015.

¹⁶ Rezoluta 427 e Asamblesë Parlamentare të NATO-s “Climate Change and International Security”, shtator 2015.

direkt ose indirekt anëtarët e Aleancës”¹⁷.

Ndryshimet e klimës do të sjellin sfida dhe mundësi. Ndryshimi i regjimeve të klimës, gjithashtu, do të formësojë mjedisin e sigurisë në mënyra të tërthorta që imponojnë vëmendjen në mënyrat aktuale të jetës, në aftësinë e individëve për të ekzistuar dhe në aftësitë e qeverive për të mbajtur ritmin dhe për të siguruar nevojat e popullsisë së tyre. Të kuptuarit shkencor dhe të kuptuarit e përgjithshëm të ndryshimeve klimatike po rritet dhe do të jetë në dispozicion për Aleancën për të punuar në mënyrë sistematike gjatë kryerjes së planifikimit afatgjatë dhe vlerësimit të rrezikut, pasi, që NATO duhet “të bëhet organizata kryesore ndërkombëtare kur bëhet fjalë për të kuptuar, përshtatur dhe zbutur ndikimin e ndryshimit të klimës në sigurinë tonë”¹⁸.

Fokusi global në përshtatjen e klimës dhe në masat zbutëse mund të ofrojë edhe teknologjitë e përmirësuara me efikasitet, të cilat mund të jenë të dobishme për forcat ushtarake, veçanërisht nëse ato sigurojnë përdorim më efikas të burimeve të zinxhirit të furnizimit, pavarësi më të madhe energjetike ose përmirësim elasticiteti. Të dhëna të reja për përmirësimin e klimës dhe parashikimin e motit mund të përdoren për të informuar planifikuesit dhe vendimmarrësit.

Në Raportin e NATO-s për vitin 2021 natyrshëm shtrohet pyetja: Cilat janë tendencat globale të identifikuara në Raportin Strategjik të Parashikimit 2021?

Raporti Strategjik i Parashikimit 2021 ka identifikuar një nga katër tendenca globale që përfshin: ndryshimet klimatike dhe sfidat e tjera mjedisore: “Ndryshimet klimatike do të vazhdojnë të përshpejtohen. Në trajektoren aktuale, ngrohja globale ndoshta do të kalojë 1.5 gradë C në 20 vitet e ardhshme dhe do të shkojë drejt 2 gradë C deri në mesin e shekullit, duke përkeqësuar presionin mbi sigurinë e ujit dhe ushqimit në mbarë botën. Deri në vitin 2050, 200 milionë njerëz në baza vjetore pritet/parashikohet të kenë nevojë për ndihmë humanitare pjesërisht për shkak të efekteve ekologjike. Stresi i klimës do të sfidojë grupet e cënueshme dhe do të kontribuojë në nxitjen e zhvendosjes dhe migrimit të popullsisë, përhapjen e konflikteve dhe shkeljet e mundshme të të drejtave themelore të njeriut”¹⁹.

Ndryshimi i klimës, së bashku me ekspozimin dhe cënueshmërinë në rritje të njerëzve, pritet të rritë ndikimin e fatkeqësive natyrore, pasi ngjarjet ekstreme të motit do të bëhen më të shpeshta dhe intensive gjatë dekadave të ardhshme. Fatkeqësitë natyrore mund të kenë efekte të ndryshme në vendet e NATO. Ndërsa shumë prej tyre mund t’i shpëtojnë ekstremeve të ndryshimit, ekziston

¹⁷ Strategic Foresight Analysis 2017 Report (SFA), faqe 9.

¹⁸ Konferencë për shtyp nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut me Këshilltarët e Sigurisë Kombëtare, 7 tetor 2021.

¹⁹ Strategic Foresight Report – Questions and Answers, 8 September 2021, Brussels.

një gjasë në rritje që një shtet anëtar mund të pësojë një katastrofë të madhe, e cila mund të ndikojë në aftësinë e saj për të kontribuar në operacionet ekzistuese ose në zhvillimin e Aleancës. Aleatët do të punojnë më shpesh në fushat e ndihmës humanitare, të cilat do të kërkojnë ndërveprim me të vërtetë gjithëpërfshirës (ushtarak, qeveritar dhe joqeveritar).

Sidoqoftë, iniciativat e sigurisë për klimën janë të kufizuara në madhësi dhe fushëveprim kur krahasohen me iniciativat që kanë të bëjnë me kërcënimet tradicionale të sigurisë. Mjedisi i sigurisë kompleks që ndryshon me shpejtësi do të vazhdojë të jetë nxitësi kryesor për përpjekjet e adaptimit edhe të Forcave tona të Armatosura. Këto përpjekje përqendrohen në transformimin e kapaciteteve ushtarake të FA-ve për të siguruar që ato të mbeten të rëndësishme dhe të besueshme, tani dhe në të ardhmen, me qëllim përmbushjen e detyrave të saj kryesore: mbrojtjen kolektive, sigurinë bashkëpunuese dhe menaxhimin e krizave.

Përfundime

Ndryshimi i klimës tani përbën një emergjencë globale, i cili kërcënon qytetërimin modern. Fatkeqësitë natyrore do të kenë ndikim në rritje, pjesërisht, për shkak të ashpërsisë së motit dhe mbisundimit të ngjarjeve të rënda prej tij, por edhe për shkak të ndryshimeve në rajonet dhe kohët e vitit ku mund të ndodhin këto ngjarje. Ndryshimet klimatike kanë ndikim të kufizuar në sigurinë tonë kombëtare, por është fakt që ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim në rritje për paqen dhe sigurinë, duke provokuar fatkeqësitë, pasojat e të cilëve do të paraqesin sfida të rëndësishme për vendin dhe FA. E rëndësishme është që të ndërmarrim një sërë masash për të zvogëluar kërcënimet potenciale në nivelin më të ulët të mundshëm.

Ndryshimi i klimës vepron si një “shumëfishues i kërcënimeve” ndaj sigurisë, duke përforcuar dobësitë dhe rritur kërcënimet ekzistuese ndaj popullatave të cilat çojnë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, në rritjen e rreziqeve e konflikteve të dhunshme. FA-të kanë dëshmuar se mund të kontribuojnë për eliminimin e kërcënimeve tradicionale, por duhet të përmirësojnë dhe të përshpejtojnë përpjekjet për të zhvilluar një strategji konkrete, e cila t’i përgjigjet shtimit të kërcënimeve të ndryshimeve klimatike, si një rrezik sigurie. Ndikimi i ndryshimeve klimatike duhet të përfshihet në planifikimin ushtarak (planet operative dhe taktike, planet logjistike, pajisjet dhe infrastrukturën në skenarët e mundshëm të ndryshimeve të klimës) dhe në procesin e arsimimit, trajnimit dhe stërvitjeve të FA.

Rekomandime

- Ndryshimet klimatike mund të vijnë më shpejt se sa pritet ose të planifikohen, duke përdorur mënyra sjelljeje më të shpejta dhe të paparashikuara. Ne duhet të pranojmë dhe përgatitemi për gamën e plotë të rreziqeve të ndryshimeve

klimatike dhe implikimet e saj ekzistenciale për vendin dhe shoqërinë. Rreziqet ekzistuese kërkojnë një qasje tjetër nga ajo konvencionale e menaxhimit të rrezikut dhe kjo kërkon struktura, teknika të reja të menaxhimit të rrezikut dhe masa paraprake të veçanta, që shkojnë shumë më tepër se ato që mund të aplikoheshin deri më tani. Duhet një artikulum i saktë i rreziqeve katastrofave dhe koha e duhur e përgjigjes ndaj tyre. Një përkufizim i vërtetë dhe i saktë i problemit është 90% e zgjidhjes. Ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike dhe pasojat që vijnë prej tyre, nëpërmjet arsimimit, përgatitjes së temave, diskutimeve, debateve apo formave/metodologjive të tjera kërkon angazhimin për transformim, për t'u përballur me sfidën, në mënyrë që rreziqet të mund të adresohen duke iu përgjigjur në mënyrë emergjente.

- Mbrojtja e mjedisit është përparësi, e cila theksohet edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë tonë Ushtarake. Degradimi i mjedisit paraqet një kërcënim potencial afatshkurtër dhe afatgjatë për sigurinë dhe mirëqenien e popullit. Prandaj, është e domosdoshme mbështetja e përpjekjeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Informacioni dhe përvojat e dokumentuara në FA tregojnë që çështjet e mjedisit janë të pandashme nga aftësitë e FA për të përmbushur objektivat kombëtarë dhe ata të dëshiruar në veprimtaritë operacionale. FA duhet të përshtaten me kërcënimet nga ndryshimi i klimës, por në të njëjtën kohë, duhet të zbatojnë të gjitha masat gjatë përdorimit të mjedisit, për të zvogëluar ndikimin e tyre mjedisor, përfshirë trajtimin e kësaj problematike gjatë trajnimeve dhe gjatë procesit të planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjeve. FA duhet të maksimizojnë forcat për ruajtjen e mjedisit nëpërmjet efikasitetit, ruajtjes së fondeve për strukturën e forcës, modernizimit dhe trajnimit. Drejtpeshimi i konsideratave mjedisore me faktorë të tjerë që kontribuojnë në suksesin e misionit është një ndërmarrje e vazhdueshme dhe kërkon ndërgjegjësim më të mirë, trajnime, informacion, doktrinë dhe udhëzime. Sot, FA-të duhet të përpiqen të shmangin dëmtimin e panevojshëm të mjedisit jo vetëm në trajnim, por edhe në të gjithë spektrin e detyrave operacionale. FA duhet të jenë në gjendje të gjejnë mënyra për të mbrojtur mjedisin natyror, ndërsa kryejnë gamën e plotë të detyrave të tyre. Shqipëria, si anëtare e NATO-s, duhet të plotësojë standardet dhe kërkesat ndërkombëtare ku, natyrisht, një prej tyre është edhe mbrojtja e mjedisit dhe zvogëlimi i kërcënimeve ndaj tij, si pasojë e veprimtarisë ushtarake të FA.

- FA-të do të kenë një rol të shtuar në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe duhet të zhvillojnë përgjegjësitë në lidhje me reagimin ndaj pasojave që shkaktojnë ndryshimet klimatike. Do të jetë e nevojshme për më shumë mbështetje humanitare, veçanërisht, në operacionet e menaxhimit të fatkeqësive, të cilat do të kërkojnë ndërveprim të vërtetë gjithëpërfshirës, si dhe një rol më të madh të strukturave të bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Gjithashtu, i rëndësishëm është edhe përmirësimi i bashkëpunimit me organet e pushtetit qendror e lokal apo me organizata të ndryshme, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve klimatike e mjedisore për planëzimin dhe kryerjen e operacioneve emergjente. FA do t'u duhet të zhvillojnë kapacitete të reja ose të përshtatin kapacitetet ekzistuese dhe së bashku me agjencinë, të mbështetin kërkimet për të përmirësuar kushtet, me qëllim që fatkeqësitë natyrore, që shkaktohen nga klima dhe ndërprerjet/dëmtimet e infrastrukturave kritike të mbështetjes së jetës ose jo, të çojnë në probleme të rëndësishme të sigurisë, si: paqëndrueshmëri politike, konflikte të dhunshme, fatkeqësi humanitare, migracion etj. FA do të duhet të zbatojnë një qasje më të fortë dhe më koherente në trajtimin e ndryshimeve klimatike. Më saktësisht, FA duhet të zhvillojnë kapacitetet e forcave për të menaxhuar krizat mjedisore të sigurisë; të përmirësojnë ndarjen e njohurive të ndërlidhura me ndryshimet klimatike; integrimin e çështjeve që lidhen me rrezikun e klimës në trajnimin dhe stërvitjet e tyre. Gjithashtu, Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe FA-ve do t'u duhet të përmirësojnë dhe të përshpejtojnë përpjekjet e tanishme për të zhvilluar një strategji konkrete që u përgjigjet ndryshimeve klimatike, si një shumëzues jotradicional i kërcënimeve e si një rrezik për sigurinë.

-Pasqyrimi i ndryshimeve klimatike dhe pasojave që sjellin ato në dokumentet kryesore strategjike, si: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, si dhe në dokumentet operacionale, taktike, në programet e arsimimit dhe stërvitjes të FA, në skenarët e mundshëm të ndryshimeve të klimës do të ishte i domosdoshëm, pasi do të bënte të mundur hartimin e planeve dhe marrjen e masave për shmangien apo përshtatjen e operacioneve në kushtet e ndryshimeve klimatike. Po kështu, faktorët në ndikimet e ndryshimeve klimatike të planifikohen në spektrin e plotë të planifikimit dhe ndikimet e parashikuara të ndryshimeve klimatike, duke u integruar plotësisht në planet kombëtare, si në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile etj. Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe FA mund të krijojnë një grup pune për të shqyrtuar rreziqet ekzistenciale të ndryshimeve klimatike dhe për të zhvilluar teknikat e menaxhimit të riskut dhe metodologjitë e krijimit të politikave të përshtatshme për t'u përballur me sfidën.

Bibliografia:

1. Climate adaptation plan, Department of Defense, September 2021.
2. Strategic Foresight Report – Questions and Answers, Brussels, 8 September 2021.
3. Report of International Nations Panel on Climate Change (IPCC), 2021.
4. Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the

North Atlantic Council in Brussels 14 June 2021.

5. Environment, climate change and security, Secretary General Jens Stoltenberg, 22 April 2021.
6. Existential climate-related security risk: A scenario approach Written By: David Spratt & Ian Dunlop Foreword By: Admiral Chris Barrie AC RAN Retired, May 2019.
7. Building resilience by linking climate change adaptation, peacebuilding and conflict prevention. Dennis Tänzler, Lukas Rüttinger & Nikolas Scherer MARCH 2018.
8. Journal MCU, Climate Change an policy 2016, published by Marine Corps University Press, 2017
9. Strategic Foresight Analysis 2017 Report (SFA. NATO Unclassified – Publicly Disclosed).
10. Climate Change: Implications for Defence - Key Findings from the Intergovernmental Panel on Climate Change; Fifth Assessment Report June 2017.
11. What Lies Beneath - The scientific understatement of climate risks, by David Spratt & Ian Dunlop September 2017, Foreword by Hans Joachim Schellnhuber, gusht 2018.
12. Implications of Climate Change and Disasters on Military Activities, published under the NATO Science for Peace and Security series - 2017
13. NATO, Climate Change, and International Security A Risk Governance Approach. Tyler H. Lippert, October 2016.
14. FM 3-100.4 MCRP 4-11B Environmental Considerations in Military Operations, Department of the Army Washington, DC, 11 May 2001
15. AJEPP-4 Joint NATO Doctrine for environmental protection during NATO-led military activities Edition B Version, 1 march 2018.
16. Environmental guidebook for military operations, published 2008.
17. The military's impact on the environment: A neglected aspect of the sustainable development debate. A Briefing Paper for States and Non-Governmental Organisations International Peace Bureau, Geneva, August 2002.
18. Resolution 427 on Climate change and international security, 26 September 2015.
19. Battle Focused Training, Headquarters Department of the Army Washington, DC, 15 September 2003.

E DREJTA E INFORMIMIT PUBLIK DHE SIGURIA KOMBËTARE

Gjeneral Brigade Msc. Editson Zarka
Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të
Përgjithshëm, MM

Trajtesë e shkurtuar.

Zhvillimet demokratike dhe integrimi euroatlantik i vendit tonë janë shoqëruar me një sërë reformash dhe rritjesh standardesh edhe në drejtim të informimit publik nga strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes. Dilema se çfarë informacioni mund t'i jepet publikut dhe çfarë jo, mbetet vijë ndarëse, e cila rregullohet me akte të veçanta ligjore e nënligjore. Përvoja e vendeve të tjera perëndimore të NATO-s dhe BE-së është një busull orientimi edhe për vendin tonë. Ky është një proces i cili zhvillohet dhe konsolidohet dita-ditës. Karakteri i mbyllur i punës i strukturave të sigurisë ka bërë që publiku të depërtojë me vështirësi për të marrë informacionin që i nevojitet.

Shpesh herë strukturat e këtyre institucioneve përdorin si barrierë mbrojtëse ligje të veçanta, të cilat kanë dalë për mbrojtjen e informacionit. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura gjithnjë e më shumë kanë rritur kapacitetet e trajtimit të kërkesave për informacion, duke i menaxhuar kërkesat dhe ankesat e ndryshme, të cilat vijnë në adresë të saj në forma dhe metoda tradicionale dhe bashkëkohore. Hapja e portaleve të veçantë si dhe krijimi i rrjetit të koordinatorëve të informimit, në përputhje me ligjin, ka mundësuar menaxhimin në kohë të tyre dhe nxitjen e strukturave për dhënie të informacionit të saktë, duke pasur parasysh kufizimet. Prosesi i dixhitalizimit dhe adresimi i kërkesave në të ardhmen në mënyrë elektronike, kërkon profesionalizmin e mëtejshëm të drejtuesve të strukturave, njësisve dhe komandave, si dhe stafëve që merren direkt më këtë të proces.

Fjalët kyçe: informimi publik, siguria kombëtare, transparencë, MM, FARSH, të drejtat e njeriut, NATO, BE.

1. E drejta për t'u informuar si e drejtë themelore dhe kushtetuese e njeriut

Edrejta për t'u informuar është një e drejtë themelore e njeriut. Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut theksohet se kushdo ka të drejtën për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion¹. Miratimi nga Organizata e Kombeve të Bashkuar të kësaj deklarate, imponon vendet pjesëmarrëse në të marrin të gjitha masat ligjore, organizative dhe funksionale për zbatimin sa me të drejtë të kësaj deklarate. Kjo e drejtë është sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 23 të saj theksohet se e drejta e informimit është e garantuar². Kështu që çdo qytetar në përputhje me ligjin ka të drejtë të marrë informacione për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione publike. Në këtë kuadër është zhvilluar edhe baza ligjore e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe aksesit në dokumentet publike të përgatitura nga autoritetet publike.

Ka disa parime ku mbështetet dhënia e informacionit, të cilat përmbledhin detyrimet e organeve publike për t'ia ofruar subjekteve fizike dhe juridike. Ndër këto parime theksohet se informacioni duhet të jetë plotë dhe i gatshëm për t'u vënë në dispozicion për kërkuuesin, me përjashtim të rasteve ku ai bie ndesh me sigurinë kombëtare apo kufizime të tjera ligjore³. Shpërndarja e informacionit duhet të jetë e tillë që për ushtarakët dhe familjarët e tyre të vihet në dispozicion në mënyra dhe metoda nga më të ndryshme. Në vendet më të përparuara demokratike perëndimore vihet re që ka një sërë mjetesh për përhapjen e tij, si: radio-televizioni (në disa raste ka kanale të dedikuara për departamentin e mbrojtjes dhe forcat e ushtrisë), *webpage*, gazeta, revista, fletë-palosje etj. Informacioni i cili mund t'i jepet publikut, nuk duhet klasifikuar me mendimin për të mbrojtur dhe fshehur situatën në një autoritet publik, qoftë kjo në institucionet e sigurisë kombëtare, duke shmangur kritikën e mundshme për mënyrën se si qeveriset apo drejtohet vendi dhe institucioni.

¹ Neni 19, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, faqe 5, https://www.ohchr.org/en/udhr/documents/udhr_translations/eng.pdf

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, faqe 9; <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Kushtetuta-2017.pdf>

³ "Principles of Information", <https://www.defense.gov/Resources/Principles-of-Information>

Marrëdhëniet me publikun janë delikate, ato duhet të fuqizohen për të mirën e dyanshme, pasi në fund të fundit këto institucione mbahen nga taksapaguesit e shtetit. Për këtë duhet që institucionet publike të përgatisin plane të qarta dhe efektive dhe të punojnë për zbatimin e tyre në praktikë.

E drejta për t'u informuar është një kërkesë që vjen nga çdo person, fizik apo juridik, vendas apo i huaj, si edhe nga ata që janë pa shtetësi. Praktika e përditshme e evidenton këtë gjë. Mënyra e kërkesës së informacionit është ajo që ndan profesionistët nga ata që nuk kanë njohuritë e duhura në këtë fushë. Ligji përcakton rregulla të qarta për mënyrën e kërkimit të informacionit, si dhe rastet kur refuzohet dhënia e tij. Publiku kë të drejtën të njihet me dokumentet, jo vetëm për t'u informuar, por edhe për të ushtuar të drejtën e kërkimit të llogarisë, në kuadrin e llogaridhënies publike. Personi që kërkon informacion nuk është i detyruar të kërkojë motivet se pse e kërkon atë. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Personi mund të inspektojë dokumentin origjinal në vendin ku ai ruhet dhe më pas mund të kërkojë edhe kopje të dokumentit, për të cilat strukturat punojnë për t'ia vënë në dispozicion..

Problemi midis një qeverisjeje të hapur dhe lirisë së informacionit ka ardhur duke u adresuar gjithnjë e më tepër. Nisur nga tradita e sistemit të kaluar, informacioni për publikun e gjerë ka qenë i kufizuar. Fillimisht, nga institucionet publike botoheshin ato të dhëna të cilat gjykoreshin se ishin të domosdoshme për njohjen nga publiku. Por, me miratimin e akteve të reja ligjore, nisur edhe nga sugjerimet e BE-së, u kalua në një stad të ri, ku jemi edhe sot, në atë të kërkesës që bën publiku për informacionin që intereson. Në këto kushte, institucionet publike janë të detyruara me ligj për të dhënë informacionet e kërkuara. Në këtë drejtim ka evoluar edhe praktika se si bëhet adresimi dhe marrja e informacionit. Kalimi në dixhitalizim ka lehtësuar këtë proces, duke i adresuar sa më shpejt këto kërkesa dhe ankesa.

2. Format dhe metodat e kërkesave për informim

Kërkesë dhe ankesat që i drejtohen autoriteteve publike vijnë të bëhen si me mënyrat tradicionale me anë të shkresave, ashtu edhe me metodat e reja në formatin elektronik. Ankesat shkresore depozitohen në institucionin përkatës me anë të postës, apo dorazi, sipas formateve të paracaktuar qartë dhe që vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Ka edhe forma të tjera, të cilat janë zhvilluar për t'i ardhur në ndihmë shtetasve. Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e vartësisë kjo gjë realizohet me anë të formateve standarde, të cilat plotësohen nga qytetarët pranë zyrave të pritjes së publikut. Me tej kërkesat merren, regjistrohen dhe adresohen nga struktura të posaçme për trajtimin e tyre. Këto kërkesa regjistrohen brenda 3 ditëve nga marrja e saj në regjistrat përkatës të kërkesave dhe përgjigje që krijohen dhe administrohen pranë autoriteteve

publike. Në këto raste, afatet për kthimin e përgjigjes janë ato të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Në rast vonese, qytetari ka të drejtë të bëjë ankesë administrative pranë organit publik dhe në rast se nuk merr zgjidhjen e duhur ai mund t'i drejtohet gjykatës administrative, apo asaj civile sipas rastit.

Format elektronike të depozitimit të kërkesave dhe ankesave janë duke u perfeksionuar dhe integruar për t'i ardhur në ndihmë publikut sa më shpejt që të jetë e mundur. Ndër këto forma që po gjejnë gjithmonë e më shumë përdorim janë portalet “Pyet shtetin”, “Informimi_mm”, “Bashkëqeverisjes - Për Shqipërinë që duam” etj. Edhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura po i përdorin me efektivitet këto forma, duke mundësuar rritjen e gamës së kërkesë-ankesave, dhe po ashtu rritjen e përfshirjes së strukturave për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

- **Në portalin “Pyet Shtetin”**, në të cilën qytetarët mund të regjistrohen dhe të zgjidhin institucionin që mbulon fushën e veprimtarisë përkatëse⁴. Kjo kërkesë paraqitet direkt pranë koordinatoreve për të drejtën e informimit, i cili vepron në emër të autoritetit publik. Afati është relativisht i shkurtër për të marrë përgjigje, prandaj strukturat përkatëse mobilizohen për të venë në dispozicion gjithë burimet e mundshme për të përmbushur në kohë kërkesën. Në rast se kërkesa nuk përmbushet brenda afatit, atëherë kërkuesi mund t'i drejtohet direkt Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes portalit pyetshtetin.al

- **Në portalin “Informimi_mm”**, kërkesat vijnë nga drejtime dhe nga subjekte të ndryshme, qofshin këto fizike apo juridike, brenda apo jashtë vendit. Koordinatorin për të drejtën e informimit në MM është përgjegjës për menaxhimin, koordinimin dhe adresimin e të gjitha çështjeve që vijnë në portal. I asistuar nga stafi i tij, kërkesat adresohen tek të gjithë strukturat e MM dhe FARSH, si dhe rrjetit të koordinatoreve të krijuar për këtë qëllim. Fluksi, dinamika, spektri i fushës të kërkesave është i larmishëm dhe shpeshherë nuk i ngjajnë njëra-tjetrës. Kujdes i kushtohet kërkesave që vijnë nga persona apo struktura të cilat nuk bëhen sipas standardeve, apo që dërgohen për arsye të tjera. Këto menaxhohen me kujdes dhe trajtohen duke pasur parasysh mbrojtjen nga ndërhyrjet e personave keqbërës dhe dezinformues.

- **Në portalin e “Bashkëqeverisjes_mm”** kërkesat dhe ankesat përcillen nga një strukturë më e lartë e cila është në vartësi të Kryeministrisë. Kërkesat dhe ankesat gjenerohen ose nga platforma “e-albania”, ose dërguar në mënyrë elektronike, në të cilat bashkëlidhen dokumente shtesë, tregues dhe justifikues. Afati për trajtimin e tyre është relativisht shumë i shkurtër dhe informacioni kërkohet të jepet i plotë brenda afatit. Ka raste që çështja nuk merr zgjidhje

⁴ https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/03/fletepalosja_pyetshtetin.pdf

menjëherë, por vijon të plotësohet me të dhëna dhe informacion shtesë. E rëndësishme është që kërkesë-ankesat e dërguara në këtë portal marrin një numër serial unik dhe shikohet ecuria e procesit, duke vënë në dijeni dhe mbajtur të informuar të interesuarin.

Aktualisht janë një sërë portalesh si “Pyet Shtetin”, “Platforma për Bashkëqeverisjen” “Informimi” etj., krahas metodave më tradicionale siç janë ato të drejtuara me shkrim dhe postë. E rëndësishme është të evidentohet se çfarë përfshihet në informacionin publik. Në këtë kontekst jepen edhe shpjegimet përkatëse, ku në këtë kategori futet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj formati që mund të jetë përgatitur një dokument, apo ruajtur me metodat audio-vizive. Autoritetet publike janë të detyruar të venë në dispozicion të të interesuarit dokumentet të cilat ndahen në tri kategori kryesore: (1) dokumente të krijuara nga vetë autoriteti; (2) dokumente të ardhura prej një autoriteti tjetër por që disponohen nga institucioni ku veprohet; (3) dokumente të ardhura nga subjekte private. Me të drejtë lind pyetja se cilat janë dokumentet e krijuara nga vetë autoriteti publik? Këtu futen vendimet, rregulloret, udhëzimet, urdhrat, kontratat, shkresat e ndryshme që i adresohen strukturave të tjera.

Koordinatori për të drejtën e informimit caktohet një nga nëpunësit publik i cili duhet të ketë përgatitjen e duhur profesionale për të menaxhuar këtë proces kaq delikat. Ligji njih edhe ngritjen dhe funksionimin e rrjetit të koordinatorëve të informimit, të cilët janë ekspertë të fushës dhe menaxhojnë kërkesat për informacion me profesionalizëm dhe brenda afateve të kërkuara. Këto afate janë relativisht të shkurtra në kohë, dhe ka masa ndëshkimore, nëse nuk zbatohen ashtu siç duhet. Afatet përgjithësisht shkojnë nga 10 ditë deri në 30 ditë pune, sipas akteve ligjore në fuqi, kodit të procedurës penale, kodit civil etj. Nëse kërkesa për informacion nuk i është përmbajtur standardeve të kërkuara, atëherë autoriteti publik kërkon saktësimin e kërkesës brenda 48-orëve nga kerkimi i saj, dhe ky afat shtyhet në rastet e festave, apo pushimeve javore (referohu tabelës 1).

Nr.	Fusha	Afatet			Kthim përgjigje	Shtyrje të mundshme
		DIP	Strukturat	DIP		
1	Bashkëqeverisja	1 ditë	5 ditë	2 ditë	8 ditë	0 ditë
2	Informimi_mm	1 ditë	5 ditë	2 ditë	10 ditë	5 ditë
3	Kërkesë-ankesa	1 ditë	5 ditë	5 ditë	30 ditë	30 ditë

Tabela nr. 1. Afatet procedurale për trajtimin e kërkesave dhe ankesave

Për mbarëvajtjen e këtij procesi është e domosdoshme që autoritetet publike mos të mjaftohen me caktimin e një personi, i cili nuk zotëron informacionin, apo nuk njih mirë strukturën organizative për të koordinuar të gjitha kërkesat

që i drejtohen institucionit. Zgjedhja e koordinatorit me parametrat e duhura ndihmon procesin dhe të gjitha hallkat hierarkie që merren me transmetimin e tij. Ai duhet të ketë statusin e duhur të funksionarit dhe të ketë formim të përshtatshëm për të kryer këtë detyrë. Koordinator i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacion publik. Kjo bëhet duke mbajtur parasysh kërkesat ligjore dhe duke i vënë në dispozicion kërkuarit dokumentin original, ose kopjen e tij të njëzuar me origjinalin, pasi ai mund të përdoret në proceset e ankimit administrativ ose gjyqësor, kur nuk plotësohet kërkesa, ose ajo plotësohet pjesërisht.

Koordinatori gjithashtu mundëson krijimin, mbajtjen, publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve duke mundësuar transparencën me publikun e gjerë. Regjistri përditësohet çdo 3-muaj dhe publikohet në faqen zyrtare⁵ të autoritetit publik si dhe në ambientet e pritjes së publikut. Ky është një mjet mjaft i mirë për të demonstruar efektivitetin lidhjen me publikun, si dhe kuadrin e llogaridhënies para tyre, për mandatin e marrë. Bashkëpunimi vertikal dhe horizontal është kyçi i suksesit në punën e koordinuarit. Kjo gjë arrihet me anë të komunikimit të vazhdueshme për adresimin dhe zgjidhjen e kërkesave të caktuara, të cilat shpeshherë kërkojnë punë voluminoze edhe pse afati është i limituar. Në çdo rast informohet ai që ka bërë kërkesën, duke e mbajtur të përditësuar edhe për rastet kur kërkohet më shumë kohë për dhënien e përgjigjes.




Figura nr. 1
Regjistri i kërkesave dhe ankesave në MM për vitet 2017-2021

Siç shihet edhe nga figura 1, ka pasur një trend rritës për kërkesa për informim nga viti 2017 në vitin 2021. Kjo tregon për interesimin gjithnjë në rritje të publikut për informacione të veçanta ndaj institucionit të mbrojtjes.

3. Programi i transparencës dhe kufizimet e informimit

Programi i transparencës përfshin informacione të kërkuara më shpesh nga publiku. Rishikimi i tyre bëhet të paktën një herë në 5 vjet sipas ligjit. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes është publikuar Programi i Transparencës⁶, i cili përfshin kategori kryesore informimi, ku çdo qytetar mund të klikojë dhe gjejë informacionin që dëshiron.

⁵ <https://www.mod.gov.al/index.php/transparence>

⁶ Po aty.

Në kuadër të zbatimit të ligjit janë përgatitur dhe publikuar edhe programet e transparencës dhe të drejtat e dhënies së informacionit për publikun. Janë gjithsej 374 autoritete publike⁷ në shkallë vendi. Një gjë e tillë është reflektuar edhe në Ministrinë e Mbrojtjes, duke bërë të mundur publikimin e të dhënave kryesore, mbi të cilat mund të marrin informacion të gjithë shtetasit, apo subjekte të tjera fizike dhe juridike të interesuara.

Strukturat e MM dhe FARSH garantojnë dhënien e informacionit të paklasifikuar publikut duke hartuar dhe publikuar këto programe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky informacion nuk është kufizuar vetëm me faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, por zbrit edhe në rreth 20 struktura të vartësisë, të cilat publikojnë⁸ në faqet e tyre zyrtare të dhënat e kërkuara. Kjo gjë bën të mundur që të interesuarit të gjejnë një pjesë të madhe të informacionit të kërkuar direkt duke aplikuar në këto faqe, pa qenë e nevojshme t'i adresohen strukturave me kërkesa të veçanta. Për më tepër, programet e transparencës përpunohen dhe freskohen periodikisht. Bazë për këtë mbetet analiza e bërë për kërkesa të ndryshme që adresohen në portalet përkatëse të informimit apo kërkesë-ankesat që bëhen nga qytetarë të ndryshëm.

Kjo gjë bën të mundur uljen e kërkesave që mund t'i drejtohen autoriteteve publike. Aktualisht në këto kategori futen: mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi MM; shërbime që ofrohen nga MM; regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve; kuadri ligjor rregullator me tekste të plota; informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të MM; procedurat/mekanizmat për të dhënë mëndmë lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të MM; ndihma shoqërore apo subvencionet të dhëna nga MM; e drejta për t'u informuar apo për t'u ankuar; informacion për procedurat e prokurimit, procedurat konkurruese koncesionit, partneritetit publik-privat; sistemi i mbajtjes së dokumentacionit; llojet e formate e dokumenteve; informacione apo dokumente që kërkohen më shpesh dhe që gjykohen të dobishme për publikim nga MM.

Kufizimet e informimit. Në rastin e organeve të sigurisë dhe mbrojtjes ka një kufizim dhe saktësim në ligj. Informacioni i kërkuar duhet të jetë vetëm për veprime të natyrës administrative dhe jo përtej kësaj gjeje. Kufizimet duhet të kenë bazën e vet ligjore, pra të jenë të sanksionuara në një akt tjetër të veçantë. Në rastin tonë, ligji nr. 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror” i ndryshuar”⁸ përbën një element të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë. Në mbështetje të këtij ligji janë edhe aktet nënligjore si

⁷ https://www.pyetshtetin.al/wp-content/uploads/2021/08/Lista-e-autoriteteve-publike_2021_per_publicim_pdf.pdf

⁸ Ministria e Mbrojtjes, urdhër nr. 813 datë 18.05.2015 “Për miratimin e programit të transparencës dhe të drejtën e dhënies së informacionit në Ministrinë e Mbrojtjes”

VKM, urdhra të MM etj., të cilat specifikojnë detaje në përputhje me veçantinë e institucionit. Megjithatë ligje të tilla japin kornizën ligjore të “mbrojtjes së institucionit” dhe autoriteteve publike. Por nëse kërkesa gjendet në dokumente të klasifikuara, atëherë mund të kërkohej de-klasifikimi i tyre, nëse interesi publik është i madh dhe kur nuk përmbajnë më rreziqe për sigurinë kombëtare etj. Kufizime të tjera të bëra me akte të veçantë janë ato që lidhen me lirinë dhe të drejtat e tjera themelore të njeriut, me mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, me ruajtjen e të dhënave personale dhe të ndjeshme etj.

Në Aktin e Lirisë së Informacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i krijuar qysh në vitin 1967, i ka dhënë të drejtën publikut për të kërkuar akses tek regjistrat e çdo agjencie federale⁹. Janë nëntë raste kur kufizohet dhënia e informacionit të cilat trajtohen shkurtimisht si më poshtë:

- Kur informacioni është i klasifikuar. Klasifikimi bëhet me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, qoftë ky një urdhër ekzekutiv për të mbrojtur sekretin në interes të politikës së mbrojtjes kombëtare dhe politikës së jashtme të vendit;
- Mbron informacionin që lidhet vetëm me rregullat dhe praktikat e brendshme të personelit të një agjencie publike;
- Mbron informacionin e veçantë, që përjashtohet nga përhapja e tij, duke ju referuar një statusi tjetër;
- Mbron sekretet tregtare, komerciale apo financiare, të cilat janë përfituar nga jashtë qeverisë dhe që duhen ruajtur në përputhje me aktet e parashikuar për këtë qellim;
- Mbron disa regjistra, të cilët qarkullojnë midis agjencive, por që kanë një afat ruajtje;
- Mbron informacionin në lidhje me individët, të dhënat personale dhe të ndjeshme;
- Mbron informacionin që lidhet me zbatimin e ligjit, të tilla si procesi i hetimit, investigimit etj.
- Informacioni që lidhet me shqyrtimin, punën dhe raportet e kushtëzuara, të përgatitura nga ose në emër të, ose që janë në përdorim nga një agjenci e cila është përgjegjëse për rregullimin ose mbikëqyrjen e institucioneve financiare.
- Mbron informacionin gjeologjik dhe gjeofizik, si dhe të dhënat që lidhen me to, përfshirë hartat që lidhen me puset.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe shëndetësore është një tjetër aspekt i rëndësishëm në fushën e të drejtës së informimit. Për këtë ka ligje të veçanta, që në rastin e vendit tonë janë të sanksionuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008

⁹ “The freedom of Information Act”, <https://www.foia.gov/about.html>

“Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Këtu futet çdo e dhënë në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt në veçanti duke iu referuar numrit të identifikimit ose një a më shumë faktorëve për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social¹⁰.

4. Përfundime

E drejta për t’u informuar është një e drejtë universale, për të cilat shtetet demokratike punojnë për ta zbatuar sa më mirë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka sanksionuar këtë të drejtë si një të drejtë kushtetuese. Për zbatimin e saj janë hartuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat janë të detyrueshme për autoritetet publike, punonjësit e administratës shtetërore, përfshirë Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe strukturat e vartësisë së tyre.

E drejta për t’u informuar dhe siguria kombëtare janë dy elemente të cilat shikohen me proporcionalitet në dhënien ose kufizimin e shpërndarjes së informacionit. Bazë për këtë është siguria kombëtare, interesi publik të cilat pre-ulojnë mbi kërkesën e individit. Kufizimi sanksionohet me akte ligjore dhe nënligjore të veçanta. Pjesëmarrja në strukturat e mbrojtjes kolektive siç është NATO, bën që ky kufizim të rakordohet me standardet e sigurisë dhe ruajtjes së informacionit të klasifikuar të këtyre strukturave.

E drejta për informimin publik kërkon marrjen e të gjitha masave organizative për t’iu përgjigjur në kohë dhe me profesionalizëm çdo kërkesë dhe për t’i shërbyer sa më mirë si pjesëtarëve të strukturave të sigurisë kombëtare, ashtu edhe publikut të gjerë. Zhvillimi dinamik i komunikimit elektronik kërkon përsosjen e formave të komunikimit për realizimin në praktik të së drejtës së informimit. Baza e hedhur deri tani shërben si një element i rëndësishëm për rritjen e profesionalizimit dhe shërbimit publik në kohë reale dhe efektive.

Bibliografia:

1. Karta Universale e të Drejtave të Njeriut; https://www.ohchr.org/en/udhr/documents/udhr_translations/eng.pdf
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
3. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ligji nr. 9887 dt.10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
5. Ligji nr.107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”.
6. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”.
7. Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar "sekret

¹⁰ Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- shtetëror”, i ndryshuar me ligjin nr.9541, datë 22.5.2006, si dhe ligjin 25/2012.
8. Doriana Matia, “Komentari i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit””, Qendra “Res Publica”, shtator 2014.
 9. Udhëzimi i MM nr.9, dt.09.10.2019 “Për trajtimin, ndjekjen, zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjeve të kërkesave, ankesave, denoncimeve, vërejtjeve e propozimeve, që lidhen me strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura”.
 10. Urdhri i MM nr.528 dt.13.04.2018 “Për administrimin dhe koordinimin e informacionit nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes”.
 11. Urdhri i MM nr.1626, dt.29.10.2021 “Për ngritjen e grupit të punës, përgjigjen për ndjekjen e ankesave dhe kërkesave që trajtohen sipas Kuadrit Ligjor “Për Bashkëqeverisjen””.
 10. “The freedom of Information Act”; <https://www.foia.gov/about.html>

TENDENCAT E ZHVILLIMIT TË TEKNOLOGJIVE TË REJA DHE SFIDAT NË MJEDISIN OPERACIONAL

Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj
Specialist në IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Në një mjedis të ardhshëm dinamik dhe operativ, të karakterizuar nga ndikimet e jashtme të subjekteve të ndryshme publike dhe private, të përfshira në zhvillimin shkencor dhe teknologjik, kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive të avancuara, të situatës politiko-ushtarake dhe ekonomike, ushtritë moderne duhet të planifikojnë dhe kryejnë operacione në shumë fusha me dimensionet e duhura për mbrojtjen dhe sigurinë, në mënyrë që të përshtaten dhe të rivendosin rendin në këtë mjedis operacional tashmë kaotik. Në këto kushte, Forcat e Armatosura duhet t'i kthejnë sfidat e mundshme, në mundësi, përmes largpamësisë, marrjes së rrezikut dhe iniciativës.

Parashikimi duke skanuar horizontin e paditur dhe duke analizuar tendencat në zhvillim, duke parashikuar ndryshimet teknologjike, i ndjekur nga eksperimentimi i hershëm me teknologjitë e reja, do të lejojë çdo ushtri moderne të kapërcejë kostot e inovacionit, të projektojë forcat për integrimin e shpejtë të teknologjisë së re dhe të zhvillojë një infrastrukturë të re mbështetëse për ato, duke i mundësuar atyre të kryejnë operacione me shumë drejtime.

Iniciativat për të eksploruar fushat relativisht të reja ushtarake, si hapësira kibernetike, apo edhe krijimi i lidhjeve midis ushtrisë, industrisë dhe arsimimit do të ofrojnë njohuri për teknologjitë në zhvillim që mund të integrohen në operacionet ushtarake. Në këtë mënyrë, përpjekja e kombinuar e fushave të interesit (parashikimi, marrja e rrezikut dhe iniciativa) sjell njohuri shtesë që FA duhet të menaxhojnë për të siguruar sukses në mjedisin e ardhshëm operacional.

Fjalë kyçe: mjedisi operativ, sfidat, teknologjia, kërcënimet hibride, NATO.

Hyrje

Aktualisht, mjedisi operacional po përballet me konkurrencën e ashpër globale për zhvillimin e inteligjencës artificiale dhe aftësive robotike. Pikërisht, agresioni rus ndaj Ukrainës tregon aktorët që fitojnë garën për epërsi dhe kanë shansin për të marrë epërsinë strategjike ndaj kundërshtarëve. Komplexiteti dhe avancimi i shpejtë i teknologjisë ka sjellë ndryshime në qasjen tradicionale ndaj konfrontimeve ushtarake, ku mjedisi i informacionit, automatizimi i proceseve të vendimmarrjes dhe veprimi ofrojnë hapësirën e preferuar luftarake për aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë, sepse siguron përfitimin e mosmarrjes së veprimeve të drejtpërdrejta. Kjo gjendje e mjedisit, e cila luhet vazhdimisht midis konkurrencës dhe konfliktit, zbulon mundësi me kohëzgjatje të shkurtër, e cila, nëse nuk shfrytëzohet në kohën e duhur, do t'i lejojë kundërshtarët e mundshëm të integrojnë proceset teknologjike në mjedisin operacional të pajisur të instrumentit ushtarak.

Në dokumentin e Strategjisë së Sigurisë Kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes së RSH theksohet se: *“Mbrojtja kibernetike është pjesë e detyrës kryesore të NATO-s, ku fokusi kryesor është mbrojtja e rrjeteve të veta (përfshirë operacionet dhe misionet) dhe rritja e qëndrueshmërisë në të gjithë Aleancën, duke forcuar vazhdimisht aftësitë e saj me edukimin, trajnimin dhe ushtrimet kibernetike.¹”*

Konfliktet specifike të shekullit të 21-të kanë treguar dimensionet në të cilat zhvillohen veprimet ushtarake në të gjitha fushat e mjedisit operacional, tokësor, detar, ajror, hapësinor, elektromagnetik dhe kibernetik, duke orkestruar përpjekjet për të angazhuar elementë ushtarakë dhe aleatë në mënyrë që të arrihen efekte sinergjike. *Lufta moderne kërkon fushata në një qasje gjithëpërfshirëse e të integruar, të koordinuar në disa fusha dhe që përfshijnë njëkohësisht dhe mbështetje të ndërsjellë.* Edhe pse toka, deti, ajri, hapësira dhe mjedisi kibernetik kanë karakteristika unike, jo rrallë secila duket të jetë e pavarur nga njëra-tjetra, megjithatë, të gjitha operacionet dhe fushatat bazohen në aspektet e sinergjisë midis fushave të veprimit.

Studimi i kërcënimeve që shfrytëzon dobësitë e identifikuara në nivel të mjedisit operacional është i rëndësishëm, sepse ndërkombëtarisht koncepti

¹ Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike, MM 2021-2023.pdf, faqe 3.

“hibrid” sot diskutohet me përparësi. Qëllimi i këtij studimi janë fenomenet e globalizimit, të cilat përcaktojnë ndërlidhjen midis shteteve dhe zhvillimit të teknologjisë, që ka çuar në nevojën e krijimit të aleancave politiko-ushtarake në përgjigje të kostos së madhe që kanë konfliktet e armatosura. Gjithashtu, elementët kombëtarë të mbrojtjes shkaktojnë fragmentimin variabël të mjedisit operacional që krijohet nga specifikat që kanë çdo shtet në përdorimin e mjeteve elektronike.

Globalizimi dhe përparimet teknologjike i lejojnë kundërshtarët, të cilët nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht struktura shtetërore të zhvilluara ekonomikisht ose kohezive shoqërore dhe politike, të sfidojnë aleancat e forta duke përdorur mjetet e pushtetit, kryesisht sepse ato janë avantazhi strategjik i fuqive të mëdha, siç janë kufizimet ekonomike dhe përdorimi i infrastrukturës së informacionit. Kjo presë me dy tehe, e përfaqësuar nga aksesit i lehtë dhe relativisht i lirë në disa zhvillime teknologjike, ofron një sërë opsionesh të reja për kundërshtarët joshitetorë për t'u përfshirë në veprime kibernetike për të prishur normalitetin, jetën, operacionet e përditshme dhe operacionet ushtarake. Ato komprometojnë informacione të ndjeshme dhe/ose teknike për të ndërprerë flukset e menaxhuara nga infrastruktura kritike, si energjia dhe rrjetet e inteligjencës. Zhvillimi i qenësishëm i teknologjive me përdorim të dyfishtë, veçanërisht në industritë që ofrojnë pajisje ushtarake, por edhe për përdorim familjar (kimia dhe biologjia), vazhdon ta bëjë të vështirë vlerësimin e teknologjisë. Duke pasur parasysh këto tendenca, të cilat parashikojnë një të ardhme të paqartë për mjedisin operativ, Organizata e Shkencës dhe Teknologjisë e NATO-s ka marrë rolin e ofrimit të anëtarëve të Aleancës analizën e plotë të sfidave të reja për mënyrën që të përdorin në përparimin teknologjik si një çështje e veçantë dhe e re. Në këtë drejtim, artikulli trajton shkurtimisht disa çështje në lidhje me tendencat transformuese të mjedisit operativ bazuar në studimet e strukturave kërkimore të Aleancës.

1. Tendencat e zhvillimit të mjedisit operacional

Kryesisht, evoluimi i situatës së sigurisë në nivel global evidenton tendencën e rikonfigurimit të ekuilibrit të fuqisë, si dhe tendencën për të përforcuar veprimet e tipit jokonvencional, asimetrik dhe hibrid. Duke pasur parasysh këto tendenca në zhvillim e kërcënimeve dhe veprimet e aktorëve të ndryshëm shtetërorë ose joshitetorë në mjedisin aktual operativ dalin skenarët e shfaqjes dhe manifestimit të një konflikti të armatosur, me implikime që përfshijn pjesëmarrjen e forcave të koalicionit ose aleancës në zona të zgjeruara. *Tendencat e përdorimit të veprimeve hibride, të kombinuara dhe të ndërlidhura me shfrytëzimin e dobësive të ndryshme, për arritjen e objektivave apo ambicieve strategjike në fusha të caktuara të interesit, përfaqësojnë peizazhin operacional që parashikon dekadat e ardhshme.* Mjedisi i ardhshëm

operacional pritet të karakterizohet nga prania e teknologjive në zhvillim, të cilat do të kenë rolin e rritjes së efektivitetit operacional dhe organizativ të Aleancës duke bërë zhvillimin e njohurive në vendimmarrjen, kapitalizimin e burimeve të besueshme të të dhënave në zhvillim, rritjen e efektivitetit të menuve operative të instrumenteve të fuqisë. Në këtë kontekst, në nivelin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, tetë fusha shumë të ndërlidhura të shkencës dhe teknologjisë konsiderohen me një rëndësi të madhe strategjike për vitet e ardhshme: vëllime të mëdha të dhënash, inteligjencë artificiale, hapësirë, sisteme autonome, bioteknologji, kuantike teknologjike, fusha hipersonike dhe materialet në zhvillim².

Duke pasur parasysh tendencat e zhvillimit dhe transformimin e mjedisit operacional, kërkohet një qasje e re ndaj qëllimeve klasike në të cilën analizohen fushat e saj aktuale, tokësore, detare, ajrore, hapësinore, elektromagnetike dhe kibernetike duke shtuar një element të ri të përcaktuar nga fusha e teknologjisë.

“Vendosja në efikasitet dhe kapaciteteve të zbulimit, analizës, zvogëlimit dhe masave të kundërpërgjigjes ndaj kërcënimeve kibernetike, duke u fokusuar në infrastrukturën kritike, rrjetet kompjuterike të lidhura me internetin dhe sisteme të tjera në interes të misionit të MM/FA-së”³.

Zhvillimi teknologjik në fushën e vëllimeve të mëdha të të dhënave, inteligjencës artificiale, sistemeve autonome, hapësirës dhe hipersonikës konsiderohet si prodhuese të efekteve të rëndësishme në mjedisin ushtarak, sepse zhvillimet në fushat teknologjike bazohen në përvoja të gjata dhe studime historike të studiuesve dhe shkencëtarëve. Ato tregojnë se çdo revolucion industrial ka çuar në një ndryshim në aftësitë ushtarake të shteteve që kanë pasur guximin, vizionin dhe mjetet ekonomike për të zbatuar përparimin shkencor. Si rezultat, transformimi domethënës, revolucionar i aftësive ushtarake ose është duke u zhvilluar ose do të ketë një ndikim të rëndësishëm në të ardhmen e afërt (5-10 vjet).

Zhvillimet e reja në bioteknologji, teknologjinë kuantike dhe studimin e materialeve të reja, të kategorizuara si në zhvillim, kërkojnë periudhë më të gjatë kohore që mund të nënkuptojë një perspektivë afatmesme (10-20 vjet) përpara se përdorimi i tyre të prodhojë efekte të rëndësishme në aftësitë ushtarake dhe mjedisin operacional. Efektet shkatërruese në mjedisin operacional ka shumë të ngjarë të materializohen përmes përdorimit të kombinuar të teknologjive të reja dhe ndërveprimeve komplekse ndërmjet tyre. Në këtë kuptim, zhvillimet, ndërveprimet dhe ndërvarësitë e mëposhtme konsiderohen jashtëzakonisht ndikuese për zhvillimin e aftësive ushtarake, duke qenë në gjendje të gjenerojnë

² Science & Technology Trends 2020-2040: Exploring the S&T Edge, NATO Science & Technology Organization, March 2020, p. 7 : https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2020/4/pdf/190422-ST_Tech_Trends_Report_2020-2040.pdf, accesat la 08.04.2021.

³ Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2021-2023.pdf, f.4.

disa tendenca në evoluimin e mjedisit operacional që duhen marrë parasysh për planifikimin e operacioneve ushtarake dhe për përshtatjen e proceseve shoqërore:

- Vëllime të mëdha të dhënash të kombinuara me inteligjencën artificiale dhe sistemet autonome do të gjenerojnë një kombinim sinergjik duke përdorur sensorë inteligjentë, të shpërndarë gjerësisht me entitete autonome (fizike ose virtuale) për të ofruar një avantazh të mundshëm vendimmarrës ushtarak në nivel strategjik dhe operacional.
- Vëllime të mëdha të dhënash të kombinuara me inteligjencën artificiale dhe bioteknologjinë do të kontribuojnë në hartimin e të dhënave të reja, modifikimin e qëllimshëm gjenetik dhe manipulimin e drejtpërdrejtë të reaksioneve biokimike.
- Vëllime të mëdha të dhënash të kombinuara me inteligjencën artificiale dhe lloje të reja materiale do të kontribuojnë në projektimin e materialeve të reja të përbëra me veti fizike.
- Vëllimet e mëdha të të dhënave të kombinuara me teknologjinë kuantike gjatë një horizonti 15-20 vjeçar do të rrisin aftësitë e mbledhjes, përpunimit dhe shfrytëzimit të të dhënave C4ISR përmes aftësive të zgjeruara të sensorëve, komunikimeve të sigurta dhe sistemeve kompjuterike jashtëzakonisht të fuqishme.
- Hapësira e kombinuar me teknologjinë kuantike do të gjenerojë pamjen e klasave krejtësisht të reja të sensorëve, të përshtatshëm për zbatimin në sistemet e reja satelitore ushtarake.
- Hapësira e kombinuar me fushën hipersonike dhe materialet e reja do të gjenerojë zhvillimin e produkteve të reja, të miniaturës, me mundësi të ruajtjes së energjisë që do të lehtësojnë zhvillimin e sistemeve të reja shtytëse me performancë të lartë me kosto të reduktuara dhe besueshmëri të shtuar.

Ndikimi i zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë ka pasur efekte të dobishme në aftësitë mbrojtëse të Aleancës dhe të vendeve anëtare të saj, gjë që ka çuar, gjatë 70 viteve të fundit zbatimin e strategjive të përshtatura me teknologjinë, duke kapitalizuar mbi këto avantazhe për të arritur efekte të rëndësishme intelektuale, politike, ekonomike dhe ushtarake. Megjithatë, vitet e fundit, këto avantazhe strategjike janë përballur nga sfida të shumta si dhe nga mangësitë apo keqkuptimet ekonomike, sociale dhe teknike. Siç theksoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg: “Përparësia teknologjike, e cila ka qenë gjithmonë një faktor kyç në aftësinë e NATO-s për të penguar dhe për t’u mbrojtur ndaj kundërshtarëve të mundshëm, do të varet nga aftësia jonë për të kuptuar, adoptuar dhe zbatuar teknologji të tilla si inteligjenca artificiale, autonomia dhe sistemet hipersonike. Në tetor 2019, ministrat e mbrojtjes miratuan një udhërrëfyes mbi teknologjitë në zhvillim dhe përçarës për të ndihmuar në strukturimin e aktiviteteve të NATO-s në fushat kryesore

të teknologjisë dhe për t'u mundësuar aleatëve të marrin në konsideratë implikimet e këtyre teknologjive për parandalimin dhe mbrojtjen, zhvillimin e aftësive, normat ligjore dhe etike, aspektet që lidhen me kontrollin e këtyre sistemeve të reja të armëve⁷⁴.

2. Efektet e zhvillimit të teknologjive të reja në mjedisin operacional

Parashikimi i mjedisit të ardhshëm të sigurisë më mirë se kundërshtarët e mundshëm është mënyra në të cilën Aleanca e Atlantikut të Veriut ka ruajtur vazhdimisht një avantazh konkurrues gjatë viteve përmes përdorimit të strukturave të inteligjencës dhe përpjekjeve të tyre për të mbledhur, përpunuar dhe analizuar të dhëna dhe informacion. Parashikimi është një aspekt kritik i përgatitjes informative të mjedisit operacional, i cili bazohet në elemente të njohurive solide të realitetit ekzistues dhe tendencave të evolucionit. Parashikimet e informacionit, zakonisht të bazuara në analiza të thella, nuk përpiqen të parashikojnë të ardhmen në detaje, por kërkojnë të ofrojnë një kontekst për parashikimin e zhvillimit, ndikimi i mundshëm i teknologjisë në operacionet e ardhshme të Aleancës.

Pyetjet përkatëse rreth mënyrës se si NATO do të jetë në gjendje të eksplorojë, zhvillojë dhe shfrytëzojë teknologjinë më të mirë dhe më të re që mund të sjellë avantazhe ushtarake ose çështjet e përfshira në këto teknologji ose ide shkencore, konsiderohen thelbësore për të formuluar strategji dhe doktrina të reja të përshtatura transformimet e qenësishme të mjedisit operativ. Për këtë qëllim, teknologjitë në përgjithësi mund të klasifikohen si⁵:

- **Në zhvillim:** ato teknologji ose zbulime shkencore që nuk përdoren gjerësisht aktualisht ose efektet e të cilave në funksionimin e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes së Aleancës nuk janë plotësisht të qarta dhe nga të cilat ato pritet të arrijnë pjekurinë në periudhën 20-vjeçare.
- **Përçarëse:** ato teknologji ose zbulime shkencore që pritet të kenë një efekt të madh, ose ndoshta revolucionare, në funksionimin e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes së Aleancës në periudhën 20-vjeçare.
- **Konvergjente:** një kombinim i teknologjive që mund të përdoren në një mënyrë të re për të krijuar efekte shkatërruese në mjedisin e sigurisë.

Duke pasur parasysh këto qasje konceptuale, ne duhet të pranojmë dhe të kuptojmë se jo të gjitha teknologjitë ose zbulimet shkencore mund të konsiderohen si në zhvillim, dhe efekti i tyre shkatërrues nuk përcaktohet vetëm nga komponenti teknologjik. Në një këndvështrim të ngjashëm, jo të

⁴ NATO: Ready for the Future - Adapting the Alliance (2018-2019), URL: https://www.nato.int/nato_static_files/2014/assets/pdf/pdf_2019_11/20191129_191129-adaptation_2018_2019_en.pdf, accesat la 07.05.2021.

⁵ NATO Science & Technology Organization, March 2020, p. 6.

gjitha teknologjitë në zhvillim do të jenë shkatërruese, jo të gjitha teknologjitë përçarëse po shfaqen dhe efekti i konvergencës nuk mund të nxitet nga shfaqja e teknologjisë⁶.

Kuptimi i procesit të zhvillimit dhe përdorimit të teknologjive në zhvillim është një kusht kyç për të kuptuar dhe vlerësuar efektet e tyre të mundshme në NATO dhe shtetet anëtare të saj⁷.

Konflikti i krijuar nga njeriu përfaqëson, në kuptimin klauzevician, një përplasje themelore vullnetesh midis grupeve të mëdha shoqërore. Gjatë një konflikti të tillë, qofshin ato ndërlyftuese me potencial të ngjashëm apo konfrontime asimetrike, teknologjia duhet të shfrytëzohet dhe të prodhojë efektet për të cilat është krijuar⁸. Ndërsa teknologjia bëhet më e aksesueshme dhe e domosdoshme për ekzistencën njerëzore, ajo do të fitojë një rol të madh në përdorimin e saj në konflikt. Siç vërejtj gjenerali Sir Richard Barrons, ish-komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta (MB), "E ardhmja e suksesit ushtarak do të jetë tani me ata që projektojnë, ndërtojnë dhe operojnë kombinime të teknologjive të bazuara në informacion për të gjeneruar fuqi të re luftarake"⁹.

Në një kontekst të gjerë strategjik dhe gjeopolitik, natyra e konfliktit konsiderohet të ndryshojë, me pajtimin e përgjithshëm se mjedisi teknologjik në transformim është një faktor domethënës dhe tashmë është një fushë referimi për analizën e mjedisit operativ. Kjo natyrë dinamike e konfliktit manifestohet në konceptet që lidhen me luftën hibride, hiperluftën¹⁰, luftën memetike¹¹ ose konfliktin e gjeneratës së ardhshme¹². Në secilën prej tyre,

⁶ Philip Breedlove, Margaret E. Kosal, "Emerging Technologies and National Security: Russia, NATO, & the European Theater", Governance in An Emerging New World, Winter Series, Issue 319, Hoover Institution, 25 February 2019, URL: <https://www.hoover.org/research/emerging-technologies-and-national-security-russia-nato-european-theater>, accesat la 12.10.2021

⁷ Frank G. Hoffman, Healthy Skepticism about the Future of Disruptive Technology and Modern War, Foreign Policy Research Institute, 4 January 2019, URL: <https://www.fpri.org/article/2019/01/healthy-skepticism-about-the-future-of-disruptive-technology-and-modern-war>, accesat la 13.10.2021.

⁸ Charlie Burton, "The advanced military technology that will win future wars", GQ Magazine, 10 February 2017, URL: <https://www.gq-magazine.co.uk/article/advanced-military-technology>, accesat la 14.10.2021.

⁹ Richard Barrons, "The nature of warfare is changing, It's time governments caught up", Wired, 14 October 2017, URL: <https://www.wired.co.uk/article/innovation-will-win-the-coming-cyber-security-war-richard-barrons-opinion>, accesat la 15.10.2021.

¹⁰ John R. Allen, Amir Hussain, "On Hyperwar", Proceedings, Volume 147, Issue 7, July 2017, U.S. Naval Institute, URL: <https://www.usni.org/magazines/proceedings/2017/july/hyperwar>, accesat la 14.08.2021.

¹¹ Jeff Giese, "It's Time to Embrace Memetic Warfare", Open Publications, Volume 1, Number 5, Spring 2017, NATO Strategic Communications Centre of Excellence Riga, URL: <https://www.act.nato.int/images/stories/media/doc/library/open201705-memetic1.pdf>, accesat la 15.10.2021.

¹² Frank G. Hoffman, "The Contemporary Spectrum of Conflict: Protracted, Gray Zone, Ambiguous, and Hybrid Modes of War", in Dakota L. Wood (editor), 2016 Index of U.S. Military Strength: Assessing America's Ability to Provide for the Common Defense, The Heritage Foundation, Washington, DC, 2015, URL: https://s3.amazonaws.com/ims-2016/PDF/2016_Index_of_US_Military_Strength_FULL.pdf, accesat la 12.09.2021.

teknologjitë përçarëse kombinohen me teknologjitë ekzistuese dhe aftësitë ushtarake për të krijuar mënyra dhe mjete të reja përdorimi në rast konflikti. Karakteristikat e përbashkëta që lidhin natyrën e këtyre teknologjive të reja janë inteligjenca, ndërlidhja, shpërndarja dhe forma dixhitale.

Sipas një raporti të fundit të NATO-s mbi zhvillimet shkencore dhe teknologjike që do të ndikojnë në mjedisin operacional gjatë 20 viteve të ardhshme, janë identifikuar katër karakteristika të përgjithshme që përcaktojnë teknologjitë e avancuara ushtarake¹³:

- **Inteligjente** - shfrytëzimi i integruar dhe integral i inteligjencës artificiale duke zhvilluar aftësitë e tyre analitike të fokusuara në njohuritë e AI-njerëzore dhe inteligjencën simbiotike për të ofruar aplikacione të ndryshme në të gjithë spektrin teknologjik.
- **Të ndërlidhura** - funksionimi i rrjeteve të domenit virtual dhe fizik, duke përfshirë rrjetet e sensorëve, organizatat, individët dhe agjentët autonome, të lidhur me metoda të reja të kriptimit dhe teknologjive të shpërndarjes së të dhënave.
- **Shpërndarëse** - përdorimi i sensorëve të avancuar për zbulimin, grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin në shkallë të gjerë të të dhënave të kudogjendura për të marrë efekte të reja përçarëse në fushën ushtarake.
- **Dixhitale** - kombinimi dixhital i fushave njerëzore, fizike dhe informative për të prodhuar një sërë efektesh të reja.

Bazuar në tendencat e mësipërme, mund të parashikohet se mjedisi i ardhshëm operacional i teknologjisë së lartë do të karakterizohet dhe madje do të drejtohet nga elementet e mëposhtme, në përputhje me karakteristikat e përgjithshme të teknologjive të avancuara ushtarake, të përmendura më sipër¹⁴:

- **Inteligjenca** - inteligjencë artificiale e integruar, analitike, me aftësi vendimmarrëse në të gjithë spektrin teknologjik të bazuar në sisteme autonome të pajisura me inteligjencë artificiale, të afta për një nivel të caktuar vendimmarrjeje autonome; inteligjencë hibride (integrim pa probleme e psiko - sistemet socio-teknologjike që mbështesin sjelljet sinergjike të sistemeve njeri-makinë) dhe analiza të avancuara të njohurive (metoda analitike të avancuara për eksplorimin e grupeve të mëdha të të dhënave dhe matematikë të avancuar për të ofruar njohuri këshilla të dobishme në procesin e vendimmarrjes).
- **Ndërlidhja** - rrjetet operuese të fushave reale dhe virtuale të mbivendosura, duke përfshirë sensorë, organizata, institucione, individë, agjentë autonomë dhe procese që përdorin sisteme të sigurta komunikimi (teknologjitë e regjistrit të shpërndarjes, shpërndarja kuantike), kriptografia post-kuantike dhe AI - cyber

¹³ NATO Science & Technology Organization, March 2020, p. 7.

¹⁴ Tech Trends Report 2019 - 12th Annual Edition, 2019, The Future Today Institute, URL: <https://futuretodayinstitute.com/2019-tech-trends>, accesat la 18.06.2021.

agjentë për të ofruar ndërveprime të sigurt për shkëmbimin e informacionit) dhe sisteme sinergjike (sisteme komplekse të përziera, sisteme fizike ose virtuale që lejojnë krijimin e ekosistemeve të reja, p.sh. qytetet inteligjente).

- **Distributiviteti** - zbulimi i decentralizuar dhe i kudondodhur në shkallë të gjerë, kapaciteti i madh i ruajtjes, llogaritjes dhe vendimmarrjes, kërkimi dhe zhvillimi.

- **Dixhitalizimi** - kombinimi i fushave njerëzore, fizike dhe informative për të krijuar realitete të reja fiziologjike, psikologjike, sociale dhe kulturore.

Këto tendenca të reja të zhvillimit teknologjik kërkojnë eksperimentim dhe inovacion për të gjeneruar produkte të qëndrueshme me aftësi veprimi në nivelin e aftësive ushtarake. Të katër elementët që korrespondojnë me karakteristikat e paraqitura teknologjike mund të kombinohen, duke gjeneruar tendenca të reja specifike për zhvillimin e aftësive ushtarake, si:

- **Inteligjenca + Shpërndarja, sistemet dhe agjentët:** sisteme të pajisura me inteligjencë artificiale me veti dhe mundësi veprimi autonome që zëvendësojnë dhe tejkalojnë aftësitë e qenies njerëzore dhe sistemet ekzistuese që deri më tani përdornin grupe rregullash fikse dhe nivele të ndryshme të kontrollit të drejtpërdrejtë njerëzor. Përdorimi i gjerë i sistemeve të inteligjencës artificiale do t'i lejojë sistemet autonome të marrin vendime dukshëm më të sofistikuar, të vetëdrejtojnë dhe, në të njëjtën kohë, të krijojnë një ekip hibrid, kompleks midis njeriut dhe makinës. Një përdorim i tillë i sistemeve inteligjente do të zgjerohet në mënyrë eksponenciale në realitetet tona sintetike, duke përfshirë rrjetet kibernetike¹⁵ dhe rrjetet sociale dixhitale. Subjektet autonome do të ofrojnë analiza të shpejta, këshilla dhe kurse veprimi për proceset e planifikimit në nivelet strategjike, operacionale dhe taktike, duke lejuar rritjen e efikasitetit të ciklit vëzhgim-udhëzim-vendim-veprim (vëzhgo - oriento - vendos - vepro / OODA). Rrjete të tilla inteligjente luftarake kanë potencialin për të rritur shpejtësinë e vendimmarrjes në nivele që do të kërkojnë metoda të reja të ndërveprimit dhe vizualizimit njeri-makinë. Konkurrenca që rezulton midis rrjeteve të betejës do të gjenerojë presione në rritje mbi algoritmet llogaritëse, secili duke kërkuar për një kombinim efektshëm për të siguruar një fitore vendimtare.

- **Rrjetet luftarake të ndërlidhjes + dixhitalizimi:** Evolucioni i shpejtë dhe miqësor ndaj mjedisit i rrjeteve C4ISR do të krijojë varësi të thella operacionale që mund të ndikojnë në veprimet ushtarake. Rrjete të tilla të avancuara luftarake do të bëhen lehtësisht një objektiv i mundshëm për ato të ngjashme, subjekt i konflikteve të bazuara në efekte. Rritja e varësisë nga lidhja e përsosur dhe e vazhdueshme do të rrisë mundësinë e përfshirjes së

¹⁵ David Goldfein, Jay Raymond, America's future battle network is key to multidomain defense, Defense News, 27 February 2020, URL: <https://www.defensenews.com/opinion/commentary/2020/02/27/americas-future-battle-network-is-key-to-multidomain-defense>, accesat la 19.08.2021.

rrjeteve të tilla në dezinformim, infektim dhe manipulim kibernetik. Sulmet e tilla kanë avantazhin e instrumentimit me shumë kohë përpara fillimit të një konflikti dhe mund të ketë efekte indirekte në flukset e furnizimit dhe logjistikës, personelit, informacionit, mbështetjes financiare ose të tjera.

• **Ndërlidhja + Shpërndarja.** Fushat operacionale po zgjerohen duke përfshirë hapësirën, fushën kibernetike dhe sferën e informacionit, nevoja për të menduar, planifikuar dhe operuar në një mënyrë gjerësisht të shpërndarë, të ndërlidhur dhe me shumë domene do të bëhet kritike, duke kërkuar vazhdimisht masa mbrojtëse, kërkesat e përshtatjes dhe rritje të kapaciteteve, të cilat do të gjenerojnë kosto dhe përpjekje të konsiderueshme.

• **Inteligjenca + Dixhitalizimi i Luftës Precision.** Një rritje në dixhitalizimin midis aftësive C4ISR, së bashku me miniaturizimin, përpunimin e të dhënave dhe kostot më të ulëta, ishin zhvillimet teknologjike që çuan në shfaqjen e sistemeve gjithnjë e më inteligjente, të ndërlidhura dhe luftarake, të shpërndara, duke gjeneruar zhvillimin të aftësive për të identifikuar objektivat dhe për të ekzekutuar të shtëna me precizion të lartë.

Inteligjenca artificiale është faktori kyç që do të ndryshojë peizazhin e mjedisit operacional dhe fizionominë e konflikteve të ardhshme dhe do të lejojë sistemet autonome dhe të ndërlidhura të kryejnë analiza, të përshtaten dhe të përgjigjen në një mënyrë të pavarur nga veprimet njerëzore. Këto ndryshime, nga ana tjetër, do të mbështesin një vendimmarrje më të mirë strategjike përmes analizave dhe skenarëve parashikues¹⁶. E gjithë kjo do të ndodhë në një kontekst sistemesh sinergjike dhe simbiotike që do të integrojnë sensorë, shoqëri dhe organizata.

Përfundime

Zhvillimi i teknologjisë në përgjithësi dhe i teknologjisë së informacionit në veçanti ka ndryshuar natyrën e konflikteve duke krijuar një nivel shtesë kompleksiteti të fushëbetejave tradicionale. Qasja e lehtë, pothuajse globale në mjedisin virtual, ka krijuar mundësi të panumërta për konflikte në internet, të cilat ndikojnë në ngjarje si në mjedisin fizik, në sistemet kompjuterike, ashtu edhe në sferën njohëse të qëndrimeve dhe besimeve të njerëzve.

Në këtë kontekst, aktorët aktualë shtetërorë dhe joshtetërorë përdorin një gamë të gjerë qasjesh hibride për të ndjekur objektivat e tyre politikë, ekonomike dhe ushtarake, duke kombinuar me mjeshtëri operacionet ushtarake me sulmet kibernetike, presionin diplomatik dhe/ose fushatat ekonomike dhe dezinformuese (propagandë). Gjatë dekadës së fundit, platformat e mediave

¹⁶ Trends Shaping the Future of Defense (The Tech in #3 Sounds Like Science Fiction), Lockheed Martin, 2018, URL: <https://www.lockheedmartin.com/en-us/news/features/2018/trends-shaping-future-defense.html>, accesat la 09.07.2021.

sociale janë bërë një nga llojet kryesore të kanaleve të komunikimit të përdorura. Infrastrukturat e informacionit të rrjeteve, rrjetet dhe platformat e komunikimit virtual janë bërë pjesë integrale e strategjive të reja ushtarake dhe të sigurisë. Konfliktet e fundit në Libi, Siri, Afganistan, Irak dhe Ukrainë kanë treguar se zhvillimi teknologjik i mjedisit të informacionit dhe përdorimi efektiv i aftësive të reja për të koordinuar veprimet, për të mbledhur informacion dhe më e rëndësishmja, për të ndikuar në besimet dhe qëndrimet e audiencës së synuar, mobilizimi i tyre shpesh për veprim, gjeneron nevojën për mirëkuptim dhe përafrim të kujdesshëm me tendencat për të ndryshuar objektivat klasike që përfshijnë planifikimin dhe kryerjen e veprimeve luftarake.

Natyra komplekse dhe adaptive e mjedisit bashkëkohor të sigurisë dhe paparashikueshmëria e tij vazhdojnë ta bëjnë të vështirë analizimin e informacionit dhe vëllimeve të mëdha të të dhënave dhe nxjerrin në pah idenë se zhvillimet teknologjike duhet të zbatohen dhe të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për sa më lart, edhe në sistemin e mbrojtjes të vendit tonë duhen vlerësuar mirë çështjet e lartpërmendura pasi ne jemi ne mesin e problemeve të vendeve anëtare të NATO-s apo të problematikës së teknologjisë së përdorimit të lartë për zgjidhjen e çështjeve madhore të sigurisë dhe mbrojtjes. Për më tej, tashmë është koha e të menduarit në mënyrë krijuese se çështjet e rishikimit apo të procesit të planifikimit të mbrojtës së vendit të vlerësohen seriozisht, në përshtatje me qëllimin dhe fushat e veprimit të bashkëlidhura me aleatët tanë strategjikë.

Bibliografia:

1. Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2021-12023.
2. Trends Shaping the Future of Defense (The Tech in #3 Sounds Like Science Fiction), Lockheed Martin, 2018, URL: <https://www.lockheedmartin.com/en-us/news/features/2018/trends-shaping-future-defense.html>.
3. NATO: Ready for the Future - Adapting the Alliance (2018-2019), NATO, 2019
4. https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2019_11/20191129_191129-adaptation_2018_2019_en.pdf.
5. Science & Technology Trends 2020-2040: Exploring the S&T Edge, NATO Science & Technology Organization, March 2020, URL: https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2020/4/pdf/190422-ST_Tech_Trends_Report_2020-2040.pdf.
6. Tech Trends Report 2019 - 12th Annual Edition, 2019, The Future Today

- Institute, URL: <https://futuretodayinstitute.com/2019-tech-trends>.
7. BREEDLOVE, Philip; Margaret E. KOSAL, "Emerging Technologies and National Security: Russia, NATO, & the European Theater", Governance in An Emerging New World, Winter Series, Issue 319, Hoover Institution, 25 February 2019, URL: <https://www.hoover.org/research/emerging-technologies-and-national-security-russia-nato-european-theater>.
 8. BURTON, Charlie, "The advanced military technology that will win future wars", GQ Magazine, 10 February 2017, URL: <https://www.gq-magazine.co.uk/article/advanced-military-technology>.
 9. GOLDFEIN, David; Jay RAYMOND, America's future battle network is key to multidomain defense, Defense News, 27 February 2020, URL: <https://www.defensenews.com/opinion/commentary/2020/02/27/americas-future-battle-network-is-key-to-multidomain-defense>.
 10. HOFFMAN, Frank G., Healthy Skepticism about the Future of Disruptive Technology and Modern War, Foreign Policy Research Institute, 4 January 2019, URL: <https://www.fpri.org/article/2019/01/healthy-skepticism-about-the-future-of-disruptive-technology-and-modern-war>.
 11. Ligjet kryesore që lidhen me sigurinë dhe krimin kibernetik: Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 2/2017 "Për sigurinë kibernetike"; Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në RSh", i ndryshuar; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar; Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar; Ligji nr. 107, datë 15.10.2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar.

SFIDAT E SIGURISË DHE RRIJTA E BASHKËPUNIMIT MES AKTORËVE SHTETËRORË DHE JOSHTETËRORË NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa
Specialist në IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Sfidat e sigurisë rajonale dhe rritja e bashkëpunimit mes aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në rajonin e Ballkanit Perëndimor është një çështje sa e trajtuar, po aq e ngarkuar me peshën e të panjohurave që kryesisht vijnë si rezultat i dinamikave e të zhvillimeve të paparashikuara që sjell mjedisi i sigurisë në ditët e sotme në një rajon ku ende ka mosmarrëveshje dhe problematika të pazgjidhura dhe ku çdo ditë e më tepër po bëhen prezent interesat dhe ndikimet e aktorëve të tretë. Këta aktorë të ndërthurur me ndikim mbi njëri-tjetrin me shfaqje e qëllime të kamufluara, hibride dhe asimetrike formatizojnë gjithnjë e më shumë mjedisin e sigurisë dhe gjithë aspektet e jetës në zhvillimet sociale-politike, ekonomike, teknologjike, kulturore, sportive, fetare dhe pse jo, edhe aspektet ushtarake.

Sot më shumë se kurrë sfidat e sigurisë janë të shumëllojta, të ndërlikuara, të ndërthurura dhe të ndërvarura midis tyre dhe me një ndikim të jashtëzakonshëm dhe sfidues në rang global, rajonal e kombëtar, duke mbajtur nën presion dinamik të vazhdueshëm mjedisin e sigurisë. Analizat, debatet apo diskutimet e kësaj natyre të adresuara për rajonin e Ballkanit e atij Perëndimor në veçanti, duhen parë e vlerësuar me një ndikim apo lidhje logjike dhe të alternuar nga influenca e aktorëve gjeopolitikë, jo vetëm rajonal, por edhe më gjerë deri tek ato me ndikim global.

Mikro-rajoni i Ballkanit Perëndimor¹ është një nocion i ri gjeopolitik i krijuar pas rënies së murit të Berlinit dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Ballkani Perëndimor përmbledh gjashtë shtete: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia, fillimisht edhe Kroacia tashmë anëtare e Bashkimit Evropian. Ballkani Perëndimor është i vetmi rajon sot i pa integruar në Bashkimin Evropian pavarësisht qasjes dhe përpjekjeve të ndryshme në këtë rrugëtim, nga ana tjetër, tre nga shtetet e rajonit janë tashmë anëtare të NATO-s, Kosova është me prezencën ushtarake të Aleancës së Atlantikut të Veriut prej 21 vitesh, ndërsa dy të tjerat nuk kanë avancuar në këtë drejtim.

Fjalët kyçe: siguri, rajon, Ballkan Perëndimor, bashkëpunim, BE, kërcënim, gjeopolitika, etj.

¹ Ballkani Perëndimor është një grup vendesh që janë në qendër të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ky grup fillimisht përbëhej nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova. Kroacia u bashkua me Bashkimin Evropian në vitin 2013 dhe për këtë arsye nuk është më në këtë grup nga politika e BE-së në Ballkanin Perëndimor.

1. Rajoni i Ballkanit dhe Ballkani Perëndimor, një vështrim i shkurtër historik

Rajoni i Ballkanit është pjesë integrale me rëndësi gjeopolitike për Evropën dhe shtrihet në jug e juglindje të këtij kontinenti. Në të shkuarën ai është vlerësuar si një brez përplasjeje dhe ka shërbyer si zanafilla e dy konflikteve të mëdha botërore. Sot një sërë shtetesh të Ballkanit janë anëtare të NATO-s dhe të BE-së, ndërsa pjesa e tjetër e mbetur jashtë BE-së por jo plotësisht jashtë NATO-s, sot quhet Ballkani Perëndimor apo siç është vlerësuar, një mikro-rajon gjeopolitik që shtrihet në pjesën perëndimore të gadishullit me të njëjtin emër dhe ka një kuatacion të ri në rrafshin gjeografik, politik, ekonomiko-kulturor, i cili në të ardhmen do të trajtohet si një identitet më vete edhe në aspektin historik.

Ballkani Perëndimor është term gjeografik dhe politik². Fillimisht, ky term u përdor nga politikë- bërësit amerikanë dhe evropianë për të përshkruar pjesën e Gadishullit Ballkanik që mbeti jashtë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Bashkimit Evropian (BE) që nga fillimi i viteve 1990. Ai përfshinte të shtatë shtetet që u formuan pas shpërbërjes së ish-Republikës Federative të Jugosllavisë (Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia) së bashku me Shqipërinë, e cila po dilte nga izolimi ndërkombëtar. Vendet e rajonit u orientuan drejt integritimit Evropian dhe që nga ajo kohë Sllovenia në vitin 2004 dhe Kroacia në vitin 2013 janë bërë anëtare të BE-së³. Ndër gjashtë vendet e mbetura, katër janë vende kandidatë për të hyrë në Bashkimin Evropian dhe tre të tjerat janë aktualisht anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Ballkani Perëndimor sot vlerësohet si rajoni më i varfër dhe i prapambetur i Evropës dhe i vetmi i pa integruar në Bashkimin Evropian. Kjo qartësohet edhe më shumë nëse u hedhim një vështrim të shpejtë statistikave rreth mjedisit jetësor të këtij rajoni, i cili banohet nga një popullsi prej rreth 17.6 milion

² Lindita Nikolla, fjala ne Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, në Athinë, 22 Tetor 2021.

³ Oxford Bibliographies, Janusz Bugajski last reviewed: 03 june 2019, I aksesueshëm në: <https://www.oxfordbibliographies.com/view/document/obo-9780199743292/obo-9780199743292-0094.xml>

banorë, në një hapësirë gjeografike me rreth 207.284 km² dhe prodhim të brendshëm bruto rreth 556 miliardë dollarë, me një infrastrukturë dhe mjedis teknologjik në zhvillim e me diferenca të mëdha me pjesën tjetër të zonës ekonomike të Evropës. Kjo hapësirë, si një etnitet i ri gjeopolitik krahasohet me Mbretërinë e Holandës si popullsi, me prodhim të brendshëm bruto afërsisht sa gjysma e saj dhe një sipërfaqe pesë herë më të madhe.

Integrimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian është një objektiv dhe aspiratë që bashkon të gjitha vendet tona, pavarësisht qasjeve, ritmit dhe pozitive specifike të secilit prej gjashtë vendeve të rajonit aktualisht. Njëkohësisht, kjo aspiratë mbështetet me të gjitha energjinë dhe vullnetin nga vendet anëtare të bashkimit evropian, politika e të cilëve është tashmë e kthjelluar se Evropa e Bashkuar është e mangët pa integrimin e Ballkanit Perëndimor dhe se vonesat apo gabimet në këtë proces do të jenë kosto e madhe shumëdimensionale dhe e papërballueshme për vetë atë dhe rajonin tonë në veçanti në të ardhmen. Gjendja mbetet problematike, duke pasur parasysh se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë kushtet bazë dhe kryesore për zgjerimin e BE-së.

Zhvillimet e fundit në Ukrainë pas sulmit të armatosur rus e kthejnë procesin e anëtarësimit të rajonit në domosdoshmëri të një rëndësi të veçantë të kohës. Problemet e integrimit të rajonit janë më aktuale se kurrë edhe për shkak të agjendave konfliktuale që mund të transferohen nga rajonet lindore të Evropës në rajonin tonë të trazuar.

Mbështetja për integrimin e Ballkanit Perëndimor ishte një nga çështjet kryesore gjatë vizitës së kancelarit gjerman Scholz në SHBA dhe takimit me Presidentin Joe Biden, siç edhe njoftoi ambasadorja amerikane Juri Kim⁴ në Twitter se: “Ne gjithashtu rikonfirmuam angazhimin tonë për të përfunduar punën për integrimin e Ballkanit Perëndimor, në institucionet evropiane dhe për të realizuar përfundimisht një Evropë të plotë, të lirë dhe në paqe. Gjermania është një nga aleatët më të ngushtë të Amerikës. Ne po punojmë në hap për të penguar më tej agresionin rus në Evropë dhe për të adresuar sfidat e paraqitura nga Kina dhe për të promovuar stabilitetin në Ballkanin Perëndimor”⁵.

2. Siguria, sfidat e saj dhe evoluimi i mjedisit të sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Siguria, si një koncept i gjerë, analizon faktorët dhe aktorë predominantë që përcaktojnë në tërësi zhvillimin normal e të qëndrueshëm të mjedisit jetësor të shoqërisë njerëzore dhe i paraprin procesit të përshtatjes dhe parakushteve për evoluimin e tij për të ardhmen. Ballkani Perëndimor si një mikro-rajon

⁴ Ambasador Yuri Kim (@USAmbAlbania) 08.02.2022.

⁵ Po aty.

gjeopolitik është në vartësi dhe ndikim të vazhdueshëm të mjedisit të sigurisë rajonale evropiane dhe atij global. Këtë realitet e konkretizon edhe një pasqyrim i shkurtër i historisë, gjeografisë politike, demografisë dhe sjelljes së Ballkanit, si një rajon gjeopolitik kryesisht gjatë dy luftërave botërore dhe Luftës së Ftohtë dhe në vijimësi ngjarjeve tragjike pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në mënyrë të veçantë, etapa të cilat është e vështirë të ndahen si me thikë.

Krijimi i një realiteti të ri gjeopolitik, ku ka fillesat edhe nocioni i Ballkanit Perëndimor deri tek ndryshimet cilësore pas anëtarësimit në NATO i një pjese të vendeve të rajonit, siç janë aktualisht Shqipëria, Mali Zi, Maqedonia e Veriut dhe aspiratat e Kosovës e Bosnjës për të qenë pjesë e saj në të ardhmen, i jep atij një ngjyrim të ri. Serbia aktualisht nuk ka agjendë në këtë drejtim të paktën deri më sot. Një proces tjetër i rëndësishëm dhe që implikon pozitivisht mjedisin e sigurisë, kohezionin dhe zhvillimin e gjithanshëm të tij është integrimi në Bashkimin Evropian i rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky proces ka sfidat specifike të veçanta për çdo vend dhe vështirësi të përbashkëta të imponuara nga diferencat midis tyre dhe rajonit ku do të anëtarësohemi në tërësi.

Shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor janë të orientuara drejt vlerave dhe aspiratave evropiane dhe euroatlantike, pavarësisht dinamikës së brendshme zhvillimit social-ekonomik specifike, apo kompleksitetit politik dhe agjendave nacionaliste. Ato janë të angazhuara në garantimin e të drejtave të grupeve të ndryshme etnike dhe pakicave fetare, por mungesa e zhvillimit social-ekonomik, polarizimi politik, rritja e ndjenjave nacionaliste dhe mungesa e besimit të ndërsjellë mund të nxisin tensione dhe dhunë ndëretnike, me pasoja për rajonin dhe më gjerë⁶.

Mjedisi aktual i sigurisë karakterizohet nga një nivel i lartë kompleksiteti, i cili vjen si pasojë e ekzistencës së predominimit të aktorëve të ndryshëm shtetërorë ose jo, shfaqjes së sjelljes dhe fenomeneve të reja, të cilat përbëjnë kërcënim për zhvillimet shoqërore. Këtë situatë të paqartë rreth rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor e ndërlikon dhe vendos në trysni të vazhdueshme mentaliteti i trashëguar i ndërthurur me burokracitë e shumta që kushtëzojnë ndërveprimin në nivele të ndryshme të brendshëm e rajonal dhe përballje gjithnjë e në rritje me ndikimin e aktorëve të tretë e global të mjedisit të sigurisë. Kjo natyrë komplekse e kërcënimeve dhe rreziqeve të sotme imponon një qasje të re gjithëpërfshirëse të mikro-rajonit tonë për të përballuar sfidat e zhvillimit të kohës, kostot integruese brenda për brenda rajonit e më gjerë dhe intensifikimin të marrëdhënieve midis aktorëve të rinj; zhvillimeve teknologjike dhe paparashikueshmërisë së intensitetit të ndryshimeve të mjedisit të sigurisë.

⁶ Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, 2019, kreu II, faqe 3.

Aktualisht po trajtojmë sfidat që karakterizojnë rajonin tonë, duke reduktuar analizën në atë që mund të themi këto janë më ballkanase, pa dashur që të nënvleftësojmë ndikimin e padiskutueshëm të çdo lloji sfide globale mbi rajonin dhe lidhjet organike që ekzistojnë sot mes aktorëve globalë e rajonale në një botë gjithnjë e më të globalizuar, si pasojë e zhvillimeve kryesisht të teknologjisë, e ndërveprimit të aktorëve potencialë që predominojnë në tërësi zhvillimet e mjedisit të sigurisë. Sfida specifike mund të cilësojmë bisedimet Kosovë-Serbi për njohje të ndërsjellë, rrezikun e dezintegritit të B&H, procesi i anëtarësimit në NATO e vendeve si Serbia, si dhe sfidat që mund të vijnë si rezultat i eksportimit të krizës ukrainase në rajonin tonë.

Disa nga sfidat në rrafshin rajonal/kombëtar të cilat mendoj të trajtoj janë: sfidat politike etnike, kulturore e fetare; korrupsioni; krimi organizuar, terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm; mungesa e burimeve për përballjen me pandemitë; kërcënimi ushtarak konvencional; sulmet kibernetike, kërcënimet hibride, dezinformimi i opinionit publik.

• ***Sfidat politike, diplomatike, etnike, kulturore e fetare.***

Marrëdhëniet politike në rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor, edhe pse vijnë nga një trashëgimi problematike të mbarsura me konflikte e divergjenca e diferenca nga njëri vend në tjetrin. Ato kulmuan me konfliktin e armatosur para dy dekadash, kanë pasur një përmirësim të dukshëm dhe pak a shumë një kohezion të admirueshëm përse i përket procesit të integritit në Bashkimin Evropian, për të cilin të gjitha vendet tona kanë një objektiv pak a shumë të ngjashëm, pavarësisht stadiit ku ato ndodhen aktualisht në këtë qasje. Përse i përket anëtarësimit në NATO-s, problemi është disi më delikat, pasi tre nga gjashtë shtete janë anëtare de facto të Aleancës: Shqipëria, Mali Zi, Maqedonia e Veriut, ndërsa Kosova ka një status të veçantë të përkohshëm, sepse siguria ofrohet nga trupat e NATO-s dhe aderon për të qenë pjesë e NATO-s. Serbia nuk ka shprehur interes dhe as aplikuar për në NATO dhe Bosnja është e dyzuar, për shkak të republikës Sërbska.

Aktualisht, sot kërcënimi më i dukshëm në planin politik janë mosmarrëveshjet mes Kosovës dhe Serbisë dhe ngecja e bisedimeve për zgjidhjen e tyre deri në arritjen e dakordësisë për njohje reciproke. Kjo problematikë edhe si shkak i joeficencës së institucioneve të BE-së për ta orientuar këtë dialog, si dhe pengesave të vazhdueshme nga pala serbe për të pranuar një realitet të ri në Ballkan, që është të qenit objektiv i një shteti të ri që prej 2008, që quhet Republika e Kosovës e njohur nga mbi 115 vende të Botës, përfshi këtu SHBA-në dhe shtetet kryesorë të BE-së. Mungesa e efektivitetit të institucioneve evropiane shihen disi të mefshta apo nganjëherë të njëanshme, duke parë se për kohëzgjatje apo çfarë tjetër, dy përfaqësuesit e BE-së, Borrel dhe Lajçak vijnë nga vende që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës, si Spanja dhe Sllovenia.

Këtë e tregojnë edhe qëndrimet e disa shtetarëve apo përfaqësuesve evropianë gjatë vizitave në Beograd apo gjetiu në Bosnje kur gryojnë apo shohin me njëanshmëri problemin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis Kosovës dhe Serbisë dhe stabilizimin dhe relaksimim e marrëdhënieve midis tyre.

Për të konkretizuar atë që në fakt është realitet, po ofrojmë reagimin e përfaqësuesit të lartë të BE-së, z. Borrell, gjatë vizitës së tij në Beograd më 25 janar 2022. Në bisedimet me kryeministren serbe, ai harron neutralitetin e rolit të ndërmjetësit dhe akuzon se “Kosova ka treguar më shumë mungesë dëshire për të marrë pjesë në dialog⁷”. Nuk kuptohet se çfarë lloj diplomacie ndërmjetësimi është kjo, kur arbitri apo ndërmjetësi i dialogut publikisht mban anën serbe dhe sulmon Kosovën dhe inkurajon Serbinë në obstruksionizmin e saj kolonial. Nuk e di askush se ku e pa spanjulli Borrell gatishmërinë e Serbisë për dialogun, kur Beogradi vjeshtën e kaluar dy herë me radhë mobilizoi forcat ushtarake në kufijtë me Kosovën dhe kërcënoi me luftë, duke pasur përkrahjen direkte ruse. Nuk e di askush, madje as serbët vetë, se çfarë hapi apo lëshimi ka bërë Beogradi, kur Serbia nuk ka ndërmarrë as gjestin më të vogël për pranimin e realitetit politik të shtetit të pavarur të Kosovës, të sanksionuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në korrik 2010 me vendimin e saj për përputhjen e pavarësisë së Kosovës me ligjet ndërkombëtare dhe me rezolutën 1244 të KS të OKB.

Duke iu referuar rëndësisë së këtij procesi, Presidenti i Francës Emanuel Macron, në konferencën për shtyp më 09.12.2021, ka veçuar Ballkanin Perëndimor, si një nga prioritetet gjatë presidencës që ai do të drejtojë në 6-mujorin e parë të vitit 2022. Macron theksoi se: “Rajoni i Ballkanit përfaqëson një aksion shumë të rëndësishëm për dekadat në vijim. Ne nuk mund ta lemë Ballkanin Perëndimor, i cili është në zemër të Evropës, të qëndrojë duarkryq dhe ndërkohë që fuqitë e huaja kërkojnë të na destabilizojnë⁸”.

Nga ana tjetër, diversiteti fetar duhet të jetë përbashkues për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duke ditur se secili vend ka pak a shumë një mazhorancë fetare të një besimi, por të bashkëshoqëruar me minorancë të një besimi tjetër. Këto marrëdhënie janë vendimtare për një kohezion, paqe e qetësi në rajonin tonë. Nuk do të ndalem në detaje, por do të sjell shembullin e vendit tonë, si model të këtij kohezioni që për hir të së vërtetës do të ishte një “ilaç shërues”, nëse përqalet nga të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo vetëm në mjedisin tonë etno-kulturor të BP.

Problem shqetësues për sigurinë në nivel kombëtar e rajonal mbeten financimi i partive politike, deformimi i vullnetit të publikut, ndërhyrjet në zgjedhjet nga aktorë të brendshëm apo jashtëm, për interesa të grupimeve që mund të

⁷ Shaban Murati, Formula e dialogut Kosovë-Serbi që parashtrroi Eskobar në Prishtinë, duke pasur në krah të dërguarin e BE-së; 2 shkurt 2022.

⁸ Macron, në konferencën për shtyp në datën 9.12.2021, ka veçuar Ballkanin Perëndimor, si një nga prioritetet gjatë presidencës që ai do të drejtojë në 6-mujorin e parë të vitit 2022.

kenë për qëllim arritjen e objektivave të tyre politikë dhe përzgjedhin aktorët që mund të jenë shtrat për mbrojtjen e interesave të tyre apo aplikimin e doktrinave të tyre të ngjyrave apo imponimeve nga më të ndryshme.

Në lidhje me aspektet e zhvillimit dhe avancimit të proceseve demokratike, revista e njohur “The ekonomist”, botuar në gazetën drita thekson se: “Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut kaluan pragun e “demokracive të dobëta” (me probleme) në “Indeksin e Demokracisë 2021” të këtij viti të publikuar nga Economist Intelligence Unit. Në këtë kategori mbeten Serbia dhe Shqipëria, ndërsa në kategorinë e regjimeve hibride Bosnja dhe Hercegovina”⁹.

• *Korrupsioni.*

Korrupsioni mbetet një problem mjaft shqetësues për zhvillimin e vendeve të rajonit, ai ndonjëherë vlerësohet si problemi më kyç i ngecjes ekonomike, varfërisë dhe cenimit të demokracisë. Korrupsioni në vetvete gërryen demokracinë, dëmton opinionin publik dhe minon mirëqeverisjen, deformon tregun e lirë, mjegullon transparencën, dëmton konkurrencën e ndershme, talentin dhe shpirtin krijues, keqpërdor financat publike, ushqen krimin, e terrorizmin.

Aq aktual është problemi i korrupsionit në rajonin dhe shoqëritë tona ballkanase, sa i dërguari special i SHBA-së për rajonin Gabriel Escobar në një intervistë dhënë për gazetën boshnjake “Dnevni Avaz”, botuar në gazetën “Tema” më 01.02.2002, thekson ndër të tjerat se “ Korrupsioni është problemi më i madh në Ballkanin Perëndimor”¹⁰.

• *Krimi i organizuar.*

Krimi i organizuar është një tjetër problem madhor për vendet e rajonit; ai nuk njeh kufij dhe ka implikim shumë më të gjerë se hapësira e mini-rajonit tonë gjeopolitike, prandaj, për vetë vëmendjen që sot i kushtohet nga të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo vetëm, e kemi trajtuar si problematikë specifike e zhvillimeve aktuale. Aktorë të krimit të organizuar, pavarësisht ndasive dhe etniteteve të ndryshme të rajonit, gjejnë gjuhën e tyre të përbashkët kur iu kërcënojnë interesat apo veprimtaritë e tyre dhe jo rrallë, kthehen në kërcënim serioz për sigurinë dhe përfshihen apo nxisin për interesa të tyre konflikte sociale me bazë fetare apo etnike.

Trafiku i drogës mbetet një gangrenë për rajonin tonë kryesisht si vende tranziti për drogat e forta, që vijnë nga Afganistani apo nga Amerika Latine drejt Evropës. Kartelet e vendeve tona në tërësi kanë rritur veprimtarinë në këtë drejtin dhe kanë thelluar konkurrencën me organizata tjera jashtë rajonit për zona influence.

⁹ Gazeta Dita, 11.02.2022; Indeksi i demokracisë, “The ekonomist”, Shqipëria përmirësohet serish në renditje.

¹⁰ Escobar, Gabriel, intervistë dhënë për gazetën boshnjake “Dnevni Avaz”, gazeta “Tema”, datë 01.02.22.

Pastrimi i parave dhe investimi i tyre në veprimtari të dyshimta dhe jo ligjore, apo përfshirja e tyre për të financuar organizatat apo forcat të ndryshme politike mbeten një problematikë mjaft delikate për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Informaliteti i ndërlidhur edhe me pastrimin e parave që vijnë nga veprimtari të paligjshme e bën edhe më kërcënues mjedisin për një zhvillim të balancuar e të gjithanshëm të vendeve të rajonit tonë.

• ***Terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm, luftëtarët e huaj.***

Terrorizmi mbetet një kërcënim global, por këtu do të trajtohet si një *kërcënim rajonal* për arsye se sot, Ballkani Perëndimor është i rikonfirmuar për pjesëmarrjen e shtetasve nga rajoni përkrah ISIS apo organizatave të tjera të këtij karakteri dhe vlerësohet si një territor i kërcënuar nga të riatdhesuarit. Nga ana tjetër, vendet e saj shërbejnë jo vetëm si rrugëkalim të trafikut të paligjshëm të qenieve njerëzore, por edhe si objektiva të grupeve terroriste siç kanë treguar eksperiencat e mëparshme, aq më tepër sot si vende anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut, e shoqëri që bien në kundërshtime qasjet e tyre radikale. Burimet kryesore të këtij kërcënimi pa nënvleftësuar edhe terrenin e brendshëm rajonal vijnë kryesisht nga vendet në konflikt të Lindjes Mesme, Afrikës Veriore, Irakut, Afganistanit etj. Mbi këtë cilësi rajoni mbart një potencial të madh rreziku për shfrytëzimin apo penetrimin e anëtarëve të ish-shtetit islamik apo grupeve të tjera terroriste, që kanë objektiv vendet perëndimor e pse jo edhe ato të rajonit tonë të Ballkanit Perëndimor. Po t’iu referohemi konflikteve të dekadës së fundit në Irak, Afganistan e së fundmi atij në Siri dhe shtetit islamik në veçanti, me qindra ish-in shtetasit e rajonit që iu bashkuan jo vetëm shtetit islamik, por edhe Al Kaidës apo organizatave e veprimtarive të tjera të jashtëligjshme, të cilat direkt apo indirekt kanë një efekt të vazhdueshëm kërcënues për rajonin tonë.

• ***Sfida: mungesa e burimeve për përballjen e pandemive.***

Siguria kombëtare sot nuk lidhet vetëm me aspektin e sovranitetit kombëtar dhe integritetit territorial nga një sulm ushtarak apo aktorë të tjerë jokonvencionalë apo asimetrikë. Vitet e fundit bota dhe për pasojë edhe rajoni ynë u përballën me një sëmundje të rrezikshme, e cila u shndërrua në një pandemi, duke u bërë një sfidë reale për sigurinë kombëtare, duke sjellë sjellje dhe praktika të panjohura, përveç anës shëndetësore edhe ato politike, ekonomike, sociale të brendshme e në marrëdhëniet ndërkombëtare e rajonale. Ajo gjithashtu influencoi direkt në marrëdhëniet e vendeve tona të brishta me burime të pamjaftueshme njerëzore, financiare, materiale e një mentalitet jo adekuat për t’u përshtatur me këto situata jo të zakonshme apo hibride siç jemi mësuar t’i theksojmë tashmë.

Vendet e rajonit tonë treguan se interesat kombëtare dhe të sigurisë nuk janë çështje më vete, por ato duhen pare në kompleksitet dhe të veprohet në unison përkundër sa këto përballje të çojnë drejt disfatave. Bashkëpunimi dhe ndihma

reciproke ishin etaloni i humanizmit gjatë kësaj situatë. Shembull për t'u analizuar ishte ndihma dhe solidariteti midis vendeve të rajonit, veçanërisht ndihma që një shtet i vogël si Shqipëria i afroji një vendi pjesëtar i G-7, siç është Italia, duke përdorur kështu një soft polici, e cila mund të përkthehet si bonus për interesat dhe imazhin tonë kombëtar. Megjithatë ne si rajon duhet të shohim më tej dhe mësimet e nxjerra t'i përdorim për t'u përballur në të ardhmen me ngjarje të tilla që atakojnë sigurinë e rajonit, duke shkëmbyer informacion dhe rritur bashkëpunimin në fushën shëndetësore dhe duke ofruar ndihmë të menjëhershme për vendet apo rajonet më të prekura.

Rritja e investimeve dhe mbështetja dhe forcimi i kapaciteteve në fushën e shëndetit publik e veçmas, strategjitë kombëtare, transparenca në bashkëpunimi rajonal, parashikimin në kohë, krijimin e rezerva dhe reagimin e duhur për përballjen me pandemitë të ndryshme përbën një çështje madhore që lidhet direkt me interesat kombëtare dhe të ardhmen e rajonit tonë të Ballkanit Perëndimor. Pa diskutim që pasojat e shkaktuara nga pandemia do të rëndojnë disi edhe mbi buxhetet e mbrojtjes në një periudhë të paktën afatshkurtër duke kërkuar rrugë dhe mundësi të reja për mbështetjen me burime të agjencive që gjenerojnë siguri dhe për investim smart mes vendeve të rajonit, duke shfrytëzuar edhe klimën shumë më të përshtatshme pas pranimit në Aleancën e Atlantikut të Malit të Zi dhe së fundmi Maqedonisë së Veriut apo në kuadër të marrëveshjeve të tjera më natyrë rajonale.

• ***Kërcënimi ushtarak konvencional.***

Kërcënimi ushtarak përbën një sfidë aktuale për rajonin me gjithë përparimin e dukshëm të evoluimit të mjedisit të sigurisë në rajoni e Ballkanit Perëndimor, ai mund të shfaqet nga ambicjet e vendeve të rajonit për heqjen e mbi lloj teorish apo mund të vijë si një implikim apo amplifikim e ngjarjeve nga jashtë rajonit tonë. Kërcënim ushtarak mund të ketë një natyrë tradicionale të një konflikti konvencional të brendshëm apo rajonal, por mund të jetë edhe objektiv i një konflikti më të gjerë apo të një natyre tjetër miks, konvencional, të ndërthurur me një sulm hibrid të ngjashëm me ndërhyrjen në Krimë në vitin 2014, deri tek ai bërthamor duke parë cilësinë e rajonit ku 3 nga 6 vendet e rajonit janë anëtare të NATO-s tashme në konflikt të hapur me Rusinë dhe njëra prej tyre Kosova *de facto*, jo *de jure* pjesë e saj, pasi NATO ekzekuton tashmë një operacion për sigurinë e paqes në këtë vend. Këtë të fundit e përforcon më shumë fakti se disa faktorë të rëndësishëm në Rusi janë shumë më të avancuar në kërkesa të tyre për një veprim më të avancuar dhe ekstrem ndaj Perëndimit dhe objektivave të NATO-s në veçanti. Duke analizuar këtë qasje analistja Fjona Hill në New York Times 25.02.2022 thekson se “Përfaqësues rusë thanë se Moskë nuk ka nevojë për një paqe me çdo kusht me Evropën. Madje disa politikanë rusë sugjerojnë mundësinë e një sulmi parandalues

kundër objektivave të NATO-s për t'u siguruar që Perëndimi ta dijë se kushtet tona janë serioze dhe se ata duhet t'i përmbushin"¹¹.

Tashmë, që agresioni i hapur i forcave të armatosura ruse mbi Ukrainë është fakt, mendojmë se një pushtim i shpejtë i plotë dhe afatgjatë i këtij vendi do të jetë i vështirë dhe me kosto të jashtëzakonshme politike ekonomike dhe mbi të gjitha njerëzore jo vetëm për Ukrainën, por edhe për vetë Rusinë. Pasojat besojmë se do të jenë edhe shumë më të mëdha në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, zgjidhjen e krizave, mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të natyrave nga më të ndryshme që sot janë prezent kudo në rang global. Nisur nga historia dhe mësimet e saj, Evropa nuk duhet të përsërisë gabimet që u bënë në prag të Luftës së Dytë Botërore në raport me Hitlerin, besimi dhe lëshimet i dhanë atij frymëzim për avancim në rrugën e tij pa kthim, duke shkaktuar katastrofën më të madhe në historinë e njerëzimit. Perëndimi dhe SHBA duhet të tregojnë në mënyrë të kthjellët e të vendosur se me masat e ndërmarra ndaj këtij veprimi arbitrar të Putinit dhe mbështetjen e gjithanshme ndaj Ukrainës do të jenë të vendosur deri në fund për zgjidhjen e këtij konflikti. Gjithashtu, vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak të lidhjeve dhe pozicionit gjeografik me këto ngjarje, duhet të analizojnë me gjakftohtësi dhe durim problematikat që ekzistojnë të pazgjydhura në rajon në mënyrë që të adresohen sa me shpejt mes bisedimeve, dialogut dhe bashkëpunimit reciprok, pasi nga lufta, konflikti dhe përdorimi i forcës nuk ka të fituar.

Tendencat separatiste, mosmarrëveshjet territoriale, për pakicat, përplasjet e agjendave qeveritare, ndarjet me sfond etnik apo fetare apo çfarëdo gjyre apo natyre tjetër, janë një kërcënim real për sigurinë, paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Probleme më shqetësuese mbetet destabiliteti i BiH nga sjelljet dhe përpjekjet për të mos njohur realitetin atje dhe krijimin e një situatë të re në raport me ato çfarë është përcaktuar në "Marrëveshjen e Dejtonit" dhe kushtetutën e këtij vendi. Aktorët kryesorë të këtij momenti turbullues me implikime gjeopolitike, jo vetëm të rajonit por më gjerë, mbeten udhëheqësi nacionalist i republikës Serbska, Millorad Dodik, i frymëzuar dhe mbështetur nga aktorë të ndryshëm kryesisht serbë, rusë dhe jo vetëm, por edhe nga përfaqësues të Bashkimit Evropian, deputet i të djathtës franceze e deri te kryeministri hungarez Orban. Ajo që ka më shumë interes, por që edhe nxit një dyshim të madh është implikimi i Komisionerit të BE-së Varhelyi i dyshuar se ka ndihmuar dhe nxitur këtë të fundit në përshkallëzimin e përpjekjeve për shkëputje të Republikës Serbe të BiH. Siç u shpreh euro-deputetja Katalin Cseh në Twitter 1.47 PM, 12.01.2022: "...Me kolegët anëtarë të Parlamentit Evropian, ne bëjmë thirrje për një hetim mbi rolin e supozuar të komisionerit Varhelyi që ndihmon përshkallëzimin separatist të Milorad Dodik në Bosnje-

¹¹ Fjona Hill, New York times, Perëndimi duhet të vlersojë seriozisht kërkesat tona.

Hercegovinë. Bashkimi Evropian duhet të qëndrojë fuqishëm dhe me besim në anë të njerëzve të paqes në BiH dhe përtej qartësisht në këtë çështje”¹².

Dodik ka kërcënuar me tërheqjen nga institucionet kryesore të shtetit duke bërë ndryshime ligjore që i mundësojnë atij të arrijnë qëllimet e tij politike, duke krijuar institucione e saj para shtetërore, deri tek krijimi i ushtrisë, duke shkelur kështu mbi “Traktatin e Paqes së Dejtonit” dhe kushtetutën e vendit. Nisur nga kjo situatë, përfaqësuesi i lartë për BiH, Christian Schmidt e ka quajtur lëvizjen e Dodikut “...të barabartë me shkëputje”¹³. Mund të konkludojmë se sjellje e qëndrime të tilla paralajmërojnë nxitje të ndarjeve në vija etnike, nacionale, përplasje dhe deri në konflikte të dhunshme e armatosura me pasoja të pallogaritshme për mjedisin e sigurisë në rajonin tonë e më gjerë.

Duke vlerësuar situatën aktuale të sigurisë dhe trendin e zhvillimeve në rajon, profesori Edward P. Joseph në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, në artikullin “Shqipëria e Madhe nuk i intereson SHBA-së”, thekson se: “Siç shkruajmë ne në raport përkeqësimi alarmues në rajon është “i vullnetshëm”, SHBA-ja, BE-ja dhe NATO-ja e mbajnë përparësinë strategjike në rajon (ndryshe nga situata në Ukrainë), është e pamundur për të kuptuar se tridhjetë vjet pas shpërthimit të luftës, përsëri flitet për luftë në Bosnje-Hercegovinë, konfrontim në Kosovë dhe tensione të pashembullta në Mal të Zi”¹⁴.

Shqetësimet e perëndimit në lidhje me zhvillimet gjeopolitike në rajonin tonë shihen edhe tek angazhimet e SHBA-së BE-së dhe së fundmi me caktimin e një përfaqësuesi diplomatik në rajonin e Ballkanit Perëndimor nga Mbretëria e Bashkuar. Ky është një tregues tjetër serioz dhe një goditje e fuqishme e projeksioneve serbe dhe ruse për dominim e influenca, pengim apo vonim të integriteteve euroatlantike apo imponimin e agjendave të tyre për zhvillimet e ardhshme. Për më tepër, kësaj gjendjeje i mëshon ndërhyrja kineze kryesisht në fushën financiare dhe buxhetimin e projekteve me procedura e interesa të papërbalueshme për vendet tona me kapacitete të kufizuara duke kthyer këto në borxhe dhe barrë rrënuese për ekonominë tona respektive. Shembulli më i freskët është investimi në autostradën e Malit të Zi etj. Për këto dhe një mijë e një arsye që ka rajoni ynë, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse e perëndimit (SHBA, BE, Britania e Madhe) për situatën e pastabilizuar në Ballkanin Perëndimor dhe bëhet edhe me imperative nga zhvillimet e fundit në Ukrainë, nga ku duhet të nxirren mësimet e të merren masa parandaluese për të reaguar me kohë, veçmas për rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor. Është më se e qartë se pas Ukrainës, territori ballkanik do të jetë cak i sulmeve, diversioneve, keqinformimeve dhe kërcënimeve e qasjeve të tjera hibride të

¹² Katalin Cseh, në Twitter, datë 12.01. 2022, ora 1.47 PM.

¹³ Christian Schmidt, Gazeta telegraf 12.01.2022

¹⁴ Edward P. Joseph, “Shqipëria e Madhe” nuk i intereson SHBA-së-Konica.al, <https://konica.al/2002201/22>.

vazhdueshme të Moskës dhe jo vetëm, por edhe atyre Kineze, nga Lindja e Mesme, Irani deri në instrumentalizimin e konflikteve civile e deri ushtarake në rajon. Nga ana tjetër, bashkimi i të gjithë aktorëve perëndimorë mundëson shkëputjen e Serbisë nga ndikimi gjeopolitik i Ruisë dhe njëkohësisht zbutjen e marrëdhënieve në rajon veçanërisht ato midis Serbisë dhe Kosovës, edhe pse qëndrimi i Serbisë pas sulmit ushtarak rus mbi Ukrainë e zbehu këtë shpresë.

Janusz Bugajski duke analizuar situatën aktuale gjeopolitike në rajon thekson: “Nëse Kremli vendos për një tjetër sulm ushtarak kundër Ukrainës, ai gjithashtu do të krijojë shpërqendrimet tjetërkund.Dy konfrontime të njëkohshme po krijohen në rajon – një në Bosnje-Hercegovinë dhe një në Mal të Zi – dhe ato mund të përkohet me një pushtim tjetër të Ukrainës nga Rusia. Thirrjet për ndarje nga Bosnje-Hercegovina të Republika Srpska, e cila është instrumenti kryesor i Moskës, do të ndezin fitilin e konfliktit të armatosur”¹⁵.

Në fakt ideja se Rusia është kthyer në Ballkanin Perëndimor nuk është e vërtetë. Rusia post-sovjetike nuk e la kurrë rajonin, por mënyra se si ajo projektonte fuqinë ka ndryshuar ndjeshëm që nga fillimi i viteve 1990. Në vitet 2000, nëpërmjet rritjes së prezencës në rajon, Rusia u përpoq të ndërtonte mekanizma për të pasur ndikim politik. Synimi kryesor i Ruisë në Ballkanin Perëndimor është të sjellë multipolaritet, paqëndrueshmëri e pasiguri të vazhdueshme duke penguar integrimin e rajonit në BE. Politika e Ruisë i ka sjellë asaj fitore taktike, por deri më tani ajo nuk ka arritur të shkaktojë një përmbyesje strategjike të lëvizjes së ngadaltë, por të qëndrueshme të rajonit drejt institucioneve perëndimore. Më 27 shtator, në Moskë agjencia pro qeveritare ruse “Regnum” promovoi librin e ri “Kosova, Serbia dhe Rusia”, nën kujdesin dhe redaktimin e drejtorit të kësaj agjencie Vladimir Zotov, ku paraqitet një përmbledhje e analizave të analistëve kryesorë rusë dhe serbë për raportet midis tre shteteve. Në librin e ri drejtori Vladimir Zotov paraqet edhe analizën e tij me titullin interesant “Kosova është Rusi”.

Është hera e parë që analistika diplomatike ruse del publikisht me tezën e re që “Kosova është Rusi” dhe nuk është Serbi. Kemi të shprehur tashmë hapur thelbin e politikës dhe të strategjisë së Ruisë në lidhje me Kosovën, të cilat fokusin e kanë jo tek mbrojtja e Serbisë, por tek interesi makro diplomatik dhe gjeopolitik rus për Ballkanin dhe për Evropën.

Libri i ri analitik rus i publikuar më 27 shtator e shpreh shumë qartë këtë strategji ruse me Kosovën: “Nëse Rusia do të ruajë atë që ka mbetur nga prania e saj në Ballkan, ajo duhet në mënyrë kategorike të refuzojë miratimin e çdo marrëveshje lidhur me ndryshimin e statusit të Kosovës. Nëse Rusia bie dakord me njohjen nga Beogradi të pavarësisë, Rusia do të humbë përgjithmonë Serbinë dhe

¹⁵ Janusz Bugajski, gazeta Dita, 06 Shkurt, 2022. “Pse Ballkani Perëndimor do përdoret si objektivi kryesor për diversion nëse Kremli vendos sulm ushtarak ndaj Ukrainës”.

*Ballkanin. Statusi i Kosovës është e vetmja gjë që e mban Rusinë në Ballkan*¹⁶.

Gjendjes dhe problematikave të rajonit iu përkushtua dhe Franca si drejtuese e unionit në periudhën e ardhshme gjashtëmujore. Gjatë takimit me presidentin e Francës për mundësitë e zgjidhjes së konfliktit, presidenti rus Vladimir Putin theksoi se: “Nëse Ukraina bëhet pjesë e NATO-s dhe nëse vendosin të rimarrin Krimenë ushtarakisht, vendet e evropiane automatikisht do të jenë në luftë me Rusinë”...Kapacitetet ushtarake të NATO-s dhe Rusisë janë të pakrahasueshme. Nuk do të ketë fitues. Ne do të donim ta shmangnim këtë dhe kjo është arsyeja pse Macron është këtu¹⁷.

Një konflikt i armatosur mund t'i ketë rrënjët apo shkaktarët edhe si rezultat i disbalancave kryesisht të mini-rajonit tonë këtë e tregojnë jo vetëm raportet mes aktorëve ushtarakë në tërësi, por edhe raportet financiare apo GDP e vënë në dispozicion të forcave të armatosura. Konkretisht, vitet e fundit Ballkani Perëndimor është përfshirë në rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes dhe riarmatimit, shpesh të shoqëruar nga një gjuhë e fortë për një garë armatimesh dhe konkurrencë ushtarake¹⁸. Në vitin 2017, Serbia shpenzoi 731 milionë dollarë amerikanë për ushtrinë e saj, më shumë se të gjitha vendet e tjera të marra së bashku. Shqipëria shpenzoi 162 milionë dollarë, Maqedonia 112 milionë dollarë dhe Mali i Zi 74 milionë dollarë¹⁹.

Në vitin 2019, buxhetet e mbrojtjes u rritën në të gjithë rajonin dhe konkretisht 9,8 % në Shqipëri, 14 % në Mal të Zi, 20,3 % në Kroaci, 27,7 % në Maqedoninë e Veriut dhe 35% në Serbi. E gjithë kjo i ka lejuar këto shtete të investojnë më shumë në modernizimin ushtarak. Rritja më e madhe e buxhetit të mbrojtjes është në Serbi. Serbia ka marrë shumicën e armëve të reja nga Rusia, duke përfshirë avionë (Mig 29), helikopterë (Mi-17V-5 dhe Mi-35M) dhe sistemet e mbrojtjes ajrore (Pantsir-S1)²⁰.

Rreziku i një sulmi konvencional mund jetë si shkak edhe i të qenit anëtar i NATO-s, siç dhe theksohet në SSK të RSH: “Ndonëse i reduktuar shumë, rreziku konvencional ndaj Shqipërisë nuk mund të përjashtohet. Një sulm ushtarak ndaj njërit prej aleatëve të NATO-s konsiderohet si rasti më tipik në të cilin Shqipëria mund të përfshihet në një konflikt konvencional²¹. Ndoshta një vlerësim i tillë vlen edhe për vendet e tjera të rajonit tonë, tashmë anëtare të NATO-s.

¹⁶ Vladimir Zotov, libri “Kosova, Serbia dhe Rusia”; viti 2021, faqe 7.

¹⁷ Deklaratë e V. Putin, publikuar në Telegraf.com 10.02.22. info@telegrafi.com

¹⁸ Filip Ejdus, The Spectre of an Arms Race in the Western Balkans, IFSH – Institute for Peace Research and Security Policy at the University of Hamburg | 2020 fq 1.

¹⁹ Blerim Reka, A new military build-up in the Balkans, January 10, 2019, I aksesueshëm në: <https://emerging-europe.com/voices/a-new-military-build-up-in-the-balkans/>

²⁰ Filip Ejdus, The Spectre of an Arms Race in the Western Balkans, IFSH – Institute for Peace Research and Security Policy at the University of Hamburg | 2020 fq 3

²¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, faqe24.

Megjithatë ka vend për optimizëm, pasi iniciativat e reja në rrafshin kryesisht ekonomik në rajon kanë përparësi sot dhe mund të çojnë në një mjedis sigurie në një shtrat gjithnjë e më të qete. Këtu ka vend për të diskutuar edhe për iniciativën e fundit aq të diskutuar të Ballkani të Hapur, i cili pak a shumë ngjan me Shengenin (Schengen) në 1985. Asokohe nga 10 vende anëtare të BE-së, vetëm 5 nënshkruan për të: Danimarka, Italia apo Greqia ishin skeptike, sepse e shihnin si një përpjekje për fuqizimin e mëtejshëm të bllokut franko-gjerman. Por krijimi i kësaj zone dhe tregu të përbashkët në këtë periudhë të ekzistencës së tij provoi se solli zhvillim për të gjithë unionin (rritje ekonomike, balancim të bilancit tregtar, të ardhura të shtuara për-kapital etj.); duke bindur me kalimin e kohës edhe më skeptikët dhe nacionalistët për dobinë e iniciativave të tilla gjithëpërfshirëse.

Ky shembull duhet të shërbejë për t'u treguar më të duruar dhe bashkëpunues, "open mind" në lidhje më këtë lëvizje të re në rajon si: Kosova, Bosnja, pse jo edhe Mali i Zi, për t'u lënë kohë që të shihen rezultatet e para konkrete të kësaj iniciative dhe ndikimet e saj në gjeopolitikën e mikro-rajonit tonë të Ballkanit Perëndimor, aq më tepër pas ngjarjeve në Ukrainë. Deri më tani ajo që kemi parë nga Ballkani i Hapur është marrëveshja mes Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë që gradualisht deri në 2023 të krijohet një treg i përbashkët për ne më shumë se 11 milionë banorë; ku qytetarët lëvizin pa kurrfarë pengese, kapitalet, shërbimet, mallrat gjithashtu etj. Njëkohësisht punëtorëve të të gjitha kategorive dhe studentëve pa përjashtime u lejohet të lëvizin, punojnë dhe arsimohen në secilin prej këtyre shteteve pa pengesa e zvarritje burokratike pa viza, për leje qëndrimi, kontrata pune etj.

Kosova, ashtu siç trajtohet edhe nga shumica e opinionit mund të jetë problemi më i mprehte në këtë ndërmarrje, pasi ajo nuk ka njohjen nga Serbia, si një nga shtetet anëtare të kësaj nisme, edhe pse atë njohin shtatë shtetet e grupit më të rëndësishëm ndërkombëtar G7, e njohin rreth dy të tretat e shteteve anëtare të OKB-së. Problematike përveç çfarë theksuam më lart janë pesë vendet anëtare të BE, plus Vatikani, si një shtet teokratik kristian, i cili duhet ta dijë se, 19 shtetet anëtare të NATO-s, që ndërhyjnë për të çliruar Kosovën nga Serbia në vitin 1999, ishin të gjitha shtete kristiane. Këto paqartësi janë një barrë që rendojmë mjedisin tonë të sigurisë edhe post asaj se ne e perceptojmë atë disi të relaksuar sot e jashtë agjendave të një konflikti të armatosur për njëmijë e një arsyje, por ngjarjet në Lindje të Evropës, duhet të vënë në alarm rajonin tonë, edhe për shkak të mungesës së kohezionit mbi ngjarjet e fundit në Ukrainë.

• ***Sulmet kibernetike, kërcënimet hibride, dezinformimi i opinionit publik.***

Sot kërcënimet dhe rreziqet kanë evoluar, krahas atyre me natyrë konvencionale, sot kemi një avancim të agjendës së sulmeve kibernetike, kryesisht kundër infrastrukturës kritike të subjekteve të shënjestruara duke krijuar kaos dhe

turbullira të natyrës financiare, ekonomike apo ato të fushës së siguresë.

Në zonën gri mes luftës dhe paqes apo siç mund vlerësojmë ndryshe një gjendje evazive në teorinë moderne të luftës ka evoluar koncepti i luftës hibride, që nënkupton angazhimin e kapaciteteve ushtarake dhe jo ushtarake, me qëllim të arritjes së objektivave politikë. Kur flasim për këtë zonë gri, lufta hibride merr formën që qëndron jashtë formave tipike konvencionale dhe jokonvencionale të luftës, duke përjashtuar elementin e dhunës në veprimet për arritjen e objektivave shtetërore në shumicën e rasteve.

Zhvillimet e vullshme të teknologjisë së informacionit, dronët dhe armët hipersonike, inteligjenca artificiale e bioteknologjia në tërësi janë faktorë parësorë të formësimit të mjedisit të sigurisë në të ardhmen, me ndikim në qasjen dhe mënyrën e të menduarit për çështjet që lidhen me sigurinë në tërësi, të cilat luajnë një rol shumë më ndikues në një rajon të tillë si Ballkani Perëndimor, kryesisht për shkak të kufizimeve të burimeve e kapaciteteve, njohjes së mentalitetit të rajonit. Konkretisht, ndryshimi më i thellë vjen nga ndikimi i teknologjisë mbi vetë sistemet demokratike të dobëta dhe pakonsoliduara siç mund të konsiderohen ato të rajonit tonë në përgjithësi.

Kërcënimet hibride me natyrë politike, ekonomike, ushtarake, etj sot janë trend i kohës dhe kërkojnë një qasje të balancuar mbi analiza shumë të mire menduara dhe më qëndrime pro aktive gjithëpërfshirëse, të agjencive shtetërore ligj zbatuese dhe jo vetëm, por edhe aktorëve të tjerë jo shtetëror. Kërcënimet hibride, përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit, operacioneve klandestine të inteligjencës, diplomacisë, kërcënimin mbi përdorimin e forcës ushtarake, mjeteve ekonomike dhe financiare e madje edhe dobësive në infrastrukturën ligjore të një vendi, synojnë të influencojnë aspekte të politikës, informacionit dhe aspekte njohëse përbrenda një shoqërie²².

Konkretisht, konflikti mes Rusisë dhe Ukrainës me fillesat në vitin 2014 më aneksimin e Krimesë, mbështetjen e separatistëve në rajonet lindore të vendit, po shoqërohet me informacione dezinformuese dhe propagandë, siç është rasti i mediave ruse që përcjellin qëndrimin nga ministria e jashtme ruse për gjoja rekrutime dhe përgatitje nga vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Kosova dhe Bosnja) të mercenarëve që do angazhohen përkrah Ukrainës, kundra trupave ruse. Këto inskenime kanë një qëllim të qartë për të shtrirë dhe intensifikuar veprimet e stabilizuese ruse dhe aleatëve të saj në këto vende të rajonit, dhe njëkohësisht për të gjete justifikim për këto sjellje dhe pasojat e tyre.

Për të konkretizuar sa thuhet më lart, po sjellim në vëmendje deklarin e ministrit të Jashtëm rus Lavrov i cili thekson se: “Kosova dhe disa pjesë të tjera të Ballkanit Perëndimor po bëhen vatër krimi. Ka terroristë, tregtarë droge. Mercenarët rekrutohen atje për konflikte ushtarake të nxitura nga Shtetet e

²² Jan Joel Andersson, Thierry Tardy, “Hybrid operations: Lessons from the past”, EUISS, 2015, f.2

Bashkuara..... dhe se autoritetet ruse po punojnë për të verifikuar informacionet për “mercenarët” nga Shqipëria, Kosova dhe Bosnja që shkojnë në Ukrainë”²³.

Përfundime

Mjedisi i sigurisë dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor me gjithë zhvillimet e bëra nuk mund të merren si të garantuara. Tensione të shumta mund të vënë në rrezik të madh paqen në rajon dhe në Evropë. Konfliktet mes kombësive, përplasjet gjeopolitike, nxitja dhe kërcënimet e ekstremizmit dhe radikalizmit, qeverisja e dobët, masat e dhimbshme ekonomike, si dhe kërkesa e vazhdueshme për reforma, tregojnë se shumë probleme mund të zbulohen në të ardhmen e mjedisit të sigurisë në Ballkan.

Pas ngjarjeve në Ukrainë, çdo marrëveshje në rajon duhet të rivlerësohet në kontekstin e ri të mjedisit të sigurisë në Evropë dhe qasjeve drejt rajonit të këtyre ndodhive me pasoja të paparashikueshme.

Shqipëria, nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me vendet e rajonit, promovimit të paqes dhe sigurisë, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me dialog dhe avancimit në procesin e integritit Evropian, konsolidimit të demokracisë përmirësimit të qeverisjes, rritjes së transparencës dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, avancojnë dhe mbështet interesat jetësore kombëtare.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë domosdoshmëri anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si caku ku zgjidh njëherë e mirë të ardhmen e vet, zgjidh mosmarrëveshjet duke lënë pas të shkuarën që ka shoqëruar me aq konflikte dhe vuajtje populje e rajonit tonë dhe vijon rrugën për të ndërtuar një të ardhme të begatë.

Bibliografia:

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2014.
2. VKM, nr. 628, datë 25.09.2019 “Rishikim Strategjik i Mbrojtjes, KM, Tiranë, 2019.
3. Iulian Chifu, “Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations”, Bukuresht , 2019.
4. Christopher Stevens dhe Jane Kennan në parathënien e librit “Reform in Eastern Europe and the Development Country Dimension”, viti 1992.
5. Lindita Nikolla, fjala ne Konferencën e Kryetarëve të Paramenteve të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, në Athinë, 22 Tetor 2021.
6. Oxford Bibliographies, Janusz Bugajski last reviewed: 03 june 2019, I aksesueshëm në: <https://www.oxfordbibliographies.com/view/document/obo->

²³ Ministri jashtëm Rus Lavror. Albanian MEFA (@AlbanianDiplo), Gazeta Shqiptare, Shkurt 18, 2022. Kosova mohon pretendimet ruse për “rekrutim mercenarësh” për luftë në Ukrainë.

9780199743292/obo-9780199743292-0094.xml

7. Stanislav Secrieru, “Rusia in the Uestern Balkans”, EUISS, 2019.
8. Shaban Murati, Formula e dialogut Kosovë-Serbi që parashtroi Eskobar në Prishtinë, duke pasur në krah të dërguarin e BE-së; 2 shkurt, 2022.
9. Macron, konferencë për shtyp, publikuar nga Le Parisien, datë 9.12.2021, ku ka veçuar Ballkanin Perëndimor, si një nga prioritetet gjatë presidencës që ai do të drejtojë në 6-mujorin e parë të vitit 2022.
10. Gazeta Dita, 11.02 2022 Indeksi i demokracisë, “The economist”. Shqipëria përmirësohet serish në renditje.
11. Robert D. Blackwell and Jennifer M. Harris, For a thorough and absorbing discussion on geoeconomics, see, War by Other Means: Geoeconomics and Statecraft (Cambridge: Harvard University Press, 2016).
12. Gabriel Escobar, intervistë dhënë gazetës boshnjake “Dnevni Avaz; publikuar nga gazeta Tema 01.02.22.
13. Fjona Hill, “Perëndimi duhet të vlerësojë seriozisht kërkesat tona”, New York Times.
14. Chistian Schmidt, gazeta Telegraf 12.01.2022.
15. Edward P. Joseph “Shqipëria e Madhe” nuk i intereson SHBA-së-Konica.al, <https://konica.al/2002201/22>.
16. Janusz Bugajski, gazeta Dita, 6 shkurt, 2022, “Pse Ballkani Perëndimor do të përdoret si objektiv kryesor për diversion, nëse Kremlinin vendos sulm ushtarak ndaj Ukrainës”.
17. Vladimir Zotov, libri “ Kosova, Serbia dhe Rusia”.
18. Telegraf.com 10.02 22. [info@telegrafi .com](mailto:info@telegrafi.com)
19. Filip Ejodus, The Spectre of an Arms Race in the Western Balkans, IFSH – Institute for Peace Research and Security Policy at the University of Hamburg | 2020
20. Blerim Reka, A new military build-up in the Balkans, January 10, 2019, I aksesueshëm në: <https://emerging-europe.com/voices/a-new-military-build-up-in-the-balkans/>
21. Filip Ejodus, The Spectre of an Arms Race in the Western Balkans, IFSH – Institute for Peace Research and Security Policy at the University of Hamburg | 2020.
22. Joel Andersson, Thierry Tardy, “Hybrid operations: Lessons from the past”, EUISS, 2015.
23. Ministri jashtëm Rus Lavror. Albanian MEFA (@AlbanianDiplo), Gazeta Shqiptare, shkurt 18, 2022.

NATO 2030, E BASHKUAR PËR NJË EPOKË TË RE

Kolonel Emëror Hajdarasi
Shef Departamenti në FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Mjedisi i sigurisë jashtë hapësirës së NATO-s ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga viti 2010, kur u publikua Koncepti Strategjik më i fundit i NATO-s. Ky koncept rekomandonte realizimin e një partneriteti strategjik me Rusinë, përmendte terrorizmin, por nuk përmendej Kina. Qysh atëherë e deri sot në mjedisin e sigurisë së NATO-s kanë ndodhur ndryshime thelbësore, të cilat ka të ngjarë të intensifikohen gjatë dekadës së ardhshme dhe kërkojnë përpjekje më të mëdha si në kohezionin politik, ashtu edhe në përshtatje me strategjinë e NATO-s.

Kërcënimet dhe rreziqet si: terrorizmi, sfidat e sigurisë të paraqitura nga pandemitë, ndryshimet klimatike dhe flukset migratore vazhdojnë të përbëjnë një sfidë të madhe për Aleancën. Ndryshimi i disa elementeve në instrumentet e fuqisë si: aftësitë kibernetike dhe ato hapësinore do të vazhdojnë të ndryshojnë natyrën e konfliktit. Megjithatë, karakteristika kryesore e mjedisit aktual të sigurisë është rishfaqja e konkurrencës gjeopolitike, përshkallëzimi i rivaliteteve agresive dhe mosmarrëveshjeve për zgjerimin e territoreve, zotërimin e burimeve dhe të pasurive natyrore.

Në dekadën e ardhshme zhvillimet teknologjike do të luajnë një rol në rritje në mjedisin e sigurisë, si në konkurrencën sistematike, ashtu edhe në rritjen e kërcënimeve ndërkufitare të sigurisë. Qysh nga themelimi i NATO-s, perëndimi ka qenë në krye të kërkimit dhe zhvillimit në inovacionet kritike për stabilitetin dhe sigurinë. Por Kina dhe Rusia tani po i alokojnë burime të konsiderueshme

të kësaj fushe në një përpjekje për të kapërcyer Perëndimin. Teknologjitë e reja do të ndryshojnë natyrën e luftës dhe do të mundësojnë forma të reja sulmesh duke përdorur armë të teknologjisë së lartë dhe operacione hibride. Popullsia në zonën euroatlantike duhet të mbrohet nga kërcënimet e reja si ato kibernetike, por edhe nga format e tjera të luftës hibride. Prandaj shtetet të mbështetura nga NATO duhet të marrin masa për parandalimin dhe mbrojtjen nga këto kërcënime të luftës moderne, por rezistenca bazë duhet të qëndrojë brenda shoqërive të shteteve respektive.

Ky shkrim do të vijojë në numrin e ardhshëm të Revistës, ku do të trajtohen çështje të tilla si: Qëllimi politik i NATO-s në shekullin e 21-të; Mënyrat e reagimit të NATO-s në dekadën e ardhshme, si dhe Forcimi i kohezionit politik dhe unitetit të saj.

Fjalët kyçe: NATO 2030, mjedisi i sigurisë, kohezion, kërcënim kibernetik, Rusia, aleanca, luftë hibride, Kina.

Hyrje

Në nëntor të vitit 2019, shtetet e vendeve anëtare të NATO-s i kërkuan Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg të bëjë një parashikim për të ardhmen e NATO-s në 10 vitet e ardhshme. Në përgjigje të këtij angazhimi, NATO publikoi më 8 qershor 2020 “NATO 2030 Initiative”. Si pjesë e kësaj iniciative, Sekretari i Përgjithshëm deklaroi se NATO do të angazhohet me liderë të rinj, të cilët do të ofronin mendime të qarta për forcimin e dimensionit të mëtejshëm politik të Aleancës, si dhe për përballjen me sfidat e sigurisë në dekadat e ardhshme.

Më 9 nëntor 2020, Jens Stoltenberg lajmëroi themelimin e grupit të liderëve të rinj të NATO-s 2030 “NATO 2030 Young Leaders Group”. Grupi përbëhet nga 14 liderë të rinj nga vendet anëtare të NATO-s të përzgjedhur nga Programet për Leadershipin e ri, të cilat menaxhohen dhe financohen nga organizata dhe institute të rëndësishme në Evropë dhe SHBA. Ata përfaqësojnë fusha të ndryshme profesionalizmi, nga studiues/hulumtues deri tek inxhinierë të hapësirës dhe diplomatë. Grupi kreu konsultime të gjera brenda dhe jashtë NATO-s, duke përfshirë studiues, drejtues nga sektori i biznesit dhe teknologjisë, parlamentarë, zyrtarë ushtarakë dhe përfaqësues të qeverisë nga të tridhjetë aleatët, shumica e shteteve partnere të NATO-s dhe shumë ndërkombëtarë. Gjatë gjithë procesit, grupi mbajti kontakte të ngushta me Sekretarin e Përgjithshëm, duke i dhënë atij dhe Këshillit të Atlantikut të Veriut përditësime të rregullta mbi ecurinë e procesit. Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se grupi bëri një vlerësim kritik të mjedisit strategjik të NATO-s dhe ofroi një sërë rekomandimesh konstruktive për forcimin e Aleancës në dekadën e ardhshme.

1. Mjedisi i sigurisë, kthimi i rivalitetit agresiv

Mjedisi i sigurisë jashtë hapësirës së NATO-s ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga viti 2010, kur u publikua Koncepti Strategjik më i fundit i NATO-s. Ky koncept rekomandonte realizimin e një partneriteti strategjik me Rusinë, përmendte terrorizmin, por nuk përmendej Kina. Qysh atëherë e deri sot në mjedisin e sigurisë së NATO-s kanë ndodhur ndryshime thelbësore, të cilat ka të ngjarë të intensifikohen gjatë dekadës së ardhshme dhe kërkojnë

përprojekte më të mëdha si në kohezionin politik, ashtu edhe në përshtatje me strategjinë e NATO-s.

Në sfondin e konkurrencës gjeopolitike, kërcënime dhe sfida të tjera vazhdojnë dhe disa po bëhen më intensive. Pjesa Jugore e NATO-s karakterizohet nga brishtësia, paqëndrueshmëria dhe pasiguria. Paqëndrueshmëria në Libi, Irak, Siri dhe Afganistan vazhdon të gjenerojë migracion të paligjshëm, e cila ndihet në mënyrë të mprehtë në të gjithë Evropën, por veçanërisht në ato vende të aleancës që kufizohen me Mesdheun.

Kërcënimet dhe rreziqet si: terrorizmi, sfidat e sigurisë të paraqitura nga pandemitë, ndryshimet klimatike dhe flukset migratore vazhdojnë të përbëjnë një sfidë të madhe për Aleancën. Ndryshimi i disa elementeve në instrumentet e fuqisë si: aftësitë kibernetike dhe ato hapësinore do të vazhdojnë të ndryshojnë natyrën e konfliktit. Megjithatë, karakteristika kryesore e mjedisit aktual të sigurisë është rishfaqja e konkurrencës gjeopolitike, përshkallëzimi i rivaliteteve agresive dhe mosmarrëveshjeve për zgjerimin e territoreve, zotërimin e burimeve dhe të pasurive natyrore.

Në dekadën e ardhshme zhvillimet teknologjike do të luajnë një rol në rritje në mjedisin e sigurisë, si në konkurrencën sistematike, ashtu edhe në rritjen e kërcënimeve ndërkufitare të sigurisë. Qysh nga themelimi i NATO-s, perëndimi ka qenë në krye të kërkimit dhe zhvillimit në inovacionet kritike për stabilitetin dhe sigurinë. Por Kina dhe Rusia tani po i alokojnë burime të konsiderueshme të kësaj fushe në një përprojekte për të kapërcyer Perëndimin. Teknologjitë e reja do të ndryshojnë natyrën e luftës dhe do të mundësojnë forma të reja sulmesh duke përdorur armë të teknologjisë së lartë dhe operacione hibride. Popullsia në zonën euroatlantike duhet të mbrohet nga kërcënimet e reja si ato kibernetike, por edhe nga format e tjera të luftës hibride. Prandaj shtetet të mbështetura nga NATO duhet të marrin masa për parandalimin dhe mbrojtjen nga këto kërcënime të luftës moderne, por rezistenca bazë duhet të qëndrojë brenda shoqërive të shteteve respektive.

Implikime për sigurinë e Aleancës vazhdojnë të jenë migrimi masiv i paligjshëm, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe kontesti gjeopolitik për burimet. Tregtia e paligjshme e armëve dhe narkotikëve, krimi i organizuar ndërkombëtar dhe pirateria kanë gjithashtu implikime për sigurinë e hapësirës euroatlantike. Ndryshimi i klimës po bëhet një kërcënim i shumëfishtë dhe ka të ngjarë të përshpejtojë mungesën e resurseve natyrore dhe pasigurinë globale të ushqimit dhe ujit. Ndërsa nivelet e oqeanëve rriten dhe masa tokësore e banueshme e botës zvogëlohet, flukset e migracionit mund të përshpejtohen drejt territorit të NATO-s. Zona të reja të konkurrencës do të shfaqen si pasojë e shkrirjes së akullnajave dhe do të hapen korridore të reja transporti, siç është rruga e detit të veriut në Polin e Veriut. Në këto kushte,

rivalët i fortë gjeopolitikë po kërkojnë ta kontrollojnë dhe shfrytëzojnë këtë mundësi që jepet nga ndryshimi i klimës. NATO duhet të marrë në konsideratë edhe shtimin e dioksidit të karbonit në hapësirë duke inkurajuar zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të gjelbra.

Kriza e COVID-19 në mënyrë dramatike dhe të papritur ka demonstruar efektet e dëmshme që mund të kenë pandemitë jo vetëm për shëndetin publik të qytetarëve të vendeve anëtare, por edhe për qëndrueshmërinë dhe sigurinë sociale në të gjithë botën. Në këtë dekadë në kushtet e zhvillimit të rivalitetit agresiv dhe rritjes së kërcënimeve dhe rreziqeve ndërkuftare, një NATO funksionale dhe e fuqishme do të jetë një aktor shumë i rëndësishëm për sigurinë dhe prosperitetin, si brenda ashtu dhe jashtë zonës euroatlantike. Asnjë aleat nuk mund të përballet me të gjitha këto kërcënime i vetëm. Aleanca ka nevojë për një kuptim të përbashkët të kërcënimeve dhe së bashku të jenë të aftë për t'u përballur me sfidat në dekadën e ardhshme.

2. Kthimi i konkurrencës gjeostrategjike të Rusisë

Rusia paraqet sfidën më të thellë gjeopolitike në zonën euroatlantike, megjithëse në aspektin ekonomik dhe social konsiderohet si fuqi në rënie, ajo ka dëshmuar se është e aftë për agresion territorial dhe ka të ngjarë të mbetet një kërcënim kryesor me të cilin NATO do të përballet gjatë dekadës së ardhshme.

Rusia e ka rifutur veten në Lindjen e Mesme dhe Mesdheun Lindor. Në vitin 2015, ajo ndërhyri në Luftën Civile Siriane dhe ende vazhdon të jetë prezent atje. Politika e Rusisë në Lindjen e Mesme ka të ngjarë të përkeqësojë tensionet dhe grindjet politike në të gjithë rajonin, pasi ajo ka shtrirë ndikimin politik, financiar, operacional dhe logjistik tek partnerët e saj në këtë rajon.

Rusia mban një arsenal të fuqishëm ushtarak konvencional dhe bërthamor që përbën një kërcënim për të gjithë territorin e NATO-s, por ky kërcënim është më i mprehtë dhe evident veçanërisht në krahun lindor të Aleancës. NATO ka bërë përparim në korrigjimin e boshllëqeve në parandalimin dhe mbrojtjen në këtë krah dhe ky angazhim duhet të vazhdojë të jetë prioritet për Aleancën edhe në dekadën e ardhshme. Rusia gjithashtu kërcënon NATO-n në fusha jokinetike në mënyra që mjegullojnë linjat midis luftës dhe paqes. Përpjekjet e NATO-s për të ndërtuar një partneritet të konsoliduar duke përfshirë edhe Rusinë, si dhe krijimin e një arkitekture të sigurisë euroatlantike të pas-Luftës së Ftohtë, nuk ka qenë e suksesshme. Në vitin 2014, Rusia aneksoi ilegalisht dhe në mënyrë të paligjshme Krimenë dhe pushtoi pjesë të Ukrainës Lindore.

Rusia duke synuar hegjemoninë dhe zotërimin e ish-republikave sovjetike minon sovranitetin/ integritetin e tyre territorial dhe bllokoi rrugën e këtyre vendeve drejt integritetit euroatlantik. Ndërsa agresioni rus në Ukrainë dhe Gjeorgji vazhdon, sjellja e saj është intensifikuar në pjesën veriore të globit

dhe Atlantikun e Veriut ku ka rritje të strukturave ajrore dhe detare brenda dhe rreth pikave kyçe të Barentit, Baltikut, Detin e Zi dhe atë të Mesdheut. Disa nga këto dislokime Rusia i ka përcaktuar si zona A2/AD (anti-qasje dhe refuzim i zonës) ku ka përqendruar sisteme të mbrojtjes ajrore S-300 dhe S-400, raketa "Bastionet", "Iskander" dhe pajisjet e luftës elektronike. Në këto zona janë të ndaluara vizitat dhe inspektimet nga strukturat dhe organizatat ndërkombëtare, kjo dëshmon më së miri synimet agresive të Rusisë. Paralelisht, ajo përpiqet të krijojë shtete satelite ose klientë brenda ose afër territorit të NATO-s, duke tentuar të aktivizojë të ashtuquajturat konflikte të ngrira, shkeljen e regjimit të kontrollit të zhvillimit armatimit, gjë që çon edhe në fundin e Traktatit për ndalimin dhe asgjësimin e raketave nukleare me rreze të mesme "Intermediat Nuclear Force" (INF). Rusia gjithashtu është përpjekur të krijojë një terren të favorshëm në pellgun e Mesdheut dhe në Afrikë, duke përfshirë përdorimin e kompanive private ushtarake ruse. Përveç kërcënimit të saj ushtarak konvencional, Rusia po aktivizon një paketë më të gjerë të formave hibride të luftimit, përfshi pajisje për sulme kibernetike, atentate të sanksionuara nga shteti, përdorimi i armëve kimike, detyrim politik dhe metoda të tjera për të shkelur sovranitetin e aleatëve.

Rikthimi i konkurrencës gjeostrategjike ka sjellë gjithashtu një përhapje të sulmeve hibride. Ky aktivitet në zonën gri ka gërryer kufijtë tradicionalë të konfliktit. Siguria e brendshme e shteteve ka filluar të ndikohet shumë nga ajo ndërkombëtare. Në kushtet e përdorimit të prox-it, kompanive private ushtarake, dezinformim dhe subversion, dallimi midis veprimeve ushtarakëve dhe atyre joushtarake janë mjegulluar shumë. Veprimet e mësipërme dhe aktiviteti hibrid i organizatave terroriste kërkojnë të dobësojnë e të përçajjnë aleatët nga brenda duke minuar kohezionin shoqëror dhe mënyrën tonë të jetesës. NATO-s i është dashur të shpenzojë shumë kohë për të elaboruar mjete politike dhe jopolitike për t'u përballuar me kërcënimet moderne, elemente të luftës hibride dhe trajtimin e dezinformimit.

3. Rritja e axhendës strategjike të Kinës

Fuqia në rritje e Kinës është një tjetër zhvillim i madh gjeopolitik, e cila po ndryshon llogaritjen strategjike të Aleancës. Ajo ka rritur ndikimin i saj në Lindjen e Mesme dhe ka nënshkruar një partneritet strategjik me Iranin. Aktualisht, është importuesja më e madhe e naftës së papërpunuar nga Iraku dhe është futur në procesin e paqes në Afganistan, ku dhe është investitori më i madh i huaj në këtë rajon.

Në takimin e tyre në Londër në dhjetor 2019, liderët e NATO-s deklaruan se rritja e Kinës dhe politikat e saj ndërkombëtare paraqesin sfida që duhen trajtuar si Aleancë. Kina paraqet një lloj sfide shumë të ndryshme për NATO-n sesa Rusia; ndryshe nga kjo e fundit ajo nuk është një kërcënim

i drejtpërdrejtë ushtarak për zonën euroatlantike megjithëse ka një axhendë strategjike gjithnjë e më globale. Kina ka dëshmuar gatishmërinë e saj për të përdorur forcën, shtrëngimet ekonomike, diplomacinë frikuese jo vetëm kundër fqinjëve të saj por edhe përtej Indo-Paqësorit. Kina gjatë dekadës së ardhshme ka të ngjarë të sfidojë gjithashtu aftësinë e NATO-s për të ndërtuar një mbrojtje të qëndrueshme, adresimin e zhvillimeve të reja teknologjike, mbrojtjen e sektorëve të ndjeshëm të ekonomisë, përfshi linjat e furnizimit. Në termin afatgjatë, Kina ka shumë gjasa të projektohet fuqi ushtarake globale duke përfshirë potencialisht edhe zonën euroatlantike.

Politika industriale e Kinës dhe strategjia e shkrirjes/bashkimit të civilëve me ushtarakët janë një komponent shumë i rëndësishëm i sfidave të saj. Modernizimi i saj ushtarak në të gjitha fushat, duke përfshirë aftësitë bërthamore, detare dhe raketore, sjell rreziqe të reja dhe kërcënime të mundshme për Aleancën dhe për stabilitetin strategjik në përgjithësi. Qasja e saj ndaj të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar sfidon ambicien themelore të një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Kina paraqet rreziqe të mëdha në disa sektorë kritikë si: telekomunikacioni, hapësira kozmike, hapësira kibernetike dhe teknologjitë e reja. Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, Kina ka zhvilluar një fushatë dezinformimi në shumë vende aleate. Ajo është angazhuar gjithashtu në vjedhjen e projekteve teknologjike me implikime për sigurinë dhe zhvillimin e hapësirës euroatlantike, si dhe sulme kibernetike ndaj vendeve aleate.

Në të njëjtën kohë, për shkak të zhvillimit ekonomik, Kina është një shtytës i rritjes globale, tregtisë, investimeve si dhe një investitor i rëndësishëm në shumë vende të NATO-s. Ajo ka filluar të ketë një plan strategjik-tregtar në zonën euroatlantike nëpërmjet iniciativës së zhvillimit, formatit 17+1, marrëveshjeve të shumta dypalëshe. Aleatët do të vazhdojnë të synojnë marrëdhënie bashkëpunimi me Kinën, të ndërtojnë lidhje ekonomike dhe tregtare, si dhe të punojnë për çështje të tilla si: ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti. Veprimet e Kinës janë shumë të rëndësishme për perspektivat e trajtimit të sfidave globale, pasi ajo prodhon një të tretën e emetimeve globale dhe pothuajse gjysmën e investimeve globale në teknologjinë e gjelbër.

Vijon në numrin e ardhshëm.....

Bibliografia

1. Raport i grupit të vlerësimit dhe të analizës për angazhimin e NATO-S në dekadën e ardhshëm.
2. Takimi i liderëve të NATO-s në Londër, për procesin e reflektimit, dhjetor 2019.

3. Seminari “Inkuadrimi virtual mbi peizazhin gjeopolitik dhe të Sigurisë së NATO-s, maj 2020.
4. Seminari “Uniteti Aleat, Solidariteti dhe Kohezioni i Aleancës”, qershor 2020.
5. Seminari “Procesi i Vendimmarrjes, Komitetet, Financimi i Përbashkët dhe Politikat e Stafit të NATO-s”, korrik 2020.
6. Seminari “Inovacioni, Shkenca dhe Teknologjia”, gusht 2020.

LUFTA E ZONËS GRI DOKTRINA GERASIMOV

Msc. Roland Tashi
AISM

Trajtesë e shkurtuar.

Përfundimi i Luftës së Ftohtë nxiti një debat të gjerë mbi transformimin e luftës duke shtruar pyetje, komente, argumente lidhur me faktorët dhe arsyet që ndikuan në këtë ndryshim. Pavarësisht qëndrimeve dhe këndvështrimeve të studiuesve gjatë përshkrimit dhe analizës së konflikteve të tridhjetë viteve të fundit, gati të gjithë mbrojnë idenë se lufta moderne nuk i ngjan konflikteve industriale të Luftës së Dytë Botërore. Në luftën moderne, informacioni dhe dimensionin informativ kanë një rol shumë të rëndësishëm, lufta moderne nuk është një luftë e “rregullt” në të cilën shtetet sovraane luftojnë duke u ballafaquar me rreshtimin e organizuar të ushtrive të tyre.

Gjenerali rus Valery Gerasimov¹, në vitin 2013 botoi një artikull në Russian Military-Industrial Courier, duke tërhequr vëmendjen ndërkombëtare. Gerasimov shkruante se “Përdorimi i përbashkët, i njëhershëm i propagandës me veprimet për përmbysjen e rendit politik dhe shoqëror të një shteti, mundëson paralizimin e tij brenda muajsh apo edhe ditësh, duke mbetur kështu viktimë e ndërhyrjes së huaj, kaosit dhe luftës civile”.

Për përgatitjen e këtij shkrimi, është punuar dhe shfrytëzuar artikulli “Koncepti i Zonës Gri. Doktrina Gerasimov, qasja ruse në operacionet hibride”. Artikulli është shkruar në nëntor 2020 nga Andrea Beccaro, profesor në Studimet e Sigurisë dhe është botuar nga Qendra Ushtarake e Studimeve Strategjike Italiane.

Artikulli evidenton dhe shpreh vetëm gjykimin dhe opinionet e autorit.

¹ Gjeneral Gerasimov është emëruar nga presidenti Vladimir Putin në datën 9 nëntor 2012 Shef i Shtabit i Forcave të Armatosura ruse si dhe zëvendësministër i Mbrojtjes. Gjenerali konsiderohet si ideator i të quajturës “Doktrina Gerasimov”, një strategji ushtarake që kombinon fushën ushtarake, teknologjinë, informacionin, diplomacinë, ekonominë, kulturën dhe elemente të tjera për arritjen e objektivave strategjikë.

Nga debatet dhe përshkrimet e luftës moderne dallohen dy koncepte: Lufta Hibride (HW) dhe Lufta e Zonës Gri (GZW). Të dyja këto përcaktime kanë karakteristika të përbashkëta lidhur me trajtimin e luftës dhe paqes, por kanë edhe dallime të rëndësishme ndërmjet tyre. Problemi kryesor është se këto koncepte janë përdorur për të përshkruar strategjinë ruse, në fakt asnjëri prej tyre nuk është pjesë e doktrinës zyrtare. Pas pushtimit të Krimesë në vitin 2014 dhe ndërhyrjes së Moskës në Siri në vitin 2015, është hapur një debat i madh publik mbi “Qasjen e re ruse në luftën hibrive dhe tipet e reja të operacioneve ushtarake”.

Fjalë kyçe: luftë hibrive, luftë e ftohtë, doktrina Gerasimov, konflikt, zona gri, operacione kinetike, etj.

1. Lufta Hibride, “Doktrina Gerasimov”

“Lufta Hibride” është një koncept strategjik i përcaktuar jo shumë qartë, ndoshta për këtë arsye ky cilësim është përdorur për të përshkruar situata të ndryshme konfliktuale që përfshijnë aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, operacione të fshehta dhe të hapura, të njohura e të panjohura, etj. Duke qenë se brenda këtij koncepti përfshihet një gamë e gjerë operacionesh, është e vështirë që ai të kuptohet saktë nëpërmjet përshkrimit në një përkufizim të vetëm. Në dekadat e fundit, konfliktet gjatë të cilave nuk është dalluar qartë një luftë konvencionale e rregullt, janë trajtuar si luftë hibride, por në fakt vetëm kaq nuk është e mjaftueshme.

Disa nga faktorët që dallojnë luftën e parregullt mund t’i vërejmë më poshtë:

Së pari, në kushtet e zhvillimit të sotëm, terreni më i përhapur është ai urban i cili është shumë kompleks. Në këto kushte, lufta duhet të bëhet në qendër, në zemër të vendit, prapa vijave kryesore të frontit.

Së dyti, lufta e parregullt nuk parashikon fronte, linja të paracaktuara luftimi, por skenarë dhe situata të ndryshueshme në të cilat ndërthuren të dyja palët e përfshira në konflikt. Në këtë teatër luftimi, popullsia, komunitetet lokale bëhen pjesë e konfliktit jo vetëm në rolin e palës së viktimizuar por edhe në atë të palës luftuese.

Së treti, lufta nuk mund të vendoset nga një betejë e vetme. Palët në konflikt, në këtë rast trupa të parregullta, duhet të veprojnë në beteja të hapura të cilat mund të jenë edhe vendimtare. Si pasojë, lufta e parregullt është një konflikt i zgjatur në të cilin koncepti strategjik i kohës ndryshon në raport me luftën e ushtrive të rregullta.

Së katërti, reagimi i popullsisë në veprime, aksione të tipologjisë guerile, përfshin një pjesë të konsiderueshme të territorit të vendit.

Së pesti, karakteri tradicional i një popullsie duhet të këtë tipare luftarake mbrojtëse.

Duke iu referuar këtij shkallëzimi, është e rëndësishme të vlerësohet, shtohet edhe një pikë e gjashtë, e cila lidhet me faktin se në një luftë të parregullt, palët luftojnë me “atë që munden”, që do të thotë se nuk mbështeten, përdorin teknologji të lartë luftimi, por armatimin tradicional, rrethanor dhe atë të

improvizuar. Shembujt historikë të luftës së parregullt janë të shumta; ky lloj konflikti jo vetëm që është shumë më i vjetër se lufta e rregullt e njohur si lufta konvencionale, por ka qenë edhe më i përhapuri pas Luftës së Dytë Botërore. Luftë e parregullt mund të konsiderohet; procesi i dekolonizimit, beteja të ndryshme gjatë luftës në Vietnam, disa nga operacionet Sovjetike në Afganistan si dhe mjaft shembuj të tjerë. Termi “Lufta Hibride” duket si një veshje e re që përdoret për të modernizuar dhe bërë më tërheqës një koncept të vjetër siç është ai i luftës së parregullt. Nocioni i “Luftë Hibride” u përdor në vitin 2002 nga William Nemeth, kolonel në Korpusin Detar të Shteteve të Bashkuara, i cili analizonte luftën Çeçene kundër Rusisë. Teoria e këtij përcaktimi u bë publike gjatë debatit strategjik lidhur me konfliktin ndërmjet Izraelit me Hezbollahun në Liban në vitin 2006. Në atë kohë, luftimet e përdorura nga Hezbollah u interpretuan si shembulli i armikut të ri, pasi ai vepronte në rrjet duke përdorur popullatën lokale nëpërmjet formave dhe taktikave të parregullta të luftimit. Më vonë, elemente të HW u përdorën në Irak kundër forcave amerikane, u përdorën gjatë operacioneve ushtarake të ISIS duke përfshirë në këtë luftë edhe aktorë që përdorën terrorizmin, taktikat e luftës guerile, etj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ruse, gjenerali Valery Gerasimov, në vitin 2013 botoi një artikull në *Russian Military-Industrial Courier*, duke tërhequr vëmendjen ndërkombëtare. Gerasimov shkruante se “Përdorimi i përbashkët, i njëhershëm i propagandës me veprimet për përmbysjen e rendit politik dhe shoqëror të një shteti, mundëson paralizimin e tij brenda muajsh apo edhe ditësh, duke mbetur kështu viktimë e ndërhyrjes së huaj, kaosit dhe luftës civile”.

Më shumë se vetë artikulli, vëmendjen e Perëndimit e tërhoqën interpretimet e Mark Galeottit, profesor londinez, studiues i çështjeve dhe politikës ruse, i cili përdori termin "Doktrina Gerasimov" për të përshkruar operacionet jo lineare të Rusisë, të cilat mbështeten te format e reja të operacioneve të përqendruara politikisht. Sidoqoftë, koncepti i HW, thekson Galeoti, nuk është i pranishëm në doktrinën zyrtare ushtarake ruse.

Ideja që konfliktet bashkëkohore përziejnë qasje, pikëpamje, taktika të ndryshme operacionale nuk është e re. Ajo që studiuesit perëndimorë e kanë quajtur "Luftë Hibride" është një shembull klasik i operacioneve të fshehta. Sipas Peter Mansoor, historian ushtarak amerikan, HW ka qenë një pjesë integrale e peizazhit historik që nga bota antike. Për më tepër, Rusia ka një traditë të pasur të përdorimit të metodave dhe praktikave të ndryshme që zakonisht konsiderohen si luftë hibride. Një nga shembujt më të spikatur njihet në histori si Loja e Madhe, lufta për Azinë Qendrore midis perandorive ruse dhe britanike që zgjati për pjesën më të madhe të shekullit të 19-të. Lufta ishte një

kombinim i operacioneve të inteligjencës, intrigave diplomatike, përpjekjeve propagandistike, luftërave të ndërmjetësuar dhe ndërhyrjeve të drejtpërdrejta ushtarake. Lufta hibride karakterizohet nga koncepti i sinergjisë, nga zbatimi i njëkohshëm i një shumëllojshmërie mënyrash luftimi për të arritur qëllimin. Në thelb, konfliktet bashkëkohore nuk mund të karakterizohen nga një dyzim i thjeshtë bardh e zi, ato kanë një spektër më të dallueshëm ngjyrimesh, duke humbur konceptin e perceptimit të një kufiri ndarës të dallueshëm. Kështu, lufta është hibride, sepse mënyra e luftimit të armikut kombinon metoda, taktika dhe mjete të ndryshme, përfshirë aftësitë konvencionale, taktikat e parregullta, terrorizmin, dhunën pa kriter dhe veprimet kriminale duke përdorur edhe teknologjitë moderne. Situata ndërlikohet më tej duke vlerësuar faktin se fusha e betejës e luftës hibride është e trefishtë; është konvencionale, është e lidhur me popullsinë autoktone, është ndërkombëtare. Vetëm në rast se mbizotëron këto tre fusha mund ta fitosh betejën.

Lufta hibride bazohet në katër elemente kryesore:

Elementet e rregullta dhe të parregullta bashkohen në të njëjtën forcë dhe përbërësi i parregullt bëhet vendimtar.

Lufta bashkon taktika të rregullta dhe të parregullta dhe ky përbën një shkak që terrorizmi mund të mbetet edhe si metodë kryesore e luftimit.

Teknologjia moderne përdoret gjerësisht, me qëllim reduktimit e mundësinë së diktimit të qëllimit dhe operacioneve si dhe arritjen e objektivit në mënyrë të shpejtë.

Lufta hibride, si në të gjitha luftërat e parregullta, përdor shumë mirë terrenin kompleks, prandaj sot ajo zhvillohet kryesisht në zonat urbane.

Bashkimi, përdorimi i taktikave dhe qasjeve të ndryshme siç janë, lufta guerile, lufta konvencionale dhe terrorizmi, përbën një element dominues në debatin aktual strategjik dhe është i ngjashëm me konceptin e Luftës së Zonës Gri (GZW).

Konceptet e HW dhe GZW janë të ngjashme dhe ndodh që mund të përdoren si sinonime, por në fakt nuk mund të flasim për të njëjtin koncept. Nocioni i HW lidhet më shumë me fushën e betejës, përqendrohet në operacionet kinetike² dhe përshkruan taktikat që një grup, formacion mund të përdorë për arritjen e qëllimit. Lufta e Zonës Gri ka më pak elemente të luftës kinetike, ajo lidhet më shumë me politikën, duke përfshirë presionin ekonomik, veprimet diplomatike, propagandën dhe mjete të ngjashme ku aplikohen kryesisht

² Operacione kinetike – Operacione në të cilat burimet dhe fuqia ushtarake përdoren për arrijen e një apo më shumë qëllimeve. Dallohen dy tipe kryesore të operacioneve ushtarake; operacione lufte (WAR), operacione sulmuese, mbrojtëse si dhe operacione të ndryshme nga lufta (MOOTW) për përballimin e krizave, operacione në ndihmë të autoriteteve civile, evakuimi i popullsisë, etj.

operacione jo të dhunshme, megjithëse kjo nuk mund të jetë gjithmonë e vërtetë.

Koncepti i Zonës Gri përshkruan mjetet që një aktor mund të përdorë për të formuar mjedisin strategjik, politik, ekonomik, kulturor para fillimit të konfliktit, i cili është një tjetër element thelbësor i debatit aktual rus. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që sapo të fillojë konflikti, mjetet dhe qasjet e GZW zhduken, përkundrazi ato mbeten në dispozicion të aktorëve.

2. Lufta e Zonës Gri

Referuar komenteve dhe argumentimeve të trajtuara, lufta hibride dhe karakteristikat dalluese të saj nuk mund të përbëjnë një risi historike. Duhet pranuar se teknologjia bashkëkohore dhe sistemi ndërkombëtar i komunikimit ofrojnë mënyra të reja për të përdorur taktika të luftës së parregullt, por nocioni i përgjithshëm dhe tiparet kryesore të saj janë të njohura, aq më tepër nga studiuesit e fushës së luftës.

GZW është një koncept që mbart paqartësi, nuk evidenton saktë elementet dalluese dhe përcaktuese duke favorizuar lidshimin politik të përdorë edhe mohimin. Tre tiparet kryesore; “paqartësia”, “shkalla e ulët e elementeve dalluese” dhe “mohimi” e karakterizojnë dukshëm nocionin e Luftës në Zonën Gri, pasi kjo zonë përbën hapësirën midis paqes dhe luftës, zonën e errët ku veprojnë së bashku, në të njëjtën hapësirë, aktorët shtetërorë dhe joshetërorë në një paqartësi juridike.

Joseph Votel³ përcakton GZW si një situatë politike konfliktuale, karakterizuar nga një konkurrencë e fortë politike, ekonomike, informative dhe ushtarake e një natyre më intensive se diplomacia normale e shtetit, por jo në nivelin e një lufte konvencionale. Lufta e Ftohtë ishte një GZW 45-vjeçare, gjatë së cilës të dy palët përdorën propagandë. Konfrontimet e drejtpërdrejta midis dy superfuqive u parandaluan nëpërmjet luftërave të ndërmjetme rajonale, në të cilat të dy palët u përballën me njëri tjetrin duke përdorur aktorë jo shtetërorë. Mendimi politik përfundimor përcakton shumë qartë se lufta është përdorimi i dhunës së armatosur nga ushtria shtetërore dhe paqja është mungesa e një gjendje apo situatë lufte. Sidoqoftë, realiteti është gjithnjë dhe më i ndërlikuar prandaj një përkufizim rigoroz i luftës nuk është vërtetuar asnjëherë në praktikë madje edhe në sistemet ndërkombëtare më të qëndrueshme duke filluar që nga idetë e lindura nga Paqja e Westfalisë dhe deri më sot. Mjafton të kujtojmë shekullin e 19-të, kur kryengritjet kombëtare dhe luftërat koloniale ishin shumë të shpeshta, pavarësisht se ishte një shekull i bazuar në fuqinë shtetërore si dhe shekullin e 20-të, në të cilin krahas zhvillimit të dy luftërave botërore u evidentuan edhe mjaft kryengritje. Sot,

³ Joseph Leonard Votel, gjeneral me katër yje, në shërbim të Ushtrisë Amerikane nga viti 1980 deri në vitin 2019.

për shkak të globalizimit dhe faktorëve ndikues politik dhe ekonomik, sistemi ndërkombëtar është më i ndjeshëm, duke inkurajuar përdorimin e koncepteve, elementëve të GZW. Teknologjia e avancuar i ka nxitur këto elemente të jenë më efektivë se më parë, duke i shndërruar nga elementë mbështetës në elementë të rëndësishëm dhe vendimtarë. Për këtë arsye, GZW është e lidhur me strategjitë politike dhe ushtarake të shteteve të tilla si Rusia, Kina dhe Irani. Referuar aktorëve, qëllimeve, teatrit të veprimeve dhe elementëve të tjerë përcaktues, Clausewitz shkruante se “Lufta është një duel në shkallë të gjerë, një akt dhune që detyron kundërshtarin t’i nënshtrohet vullnetit tonë”⁴. Sipas Clausewitz, lufta është një fenomen social që dallon nga konfliktet e tjera pasi përfshin vrasjen e njerëzve. Duhet theksuar se nuk kishte të njëjtin qëndrim, përjasje për luftën, strategu ushtarak kinez Sun Tzu⁵, i cili i referohej konceptit të fitores pa luftë. Në librin “Arti i Luftës”, gjenerali i madh trajton konceptin se fitorja duhet të vijë nëpërmjet shmangies së përlëshjes, fushëbetejës. Në të vërtetë, citon strategu, lufta, për më tepër luftërat shumëvjeçare, sjellin pasoja shumë të mëdha.

Fakti që luftërat konvencionale, betejat ndërmjet ushtrive të shteteve të përfshira në konfliktet frontale, kanë një kosto të madhe ekonomike dhe në dekadat e fundit përbëjnë një përqindje të vogël të konflikteve, kjo nuk do të thotë që konkurrenca ndërkombëtare dhe shkaqet e luftës janë zhdukur. Përkundrazi, ato janë një prani e vazhdueshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, ato janë tipare të lindura të politikës dhe është e vështirë të eliminohen, sot ato thjesht kanë ndryshuar formën në raport me të kaluarën.

Në vitin 2008, gjenerali i ushtrisë Makhmut Gareev, një nga teoricienët strategjikë më të rëndësishëm rusë, prezantoi konceptin e deterencës/parandalimit strategjik, që nënkuptonte "një grup masash politike, diplomatike, informative, ekonomike, ushtarake të ndërthurura midis tyre, të cilat dekurajojnë, zvogëlojnë ose parandalojnë kërcënimet dhe veprimet agresive nga shtete të veçanta apo koalicione të tyre. Në këtë kontekst, Gareev apelon për masa asimetrike të bashkuara nga një qëllim i përbashkët për të përballuar kërcënimet e shekullit të 21-të.

3. Roli i Rusisë në sistemin modern ndërkombëtar

Rusia e sotme nuk është një superfuqi, një vend i cili mund të ushtrojë fuqi të mjaftueshme ushtarake, politike dhe ekonomike për të bindur kombet në çdo rajon të botës siç ishte Bashkimi Sovjetik në kohën e Luftës së Ftohtë. Sidoqoftë, Kremlini ka elementë përcaktues që e lejojnë atë të luajë një rol kryesor në rajone dhe situata të ndryshme. Moska mbetet një nga fuqitë më të mëdha bërthamore në botë, konkurrenente për Shtetet e Bashkuara, ajo është një

⁴ Clausewitz 1940: Libri I, kap. I.

⁵ Sun Tzu, strateg ushtarak kinez, ka jetuar ndërmjet shekujve VI dhe V para erës sonë.

nga pesë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB, ka burime të mëdha natyrore dhe shtrirja e saj territoriale e lejon të jetë një aktor rajonal në Azi, Lindjen e Mesme dhe Evropë. Për më tepër Rusia vetëvlerësohet si një fuqi e madhe, koncept i cili ka rrënjë të thella kulturore, bazuar në histori si një mbrojtëse e Evropës nga pushtimi Mongol, mbrojtëse nga fushatat pushtuese të Napoleon Bonapartit në shekullin e 19-të dhe së fundmi kontribuuese në çlirimin e Evropës nga Hitleri. Gjithashtu, ajo mbështetet në argumente fetare, Moska si Roma e Tretë dhe në argumente ideologjike, si mbrojtëse e të gjithë sllavëve. Pavarësisht këtyre elementëve, Moska nuk ka fuqinë ekonomike, politike dhe ushtarake për të ushtruar një rol global, por ajo mund të luajë një rol kyç në nivel rajonal. Rendi aktual ndërkombëtar është vështirë të përcaktohet, Kremlinin e interpreton atë si unipolar, domethënë një sistem i ndërtuar rreth unipolaritetit amerikan. Rusia gjithashtu e përdori kornizën unipolare duke iu referuar BE-së në kontekstin e krizës ukrainase. Si pasojë, qëllimi rus është të ndryshojë këtë arkitekturë politike nga unipolaritetin në multipolaritet, në mënyrë që Moska të luajë një rol më qendror dhe të gjejë më shumë hapësira për manovrim.

4. Lufta e informacionit

Debati mbi strategjinë ruse nënvizon tre elemente kryesore të luftës bashkëkohore: - përdorimi i integruar i mjeteve ushtarake dhe jo ushtarake, - roli në rritje të luftës së informacionit, - përdorimi i armëve me teknologji të avancuar po aq efektive sa armët bërthamore. Tek elementet e përmendura më lart, për disa arsye kryesore, më evidente mbetet lufta e informacionit. Informacioni mbetet element shumë i rëndësishëm jo vetëm për metodologjinë e luftimit por edhe për ndikimin masiv në popullsinë lokale. Moska sheh një ndryshim në qendrën e gravitetit të luftës moderne, nuk janë në fokus vetëm forcat e armatosura, por edhe psikologjia, mendimi i popullsisë, të cilat bëhen shënjestër e fushatave specifike të informacionit, propagandës etj. Për Kremlinin, aktualisht informacioni ka përparësinë në operacione duke investuar për këtë qëllim në transmetimin e lajmeve dhe informacioneve jo vetëm brenda vendit me kanale në gjuhën ruse, por edhe në nivel ndërkombëtar, me kanalin anglisht-folës Russia Today (RT) dhe Sputnik News, i cili transmeton në disa gjuhë. Moska e kupton dhe përkufizon informacionin në një mënyrë shumë të ndryshme nga Perëndimi, i cili përqendrohet më së shumti në infrastrukturë. Në të kundërt, rusët kanë një fokus më të gjerë duke u kujdesur edhe në përmbajtjen e vetë informacionit. Ata përdorin dy fjalë për të treguar elementet e informacionit: informacionin teknik, mjetet e transmetimit dhe informacionin psikologjik, mjetet që do të ndikojnë në mendjet e popullatës. Mbrojtja e informacionit psikologjik do të thotë që kultura dhe vlerat morale bëhen objektiva për tu sulmuar dhe mbrojtur. Gjatë luftës ruso-gjeorgjiane, sulmet kibernetike dhe operacionet konvencionale

ushtarake funksionuan njëkohësisht. Duke përdorur pamjet televizive dhe intervistat e përditshme me një zëdhënës ushtarak, Rusia kontrollonte rrjedhën e informacionit ndërkombëtar dhe ndikonte në popullsinë lokale duke diktuar lajme, duke treguar përparimin e trupave në mbrojtje të qytetarëve rusë dhe duke propaganduar mizoritë gjeorgjiane. Pas luftës ruso-gjeorgjiane, Rusia përsosi teknikat dhe aftësitë e saj duke i përdorur në mënyrë me efikasë në Krime, ku sulmet kibernetike bllokuan infrastrukturën e telekomunikacionit, faqet kryesore mediatike të Ukrainës, telefonat celularë të zyrtarëve të lartë ukrainas përpara se forcat ruse të hynin në gadishull më 2 mars 2014.

5. Përfundime

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ruse, Valerij Vasilevic Gerasimov nuk është autori i parë që i referohet efektivitetit të mjeteve joushtarake, për më tepër ai përkrah idenë se dallimet midis luftës dhe paqes janë të paqarta. Kjo nuk do të thotë që forca ushtarake nuk përdoret, por ajo duhet të aplikohet vetëm pasi mjetet joushtarake nuk kanë mundur të arrijnë objektivin e kërkuar. Debati mbi idetë e Gerasimov filloi në vitin 2013 pas botimit të një artikulli, në të cilin studiues perëndimorë konstatuan trajtimin e konceptit të "Luftës Hibride". Gerasimov, në artikullin me titull "Vlera e shkencës është aftësia për të parashikuar, sfidat e reja kërkojnë rimendimin e formave dhe metodave të ekzekutimit të operacioneve luftarake", botuar më 26 shkurt 2013, nuk e përdor në mënyrë të drejtpërdrejtë termin "luftë hibride", nuk jep rekomandime në nivel doktrine apo strategjie të re, por shpjegon vizionin e tij për mjedisin operativ dhe natyrën e luftës së ardhshme. Gerasimov sugjeron se karakteristikat e konfliktit kanë ndryshuar dukshëm që nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe kryesisht në mijëvjeçarin e ri, duke përfshirë tani përdorimin e metodave të informacionit politik, ekonomik, kompjuterik, humanitar dhe elementë të tjerë jo ushtarakë. Një ndryshim tjetër është përdorimi në rritje i operacioneve asimetrike, të cilat mundësojnë kompensimin e epërsisë konvencionale të armikut, siç janë: elementi i befasisë, përdorimi i forcave speciale operacionale, nxitja e konfliktit të brendshëm, protestat e popullsisë, etj. Në këtë kontekst, Gerasimov komenton se operacionet jo ushtarake po ndodhin në raportin 4 me 1 ndaj atyre ushtarake.

Gjenerali Gerasimov, si dhe autorë të tjerë të mëparshëm, i zhvilluan këto ide pas analizës së ngjarjeve të Pranverës Arabe dhe manifestimeve të dhunshme në Ukrainë në 21 dhe 22 nëntor 2013. Ai shkruan gjithashtu se një shembull i spikatur i mënyrës së re të zhvillimit të luftës është ajo që ndodhi në Libi në vitin 2011, ku u krijua një zonë e ndaluar fluturimi, u vendos një bllokadë detare dhe kontraktorët ushtarakë u përdorën gjerësisht në ndërveprim të ngushtë me formacionet e opozitës.

Në përmbledhje, Gerasimov identifikon katër aspekte thelbësore të luftës moderne:

- Përdorimi i integruar i forcës ushtarake me forca dhe burime të një natyre jo ushtarake.
- Roli vendimtar i luftës së medias dhe informacionit në mënyrë që të arrihen objektivat politikë pa përdorimin e forcës.
- Pjesëmarrja e forcave joushtarake si dhe kompanive private në operacionet ushtarake.
- Përdorimi i metodave indirekte dhe asimetrike.

Gjenerali ndalet edhe në përdorimin e inteligjencës artificiale për të ndikuar gjatë një konflikti të armatosur, duke theksuar se "Ndërsa sot kemi dronë fluturues, fushat e nesërme të betejës do të mbushen me robotë që ecin, zvarriten, kërcëjnë dhe fluturojnë". Ai, nëpërmjet pikëpamjeve dhe interpretimeve, shpreh nevojën për një ndryshim në kulturën strategjike ruse e cila gjithmonë është mbështetur në një strukturë të fortë komanduese hierarkike që nga koha e Carit deri në epokën sovjetike, duke kultivuar idenë se rezultati i një operacioni është më i rëndësishëm se sa mjetet specifike që do të përdoren për ta arritur. Në këtë taktikë të re, komandanti më i lartë i strukturës ushtarake u cakton vartësve objektivin, detyrën, kohën, periudhën brenda së cilës duhet të arrihet objektivi dhe më pas këta vepronë të pavarur. Në këtë skemë, ushtarakëve të vartësisë u mundësohet iniciativa e planifikimit, kanë më shumë liri veprimi dhe shkallë të lartë fleksibiliteti. Delegimi i autoritetit nxit iniciativën dhe dinamizmin e vartësve si dhe ndikon në aftësinë e tyre për të kuptuar më gjerë kontekstin e misionit luftarak që po kryejnë. Gerasimov ka nënvizuar nevojën për të inkurajuar dhe trajtuar cilësi të veçanta ushtarake, si aftësia për të vlerësuar shpejt situatën, për të marrë vendime jo standarde, për të përdorur dinakërinë ushtarake dhe për të vepruar në befasi. Sipas tij, komandantët duhet të jenë krijues, të jenë të gatshëm të devijojnë nga modeli, të parashikojnë rrezikun dhe të shprehin një iniciativë të arsyeshme.

Tërheqin vëmendjen edhe dy elemente të tjera të rëndësishme të këndvështrimit ushtarak të gjeneralit.

Së pari, thekson se në konfliktet bashkëkohore, UAV-të (dronët dhe avionët pa pilot) janë një kërcënim i vazhdueshëm, ndërsa sistemet për t'u mbrojtur prej tyre nuk janë efikase. Sidoqoftë, ai pohon se Rusia po përdor UAV në operacionet taktike, për të rritur efektivitetin e zjarrit të artilerisë dhe nuk përmend përdorimin strategjik të tyre.

Së dyti, evidenton rolin qendror të trupave tokësore me një shkallë të lartë të lëvizshmërisë. Në doktrinën ushtarake ruse, forcat e sulmit ajror gjithmonë kanë luajtur një rol të rëndësishëm, tani ato janë pjesë e forcave të reagimit të shpejtë së bashku me njësi më të vogla të tankeve për të rritur aftësitë e tyre luftarake dhe për të siguruar pavarësinë operacionale.

BASHKIMI EVROPIAN DHE ESKATOLOGJIA E LUFTËS RASTI I UKRAINËS

Dr. Malvina Tema

Specialist në Ministrinë e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar.

Bashkimi Evropian është e përkushtuar ndaj vlerave të paqes, demokracisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, por suksesi në promovimin e këtyre vlerave në ditët e sotme, më shumë se kurrë, ndodhet në një udhëkryq historik.

Ky artikull analitik diskuton dinamikën që lidhet me rolet komplekse të Bashkimit Evropian (BE), në ndërthurje me situatën e Ukrainës, bazuar në premisat e politikave të sigurisë dhe perspektivat e integritetit. Kjo përpjekje analitike synon të hedhë dritë kryesisht mbi dinamikën e politikës së jashtme të BE-së në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar, që lidhet me ndryshimin në 'kushtet e nevojave të sigurisë' dhe implikimeve të politikave humanitare, të cilat (ndërkohë) zbatohen kundrejt fqinjëve të BE-së dhe më gjerë. Ukraina përbën dilemën aktuale që vë në pikëpyetje mozaikun e sistemit ndërkombëtar dhe rolin e Bashkimit Evropian, rol i cili varet mjaftueshëm edhe nga parashikimet, përcaktimet dhe nga perspektivat jashtë tij. Në fakt, BE-ja bën thirrje për zhvillimin e paqes përmes diplomacisë, të mundësuar nëpërmjet qeverisjes së qëndrueshme, por edhe duke synuar shmangien e kërcënimeve ndaj faktorëve ekonomikë, përmes miratimit të strategjive të ndryshme, kryesisht të bazuara në 'kushtëzim (conditionality)' dhe 'fuqinë e butë (soft power)'. Në këtë këndvështrim, synohet të vihet në diskutim efektiviteti dhe kufizimet e BE-së si promovues i paqes, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, përmes 'agjendave' për vendet partnere (në Lindje), me 'instrumente të buta

pushteti', ingranuar në një mekanizëm të aktivitetit ushtarak.

Është e vështirë të vihen në dukje dhe etiketohen/përcaktohen strategjitë e BE-së në arenën ndërkombëtare, por duhet theksuar se në kushtet aktuale, megjithëse ndërhyrja humanitare nuk ka qenë kurrë një strategji e patëmetë dhe krejtësisht e qartë për BE-në, është veçanërisht e rëndësishme të njihet fakti që në botën e sotme, ky element ka një rol të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm, në rritje. Përveç aktorëve tradicionalë, shekulli i 21-të përqafton formësimin e aktorëve pa shtetësi/joshtetërorë, luftërat civile, si dhe kërcënimet e reja shkatërruese, ndërsa përballemi me 'dilema të ndryshme humanitare'. Në shumë nga krizat më komplekse humanitare në botë, duhet theksuar se ka një mbivendosje të prioriteteve humanitare, kundrejt "objektivave më të gjera të politikës së jashtme". Mjetet ushtarake të përziera me veprime politike dhe humanitare përfshijnë llogaritje të vështira për t'u bërë/realizuar, në lidhje me aktorë (të polarizuar), disa prej të cilëve mund të përparojnë në ndërthurje me 'veprimet' -në parim humanitare.

Sot, BE-ja është me të vërtetë e përkushtuar ndaj vlerave të paqes, demokracisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, por suksesi në promovimin e këtyre vlerave kalon nëpërmjet ndërvarësisë dhe mbetet ende në pikëpyetje. Për këtë arsye, ky artikull do të paraqesë një përpjekje për një vlerësim të përgjithshëm të rolit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, në lidhje me një situatë sfidash, të lidhura me shqetësimet e sigurisë dhe nevojat humanitare - jashtë BE-së.

Fjalët kyçe: krizë, strategji, BE, bashkëpunim, siguri, sfidë, nevojë humanitare, të drejtat e njeriut, konflikt, diplomaci, luftë, Ukraina, NATO.

1. Vendosja e kontekstit

Një nga tiparet më të rëndësishme të sistemit global në kohën e sotme është rritja e ndjeshme e numrit dhe rëndësisë/peshës së subjekteve/aktorëve dhe formave apo metodave të reja të kërcënimeve ndërkombëtare. Bota e globalizuar përcaktohet nga një ndërvarësi në rritje dhe një komunikim i rrjetëzuar dhe intensiv midis shoqërive të ndryshme -në një shumëllojshmëri agjendash. Ekziston një shumëllojshmëri e 'konfigurimeve të reja' që funksionojnë në një kuadër rajonal, por edhe në një bazë globale. Rritja e numrit dhe rolit të aktorëve të ndryshëm joshitetorë dhe përfshirja e tyre (në rritje) në politikën botërore ndeshet me supozimet realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat formojnë një mjedis ndërkombëtar, ku respektivisht, shtetet janë të vetmet njësi kryesore të sistemit (ndërkombëtar). Pikëpamjet liberale, nga ana tjetër, pranojnë se entitetet joshitetorë dhe josovrane kanë çuar në ndryshime të thella në politikën botërore. Ndërkohë, përballemi me një përshkallëzim të roleve, numrave dhe 'shtigjeve' të aktorëve që duhet të njohim dhe deshifrojmë, në ndërveprim ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshitetorë. Këto pikëpamje krijojnë një realitet të paqëndrueshëm teorik dhe praktik në arenën (politike) ndërkombëtare.

Në mjedisin ndërkombëtar me shumë nivele analize, -ndonëse roli i dimensionit normativ është rritur me kalimin e kohës, -marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me vendet e treta (në Lindje) kanë qenë prej kohësh të dominuara kryesisht nga prioritetet realiste dhe strategjike (të sigurisë), duke filluar me luftën kundër terrorizmit, kontrollin e (e)migracionit, aksesin në energji, etj. Megjithatë, pa përjashtuar nivelet e destabilitetit dhe problemet e koherencës së brendshme, sot parimet liberale motivojnë ndjeshëm orientimin e politikës së jashtme të BE-së, pavarësisht alternativave realiste. Kjo është një çështje e lidhur me faktin se shtete të ndryshme anëtare në BE, mbajnë një kontroll të fortë kombëtar mbi çështje të veçanta -dhe vendosin të veprojnë kolektivisht nën 'ombrellën' e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë -kur rëndësia e marrëdhënieve në politikën e jashtme të BE-së -dhe mjetet e saj, synojnë të jenë dukshëm më efektive (në një këndvështrim racional dhe normativ së bashku). Në këtë këndvështrim, strategjitë, taktikat dhe veprimet që BE-ja mund t'i 'rregullojë' dhe t'i 'ripërshtatë', varen nga forca dhe koherenca e

brendshme e Unionit. Megjithatë, veprimet e BE-së ndryshojnë nën ‘ngjyresat’ e interesave të paqëndrueshme në politikën e saj të jashtme. BE-ja duhet të përballlet me ‘kërcënime të reja’ dhe rreziqe ‘të vjetra’, ndërkohë që sistemi ndërkombëtar tregon se nuk e ka harruar kurrë atë që quhet -‘luftë’.

2. Suksesi dhe dështimet: Ngritja e dyshimeve

Bashkimi Evropian është ‘përgjigjur’ ndaj situatave jashtë territorit të vet në disa raste, nën kauzën e ndërhyrjes humanitare. Disa përfshirje kanë rezultuar në sukses, ndërsa shumë të tjera nuk kanë rezultuar të tilla. Koncepti i ndërhyrjes humanitare, -është një koncept i kontestuar që duhet të rimendohet dhe të ristrukturohet sipas kompleksitetit të kushteve dhe mjediseve politike, ekonomike, sociale etj. Studiues të ndryshëm e kanë përkufizuar gjerësisht ‘ndërhyrjen humanitare’ si ...‘marrjen e masave shtrënguese nga një ose më shumë shtete (duke mos përjashtuar përdorimin e forcave të armatosura), në një shtet tjetër, (pa pëlqimin e autoriteteve të tij); -për të parandaluar vuajtjet masive apo vdekjen mes njerëzve -kudo që janë’. Ndërhyrjet humanitare përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh të mundshme, duke përfshirë sanksionet politike dhe ekonomike dhe komunikimin diplomatik të bazuar në dialog, si dhe synim drejt konsensusit për të shmangur përshkallëzime konflikti. Nga një këndvështrim tjetër, forcat ushtarake përfshihen vetëm në rastet më ekstreme (që sot nuk mungojnë, fatkeqësisht për të gjithë ne). Ndërhyrja humanitare do të thotë që kufijtë shtetërorë nuk duhet të shihen si një mbrojtje statike për kriminelët e luftës apo vrasësit e popullatës. Fakti që konflikti mund të jetë ‘i brendshëm’, nuk u jep palëve asnjë të drejtë të shkelin rregullat më elementare të normave humane (humanitare).

Për më tepër, sipas një doktrine ende mjaft të paqartë të ndërhyrjes humanitare, midis aspekteve të tjera, qëndron tipari thelbësor –‘ushtarak i doktrinës’, që ka marrë vëmendjen më të madhe nga studiuesit dhe udhëheqësit e real politikës. Disa studiues dhe intelektualë (të njëanshëm ose jo) besojnë se ndërhyrja e pastër humanitare nuk ka ndodhur kurrë dhe të gjitha ndërhyrjet (ushtarake) janë të motivuara nga më shumë sesa thjesht një qëllim për të mbrojtur më të dobët. Veprimet ushtarake të përziera me veprime politike dhe humanitare shpesh prodhojnë udhëkryqe dhe situata kontradiktore, të cilat minojnë përpjekjet për të ruajtur linjën humanitare ‘të paprekur’.

Komuniteti ndërkombëtar (përfshirë BE-në) e njeh faktin që ‘forcat’ e imponuara nga sistemet perëndimore të lidhura me shtigjet e shtet-ndërtimit dhe zhvillimit janë shpesh agonizuese. Megjithatë, është rasti dhe rrethana të përmendet se një pikëpamje dhe reagim specifik në lidhje me rastin e Kosovës (p.sh.) ka prodhuar realitetin e një arritjeje, ndërsa NATO është ‘drejtimit i sigurt’ dhe integrimi në BE një nxitje e fortë politike dhe strategjike në Rajon.

3. Vërejtje mbi rolin aktual të BE-së - A po përballet Unioni me 'supozime realiste' në 'një pasqyrë' të 'diplomacisë së ndritur'?

Mekanizmat 'soft' dhe 'kushtëzimi' i BE-së (në rastet kur funksionojnë) kërkojnë vazhdimisht vënien në pikëpyetje të marrëdhënieve dhe implikimeve të politikave të BE-së në vende specifike, të cilat përqafojnë shpresa të gjera drejt Unionit. Në këtë kontekst, natyra komplekse e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të treta, jashtë BE-së (nën kategori të ndryshme), kërkon që BE-ja të avancojë me stimuj të rinj dhe motivim të kujdesshëm. Në fakt, ekziston një nevojë reale për të (ri)menduar për ndërvarësinë ndërmjet BE-së dhe vendeve të treta (dhe aktorëve joshtetërorë njëkohësisht), - në një proces që mund të hapë shtigje të reja.

Perëndimi (dhe jo vetëm) supozohet se beson se 'deontologjisë së paqes demokratike' duhet t'i jepet froni që i takon; -por mjetet dhe qëllimet, deri më tani, nuk janë përafuar saktësisht me rrugët/hartat strategjike. BE-ja, më shumë se kurrë, duhet të kapërcejë dhe tejkalojë kakofoninë e mozaikut ndërkombëtar dhe duhet të lëvizë shpejt përpara, në drejtimin e politikës së saj të jashtme, duke gjetur një zë të qëndrueshëm/koherent për çështjet e fundit. Situatat 'gjithnjë në ndryshim', ndër të tjera, lidhen me elemente të një 'mbrojtjeje cilësore'.

4. Ukraina - Perëndim dhe Lindje – A është Bashkimi Evropian një perspektivë e vërtetë?

Revolucioni i Tetorit 1917 solli jo vetëm një ndryshim rrënjësor në qeverisjen ruse, por edhe 'energji' të reja në sistemin politik ndërkombëtar. Për herë të parë në histori një parti marksiste mori kontrollin e shtetit. Ky revolucion nuk ndodhi në asnjë vend të industrializuar të Evropës Perëndimore, siç parashikohej nga Marksisi apo Engelsi, - por u zhvillua në Rusi, - një vend me një shkallë të gjerë të popullsisë/orientimit/konfigurimit rural. Rusia ka marrë një drejtim/rrugë tjetër zhvillimi nga vendet e Evropës Perëndimore. Më vonë, -pas sundimit të tij, - vdekja e Stalinit ngriti pyetje të tilla si: - Nëse sistemi i krijuar deri në atë kohë do të mbijetonte ende dhe, nëse jo, si do t'i ofroheshin masave politika 'të reja'?

Duke paraqitur një diskutim të gjatë me pak fjalë, nga e kaluara sovjetike e në vazhdim, proceset politike me vështirësi u orientuan drejt hapjes, ndërkohë që diskutimi mediatik për 'pika graviteti specifike' ka qenë thelbësor për të 'ushqyer' shpresat dhe pritshmërinë. Megjithatë, ndikimi i drejtpërdrejtë i masave në demokracinë/politikën deliberative rezultoi i kufizuar. Përpjekjet dhe lëvizjet e brendshme për demokratizim dhe përpjekjet që u ndikuan nga jashtë në vendet e Evropës Lindore, shpesh (drejtpërsëdrejti ose tërthorazi) u shtypën nga Rusia. Megjithatë, me kalimin e kohës, reformat e brendshme (kombëtare) partiake çuan në një farë mase social-demokratizimi. Në shumë raste lëvizjet reformiste përfunduan me ndërhyrje ushtarake, duke përcaktuar historinë politike, ekonomike dhe sociale të Evropës Lindore.

Në lidhje me Ukrainën, në kontrast midis modernizimit dhe të kaluarës, shkëlqimit dhe mureve të rrënuara, mund të identifikoheshin shenja të kontradiktave shumë më serioze. Para përshkallëzimit të konfliktit në luftë, kishte shenja të një shoqërie - të përfshirë në një proces tranzicioni -me një demokraci të brishtë dhe jo të plotë, -shenja të lirive të kufizuara në kohë dhe një sistem tregu të kufizuar. Në fakt, të gjitha rrugët janë 'minuar' nga shkatërrimi dramatik i luftës. Zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale në Ukrainë marrin një rëndësi të veçantë për Rusinë, por pa u përfshirë një diskutim mbi perspektivat dhe politikën ruse, -duhet thënë se Ukraina lufton në një luftë midis një trashëgimie të shtrembëruar dhe -modeleve të reja perëndimore, - duke u përballur me dinamikën më të vështirë të mundshme, -luftën.

Në fakt, BE-ja i mban gjallë shpresat në Ukrainë, fillimisht në një përpjekje për të siguruar paqen, pastaj me një premtim për një të ardhme të qëndrueshme, të zhvilluar dhe demokratike për qytetarët e saj. Në mes të dramës, perspektiva e integritit në BE përbën një nga mjetet kryesore për afrimin e Ukrainës me vlerat dhe standardet e vendeve perëndimore.

Më herët, para luftës, Ukraina nisi një program ambicioz reformash për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe për të përmirësuar jetesën e qytetarëve të saj, ndërsa BE-ja nuk harroi të zbatonte "kushtëzimin e saj tradicional", në varësi të progresit të tyre. Që nga shpërthimi dhe përshkallëzimi i konfliktit në vitin 2014, BE-ja ka ofruar (në një farë mase), ndihmë humanitare dhe mbështetje për zhvillimin socio-ekonomik. Mbështetja e BE-së ka ndihmuar në mbrojtjen bazike të jetesës dhe në zbutjen e vuajtjeve të popullatës në zonat e konfliktit. Megjithatë, tani, termi 'zona konflikti' ka një kuptim tjetër.

Larg nga diskutimi për rrënjët dhe trashëgiminë që lidhen me konfliktin në Ukrainë, fakt është se konflikti u përshkallëzua në mënyrë agresive që në vitin 2014 dhe, aktualisht, është zgjeruar në mënyrën më të rrezikshme. Ndërsa situata humanitare në Ukrainë bëhet gjithnjë e më dramatike dhe vendet fqinje pranojnë shtetas nga Ukraina në territorin e tyre, duhet të specifikohet dhe të njihet fakti se Bashkimi Evropian vepron në disa fronte për të ofruar ndihmë emergjente.

Civilët paguajnë çmimin më të lartë të agresionit ushtarak rus ndaj Ukrainës. Përveç problemeve të tjera, lufta nënkupton rreziqe të zhvendosjes së miliona ukrainasve, duke çuar në një rritje të mprehtë të nevojave humanitare. Kjo nyje lidh Ukrainën në të gjitha dimensionet, por në fakt ngrihen edhe probleme (deontologjike dhe praktike) në vendet fqinje ku ukrainasit kërkojnë siguri. Dhuna e armatosur dhe kërcënimet me rrezikshmëri të lartë shkaktojnë vuajtje të gjera njerëzore, viktime mes civilëve (e jo vetëm), dëmtime në infrastrukturën civile, zhvendosje të gjerë dhe përshkallëzim të nevojave humanitare, të cilat rrjedhin nga konflikti aktual (dhe mbartur në kohë). Pandemia e rëndon situatën, pasi nivelet e pasigurisë rriten.

Ndërkohë që ‘Diplomacia e BE-së’ punon për paqen, demokracinë, dialogun, të drejtat e njeriut dhe një panoramë të qëndrueshme ndërkombëtare, Ukraina dhe BE-ja, në këtë panoramë, përballen në një ‘pasqyrë të krisur’, ku shfaqet imazhi i Sun Tzu-së dhe Clausewitz-it.

5. Implikime dhe deduktime

Një e ardhme e përbashkët (e pa)sigurt

Ukraina po kalon një situatë dramatike, në rrethana të një shkatërrimi historik, me një jehonë afatgjatë dhe të gjerë. Megjithatë, perspektiva ‘përendimore’ luan një rol të rëndësishëm duke mbajtur gjallë shpresat për të ardhmen e vendit. Shpresat mund të jenë thelbësore, nëse aktorët lindorë nuk vendosin të materializojnë veprime të papritura, të cilat mund ta detyrojnë sistemin të bëhet irracional. Lufta e tanishme ushqehet me mundësinë/rrezikun e kërcënimeve bërthamore, të cilat mund të gjunjëzojnë të gjithë aktorët në arenën ndërkombëtare.

Pyetje ngrihen: -A mund të lehtësojë lufta një procedurë më të shpejtë të integritimit në BE? -A mund të provokojnë sulmet ruse një procedurë të përsheptuar të anëtarësimit në BE për Ukrainën?

Perëndimi e përshkruan Presidentin ukrainas si një arketip të vlerave evropiane, por askush nuk jep një premtim, një afat kohor ose përcaktim. Populli ukrainas ka nevojë mbi të gjitha për mbrojtje por edhe për frymëzim, por ka ende një rrugë të gjatë përpara, drejt terrreneve të sigurt. Anëtarësimi në BE nuk është një çështje që mund të negociohet brenda pak muajsh. Procedura e anëtarësimit në BE sipas Traktatit të Lisbonës është e gjatë dhe e ndërlikuar.

Bisedimet e anëtarësimit mund të zgjasin me vite dhe vite. Turqia filloi negociatat me BE-në që nga aplikimi i saj në 1987. Mali i Zi ka negociuar në thelb në bisedime që nga viti 2012, Serbia që nga viti 2014. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë gjithashtu vende candidate, por për shkak të mosmarrëveshjeve brenda BE-së, ende në vitin 2022 bisedimet nuk kanë filluar.

Me Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Moldavinë, si ish-republika sovjetike, BE-ja ka krijuar dialog, duke synuar të mundësojë afrimin social dhe politik. Deri më tani, anëtarët e BE-së i janë shmangur një premtimi ‘të vendosur’ -që këto përpjekje do të finalizohen me anëtarësimin. Në një situatë pasigurie dhe në kushtet e mosfunksionimit të diplomacisë, aktualisht, shtetet në Lindje, shpresojnë edhe që një ditë mund t’i bashkohen aleancës së NATO-s. Kjo dinamikë komplekse ka përcaktuar ‘ambiciet’ në Lindje dhe ka ‘shtrembëruar’ funksionimin e diplomacisë.

Duke u kthyer te diskutimi mbi anëtarësimin në BE, një procedurë e përsheptuar, siç kërkohet në fakt nga Ukraina, nuk parashikohet nga Unioni, por nën dritën e situatës aktuale gjeostrategjike në Evropë, nuk përjashtohet

që ky mund të jetë një rast specifik, me një përgjigje specifike.

Si përfundim, larg premtimeve të 'integritit të shpejtë', BE-ja mbetet e përkushtuar ndaj paqes dhe deontologjisë së saj, me një kapacitet të vërtetë për të 'ndriçuar' një të ardhme të përbashkët, larg filozofisë dhe antropologjisë së luftës. Suksesi për të rikthyer në jetë Ukrainën, e cila mund të ngrihet nga rrënojat, mbetet për t'u jetësuar, duke 'ulur perden' e 'aktit të fundit', në një 'dramë' luftime. Diplomacia ka peshën e saj specifike, por 'konflikti dhe kërcënimet (edhe bërthamore)' përbëjnë faktorë 'frike masive' dhe 'shtrëngim' i pashmangshëm në sistemin ndërkombëtar. Përgjigjja mbetet 'një mbrojtje cilësore'.

Bibliografia:

1. Archer, C. (1992): International Organizations. London: Routledge.
2. Access to European Union Law: Available at: <https://eur-lex.europa.eu/homepage.html>
3. Clausewitz, C. v., Howard, M., Paret, P., & Brodie, B. (1984). On war. Princeton, N.J.: Princeton University Press.
4. Bull, H. (1977): The anarchical society. A study of world order. London: Macmillan.
5. Evans, G. and Newnham, J. (1990): The Dictionary of World Politics. New York: Harvester Wheatsheaf.
6. Europa Summaries of EU Legislation. https://eur-lex.europa.eu/search.html?DTS_SUBDOM=ALL_ALL&orDNGroup=CM%3D36813_0840c6_9684&lang=&type=advanced&qid=1646503286138
7. Frankel, J. (1988): International Relations in a Changing World. Oxford: Oxford University Press.
8. Haufler, V. (1993): Crossing the Boundary between Public and Private: International Regimes and Non-State Actors: In: Rittberger, V. (ed.) Regime Theory and International Relations. Oxford: Oxford University Press, 94-111
9. Hocking, B. and M. Smith. (1990): World Politics. New York: Harvester Wheatsheaf.
10. EU humanitarian aid instrument. Available at: http://europa.eu/legislation_summaries/humanitarian_aid/r10001_en.htm
11. Jacobson, H.K. (1984): Networks of Interdependence: International Organizations and the Global Political System. New York: Knopf.
12. Morgenthau, H. (1949): Politics among Nations; the Struggle for Power and Peace. New York: Knopf.
13. Peen Rodt & Wolff. (2012). The EU as a Global Conflict Manager. Routledge.
14. Roberts, A. (2000): The So-called 'Right' of Humanitarian Intervention. Yearbook of International Humanitarian Law. V. 3: pp 3-51.

RUBRIKA E DYTË

Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja- Ndikimi i tyre në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Në këtë edicion të Revistës Ushtarake, **Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi** vjen me shkrimin **“Kohezioni i grupit dhe lidhshëpi”**, duke sjellë në vëmendjen e lexuesit termin “kohezion”, si një element shumë i rëndësishëm për të kuptuar unitetin brenda grupit, si ndikon tek anëtarët e tij në veprimtaritë rutinë dhe të dedikuara për të realizuar detyra me peshë specifike në kuadër të përmbushjes së objektivave apo misionit të organizatës.

Qëllimi i këtij shkrimi është të shpjegojë se çfarë është kohezioni dhe si lidhet me besimin e ndërsjellë midis anëtarëve dhe performancën e përgjithshme të grupit. Fokusi do të jetë kohezioni në strukturat e vogla të Forcave të Armatosura ose, e thënë ndryshe kohezioni ushtarak, karakteristikat e një grupi koheziv, roli i lidhjeve të forta dhe marrëdhëniet midis anëtarëve brenda dhe jashtë grupit për të mbajtur një kohezion të qëndrueshëm.

Rubrika e dytë vijon me shkrimin **“Metoda vlerësimi për efektivin e personelit në QKR, në kohë paqeje, krize dhe konflikti”** të nënkolonel **Msc. Eduart Pllaha**. Nëpërmjet një model vlerësimi, ai përshkruan dhe analizon faktorët që ndikojnë tek efektiviteti i Qendrës së Kontroll-Raportimit (QKR) në Forcën Ajrore, në kohë paqe, krize dhe lufte. Ky model mund të zbatohet në çdo nivel komandim-kontrolli dhe ofron rezultate të sakta për matjen e efektivitetit luftarak në kohë krize, stërvitje e trajnimi. Qendra e Kontroll-Raportimit (QKR) e Forcës Ajrore është në proces modernizimi duke zbatuar dy projekte

të rëndësishme: “SIVHA-Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore” dhe “Sistemi i Komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (T-A-T)”. Përveç përvetësimit dhe eksplorimit më të mirë të sistemeve, duhet të merren në konsideratë edhe elemente të tjera që ndikojnë në efektivitetin e realizimit të detyrave, si: trajnimi dhe stërvitja e personelit, kushtet e punës në të cilën shërbejnë efektivët e QKR-së, etj.

KOHEZIONI I GRUPIT DHE LIDERSHIPI

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi

Pedagog për Udhëheqjen Ushtarake, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Kohezioni është një element shumë i rëndësishëm për të kuptuar unitetin brenda grupit, si ndikon tek anëtarët e tij në veprimtaritë rutinë dhe të dedikuara për të realizuar detyra me peshë specifike në kuadër të përmbushjes së objektivave apo misionit të organizatës. Funkcionimi i një grupi bazohet në shpërndarjen dhe konfigurimin e disa elementeve, si rolet, normat dhe kohezionin grupor. Të gjithë këta elemente veprojnë si një “ngjitës” që i kthen njerëzit e zakonshëm në një grup. Por grupet kërkojnë një identitet të përbashkët, një strukturë dhe ndërvarësi. Bazuar në këto variabla, duhet të themi se kohezioni i grupit është i ndryshëm. Në sociologji, kohezioni shoqëror i referohet bashkimit që ekziston midis anëtarëve të një grupi që ndajnë ide dhe kanë një ndjenjë të përkatësisë, e cila lejon kryerjen e një projekti ose qëllimi të përbashkët. Kohezioni mund të “ngjizet” në një grup, që ndodhet në hierarkinë e një strukture përkatëse në një organizatë të caktuar ushtarake apo civile.

Në këtë kuadër, qëllimi i këtij shkrimi është të shpjegojë se çfarë është kohezioni dhe si lidhet me besimin e ndërsjellë midis anëtarëve dhe performancën e përgjithshme të grupit. Fokusi do të jetë kohezioni në strukturat e vogla të Forcave të Armatosura ose, e thënë ndryshe kohezioni ushtarak, karakteristikat e një grupi koheziv, roli i lidhjeve të forta dhe marrëdhëniet midis anëtarëve brenda dhe jashtë grupit për të mbajtur një kohezion të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: kohezion, grupi/njësia, organizata, marrëdhënie, vlerë shpirtërore, elementi njeri, faktori moral, karakteristika, strukturë, lidhje, sukses, mision.

Hyrje

“Personat e rëndësishëm për ushtarin që lufton janë njerëzit, të cilët luftojnë përkrah tij dhe që ndajnë me të provën e rëndë të përpjekjeve për mbijetesë”¹

Aleksandër George² (në përshkrimin e aksioneve të ushtarëve në Kore)

Në kujtimet e tij në librin “Udhëtimi im amerikan”, Gjenerali amerikan Kolin Pauell tregon për jetën e tij, për ngjarjet dhe për luftërat ku ai ka marrë pjesë drejtpërdrejt apo ka pasur një rol të caktuar. *“Ne na mësuam - thekson ai, - që ushtari amerikan duhet të dijë arsyet e sakrificës së tij. Ushtarët tanë nuk janë vasalë apo mercenarë. Ata janë bij dhe bijat e vendit të tyre. Ne vëmë në rrezik jetët tona vetëm për objektivat që ia vlejnë. Nëse detyra e ushtarit është të rrezikojë jetën e tij, përgjegjësia e eprorit të tij është të mos e harxhojë kot atë jetë”³*. Duke e lexuar librin ndokush mund të krijojë përshtypjen, se disa veprime apo vrasje mund dhe të ishin shmangur. Është e natyrshme për një njeri jashtë një organizate ushtarake ta pretendojë këtë, por për ushtarin në fushën e luftës, çështja shtrohet të vrasësh apo të të vrasin. Gjeneral Pauelli ka të drejtë kur e shtron këtë çështje kështu. Në Vietnam për shembull, për ata që luftonin, pala tjetër përpiqej t’u bënte të njëjtën gjë, t’i vriste⁴. Por, ushtarët dërgohen në luftë nga kombi i tyre dhe legjitimisht për të vuarë. Kjo është puna e tyre dhe ata duhet ta bëjnë atë. Pyetja që shtrohet natyrshëm është: “Përse lufton ushtari?” ose “Çfarë e shtyn që të luftojë një ushtar?”

Në analizat e bëra del në pah se në luftërat që zhvillohen sot, ushtari është pjesë e një grupi në strukturat hierarkike ushtarake, duke llogaritur këtu dy apo tre shokët në të majtë e në të djathtë të tij. Format e ndryshme të organizimit të FA nuk japin mundësi, që ushtari të vëzhgohet në luftim, aq më pak të mbikëqyren veprimet e tij në fushën e luftës. Është kjo arsyeja që, ajo çka ndjen ushtari për grupin e vogël ku bën pjesë, të ketë një vlerë që nuk

¹ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 10.

² Alexander L. George (31 maj 1920 Çikago - 16 gusht 2006 Seattle) ishte një shkencëtar amerikan i sjelljes (mënyrës së të sjellurit). Ai dha kontribute me ndikim në psikologjinë politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe metodologjinë e shkencave shoqërore (shënim i autorit).

³ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999, faqe 40.

⁴ Po aty, faqe 10.

mund të injorohet. Grupi i vogël vendos rregulla të forta sjelljeje dhe kërkesash ndaj individit në sajë të marrëdhënieve të ngushta që krijohen brenda tij dhe për pasojë, bëhet faktori vendimtar i veprimtarisë së ushtarit. Në një njësi që udhëhiqet e kontrollohet si duhet nga drejtuesi i saj, të gjitha ndikimet e tjera bëhen të dorës së dytë. Ky ndikim mbizotërues i grupit të vogël në luftë, ashtu si dhe në paqe, është dëshmuar në shumë ushtri. Citojmë fjalët e një ushtari gjerman të Luftës së Dytë Botërore që e thotë mjaft qartë: *“Kompania është e vetmja bashkësi me të cilën ne kemi lidhur ekzistencën tonë dhe që drejton gjithë jetën tonë këtu. Kjo bashkësi nuk të lejon as kohë, as qetësi për të pasur jetën tënde private; ajo na shtrëngon të gjithëve në qerthullin e saj të ngushtë, sepse jeta në çdo çast është në rrezik. Natyrisht, mund të bëhen dhe kompromise dhe detyrimet të lihen mënjatë përkohësisht. Kështu që ideja e të luftuarit, të jetuarit dhe dhënies së jetës për atdhe, s’është veçse një mendim i largët ose, së paku, ajo nuk luan një rol të madh në motivimin e njeriut këtu”*⁵. Në të njëjtën linjë gjykimi është edhe S.L.A. Marshall⁶, që i kishte vëzhguar nga afër ushtarët në shumë ushtri dhe luftëra: *“Pohoj pa mëdyshje se e vërteta e thjeshtë mbi atë çka e bën një ushtar këmbësor të çajë përpara me armën e tij shtrënguar në dorë, është prania e një shoku përkrah tij ose figura e imagjinuar e një shoku lufte”*⁷.

Ndikimi i grupit të ngushtë në kohezionin e organizatës është pranuar prej të gjithë atyre që e kanë studiuar këtë dukuri, si shumë domethënëse. Edhe ata që thonë se kjo dukuri ka kufizimet e veta, megjithatë pranojnë se koncepti i grupit të vogël është qendror në shpjegimin e sjelljes së ushtarit. Studiuesit e shkencave sociale, përgjithësisht nuk ia kushtojnë gatishmërinë e ushtarit për të luftuar, vetëm grupit të ngushtë të shokëve të tij. Të gjithë e pranojnë se grupi i ngushtë mund të veprojë kundër kërkesave të njësisë më të madhe, në qoftë se drejtuesit apo më mirë komandantët nuk kanë ndikim mbizotërues brenda grupit. Për më tepër, Janoviçi⁸, një nga të parët që kuptuan rëndësinë e grupit të vogël në shpjegimin e sjelljes së një ushtari, konfirmon se **koncepti i grupit të vogël duhet të përfshihet e të shpjegohet brenda teorisë së sjelljes së organizuar apo të drejtuar**, kur kjo sjellje e individit shpjegohet në kuadrin e koncepteve të përgjithshme sociologjike.

⁵ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 9 - 10.

⁶ Gjeneral Brigade Samuel Lyman Atwood Marshall (S.L.A. Marshall) 18 Korrik 1900 – 17 dhjetor 1977, i njohur gjithashtu si Slam, ishte një gazetar dhe historian ushtarak. Ai shërbeu me Forcat Amerikane të Ekspeditës në Luftën e Parë Botërore, para se të nisej për të punuar si gazetar, i specializuar në punët ushtarake. (shënim i autorit)

⁷ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 10.

⁸ Morris Janowitz ishte një sociolog dhe profesor amerikan që dha kontribute të mëdha në teorinë sociologjike, studimin e paragjyqimeve, çështjet urbane dhe atdhetarizmin. Ai ishte një nga themeluesit e sociologjisë ushtarake dhe dha kontribute të mëdha, së bashku me Samuel P. (shënim i autorit).

1. Kohezioni ushtarak

“As forca e ushtrisë, as fuqia e armëve, por forca e shpirtit është ajo që sjell fitoren”⁹

Johan Gotlib Fihte¹⁰

Referuar betejave të shumta, zhvilluar në kohë të ndryshme, ka mjaft raste, ku ndër palët pjesëmarrëse kanë dalë fituese shtete me fuqi ushtarake më të ulët. Arsyeja është e thjeshtë: nga analizat e bëra për këtë qëllim janë marrë në konsideratë elementet përkatës si strategjia, armatimi, mbështetja logjistike, teknologjia, numri i ushtarëve etj., por ajo që ka pasur rëndësi vendimtare ka qenë elementi “**njeri**”, ose e thënë ndryshe **faktori moral**, që shpesh lihet në harresë, apo nuk ka pasur vëmendjen e duhur në analizat përkatëse. Për rëndësinë e këtij të fundit, është me vend të përmendim një thënie të Montgomerit¹¹, i cili elementin njeri e quan “thembra e Akilit”, dhe sipas tij, çështja bazë e luftës mbetet njeriu, si një forcë e vërtetë kolosale: *“Asnjë komandant nuk mund të arrijë sukses gjatë betejës në qoftë se ai nuk arrin të krijojë lidhjet e tij me ndjenjën dhe forcën shpirtërore të luftëtarëve që ai komandon. Lufta pikësepari fitohet në zemrat dhe mendjet e njerëzve duke mbajtur gjithmonë lart moralin e tyre...¹²”*.

Elementi njeri përbën shpirtin e organizatës, moralin e grupit. Nga perspektiva e individit, grupi kryen disa funksione. Ai kënaq nevojat për siguri, bashkim, përkushtim ndaj të tjerëve, vetëvlerësim dhe identitet personal, njohje nga të tjerët dhe pushtet. Bashkimi me grupin u jep individëve mundësi për arritjen e objektivave. Ai mund të pakësojë pengesat, ankthin dhe ndjenjën e pafuqisë. Ai krijon mundësi për t’u bashkuar me të tjerë që kanë aftësi të ndryshme dhe më të mëdha. Ai ndihmon individët të verifikojnë perceptimet për mjedisin ku punojnë. Ai mund të jetë thelbësor për përparim e sukses¹³. Grupi shërben për të rritur vetëvlerësimin e individit dhe i jep atij një **ndjenjë identiteti**. Pra, duket se grupi mund t’u shërbejë funksioneve të individëve.

Në këtë kuadër, analistë të ndryshëm janë të prirur ta quajnë motivimin e individit, ushtarit si një pjesë të grupit. Përderisa individi, që në çastin që i bashkohet FA, “humb” lirinë vetjake, ai është i detyruar të jetojë sipas

⁹ Pjer Luixhi Borfoloso, “Historia e doktrinave ushtarake”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 147.

¹⁰ Johann Gottlieb Fichte ishte një filozof gjerman që u bë një figurë themeluese e lëvizjes filozofike e njohur si idealizëm gjerman, i cili u zhvillua nga shkrimet teorike dhe etike të Immanuel Kant-it. (shënim i autorit)

¹¹ Feldmareshall Bernard Montgomery (1887-1976), një nga udhëheqësit më të shquar ushtarakë të L2B, arkitekt i fitores britanike në El Alamein dhe Komandant i Forcave Tokësore Aleate në invazionin fitimtar të Evropës Veriore në vitin e fundit të luftës. (shënim i autorit)

¹² Bernard Montgomeri, “Fushëbetajat” (kujtime), Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, fq. 287.

¹³ Mimoza Kasimati, “Sjellje organizative”, Tiranë 2010, ISBN: 978-99956-43-270, faqe 268.

një rregulli të përcaktuar nga eprori i tij. Individualiteti i tij “gëlltitet” nga kolektiviteti¹⁴. Për rrjedhojë, në ditët e sotme, termit të preferuar “**kohezion**” i është dhënë një kuptim më i gjerë dhe më i përcaktuar. Duke kuptuar se interesat dhe normat e një grupi të vogël mund t’i bien ndesh një organizmi më të madh, disa studiues parapëlqejnë të përdorin termin “**kohezion ushtarak**”, për të treguar se rregullat e grupit të vogël janë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e organizatës ushtarake. Në mënyrë më specifike kohezioni është cilësuar si: “*Sigurimi i lidhjeve të tilla midis anëtarëve të një organizimi dhe grupi në mënyrë që ata të ruajnë dëshirën dhe angazhimin ndaj njëri-tjetrit, ndaj njësisë (organizatës) dhe misionit të tyre*”¹⁵. Më hollësisht, kohezioni ekziston në një njësi, kur objektivat më të qenësishme që realizohen ditë për ditë nga ushtari, grupi i vogël me të cilin ai mëshirohet dhe fiton identitetin e tij dhe drejtuesi i këtij grupi janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, ku çdonjëri i fal kësaj shoqërie të ngushtë pjesën më kryesore të mendimeve dhe emocioneve të veta, sa arrihet deri aty ku çdo pjesëtar të jetë i gatshëm të rrezikojë jetën për të arritur objektivin e përbashkët.

Procesi i të ndërtuarit të një grupi rezultat-dhënës, njeh si parim kyç mosndarjen e performancës individuale nga ajo e pjesëtarëve të tjerë. Referuar një citati (varur në muret e dhomës së veshjes së Klubit Futbollistik Burnley) është shkruar: “*Në një skuadër të vërtetë, instinkti i promovimit individual, realizohet përmes ndjekjes së synimit të skuadrës*”. Grupi rezultat-dhënës ka një udhëheqje të mirë, ndjenjë të fortë e të përbashkët mbi strategjinë dhe objektivat, burimet për t’i realizuar ato, si dhe qartësi mbi rolet individuale. Ky është thelbi mbi ndërtimin e grupit. Ca më tej është shpirti i grupit, që ngjason më tepër me zamkën që mban grupin bashkë: sinqeritet dhe krijueshmëri, qëndrueshmëri ndaj taktikës së fajësimit kur gjërat shkojnë keq, dhe kulturë që inkurajon zhvillimin, përshtatshmërinë dhe rilindjen pafund. Rëndësi të veçantë merr integrimi si një proces koordinimi i detyrave, njerëzve dhe funksioneve, për të arritur unitet në përpjekjen e përbashkët – pra, për të bërë gjithkush “të shtyjë në të njëjtin drejtim” apo “të jetë në të njëjtën linjë”¹⁶. Parë në këtë këndvështrim, midis dy palëve ndërloftuese, kohezioni është ai që vendos se cila nga palët kundërshtarë qëndron më lart në faktorin moral. Luftërat e kohës së sotme kanë treguar se kohezioni i “njësive të vogla”¹⁷ është e vetmja forcë e aftë që i bën ushtarët t’i nxjerrin gjoksin armëve të kundërshtarit për të arritur objektivat e luftimit. Konfuzioni,

¹⁴ Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993, fq.24.

¹⁵ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 7.

¹⁶ Alastair Campbell, “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin”, Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë 2015, ISBN: 978-9928-190-55-0, faqe 98.

¹⁷ Me termin “njësi të vogla” nënkuptojmë strukturat më të vogla të një organizate ushtarake (shënim i autorit).

rreziku, mundimi dhe izolimi para të cilave provohet ushtari sot në luftë, kanë zhvlerësuar pothuajse krejt urdhrat strikte, stërvitjet, trajnimet dhe disiplinën shtrënguese. Në të njëjtën kohë është lëshuar ndjeshëm në kontrollin e ushtarit gjatë zbatimit të detyrës luftarake. Këto ndryshime janë shoqëruar me rritjen gjithnjë e më shumë të kompaktësimit të ushtarëve përmes krijimit të vlerave shpirtërore të përbashkëta dhe rregullave që veprojnë në funksion të zbatimit të detyrave, synimeve dhe vlerave të të gjithë njësisë ku bën pjesë ushtari. Nevoja për ndryshime të tilla është kuptuar në masë të ndryshme nga shumica e ushtrive bashkëkohore. Argumentin përkatës na e jep Hendersoni në librin e tij “Kohezioni, elementi njeri në luftim”: *Në ushtri, bindja e vartësve ndaj eprorëve duhet të bëhet ligj, ... por baza e disiplinës ushtarake duhet të jetë ndërgjegjja e çdonjërit. Një disiplinë e detyrimit me forcë të ushtarëve nuk është efektive. Disiplina duhet të jetë e vetëdijshme, sepse vetëm atëherë ushtari do të jetë në gjendje të kuptojë plotësisht përse lufton dhe si duhet të zbatojë urdhrat. Kjo lloj discipline bëhet një shtyllë e fuqishme në ushtri dhe kjo është e vetmja mënyrë që me të vërtetë është në gjendje të harmonizojë marrëdhëniet ndërmjet ushtarëve dhe oficerëve*¹⁸.

Në situatë luftarake, në çaste të caktuara kujdesi shpirtëror merr rol vendimtar. Kështu, kur lufta merr karakter të zgjatur, përfundimin e saj e vendos ana morale dhe shpirtërore dhe jo ajo fizike. Qëllimi përfundimtar i çdo lloj beteje është më shumë psikologjik se sa fizik.¹⁹ Qëllimi i vërtetë qëndron jo aq shumë në faktin që të asgjësohet armiku se sa në faktin që të dërmohet vullneti i tij, të thyhet shpirti i tij për vazhdimin e luftës. Në këtë kuadër, le të hedhim më nga afër një vështrim Luftës së Vietnamit, e cila në tërësi tregon një dukuri të jashtëzakonshme. Amerika, në fakt, fitoi pjesën dërrmuese të betejave në të cilën u përfshi. Gjatë dhjetë vjetëve në të cilat trupat amerikane ishin aktive në Luftën e Vietnamit, Amerika humbi 58.000 trupa. Vietnamit i Veriut humbi mbi tre milionë njerëz. Si përqindje popullsie, është sikur Amerika të humbiste 27 milionë njerëz në vitin 1968²⁰. E gjithë kjo shtron pyetjen: si mundet që të fitosh pothuajse çdo betejë, të asgjësosh armikun dhe prapëseprapë të humbësh luftën?

Arsyeja është e thjeshtë. Duke qenë përballë një fuqie kaq të madhe ushtarake, Vietnamit të Veriut i duhej të mbështetej në **faktorin moral**. Hierarku më i lartë ushtarak vietnamez (Van Tien Dung), e paraqet kështu strategjinë vietnameze: *“Armët dhe pajisjet tona ishin më të dobëta se të armikut, kështu që ne nuk na mbetej veçse të zhvillonim epërsinë morale (brenda ushtrisë), sepse vetëm*

¹⁸ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 8-9.

¹⁹ Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993, fq. 23.

²⁰ Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5, faqe 2.

atëherë do të kishim kurajën të sulmonim armikun; vetëm atëherë do të guxonim të luftonim vendosmërisht; vetëm atëherë do të mund të qëndronim para provave të vështira të krijuara nga fuqia më e madhe e zjarrit, që armiku përdori në luftë”²¹. Duke ndjekur këtë strategji, ushtria vietnamezo-veriore ruajti kohezionin dhe rezistoi, kur ndoshta ushtritë e tjera do të mposhteshin ose do të tërhiqeshin nga fusha e luftës. Kur Van Tien Dungu flet për “epërsinë morale” në radhët e ushtrisë së Vietnamit të Veriut, ai e ka fjalën për atë që shumë analistë e konsiderojnë si krijimin e një prej ushtrive më kohezive të rreshtuara ndonjëherë në fushën e luftës. Kujdesi që iu kushtua në këtë ushtri organizimit, udhëheqjes, ushtarit, zhvillimit të kohezionit ushtarak dhe të kontrollit psikologjik në strukturat më të vogla të ushtrisë, nuk mund të krahasohet me ushtritë e tjera moderne. Ushtria e Vietnamit të Veriut që në gjendje të përballonte stresin më të rëndë të luftës për shkak të zhvillimit të jashtëzakonshëm të faktorit moral.

2. Karakteristikat e grupit koheziv

“Entuziazmi llamburitës, i shoqëruar nga ndjesia e fuqishme e përkatësisë, është cilësia që më shpesh formëson suksesin”²²

Dale Carnegie

Shenjat e kohezionit në organizatë (FA) duhen kërkuar atje ku ai shfaqet, pra në nivel njësie të vogël, grupet e ngushta të shokëve, që krijohen si në kohë paqeje ashtu dhe në kohë lufte. Siç e kemi thënë më lart, kohezioni ushtarak do të thotë lidhja e pjesëtarëve të një njësie në një formë të tillë, që çdo pjesëtar i saj t’ia nënshtrojnë vullnetin dhe angazhimin e vet shokut të tij, njësisë ku bën pjesë dhe misionit të ngarkuar. Duke pasur parasysh këtë përkufizim të kohezionit ushtarak të pranuar nga të gjithë, renditja e karakteristikave të një organizate ushtarake të tillë (kohezive) duhet të përfshijë këto fusha²³:

- o strukturën e përgjithshme organizative, (udhëheqja ose burime që të sigurojnë qëllimet, politikat dhe mbështetjen);
- o të ashtuquajturin “element moral” apo grupet e ngushta që kontrollojnë dhe motivojnë ushtarët përmes normave të tyre të brendshme të jetesës;
- o ndikimin e drejtuesit të strukturës mbi grupin e vogël;
- o angazhimin e individit në arritjen e objektivave të organizatës që vjen si rezultat i këtij ndikimi.

²¹ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 4.

²² Dale Carnegie & Associates, “Si të bëhesh udhëheqës i zoti”, Shtëpia Botuese “Pema”, Viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6, faqe 57.

²³ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 14.

Në strukturat ushtarake, niveli i vetëm ku këta tre faktorë shfaqen njëkohësisht, për këtë arsye edhe niveli më i përshtatshëm ku duhet përqendruar kërkimi mbi kohezionin është ajo pikë ku organizata, grupi i vogël dhe drejtuesi përfshihen së bashku dhe që në FA është niveli më i ulët i organizimit ushtarak. Grupi, skuadra, toga dhe strukturat (në nivel seksioni) janë më të përshtatshëm për t'ju futur kësaj teme për arsye se në këtë nivel bëhet organizimi zyrtar ushtarak dhe po kështu është e mundur të vëzhgohet se si pjesëtarët e grupeve të vogla zhvillojnë veprimtarinë e tyre si individë brenda grupeve. Gjithashtu në këtë nivel mund të vrojtohen qartë teknikat drejtuese dhe ndikimi i tyre në njësinë e vogël.

Karakteristikat organizative.

Ndoshta, qëllimi i parë i një organizate është t'i japë (sigurojë) një qëllim kohezionit të njësisë në formën e synimeve dhe të objektivave që duhen arritur. Nëse themi që qëllimi i luftës është arritja e përfundimeve politike, atëherë organizimi i përgjithshëm i një strukture ushtarake duhet t'i shërbejë përcjelljes së këtyre synimeve politike përmes një “zinxhiri komandues” drejt atyre njësisve përkatëse që, në fund të fundit, janë ngarkuar t'i arrijnë këto objektiva. Në këtë mënyrë, qëllimet e gjëra politike të udhëheqjes së lartë të përcillen dhe depërtojnë në grupin e vogël koheziv. Suksesi është më i sigurtë kur të gjitha strukturat përkatëse janë në një linjë dhe angazhimi i forcave është në objektivat sipas prioriteteve. Kaye dhe Evans në librin e tyre “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” e trajtojnë shumë bukur këtë dukuri kur këshillojnë: “Ndajeni me të tjerët një mision kuptimplotë – Pse ekziston ekipi dhe organizata juaj? Cili është misioni juaj? Ndajeni këtë mision me punonjësit tuaj. Më pas ndërthurni punën e punonjësve tuaj me këtë mision. Tregojini se si ndikon puna e tyre te misioni. Tregojini se sa të rëndësishëm janë ata për ju, për misionin e ekipit dhe për organizatën”²⁴. Kjo do të bëjë të mundur që gjithsecili në organizatë, sipas niveleve të detyrave të ndjehet i domosdoshëm dhe i rëndësishëm në misionin përkatës, gjë që rrit shkallën e kohezionit. Ja sa këndshëm shprehet Klei Shërki në librin “Po vijmë të gjithë”: “Punët që mendojmë se janë kompetencë e një mendje të vetme, në fakt kërkojnë një turmë për t'u kryer”. Edhe “Mikelanxhelo punësoi ndihmës, që të pikturonin pjesë të kupolës së kishëzës sistine”. (Paçka se ndihmësit nuk ishin të pazëvendësueshëm si piktori)²⁵. Pra, në një organizatë (ushtarake ose civile) strukturat përkatëse janë në funksion të misionit dhe ato punojnë si një makineri ku të gjithë mekanizmat (si i madhi, i mesmi, i vogli, ose një tjetër në dukje i parëndësishëm) duhet të punojnë në harmoni dhe në

²⁴ Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” (Si duhen trajtuar njerëzit e mirë, që të qëndrojnë në punë, 26 strategji për menaxherë aktivë, që dinë t'i angazhojnë njerëzit në punë), botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3, faqe 233.

²⁵ Susan Cain, “Pushteti i të heshturave”, Shtëpia Botuese “Living”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-216-59-5, faqe 81.

funksion të qëllimit kryesor, duke pasur peshën e vet specifike dhe rëndësinë e padiskutueshme.

Një funksion tjetër drejtues i strukturave të nivelit më të lartë është të sigurojë mbështetjen e nevojshme strukturave më të ulëta kohezive. Nga ky organizim kërkohet mbështetje logjistike dhe personel, siç kërkohet dhe ndërtimi i politikave që nxisin kohezionin.

Funksioni i fundit i një organizmi të caktuar është të përshkruajë dhe përcaktojë karakteristikat strukturore, se si duhet ndërtuar njësia e vogël në mënyrë që të nxitet kohezioni. Synimi i këtyre karakteristikave strukturore është të shkurajojë prirjet individuale tek çdo anëtar. Nga ana tjetër, njësia e vogël strukturohet në atë mënyrë që të inkurajohet përgjegjshmëria e ushtarit ndaj objektivave të njësisë²⁶. Ushtarit, në mënyrë të vazhdueshme, i silllet ndërmend përgjegjësia e tij ndaj shokëve të vet, ndaj komandantit të grupit, skuadrës, togës dhe së fundi ndaj kombit apo kushtetutës, nëpërmjet strukturës së njësisë ku bën pjesë. Kështu që, disa karakteristika organizative janë të rëndësishme. Madhësia e grupit për shembull, ka një domethënie të madhe, sepse kohezioni është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin e pjesëtarëve të grupit. Disa organizata ushtarake, në fakt kanë përcaktuar si ideale skuadrën deri në 9 pjesëtarë. Disa të tjerë kanë zgjedhur grupin me 3 njerëz si qelizën bazë, e cila bëhet blloku bazë me të cilin ndërtohet e tërë ngrehina e forcës njerëzore në FA. Kohezioni, po kështu, rritet sa më shumë që ushtari mendon se do të rrijë në FA. Gjithashtu, edhe shpeshtësia e kontaktit midis ushtarëve është e rëndësishme. Sa më e madhe të jetë shpeshtësia e kontakteve në zbatim të qëllimeve të përbashkëta, aq më tepër rritet kohezioni në grup. Dhe së fundi, sa më të strukturuara dhe të ndërvarura të bëhen këto kontakte midis ushtarëve brenda grupit, aq më tepër ndikim do të ushtrojë grupi mbi ushtarët.

Në këtë kuadër, solidariteti brenda grupit është shumë i rëndësishëm. Duke bërë një paralelizëm me ekipet sportive, këtë mund ta dallosh kur sportet individuale kthehen në sporte skuadrash. Në këtë rast shndërrohet në tjetër sport, sjell një vlerë të shtuar kur njerëzit punojnë bashkë; emocionet, të kërkuarit e diçkaje së bashku dhe papritmas interesi bëhet më i madh, papritmas flitet për “ne” dhe jo për “mua”. Qeniet njerëzore e kuptojnë vetvetiu që vetëm nuk janë asgjë, kurse në skuadër mund të arrijnë gjëra të mëdha²⁷. Me këtë logjikë, mund të konkludojmë se këto marrëdhënie të strukturuara e të përcaktuara, gjithashtu, shërbejnë për të përcaktuar kufijtë e grupit, që krijojnë një dallim të dukshëm në mes të pjesëtarëve të grupit dhe të tjerëve, ose siç mund të thuhet ndryshe, formojnë konceptet “ne” dhe “ata”.

²⁶ Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 16.

²⁷ Alastair Campbell, “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin”, Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë 2015, ISBN: 978-9928-190-55-0, faqe 102.

Grupi i vogël dhe karakteristikat e njësisë.

Njësitë e vogla kohezive, zakonisht, kanë disa karakteristika që i dallojnë. Njësia kohezive shërben si një njësi bazë taktike, zjarri dhe manovre ose shërbimi. Njësia kohezive duhet të funksionojë si një “grup shokësh”, e aftë të plotësojë (kënaqë) nevojat bazë psikologjike dhe sociale të ushtarit. Një karakteristikë tjetër është prania e grupit mbizotërues, i cili kontrollon sjelljen dhe veprimtarinë e përditshme të ushtarit. Drejtuesi i grupit vepron brenda tij për t’u siguruar që normat e sjelljes dhe detyrat të jenë në përputhje me objektivat e organizatës në përgjithësi. Karakteristika e fundit është ekzistenca e një sistemi vrojtimi e raportimi nëpërmjet veprimit të grupit të shokëve apo ndikimit ndreqës të drejtuesit që shërben për vetëkorrigjimin e shmangies prej rregullave të grupit, në mënyrë që sjellja e individit të ndreqet sipas kërkesave që përmendëm më lart.

Karakteristikat e drejtuesit.

Drejtimi është faktori më i rëndësishëm në përputhshmërinë midis normave të njësisë dhe objektivave organizative. Që drejtuesit të jenë të suksesshëm në futjen e rregullave që pajtohen me objektivat e organizatës, duhet që procesi i drejtimit të mbështetet në marrëdhëniet vetjake ndërmjet drejtuesit dhe ushtarëve dhe jo në atë të tipit të drejtimit e të komanduarit në largësi. Campbell në librin e tij “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin” shprehet: “*Në rast se njerëzit rreth udhëheqësit tregojnë qartësisht se janë të bashkuar, kjo kthehet në një zakon për ekipin. Nuk është e nevojshme që njerëzit të kalojnë çdo minutë të çdo ditë së bashku, por domosdoshmërisht duhet të kenë sensin e të punuarit për njeri-tjetrin. Në rast se udhëheqësi i ekipit jep sinjale se di të luajë në ekip, kjo i jep fuqi veprimtarisë në pikëpamje të organizimit, motivimit, energjisë që njerëzit do shpalosin*”²⁸. Parë në këtë këndvështrim, gjenden disa funksione të veçanta që karakterizojnë drejtimin e një njësie kohezive. Drejtuesit duhet t’i transmetojë njësisë kohezive objektivat e organizatës në mënyrë sa më të efektshme. Pastaj ai duhet të drejtojë njësinë e tij në arritjen e këtyre objektivave përmes ndikimit të tij në grup dhe përmes njohurive të tij teknike si specialist. “*Drejtimesit e zotë, - thekson Dale Carnegie, - nuk i përcaktojnë synimet për njerëzit e tyre thjesht duke u thënë si t’i arrijnë. Drejtuesit e zotë punojnë me njerëzit e tyre për t’i nxitur që ata të përcaktojnë synimet vetjake, duke u dhënë mjetet që u duhen për t’i arritur ato*”²⁹. Gjithashtu, drejtuesi duhet të ruajë kohezionin në njësi, duke siguruar një mbështetje të vazhdueshme nga organizata dhe duke diktuar dhe ndrequr çdo veprim që bie në kundërshtim me normat e grupit. Së fundi, drejtuesi punon në formimin e

²⁸ Po aty, faqe 92-93.

²⁹ Dale Carnegie & Associates, “Si të bëhesh udhëheqës i zoti”, Shtëpia Botuese “Pema”, viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6, faqe 65.

individit me anë të shembullit vetjak, me anë të të mësuarit dhe stërvitjes dhe me anë të ndikimit të vazhdueshëm.

3. Fortësia e lidhjeve dhe faktorët përkatës

“Katër njerëz të guximshëm, që nuk e njohin njeri-tjetrin, nuk do të guxojnë të sulmojnë një luan. Katër njerëz me zotësi më të vogël, por që e njohin njeri-tjetrin mirë, sigurojnë besimin dhe mbështetjen e ndërsjellë do ta sulmojnë luanin në mënyrë të vendosur”³⁰.

Ardnant du Pica, shkrimtar ushtarak francez

Individët nuk mund t’i kuptojmë jashtë grupeve, pasi grupi u jep atyre një mekanizëm për zgjidhjen e problemeve personale dhe ndërpersonale. Me këtë arsytim, duket se grupi ka të gjitha gjasat t’u shërbejë funksioneve të individëve. Përpos kësaj, kohezioni në grup fortëson lidhjet midis anëtarëve të grupit. Lidhjet shihen si një domosdoshmëri shumëdimensionale që i shërbejnë jo vetëm individit apo grupit por edhe vetë organizatës e misionit të saj.

Anëtarët e grupit janë shtylla kurrizore e çdo ndërmarrjeje të suksesshme. Ndërsa drejtuesit mund të marrin të gjitha vendimet e mëdha, anëtarët e grupit janë ata që bëjnë punën e nevojshme për t’ia dalë mbanë. Pa punonjës të mirë, një organizatë nuk mund të funksionojë siç duhet³¹. Procesi i të ndërtuarit të një grupi rezultat-dhënës, njeh si parim kyç lidhjet e forta midis anëtarëve, mosndarjen e performancës individuale nga ajo e të tjerëve dhe krijimin e shpirtit të grupit. *“Kjo është arsyeja, -thekson Xh. Blleidsi - që kur individët kanë aftësi të mira dhe efektiviteti ka kohezion të lartë, sa më të mobilizuar të jenë njerëzit, aq më të mirë do të jenë rezultatet”³².* Në këtë kuadër, fortësia e lidhjeve (koheziviteti) përcaktohet si masa në të cilën anëtarët janë të tërhequr ndaj njëri-tjetrit; dëshirojnë të mbeten në grup dhe janë të përkushtuar ndaj tij. Ajo ndikohet nga masa në të cilën objektivat e grupit janë në harmoni me ato të individit. Kur anëtarët kanë shumë dëshirë të rrinë në grup dhe të pranojnë objektivat e tij, themi se kemi grup me lidhje shumë të forta. Në përgjithësi anëtarët e grupit lidhen me njëri tjetrin, duke krijuar një identitet të përbashkët, që mund të përmbliidhen në dy grupe³³ kryesore:

a. Grupi, ku anëtarëve u pëlqen shoqëria e njëri-tjetrit (kohezioni ose lidhja socio-emocionale); Tërheqja socio-emocionale që anëtarët kanë ndaj njëri-tjetrit zhvillohet sepse anëtarët kanë një kënaqësi emocionale nga pjesëmarrja në grup.

³⁰ “Udhëheqja Ushtarake”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 114.

³¹ Dale Carnegie, “Arti për t’u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia botuese “Pegi”, Viti 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0, faqe 90.

³² Xhon U. Bllades, “Rregullat e drejtimit”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, faqe 83.

³³ Mimoza Kasimati, “Sjellje organizative”, Tiranë 2010, ISBN: 978-99956-43-270, faqe 289.

b. Grupi, ku anëtarët kanë nevojë për njëri-tjetrin për të realizuar detyrat e përbashkëta, për të arritur objektivat (kohezioni ose lidhja instrumentale). Lidhja instrumentale rezulton kur anëtarët e grupit varen reciprokisht nga njëri-tjetri sepse besojnë se nuk mund të realizojnë objektivin e përbashkëta duke vepruar veç e veç.

Cilët janë faktorët që përcaktojnë forcën e lidhjes që anëtarët e grupit kanë ndërmjet tyre?

Në qoftë se tërheqja është socio-emocionale faktorët janë si më poshtë:

1. *Koha e harxhuar së bashku.* Sa më shumë kohë harxhojnë me njëri-tjetrin aq më tepër kanë mundësi të miqësohen dhe të angazhohen në veprimtari të përbashkëta gjë që i ndihmon të zbulojnë interesat e përbashkëta. Është detyrë e drejtuesit që të theksojë karakteristikat dhe interesat e përbashkëta të anëtarëve, të inkurajojë ndërveprimin dhe bashkëpunimin.

2. *Përmasa e grupit.* Ky faktor ndikon në të kundërt nga sa ndikon koha e harxhuar së bashku. Sa më i madh grupi, aq më e vogël bëhet koha që anëtarët mund të harxhojnë me njëri-tjetrin, dhe aq më e vështirë është që të kenë të gjithë një qëllim të përbashkët. Në këto kushte, rritet dhe mundësia e formimit të nëngrupeve brenda grupeve, gjë që dobëson lidhjet e përgjithshme. Është detyrë e drejtuesit që të përpiqet të ruajë përmasën e grupit në kufijtë relativisht të ulët.

3. *Rreziqet e jashtme.* Forca e lidhjeve në një grup shtohet kur ky sulmohet nga jashtë. Në këto rreziqe hyjnë dhe përpjekjet që drejtuesit mund të bëjnë për të riprojektuar qoftë dhe një punë të vetme, ose për të disiplinuar një ose disa anëtarë. Është detyrë e drejtuesit të bëjë të qarta rreziqet e jashtme për të forcuar radhët e grupit.

4. *Sukseset e mëparshme.* Në qoftë se një grup ka një histori të mëparshme të suksesshme, kjo i tërheq dhe i bashkon anëtarët. Një organizatë e suksesshme e ka më të lehtë të gjejë dhe tërheqë anëtarë të rinj. E njëjta gjë vërtetohet për një grup kërkimor të suksesshëm, për një universitet të mirënjohur, për një skuadër sportive që fiton gjithmonë. E njëjta gjë vlen edhe për grupet e suksesshme, cilido qoftë lloji i punës së tyre. Është detyrë e drejtuesit që të përpiqet me çdo kusht për një imazh publik që është në favor të statusit dhe prestigjit të anëtarëve të grupit.

5. *Ashpërsia e fillimit.* Sa më e vështirë të jetë hyrja në një grup të dëshiruar, aq më shumë vlerësohet qenia aty, pas futjes. Në qoftë se anëtarët kanë mundësi të zgjedhin njëri-tjetrin kjo do të ndikojë për mirë në lidhjen socio-emocionale. Gjithashtu kjo lloj tërheqje mund të përforcohet nga veprimtari shoqërore jashtë pune që kanë anëtarët e grupit. Tërheqja socio-emocionale duhet të ekuilibrohet me atë instrumentale.

Në qoftë se tërheqja që kanë anëtarët ndaj njëri-tjetrit dhe ndjenja e të qenët

pjesë e grupit ka në bazë instrumentalitetin (“më duhet, se nuk bëj dot punë pa të”) faktorët që mund të ndikojnë në forcimin e lidhjes, që duhen mbajtur parasysh nga drejtuesit janë:

1. T’i jepet çdo anëtar i grupi një pjesë e rëndësishme nga gjithë ajo që do të bëjë grupi.
2. Të qartësohen e të sqarohen rregullisht objektivat e përbashkëta të grupit.
3. Të kanalizohen sa më mirë talentet individuale të anëtarëve të grupit për arritjen e objektivave të përbashkëta.
4. T’i njihet dhe shpërblehet në mënyrë të barabartë kontributi secilit prej anëtarëve të grupit.
5. Vazhdimisht u duhet kujtuar anëtarëve të grupit, që ata kanë nevojë për njëri-tjetrin për të bërë punën.

Në përpjekjet e tyre për rritjen e fortësisë së lidhjeve të anëtarëve të grupit, drejtuesit duhet të mbajnë parasysh që tërheqja shumë e fortë është e dëmshme, sepse ndikon në presionin për konformizëm. Lidhje të forta të anëtarëve të grupit, nuk nënkuptojnë medoemos dhe konformizëm. Grupet shumë të suksesshme mund të karakterizohen nga lidhje të forta dhe përkushtimi i anëtarëve, por njëkohësisht edhe nga respektimi dhe inkurajimi i dallimeve individuale në mendim dhe sjellje.

4. Marrëdhëniet e shëndosha, parakusht për një kohezion të qëndrueshëm

Skuadrat e nxehta janë ato ku puna të jep gëzim dhe, mbaron dita, mezi pret të vijë e nesërmja. Skuadrat e nxehta janë atje ku të gjithë bëjnë shumë punë në më pak kohë, pa iu bërë titur dhe pa i detyruar njeri³⁴.

Puna në grup është shumë e rëndësishme, për të arritur rezultatet e kërkuara. Njerëzit me shpirtin e fituesit e kuptojnë se suksesi i grupit është njëkohësisht dhe suksesi i tyre. Vendimet e mira zakonisht vijnë nga një grup njerëzish që punojnë së bashku. Një grup i suksesshëm përqendrohet tek respekti i ndërsjellë ndërmjet anëtarëve të grupit, mbështetja pa kufij, dhe vizioni i përbashkët se ku është duke shkuar grupi³⁵. Bashkëpunimi, marrëdhënia, sikurse dashuria dhe miqësia është diçka që e merrni duke e dhënë. Jo më kot Koloneli Blleids, autor i librit “Rregullat e drejtimit” e ka përcaktuar *kohezionin si shkallën në të cilën individët shfaqin mbështetje ndaj njëri-tjetrit, ndihmë të dyanshme, bashkëveprim organizativ dhe punë të bashkërenduar për përmbushjen e*

³⁴ Laurence Haughton, “Jo çfarë thua por çfarë bën”, Shtëpia Botuese “Max”, Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5, faqe 240.

³⁵ Vasil Naçi, “Vlerat bazë, sistemi i bindjeve për sukses”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2012, faqe 52.

*detyrës së tyre të përbashkët*³⁶. Ka shumë udhëtarë në rrugën që të çon drejt suksesit. Juve do t'ju duhet bashkëpunimi i tyre dhe atyre do t'u duhet i juaji. Filozofinë e bashkëpunimit e shpjegon mençurisht edhe E. Fromm në pasazhin e mëposhtëm: "...Një element i rëndësishëm është fakti se njerëzit nuk mund të jetojnë pa ndonjë lloj bashkëpunimi me të tjerët. Në të gjitha tipet e mundshme të qytetërimit, njeriu duhet të bashkëpunojë me të tjerët, në qoftë se do të mbijetojë, qoftë për t'u mbrojtur nga armiqtë ose nga rreziqet e natyrës, qoftë për të punuar e prodhuar"³⁷. Prandaj theksojmë se sukcesi i një grupi përcaktohet nga mënyra se si anëtarët e tij ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Mund të kesh në grup njerëzit më të talentuar, por sukcesi nuk do të arrihet nëse ata nuk punojnë së bashku, nëse ata nuk karakterizohen nga marrëdhënie të mira edhe të qëndrueshme.

Njohja e natyrës njerëzore është element shumë i rëndësishëm i veprimtarisë drejtuese. Kjo i jep mundësinë drejtuesit që të njohë më mirë vartësit e bashkëpunëtorët e tij, natyrën e tyre, interesat dhe motivet e tyre, dëshirat dhe ndjenjat, pakënaqësinë dhe shqetësimet, jetën familjare, të kaluarën dhe shpresat për të ardhmen.³⁸ Në këtë mënyrë, ai do ta ketë më të lehtë për të ndërtuar marrëdhënie më të qëndrueshme me ta në funksion të organizatës. Disa elemente kyç³⁹ që ndikojnë pozitivisht brenda grupit për të pasur marrëdhënie të qëndrueshme si në linjën horizontale dhe atë vertikale janë:

Respekti për të tjerët. Anëtarët e grupit duhet vazhdimisht të mbështesin dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Interesimi i sinqertë për të tjerët ndihmon në forcimin e besimit. Laurence Haughton, në librin e tij "Jo çfarë thua por çfarë bën", për njësitë kohezive përdor termin "skuadër e nxehtë". Një çast, kur punonte në një skuadër të tillë, ai tregon: "Një ditë, një inxhinier mbikëqyrës (jo drejtues i imi) më mori mënjane, pasi dëgjoji rastësisht, disa fjalë ironike që kisha thënë për një punëtor. Më tha: "Dëgjo, të gjithë këtu japin një kontribut të madh. Dhe duhet të jenë të mirë, ndryshe nuk do të ishin këtu. Mos fol në këtë mënyrë". U habita. Para meje kisha një drejtues (ndonëse jo i imi), që nuk merrej me procesin e prodhimit, por që kujdesej për ndjenjat e punëtorëve. Interesimi i tij më mësoi që të tregoja respekt dhe ta vlerësoja çdo anëtar të skuadrës. Këtë ai e bëri pa më bërtitur"⁴⁰. Mungesa e respektit sjell mungesë iniciative. Xhodi Hofer Gitell, autore e librit "Linjat ajrore të Jugperëndimit: Forca e marrëdhënieve për një ecuri të lartë" ka studiuar marrëdhënien

³⁶ Xhon U. Billades, "Rregullat e drejtimit", Shtëpia Botuese e Ushtisë, Tiranë 1995, faqe 104.

³⁷ Erich Fromm, "Arratisje nga liria", Shtëpia Botuese "Phoenix", Tiranë 2000, faqe 25.

³⁸ Norman Kouplend, "Psikologjia dhe ushtari", Shtëpia Botuese e Ushtisë, Tiranë 1993, faqe 152.

³⁹ Vasil Naçi, Alma Bici, "Komunikimi dhe Puna në skuadër", botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2012, fq. 75-76.

⁴⁰ Laurence Haughton, "Jo çfarë thua por çfarë bën", Shtëpia Botuese "Max", Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5, fq. 239.

midis respektit dhe zbatimit efektiv në situata të vështira. Nisur nga puna e saj kërkimore ajo e lidh mungesën e iniciativës me mungesën e respektit. “Respekti... i shtyn pjesëmarrësit që të marrin në konsideratë veprimet e të tjerëve, duke përforcuar tek ta prirjen për bashkëpunim”, shpjegon ajo. “Respekti gjithashtu, krijon një mënyrë më të mirë komunikuese”. Të dyja këto janë pika thelbësore për zbatimin deri në fund të proceseve⁴¹. Gjithashtu, për drejtuesit është e rëndësishme edhe mënyra si i mirëpret dhe i orienton pjesëtarët e rinj të grupit, kjo tregon interesimin e tij për të tjerët. Problemet e një anëtari bëhen problemet e grupit dhe duhen zgjidhur. Në të njëjtën mënyrë dhe fuqitë e grupit janë fuqitë individuale. Për të arritur objektivat e përbashkëta bashkëpunon, respekto kolegët e tu, trajtoji me drejtësi, ji i ndershëm në vlerësime dhe kënaqu në shoqërinë e tyre.

Energji dhe entuziazëm pozitiv. Të kesh qëndrim pozitiv dhe të motivohesh është zgjedhje që e bëjmë çdo ditë. Optimizmi, entuziazmi dhe humori janë ngjitës. Besimi pozitiv është një qëndrim mirëbesimi që vjen me përgatitjen. Mënyra si vepron tregon qëndrimin tënd dhe e anasjellta. Mjedisi i punës së grupit forcon zhvillimin e këtyre qëndrimeve. Njerëzit pozitivë e shikojnë veten si luftëtarë, zot të fatit të tyre, ndërsa njerëzit negativë e shikojnë veten si humbës, të mundur, viktimë. Referuar D. Goleman-it: *“Optimizmi, njësoj si shpresa, do të thotë të kemi një pritshmëri të fortë se, në përgjithësi, gjërat do të na ecin mirë në jetë pavarësisht vështirësive dhe humbjeve të tanishme. Nga këndvështrimi i inteligjencës emocionale, optimizmi është ai qëndrim që nuk i lejon njerëzit të bien në gjendje amullie, apo të humbim shpresën dhe të kridhen në dëshpërim në valën e vështirësive. Po ashtu si shpresa, optimizmi na sjell përfitime të mëdha në jetë”*⁴². Në këtë kuadër, mendimi pozitiv (nënkupto: optimist) është një qëndrim që reflektohet në mendime, fjalë dhe imazhe që çojnë në rritje dhe sukses. Një mendje pozitive parashikon lumturinë, gëzimin, shëndetin dhe rezultatet e suksesshme në çdo situatë dhe veprim.

Njohja e individualitetit. Ndërsa njerëzit punojnë, a kemi pyetur ndonjëherë veten: “A ndihen ata të lumtur ndërsa punojnë aty? A do të dëshironin vallë të punonin diku tjetër?” Në këtë kuadër, rëndësi merr njohja e individualitetit. Secili nga njerëzit tanë është i ndryshëm nga ne dhe të tjerët në grupin tonë. Çdo njeriu i pëlqen të mendojë se ne ia njohim këto ndryshime dhe e trajtojmë si njeri të veçantë, dhe jo si diçka standard. Sipas D. Carnegie: *“Drejtuesit duhet të dëgjojnë dhe t’i vëzhgojnë njerëzit që mbikëqyrin dhe të mësojnë t’i dallojnë ata. T’i mësojnë pikat e forta dhe kufizimet e tyre, të mirat dhe të këqijat, mënyrën si ata veprojnë dhe reagojnë, e ta përshtatin mënyrën si*

⁴¹ Po aty, fq. 336.

⁴² Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, fq. 114.

*përballen me secilin syresh dhe individualitetin e tyre*⁴³. Prandaj, drejtuesit duhet të zotërojnë terminologjinë e psikologjisë, me qëllim që të kuptojnë individualitetin e gjithsecilit, ky është një parakusht për të pasur marrëdhënie të qëndrueshme dhe, për pasojë, për sukses.

Komunikimi miqësor, i hapur dhe pozitiv ndodh atëherë ku individët e njohin dhe respektojnë njëri-tjetrin. Anëtarët e grupit tregojnë përkujdesje dhe interesohen për jetën e njëri-tjetrit edhe jashtë punës, respektojnë diferencat individuale, bëjnë shaka dhe i bëjnë të gjithë të ndihen të mirëpritur. Paaftësia për t'i kuptuar ndjenjat e të tjerëve është një mangësi tepër e madhe në inteligjencën emocionale, dhe një dështim i plotë i thelbit të qenies njerëzore. Sipas të gjithë treguesve, aftësia për të treguar dashamirësi dhe përkujdesje e ka burimin te ndjesia e empatisë. Prandaj, komunikimi pozitiv ndikon në energjinë e punës në grup.

Transparenca është një element që ka të bëjë me anën morale e shpirtërore të njerëzve dhe menaxhimi sa më drejt i saj sjell nxitjen e anëtarëve për të pasur sukses në veprimtarinë e tyre. Drejtuesi, duke qenë i hapur me vartësit e tij, ndriçon të gjitha skutat e errëta, u bën parapritë pengesave dhe u krijon lirshmëri, u jep kënaqësi në veprimtarinë e tyre, duke ju shumëfishuar forcat si intelektualisht dhe fizikisht. Transparenca bën që anëtarët të mos gjenden asnjëherë të painformuar, të jenë gjithnjë në dijeni të problemeve si brenda grupit dhe jashtë tij. Ky është një element nxitës për të arritur suksesin e kërkuar.

Feedback-u. Njerëzit janë të etur për *feedback*. Të gjithë kemi dëshirë të dimë se si po ecim. Shpeshherë në qoftë se nuk marrim *feedback*, mendojmë se jemi në rregull. Anëtarët e grupit kanë nevojë për informacion mbi performancën e tyre. Vlerësoje kolegun për diçka të cilën ai e bën vërtet mirë. Pra, çfarëdo që mund të thoni, bëjeni me sinqeritet. Sugjero se çfarë i duhet që të bëhet më mirë, tregoni sjelljen tuaj të mirë gjatë bisedës, jep informacion, por edhe merr. *Feedback-u* është një proces në zhvillim që kërkon dëgjim të përqendruar dhe përgjigje të fokusuar.

Lidhjet, afrimiteti. Çdo grup duhet të ketë marrëdhënie të mira dhe lidhje edhe me grupet e tjera. Këto lidhje do ta ndihmojnë grupin në punën e tij në vazhdimësi. Ne besojmë se cilësia e marrëdhënieve përcakton dhe cilësinë e jetës. Për të krijuar marrëdhënie të mira, është më mirë të përshtatesh se sa të tentosh t'i ndryshosh njerëzit. Nëse do miq, bëhu i tillë. Tregojë miqësinë. Largoje cinizmin. Miku i vërtetë gëzohet për arritjet dhe mërzitet për dështimet. Nëse i do njerëzit pa kushte, më shumë dashuri do të kesh. Duaji njerëzit ashtu siç janë dhe shërbeju atyre. Shumë grupe kalojnë një pjesë të madhe të kohës së bashku në grupe të mëdha, me kolegë të strukturave të tjera. Afrimiteti

⁴³ Dale Carnegie & Associates, "Si të bëhesh udhëheqës i zoti", Shtëpia Botuese "Pema", viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6, faqe 54-55.

është një faktor që do të ndihmojë grupet që të performojnë në një nivel më të lartë. Është me rëndësi të kushtohet vëmendje marrëdhënieve si në linjën vertikale, ashtu dhe horizontale. Një grup bashkëpunues mund të shtojë vlerë dhe të ketë sukses të vazhdueshëm, vetëm në qoftë se i kushton vëmendje zhvillimit të vazhdueshëm të tri lidhjeve të rëndësishme: mes anëtarëve të grupit, mes grupeve të tjera brenda organizatës dhe me vetë organizatën⁴⁴. Kur një grup është i lidhur me organizatën, anëtarët diskutojnë ecurinë e grupit në lidhje me prioritetet e organizatës. Ata konsiderojnë nevojat e grupit që përputhen me nevojat e organizatës dhe bëjnë atë çfarë i shërben më mirë objektivave të përbashkëta. Për të ndërtuar lidhje të forta me grupet e tjera, mbani komunikim të vazhdueshëm, duke u interesuar shoqërisht për ato.

Harmonia e brendshme. Një element shumë i rëndësishëm për konsolidimin e marrëdhënieve dhe në arritjen e rezultateve më të larta në veprimtarinë e një grupi është masa në të cilën anëtarët janë të aftë të krijojnë gjendjen e harmonisë së brendshme, gjë që u mundëson të shfrytëzojnë plotësisht talentin e çdo anëtari. Performanca e përgjithshme e një grupi ku mbretëron harmonia, rritet së tepërmi kur njëri prej anëtarëve është veçanërisht i talentuar. Sipas Goleman: *“Grupet, në të cilat kishte fërkime e kishin shumë vështirë të përfitonin nga talentet e veçanta të anëtarëve. Në grupe ku ndihen nivele të larta të problemeve shoqërore, si inatet personale, konkurrenca e sëmurë apo hatërmbetjet, njerëzit nuk jepnin dot më të mirën. Përkundrazi, harmonia i mundëson një grupi të përfitojë maksimalisht nga anëtarët me cilësi dhe dhunti të veçanta”*⁴⁵. Në këtë këndvështrim, çdo njeri (anëtar grupi) duhet të zotërojë një element thelbësor i inteligjencës shoqërore, aftësinë për të dalluar çfarë është e pranueshme dhe çfarë jo në një marrëdhënie. Kjo do të ndikojë domosdoshmërisht në kohezionin e grupit dhe, për pasojë në suksesin e tij.

5. Përfundime

Organizatata (ushtarake) duhet të veprojnë si një ekip. Është shumë e rëndësishme që njerëzit të kenë ndjenjën e të punuarit në grup.

Në qoftë se drejtuesit e njësisë të vogla që përbëjnë organizatën (ushtarake) janë kompetentë, dhe nëse anëtarët e tyre i besojnë njëri-tjetrit, këto struktura, përfshirë dhe atë eprorë (nga e cila kanë varësinë) do të punojnë së bashku në të njëjtin rrugëtim. Njerëzit që i përkasin një grupi të suksesshëm shikojnë pothuajse gjithçka me optimizëm; qëndrimet e fituesve janë ngjithëse dhe për të tjerë, ata i shohin problemet si sfida dhe jo si pengesa. Për më tepër, një njësi kohezive e përmbush misionin shumë më me efektivitet sesa një grup individësh.

⁴⁴ Vasil Naçi, Alma Bici, “Komunikimi dhe Puna në skuadër”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2012, faqe 78.

⁴⁵ Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, faqe 195.

Prandaj, kohezioni ushtarak trajtohet si një lidhje e fortë e pjesëtarëve të një strukture të vogël (grup/njësi) në mënyrë të tillë që secili t'ia nënshtrojë vullnetin dhe angazhimin e vet shokut të tij, njësisë ku bën pjesë dhe misionit të ngarkuar.

Fryma kohezive bën që çdo njeri, përmes procesit të edukimit, ngulitjes së vlerave dhe kodeve të sjelljes të veprojë si një pjesëtar i besueshëm i njësisë. Padyshim që burimi i vlerave shpirtërore dhe i vlerave të sjelljes së tyre është grupi i vogël. Forca e vetme, që mund të bëjë gjithsecilin të ecë vazhdimisht përpara, është besnikëria e tij ndaj grupit të vogël dhe besimi i shokëve të grupit se ai do të bëjë pikërisht këtë.

Zhvillimi i kohezionit kërkon nga drejtuesi një punë të palodhur, durim dhe mjaft aftësi ndërpersonale, por është një investim që ia vlen. Kujdesi shpirtëror nuk është vepër e një dite, jave apo viti. Ajo duhet të jetë një punë e vazhdueshme dhe e pafundme nga drejtuesi. Grupet me kohezion të lartë arrijnë rezultate të suksesshme.

Grupet/njësitë kohezive dallohen nga të tjerët sepse punojnë së bashku për të përmbushur misionin, ekzekutojnë plotësisht dhe shpejt detyrat, plotësojnë ose tejkalojnë standardin, kanë sukses në sfidat e radhës, mësojnë nga përvojat dhe janë krenarë për arritjet e tyre.

Bibliografia:

1. Xhon U. Bllades, “Rregullat e drejtimit”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.
2. Pjer Luixhi Borfoloso, “Historia e doktrinave ushtarake”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.
3. Susan Cain, “Pushteti i të heshturve”, Shtëpia Botuese “Living”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-216-59-5.
4. Alastair Campbell, “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin”, Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë 2015, ISBN: 978-9928-190-55-0.
5. Dale Carnegie, “Arti për t’u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia botuese “Pegi”, Viti 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0.
6. Dale Carnegie & Associates, “Si të bëhesh udhëheqës i zoti”, Shtëpia Botuese “Pema”, Viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6.
7. Erich Fromm, “Arratisje nga liria”, Shtëpia Botuese “Phoenix”, Tiranë 2000.
8. Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7.
9. Laurence Haughton, “Jo çfarë thua por çfarë bën”, Shtëpia Botuese “Max”,

- Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5.
10. Deril Henderson, “Kohezioni, elementi njeri në luftim”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.
 11. Mimoza Kasimati, “Sjellje organizative”, Tiranë 2010, ISBN: 978-99956-43-270.
 12. Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” (Si duhen trajtuar njerëzit e mirë, që të qëndrojnë në punë, 26 strategji për menaxherë aktivë, që dinë t’i angazhojnë njerëzit në punë), botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3.
 13. Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993.
 14. Bernard Montgomeri, “Fushëbetejat” (kujtime), Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994.
 15. Vasil Naçi, “Vlerat bazë, sistemi i bindjeve për sukses”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2012.
 16. Vasil Naçi, Alma Bici, “Komunikimi dhe Puna në skuadër”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2012.
 17. Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999.
 18. Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5.
 19. “Udhëheqja Ushtarake”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995.

METODA VLERËSIMI PËR EFEKTIVIN E PERSONELIT NË QKR, NË KOHË PAQEJE, KRIZE DHE KONFLIKTI

Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha

Shef Shtabi në Qendrën e Kontroll-Raportimit, FAJ

Trajtesë e shkurtuar.

Qendra e Kontroll-Raportimit (QKR) e Forcës Ajrore është në proces modernizimi duke zbatuar të dy projektet e rëndësishme: “SIVHA-Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore” dhe Sistemi i Komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (T-A-T). Për të qenë në një hap me projektet, përveç përvetësimit dhe eksplorimit më të mirë të sistemeve, duhet të marrim në konsideratë edhe elemente të tjera që ndikojnë në efektivitetin e realizimit të detyrave, si: trajnimi dhe stërvitja e personelit, kushtet e punës në të cilën shërbejnë efektivët e QKR-së, etj.

Këto elemente do të trajtohen në këtë shkrim nëpërmjet një “model vlerësimi” që përshkruan dhe analizon faktorët që ndikojnë tek efektiviteti në kohë paqe, krize dhe luftë. Ky model mund të zbatohet në çdo nivel komandim-kontrolli dhe ofron rezultate të sakta për matjen e efektivitetit luftarak në kohë krize, stërvitje e trajnimi. Për të përgatitur këtë shkrim jemi mbështetur në materiale të publikuara nga Organizata e Kërkimit dhe Teknologjisë së NATO-s dhe Departamenti i Mbrojtjes Ajrore të Universitetit të Mbrojtjes në Brno, Çeki, Joint Air Power Competence Centre të AIRCOM, si dhe në përvojën e punës shumëvjeçare si pjesëtar i kësaj qendre (QKR).

Fjalët kyçe: Qendra e Kontroll-Raportimit (QKR), efektivitet luftarak, modeli i gatishmërisë luftarake, NATINAMIDS, TACEVAL, trajnim, stërvitje, sjellje individuale.

Hyrje

Puna e kontrollorëve të Trafikut Ajror dhe të Mbrojtjes Ajrore është element thelbësor në plotësimin e misionit të CRC-së, e cila është pjesë përbërëse e Sistemit të Integruar të Mbrojtjes Ajrore të NATO-s (NATINADS). Përveç rëndësisë që puna e kontrollorëve mbart, po ashtu ajo paraqet vështirësi, për shkak të ngarkesës së madhe që ka. Përgjithësisht, vështirësia qëndron te përballja me situata të ndryshme që zhvillohen shumë shpejt dhe që kërkojnë zgjidhje/reagim të menjëhershëm, si në rastet e humbjes së komunikimit (CommLoos), rrëmbim avioni, kërcënimet e ndryshme terroriste, emergjenca, dekonfliktimi i trafikut ajror ushtarak nga ai civil, etj.

Për të vlerësuar dobësinë e punës të personelit gjatë punës në QKR, nuk ekzistojnë metoda as manual. Po ashtu nuk ka mundësi për të shprehur degradimin e efektivitetit luftarak (EL) të efektivit, si dhe vlerësimin e procesit të punës së tyre për shkak të përfshirjes së shumë problemeve (situatave), faktorëve që dalin në kohë paqeje, krize dhe luftime. Efektiviteti luftarak dhe reagimi i personelit ndaj situatave të mësipërme në Qendrat e Kontroll-Raportimit është element vlerësimi dhe për të bërë një vlerësim sa më real dhe më afër realitetit të fushës së betejës dhe në kohë krize ne sugjerojmë përdorimin e “Modelin e Gatishmërisë Luftarake të Personelit (MGLP) të QKR-së në kohë paqeje, krize dhe luftime”. Kjo metodë është gjithëpërfshirëse e disiplinave të ndryshme por edhe studimeve psikologjike. Nëpërmjet kësaj metode mund të përshkruhet performanca e operatorëve të trafikut ajror dhe të mbrojtjes ajrore në QKR, kundrejt aftësive të tyre, kushteve të punës, trajnimit dhe stërvitjes¹.

1. Modeli i Gatishmërisë Luftarake të Personelit

Sipas publikimit “SAS-050 Exploring New Command and Control Concepts and Capabilities”² të Organizatës së Kërkimit Teknik të NATO-s, ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në efektivitetin luftarak të personelit në detyrë, të cilët grupohen në:

¹ N. Jelínková dhe V. Májek “The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War” Department of Air Defense Systems at the University of Defense in Brno, Republika Çeke, fq 1.

² NATO Research & Technical Organization RTO-TR-SAS-050 Exploring New Command and Control Concepts and Capabilities fq. 4.

- faktori teknologjik;
- faktori njerëzor.




Figura nr. 1 - Modeli i Gatishmërisë Luftarake të Personelit

Në lidhje me efektivitetin luftarak të personelit, do të trajtojmë kryesisht faktorin njerëzor, i cili lidhet ngushtë me aftësinë e efektivit për të punuar. Shumë nga këta faktorë ndikues mund të interpretohen nëpërmjet procesit të Komandim-Kontrollit (C2), por disa faktorë të tjerë, shfaqen vetëm në situatat e krizës. Pjesë e këtyre faktorëve ndikues në efektivitetin luftarak janë edhe karakteristikat individuale dhe të grupit, të sjelljes së tyre gjatë shërbimit, kohezionit të grupit etj. Përveç faktorëve të mësipërm një ndikim të madh kanë edhe ngjarjet që mund të ndodhin, për rrjedhojë efektiviteti luftarak mund të jetë në nivelin $B=0$ si në rastin e shpërthimeve bërthamore apo fatkeqësive natyrore. Ndërsa ngjarje të cilat nuk kanë ndikim shkatërrues si p.sh., rrëmbimet e avionëve nga terroristët, sulmet ajrore, aksidentet ajrore etj., rrisin nivelin e stresit tek personeli në detyrë, efektiviteti luftarak nuk është në nivelin $B=0$.

Modeli i Gatishmërisë Luftarake të Personelit (shih figurën 1) i cili përfshin faktorët humanë që ndikojnë në efektivitetin luftarak ndjek konceptin e publikuar nga Organizata e Kërkimit Teknik së NATO-s³ në manualin “SAS-050”. Ky koncept adreson variablat, si dhe marrëdhëniet dhe ndarjet midis tyre që mund të ndikojnë në sjelljen e efektivit për një vendim cilësor gjatë procesit të Komandim-Kontrollit (C2). Në bazë të këtij koncepti janë përcaktuar dhe faktorët kryesorë me të cilët mund të vlerësojmë efektivitetin luftarak, konkretisht: niveli i trajnimit dhe stërvitjes, kushtet e punës dhe stresi⁴. Këta

³ Po aty fq. 5.

⁴ N. Jelinková dhe V. Májek “The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War” Department of Air Defense Systems at the University of Defense in Brno, Republika Çeke, fq 3

faktorë nëpërmjet koeficientit matematikor do të shpreheshin si më poshtë:

B - koeficienti i efektivitetit luftarak;

V - koeficienti që përshkruan nivelin e trajnimit dhe stërvitjes;

Kpi - koeficienti që përshkruan ndikimin e kushteve të punës te personeli;

Ksi - koeficienti që përshkruan ndikimin e stresit te personeli.

Trajnimi/ushtrimi dhe stërvitja (V): si e pamë më lart është pjesë përbërëse dhe ka një rol të madh në vlerësimin e efektivitetit luftarak, pasi vetëm personeli i trajnuar dhe stërvitur mund të sigurojë kryerjen e detyrës në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive. *Njohuritë janë baza kryesore për praktikën dhe pa një metodologji trajnuese të sofistikuar është e pamundur të arrihet përvoja e duhur.* Për këtë arsye, efektivi e kësaj qendre duhet të jetë i trajnuar dhe i stërvitur për situatat që ndikojnë në efektivitetin luftarak të tyre, në kohë krize dhe lufte, me qëllim plotësimin e detyrave të funksionit. Ushtrimi i tyre duhet të jetë plotësisht i integruar dhe i sinkronizuar në nivel kombëtar por dhe në nivel NATO, pasi dhe në kohë krize dhe lufte, kriza/beteja do të jetë plotësisht e integruar në nivel kombëtar dhe në nivel NATO.

Gjithashtu, trajnimi dhe stërvitja kanë në fokus rritjen e cilësisë së koordinimit dhe komunikimit brenda zinxhirit të komandimit në sistemin e integruar të mbrojtjes ajrore të NATO-s (NATINAMIDS)⁵. Njësitë e integruara në sistemin NATINAMIDS sikundër është dhe CRC e Forcës Ajrore, janë pjesë e vlerësimit të AIRCOM nëpërmjet sistemit TACEVAL. Ky vlerësim i AIRCOM përfshin po ashtu trajnimin dhe stërvitjen e efektivëve të CRC-ve. Ndaj për të përballuar apo menaxhuar më mirë detyra të funksionit në varësi të situatave të ndryshme, është e nevojshme që kontrollorët të stërviten në kushte sa më afër realitetit dhe për këtë ekzistojnë disa lloj stërvitje të cilat janë në të njëjtën linjë dhe standard me ato të NATO-s⁶.

Konkretisht, kemi stërvitje reale (LivEx), të tilla si: stërvitjet me avion-kapës (T-Scremble) për realizimin e policimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe stërvitje reale me trupa për stërvitjen e personelit në kushte të vështira, me qëllim rritjen e profesionalizmit të personelit dhe reagimit ndaj situatave (si Ambicia e Shqiponjës). Këto stërvitje reale mund të jenë taktike, operacionale në nivel kombëtar por dhe stërvitje shumëkombëshe. Konkretisht, gjatë vitit 2021, kemi pasur stërvitjen reale shumëkombëshe “Defender Europe 21” në të cilën mori pjesë dhe kjo CRC, po ashtu edhe qendra të tjera ekuivalente të vendeve pjesëmarrëse.

⁵ LtC G. W. ‘Berry’ Pronk, NE AF, “The Importance of Integrated Air and Missile Defence Training A Renaissance of NATO Integrated Air and Missile Defence?” tek <https://www.japcc.org/the-importance-of-iamd-training/>, shtator 2020.

⁶ SACEUR Annual Guidance for Education and Training dhe <https://shape.nato.int/exercises>.

Qendra e Kontroll-Raportimit, në kuadër të përgatitjes së personelit me qëllim rritjen e efektivitetit, realizoi këtë vit stërvitjen reale me trupa “Ambicia e Shqiponjës 21” (figura nr. 2), e cila kishte në fokus stërvitjen e efektivit në kushte të vështira, duke zbatuar kërkesat e manualit të NATO-s për stërvitjet “Bi-SC 75-3”⁷ dhe Doktrinën e Forcës Ajrore. Kjo stërvitje u planëzua, organizua dhe u drejtua nga Qendra e Kontroll-Raportimit në bashkëpunim me Komandën e Forcës Ajrore. Stërvitja u realizua në venddislokimin e radarit⁸ duke ndjekur një skenar i cili ishte ideuar për të plotësuar misionin, detyrat e repartit në kushte dhe mjedise jokonvencionale për realizimin e komandim-kontrollit të mjeteve ajrore si dhe rritjen e masave të sigurisë e të ruajtjes së objekteve me rëndësi. Duke parë rezultatet pozitive dhe plotësimin e objektivave që solli kjo stërvitje reale me trupa, është bërë pjesë e planeve stërvitore vjetore që ka kjo qendër. Madje është në synimin e komandës së këtij reparti që stërvitja “Ambicia e Shqiponjës” të zgjerohet duke përfshirë dhe reparte të tjera të Forcës Ajrore. Gjithashtu, kjo stërvitje është një mundësi shumë e mirë për të vlerësuar rolin që kanë faktorët si: trajnimi dhe stërvitja, kushtet e punës dhe stresi në efektivitetin luftarak të kontrollorëve të kësaj qendre.



Figura nr. 2
Stërvitja reale me trupa “Ambicia e Shqiponjës 21”

Përmes stërvitjeve sintetike me kompjuter (CPX), të cilat simulojnë situata dhe skenarë të ndryshëm, personeli rrit aftësitë reaguese e të menaxhimit në mënyrë sa më efektive të situatave, zgjeron njohuritë dhe familjarizohet me zbatimin drejt procedurave standarde të veprimit (PSV). Stërvitjet sintetike (CPX) mund të konceptohen, planëzohen dhe realizohen në nivel taktik, brenda QKR-së për të stërvitur dhe ushtruar efektivin për të përballuar situata të ndryshme si p.sh.: humbje komunikimi (CommLoos), rrëmbim avioni, kërcënimet e ndryshme terroriste, emergjenca, dekonfliktimi i trafikut ajror ushtarak nga ai civil. Stërvitjet sintetike në nivel operacional me përfshirjen e enteve eprorë si p.sh.: Qendrën e Kombinuar të Operacioneve Ajrore të AIRCOM (CAOC Torrejon) kanë për qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë

⁷ BI-SC Collective Training and Exercise Directive (CT&ED) 075-003 02 October 2013.

⁸ <https://aaf.mil.al/komanda-e-faj/145-stervitjet-dhe-aktivitete-te-faj/6039-2021-10-18-13-00-15>

në kuptimin e përbashkët të doktrinës, koncepteve të operimit, taktikave, teknikave dhe procedurave, pa harruar dhe plotësimin e misionit të CRC-së e cila është pjesë përbërëse e NATINAMIDS⁹ etj.

Pra, këto stërvitje reale apo dhe sintetike ndikojnë në rritjen e cilësisë së reagimit dhe të menaxhimit të situatave por që të arrihet një efektivitet më i lartë i kontrollorëve nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse dhe një vlerësim matematikor nëpërmjet koeficientit të trajnimit dhe stërvitjes (V), e cila mund të shprehet në katër raste për të treguar ndikimin te modeli i vlerësimit të efektivitetit. Këto vlera të mëposhtme mund të dalin si vlera të përafërta matematikore pasi kemi vlerësuar performancën e kontrollorëve ndaj situatave reale dhe në stërvitje, si më poshtë.

Njohuritë janë të shkëlqyera dhe këtë performancë të efektivitetit mund ta shprehim: $v=1$.

Njohuritë janë të kënaqshme ose janë të mjaftueshme dhe $v=0,8 - 0,89$.

Njohuritë janë të gabuara dhe kanë një ndikim negativ në performancën e punës, por këto nuk shkaktojnë gabime themelore dhe $v=0,8 - 0,89$.

Njohuritë janë të pamjaftueshme dhe $v=0,79$ ose më pak.

Kushtet e punës (Kp) në një Qendër të Kontroll-Raportimit janë të veçanta sepse është ndërtuar për të vepruar në mënyrë të vazhdueshme, për t'i rezistuar situatave dhe kërcënimeve të ndryshme. Në kushtet e punës futen dhe elemente si: lagështira, elektriciteti, mjetet elektronike dhe ndriçimi (me luhatje apo jo i mjaftueshëm), si dhe temperatura e mjedisit të punës, e cila duhet të jetë konstante. Salla e pushimit dhe elementet e saj ndikojnë drejtpërdrejt në qetësinë dhe uljen e ngarkesës së punës të situatave të ndryshme të krijuara në QKR. Këto elemente mund të kenë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në efektivitetin e punës së personelit dhe mund të shprehen në mënyrë grafike (figura 3). Nga ky diagram mund të themi se kushtet jo të mira të punës sjellin një performancë të ulët pune nga ana e personelit dhe në rast se ka ndikim të madh atëherë efektiviteti luftarak i saj do të jetë ($B=0$). Vlen të theksohet se ky sistem nuk është i vlefshëm vetëm në kushte pune shkatërruese.

Kushtet e punës mund t'i shprehim si funksion matematikor, konkretisht:

$Kp= 1-(1-Ki)^n$, $n \in \mathbf{N}$ ku: n -numri i elementeve¹⁰ që merret në konsideratë për t'u përfshirë në këtë funksion. Koeficienti i kushteve të punës mund të shprehet në vlera si më poshtë:

⁹ LtC G. W. 'Berry' Pronk, NE AF, "The Importance of Integrated Air and Missile Defence Training A Renaissance of NATO Integrated Air and Missile Defence?" tek <https://www.japcc.org/the-importance-of-iamd-training/>, fq 6, shtator 2020

¹⁰ N. Jelínková dhe V. Májek "The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War" Department of Air Defense Systems at the University of Defense in Brno, Republika Çeke, fq 4

Kushtet e punës nuk ndikojnë në personel dhe $K_p=1$;

Kushtet e punës ndikojnë pak në personel dhe $K_p=0.9$ deri 0.99 ;

Kushtet e punës ndikojnë dukshëm në personel dhe $K_p=0.89$ deri 0.51 ;

Është e pamundur të punohet në këto kushte dhe $K_p=0.5$ dhe më pak.




Figura nr. 3. Vlerësimi i kushteve të punës

Në këtë funksion është e dukshme se sa të rëndësishme janë kushtet e punës dhe sa ndikojnë ato, apo sa do të ndikojnë në efektivitetin e punës së personelit të bashkuara me elementet e tjera të lartpërmendura. Nëse kërkojmë të ketë efektivitet të plotë të personelit në QKR, numri i elementeve (n) i kushteve të punës që ndikojnë duhet të jetë sa më i vogël dhe të shkojë drejt zeros për të pasur koeficientin e kushteve të punës ($K_p=1$). Shpesh herë ndodh që kushtet e punës i trajtojmë shumë pak si elemente që ndikojnë në efektivitetin e personelit nga ana e strukturave përgjegjëse. QKR-ja është një qendër që punon 24 orë në 7 ditë të javës dhe këto elemente të kushteve të punës që ndikojnë në efektivitetin luftarak duhet të kenë një vëmendje në vazhdimësi për eliminimin e tyre, me qëllim uljen e ndikimit të tyre në efektivitetin luftarak.




Figura nr. 4
Kushtet e punës

Karakteristikat dhe sjelljet individuale të personelit janë elemente që ndikojnë në ecurinë e përgjithshme të QKR-së nëpërmjet efektivitetit luftarak individual. Në këtë pjesë do të shohim variablat që ndikojnë në procesin e punës nëpërmjet karakteristikave individuale të personelit, konkretisht¹¹:

sjellja – e cila ka të bëjë p.sh., me kujtesën, shpejtësinë për të reaguar, marrjen përsipër të rrezikut, vetëkontrollit etj.;

aftësitë njohëse – p.sh., inteligjenca e përgjithshme.;

personaliteti dhe vlerat individuale – qëndrueshmëria emocionale, ndërgjegjja,

¹¹ RTO-TR-SAS-050 Exploring New Command and Control Concepts and Capabilities, Kap V. fq. 6.

përvoja, stili vendimmarrës dhe stili i zgjidhjes të problemeve.;

aftësitë fizike – fuqia fizike, aftësitë motorike.;

faktorët dinamikë dhe statikë – niveli i sheqerit në gjak, shëndeti, mungesa e gjumit.

Pjesë e ngarkesës së punës në QKR-ë është edhe **stresi**, i cili shkaktohet nga rrethanat në të cilat gjendet personeli gjatë zbatimit të detyrës. Ndikimi i stresit në personel mund të shprehet në mënyrë grafike si në fig. 5. Shkaktarët që shkaktojnë stresin quhen stresorë. Stresorët ndryshojnë në ashpërsi dhe kohëzgjatje. Këta stresorë mund të jenë të shumtë por ndodhin nga arsye apo shkaqe që personeli nuk mund t'i kontrollojë¹². Nëse stresi është i madh dhe ka ndikim tek qendra atëherë efektiviteti do shprehej si ($B=0$), në rastin kur ndikimi i tij nuk është shkatërrues atëherë duhet vlerësuar niveli i ndikimit të tij. Ndaj kërkohet që personeli të jetë i trajnuar për të menaxhuar stresin dhe ngarkesën si dhe të shmangen faktorët e jashtëm që nuk kanë lidhje me punën me qëllim që të mos kenë ndikim në këtë vlerësim. **Stresi negativ** (distres) është më kryesori me të cilin përballet personeli dhe mund të shprehet si **Ksi**¹³.




Figura nr. 5. Analiza e stresit

Stresi është motivues **Ks = 1**.

Distresi nuk ndikon në mënyrë të dukshme dhe **Ks = 0.0 - 0,99**.

Distresi ndikon në personel (edhe tek i trajnuari) dhe është **Ks = 0,51 - 0,89**.

Personeli nuk është në gjendje të punojë dhe vihen re gabime jetësore ku **Kp = 0.5 dhe më poshtë**.

Analiza e elementeve të mësipërme tregon se vlerësimi i performancës së punës të personelit në QKR do të varej nga vlerësuesit e marrë në studim, si: trajnimi dhe stërvitja (përvoja dhe dijet), kushtet e punës, personaliteti, stresi. Koeficienti i efektivitetit të punës së personelit (B) në fund mund të shprehet si: prodhimi i koeficientëve përkatës k_p , k_s dhe v . Këta koeficientë siç i pamë më lart do të marrin vlera nga 0 në 1:

¹² Stresi dhe përballimi i tij/psikologjia.com

¹³ N. Jelínková dhe V. Májek “The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War” fq 3.

$$B = K_p \cdot K_s \cdot V; \text{ ku } K_p, K_s, V \in (0,1)^{14}$$

E gjithë sjellja e sistemit për matjen e efektivitetit luftarak mund të shprehet në tre gjendje. *E para* është më e mira dhe tregon që problemet tejkalohen dhe efektiviteti i punës së personelit është i lartë. *E dyta* shpreh gjendjen e krizës dhe mund të presim disa vështirësi që duhet të trajtohen. *E treta* dhe më e keqja është kur stabiliteti është prishur dhe janë shumë elemente shkatërruese ndikuese në të dhe efektiviteti është shumë i ulët. Nëse të tre fazat e mësipërme të efektivitetit luftarak (B) do t'i jepnim nëpërmjet përqindjes në mënyrë grafike në boshtin vertikal, kundrejt kohës (t) në boshtin horizontal gjatë fazave që punon personeli do të formohej **kurba e efektivitetit luftarak në kohë paqeje, krize dhe lufte**. (Figura 6)

Kjo kurbë efektiviteti është e shprehur në të tre gjendjet e efektivitetit luftarak (B) dhe gjatë kalimit nga faza e paqes në krizë kemi një rënie të efektivitetit për një interval kohe (t_1 dhe t_2) dhe më pas do ringritje për të vazhduar në rritje efektiviteti të punës së personelit.




Figura nr. 6
Kurba e efektivitetit
luftarak

2. Përfundime

Modeli matematikor për efektivitetin e personelit i sipërcituar është një hap përpara për shkak se përfshin specifikime matematikore të trajnimit dhe stërvitjes, faktorit njerëzor dhe kushteve të punës.

Pasi studiuam marrëdhëniet e faktorit njerëzor, kushteve të punës e të trajnimit nëpërmjet këtij modeli të vlerësimit të efektivitetit të personelit në QKR, mund të themi që për herë të parë kemi një metodë vlerësimi për efektivitetin e personelit në kohë paqeje, krize dhe konflikti (lufte).

Zbatimi i këtyre përfundimeve do të rrisë në nivel të lartë efektivitetin e QKR-së, pasi përfshihen dhe specifikime matematikore duke e bërë më të zbatueshme.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të punës të kontrollorëve, Qendra e Kontroll-

¹⁴ N. Jelínková dhe V. Májek “The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War”, fq 3.

Raportimit ka marrë në konsideratë këta faktorë ndikues, duke zbatuar programe të ndryshme investimesh për përmirësimin e kushteve të punës, ndërsa trajnimi i efektivit është parashikuar të realizohet brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet bashkëpunimit me vendet partnere, si: Italia, Greqia dhe Turqia.

Gjithashtu, është hartuar dhe detajuar plani i stërvitjes të tyre për një periudhë 3-vjeçare, i cili përfshin stërvitje reale dhe simuluese. Ky plan do të zbatohet konkretisht në plan-stërvitjet vjetore. Elementi i tretë, roli dhe ndikimi i stresit tek efektivit është një fenomen i cili po merret në konsideratë me qëllim zbehjen e ndikimit të tij në efektivitetin luftarak.

Bibliografia:

1. TŮMA, Jaroslav, Vlastimil TICHÝ, Dana ČERNOCHOVÁ a Miroslav ŠMÍD. Psychofyzilogická výkonnost příslušníků OŘL během 24hodinové směny velitelského stanoviště. Ús-tav leteckého zdravotnictví, 1988, s. 15.
2. NATO Research and Technical Organization. RTO-TR-SAS-050 Exploring New Command and Control Concepts and Capabilities.
3. Nad'a JELÍNKOVÁ and Vojtěch MÁJEK "The Combat Effectiveness Model of Air Operation Centre in Times of Peace, Crises and War".
4. LtC G. W. 'Berry' Pronk, NE AF, "The Importance of Integrated Air and Missile Defence Training A Renaissance of NATO Integrated Air and Missile Defence?" tek <https://www.japcc.org/the-importance-of-iamd-training/>, shtator 2020.
5. SACEUR Annual Guidance for Education and Training dhe <https://shape.nato.int/exercises>.
6. BI-SC Collective Training and Exercise Directive (CT&ED) 075-003 02 October 2013.
7. Stresi dhe përballimi i tij/psikologjia.com.

RUBRIKA E TRETË

Studime historike

Dr. Eva Smaçi me shkrimin e saj ***“Roli i marrëveshjeve ushtarake Shqipëri - Bashkim Sovjetik të viteve 1957 - 1959 në institucionalizimin e Ushtrisë Popullore Shqiptare”***, synon të analizojë dy marrëveshjet e Shqipërisë me Traktatin e Varshavës në kontekstin e kohës kur ato u nënshkruan, si dhe pasojat që erdhën prej nënshkrimit të tyre.

Autori, përmes hulumtimit të dokumenteve në arkivat shqiptare dhe veçanërisht në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura (AQFA), kërkon të sjellë në këtë punim një panoramë të re, që mund të paraqesë interes për të vlerësuar me objektivitet rolin që luajtën këto marrëveshje në identifikimin e Bazës së Vlorës, si baza e vetme sovjetike në Mesdhe në vitet e Luftës së Ftohtë.

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi sjell në këtë rubrikë një tablo të qartë të qeverisë së Nolit të vitit 1924, e cila ishte një copëz pushteti i shkurtër në kohë për një Shqipëri të lirë, demokratike, të barabartë, të pakorruptuar, me besim në vetvete, e gatshme për të bashkëpunuar për fqinjësi të ndershme dhe që dëshironte të mbronte parimet universale të drejtësisë, për të ndaluar grykësinë njerëzore. Programi i qeverisë “Noli” përbante në vetvete esencën e mendimit të përbashkët të intelektualëve demokratë, të diplomuar në universitetet më në zë të Evropës Perëndimore dhe SHBA, por edhe ushtarakëve progresistë e profesionistë shtatmadhorie të përgatitur në shkollat dhe akademitë më prestigjioze të kohës.

Kronologjia e ngjarjeve në shkrim vërteton dhe një herë faktin se Fan Noli dështoi “në modelin e ri të krijimit të shtetit”, por shkëlqeu me veprën që u la shqiptarëve trashëgimi. Parimi i përdorimit të forcës ushtarake e policore/xhandarmërisë më 1924 shkonte përtej sigurisë së brendshme dhe të jashtme të mbrojtjes së shtetit, ndërkohë që në fakt përdorej për mbrojtjen e pushtetit nga rrëmbimi i pushtetit e në këtë rast pushtimi i kryeqytetit. Noli me strukturat ushtarake dhe të xhandarmërisë në dispozicion nuk mundi të realizonte sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm të Shqipërisë.

ROLI I MARRËVESHJEVE USHTARAKE SHQIPËRI – BASHKIM SOVJETIK TË VITEVE 1957 – 1959 NË INSTITUCIONALIZIMIN E USHTRISË POPULLORE SHQIPTARE

Dr. Eva Smaçi

Zëvendësdekan i FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim synon të analizojë dy marrëveshjet e Shqipërisë me Traktatin e Varshavës në kontekstin e kohës kur ato u nënshkruan, si dhe pasojat që erdhën prej nënshkrimit të tyre. Gjatë trajtimit, jam munduar t'u jap përgjigje pyetjeve të tilla si: a ishin marrëveshjet në shërbim të interesave kombëtare dhe sa i shërbyen ato mbrojtjes së vendit? Çfarë përfitoi Shqipëria në kushtet e një vendi të varfër në fushën e mbrojtjes, duke iu referuar listave të pajisjeve ushtarake e deri te furnizimet me karburant, veshmbathje e ushqime? Realisht, a u shkelën marrëveshjet nga të dyja palët? Pse ato marrëveshje (sidomos ajo e vitit 1959) u konsideruan si pika ngjizëse të konfliktit dhe instrumente për përjashtimin pa kthim të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës etj.?

Dokumentet e shfrytëzuara nga arkivat shqiptare e, në mënyrë të veçantë, ato që janë sjellë nga Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA) sjellin në këtë punim një panoramë të re, që besojmë se paraqet interes për të vlerësuar me objektivitet rolin që luajtën këto marrëveshje në identifikimin e Bazës së Vlorës, si baza e vetme sovjetike në Mesdhe në vitet e Luftës së Ftohtë.

Fjalë kyçe: Marrëveshje ushtarake, Bashkimi Sovjetik, baza detare e Vlorës, Lufta e Ftohtë, Shqipëri, Europë Lindore, Pashaliman.

Hyrje

Në studimet e ndryshme të analistëve e historianëve perëndimorë që janë marrë me shqyrtimin e aspekteve kryesore të Traktatit të Varshavës, duke përfshirë këtu edhe botimet e publikuara pas rënies së tij më 31 mars 1991¹, është vënë në dukje se ajo ishte një aleancë e mirëfilltë ushtarake e të njëjtit tip, që Bashkimi Sovjetik (BS) kishte nënshkruar edhe me vendet e tjera satelite të Evropës Lindore e Qendrore.

Ndikimit ushtarak të BS nuk mundi t'i shpëtonte as Shqipëria, pavarësisht largësisë gjeografike të saj me këtë vend. Por, në dallim nga vendet e tjera, ku trupat sovjetike ishin të pranishme përpara nënshkrimit të Traktatit të Varshavës të 14 majit 1955, në Shqipëri ato u instaluan në mënyrë masive, së bashku me armatimin dhe mjetet e tjera luftarake, vetëm pas nënshkrimit të dy marrëveshjeve të lartpërmendura. Të dyja këto marrëveshje mund të konsiderohen nyje lidhëse e konfliktit shqiptaro-sovjetik në vitet 1960- 1961. Palët (sovjetike dhe shqiptare), duke iu referuar atyre akuzonin njëra-tjetrën si shkelëse të marrëveshjeve dhe përgjegjëse për situatën e acaruar dhe të rënduar në Bazën e Vlorës, që u zgjidh me largimin e forcave ushtarake-detare sovjetike nga Bazës e Vlorës, ashtu si edhe ishte vendosur në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ (KPK) më 29-29 mars 1961², duke mbyllur kështu historikun e saj si bazë e TV.

Krijimi i Traktatit të Varshavës legjitimoi praninë e trupave sovjetike në vendet e Bllokut Komunist dhe i hapi rrugën krijimit të bazave të reja ushtarake sovjetike edhe në vende ku më parë nuk kishte pasur trupa sovjetike, siç është rasti i Shqipërisë. Krijimi i këtyre bazave u parapri nga procesi i nënshkrimit të marrëveshjeve ushtarake. Ato u konsideruan si marrëveshje brenda Traktatit të Varshavës, pavarësisht se morën trajtën e marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet një vendi anëtar të këtij pakti dhe BS. Të tilla ishin edhe dy marrëveshjet e arritura ndërmjet Shqipërisë dhe BS, në harkun kohor të viteve 1957-1959, të

¹ Vojtech Mastny and Malcom Byrne, *A Cardboard Castle? Inside History of Warsaw Pact, 1955 -1991*, PHP Publication Series, Washington. D.C/ Zyrich, May 2005, Paralle History Project on NATO and Warsaw Pact (PHP); Denis Deletant and Mihail Ionescu. "Romania and the Warsaw Pact, 1955- 1989, Widrow Wilson Center Cold War International History Project.

² Arkivi Qendror Shtetëror (më tej AQSH) Fondi 14, Traktati i Varshavës (më tej TV), Viti- më tej V. 1961, Dosja- më tej D. 1 , f.84, Vendim i KPK të TV.

cilat u finalizuan me ndërtimin e Bazës Ushtarake Detare të Vlorës. Vendimi për krijimin e kësaj baze ka qenë një moment kyç për përfshirjen e vendit tonë në planet mbrojtëse të BS në raport me NATO-n. Interpretimi i marrëveshjeve të nënshkruara në vitet 1957 dhe 1959 ka ngjallur debat, pasi disa nga dëshmitarët e ngjarjeve që kanë shkruar kujtime ose kanë dhënë intervista, mendojnë se të ndikuar emocionalisht iu janë kundërvënë studiuesve e fushës, në mënyrë të veçantë për krijimin e Bazës Detare Ushtarake të Vlorës³.

Një pyetje që mund të shtrohet është se në ç'rrethana lindi interesi i BS për të pasur një bazë ushtarake detare në Shqipëri, pas anëtarësimit të kësaj të fundit në Traktatin e Varshavës? Shqipëria mori rëndësi strategjike për Moskën fill pas prishjes me Jugosllavinë, kur ajo u pa si një pikë mbështetje në luftën ideologjike kundër Titos dhe si një kundërvënie për Perëndimin. Në kuadër të Luftës së Ftohtë, pranë “zonës së vdekur” jugosllave ndodhej Shqipëria, e cila kishte nevojë për ndihmë⁴, sepse tashmë kjo e fundit nuk kishte më, sikurse më parë lidhje tokësore me vendet e Bllokut Komunist dhe ndihmat nuk mund t'i merrte përmes kësaj rruge. Me prishjen e marrëdhënieve me jugosllavët dhe dëbimin e të gjithë këshilltarëve të tyre në Shqipëri do të rriteshin ndjeshëm misionet ushtarake sovjetike. Pas marrëveshjes së parë ushtarake, të nënshkruar ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe BS më 1 qershor 1949⁵, ushtria shqiptare do të garantonte pa shpërblim gjysmat e nevojave të saj për ushqime veshmbathje dhe materiale të tjera. Kjo marrëveshje bazohej në numrin e përgjithshëm të efektivëve të forcave të armatosura. Dorëzimi i ndihmave do të bëhej përmes porteve të Durrësit dhe Vlorës. Marrëveshja hynte në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe do të mbetej në fuqi edhe vitin pasardhës, nëse nuk deklaroheshin tre muaj para revokimit të saj. Kjo marrëveshje u bë bazë për marrëveshjet që pasuan atë. Ajo mbeti në fuqi deri në vitin 1961, kur u prishën marrëdhëniet me BS.

1. Marrëveshja e vitit 1957

Në ndryshim nga disa vende të tjera anëtare të Traktatit të Varshavës asnjë njësi taktike (nuk kishte prani të trupave ushtarake E.S) sovjetike nuk ishte pozicionuar në Shqipëri deri në kohën e hapjes së Bazës Ushtarake Detare të Pashalimanit. Në librin e Nikita Hrushovit “Kujtime, unë nuk jam gjykatës”⁶, bëhet një analizë e qartë e vendimmarrjes nga ana e BS për ta përdorur

³ Debatimi mes studiueses Prof. Dr. Ana Lalaj dhe inxhinierit ushtarak Fatosh Voshtina i bërë publik në shtypin e përditshëm, gazeta “Shqiptarja.com”, 2013.

⁴ Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, Ideart, Ideart, Tiranë, f.345

⁵ Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (më tej AQFA) Viti – më tej V. 1949, dosja, më tej-D. 158. Marrëveshja u nënshkrua në Moskë më 28.09.1949, për Bashkimin Sovjetik nga mareshalli Sokollovski V.D dhe për MMP nga i ngarkuari i jashtëzakonshëm i RPSH në BS, z. Mihal Prifti.

⁶ Nikita Hrushovi, Kujtime, Unë nuk jam gjykatës Tiranë 2004., Shtëpia Botuese Ombra GVG, f.136

Shqipërinë si një bazë për të shtrirë influencën politiko-ushtarake në Mesdhe. Ai vlerëson pozicionin strategjik të Shqipërisë, duke u shprehur haptazi se “ne e konsideronim atë në atë kohë, si një bazë të fuqishme të vendeve socialiste”. Por, në arsyetimet e Hrushovit nuk mungon dilema, nëse ishte e nevojshme që “të mbanim atje (në Shqipëri) ushtrinë tonë apo të krijojmë ushtrinë e fortë shqiptare”. Përgjigjen e jep përsëri po vetë, kur shkruan: “Realisht, Shqipëria mund të mbante vetëm një ushtri të vogël në numër, e cila nuk do të ishte në gjendje t’u bënte përshtypje kundërshtarëve tanë. Kështu vendosëm ta ndihmonim edhe materialisht Shqipërinë për krijimin brenda mundësive të një ushtrie të madhe shqiptare...”⁷.

Pozicioni strategjik por edhe ashpërsimi i marrëdhënieve të BS me Perëndimin pas Luftës së Dytë Botërore, që nuk e përjashtonte edhe një konflikt të mundshëm ushtarak edhe në Ballkanin Perëndimor, janë për N. Hrushovin dy ndër arsye madhore se përse sovjetikët “u morën vesh me shqiptarët për krijimin e një baze nëndetëse”. Propozimi për krijimin e një baze ushtarake iu bë Enver Hoxhës nga vetë Hrushovit në rrugë jo zyrtare, gjatë darkës së dhënë në vilën Gorki për nder të delegacionit shqiptar që ndodhej në Moskë më 23 dhjetor 1956. “Pa ngritur dollinë, u shpreh Hrushovi, duhet ta kemi tonin Mesdheun, ta kemi nën kontrollin tonë dhe çdo lidhje ta bëjmë me Shqipërinë. Ne ju thamë, vazhdonte ai më tej, le ta bëjmë bile sa më parë. Do ta bëjmë që të krijojmë baza të forta për nëndetëse. Instalimet që janë bërë tani shikojnë tërë Mesdheun, të tëra lëvizjet e aeroplanëve etj.”⁸. Hrushovi insistoi shumë për këtë çështje.

Biseda e mësipërme nuk kaloi pa u vënë re nga udhëheqja e lartë e Shqipërisë. Pa kaluar as një muaj prej saj, në fund të janarit 1957, një delegacion i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë u ftua për bisedime dypalëshe në Moskë nga komandanti i Forcave të Bashkuara të Traktatit të Varshavës dhe nga Ministria e Mbrojtjes e BRSS. Bisedimet e zhvilluara në periudhën 1 deri më 4 shkurt 1957 u fokusuan në disa çështje që buronin nga angazhimi i Shqipërisë në Traktatin e Varshavës, të tilla si: pakësimi i numrit të forcave të armatosura në kuadrin e sistemit të çarmatimit, nevojat për teknikë e armatime etj. Pjesë e bisedimeve u bë edhe përcaktimi i disa bazave detare ushtarake në territorin e vendit tonë⁹. Këtij qëllimi do t’i shërbente më pas përgatitja e një studimi, që do të shihte mundësitë e vendosjes së nëndetëseve sovjetike në portet shqiptare. Po kështu, do të krijohej një komision mik

⁷ Po aty... f.137.

⁸ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D.6, f.17, Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, datë 13, 1,1957 i delegacionit që shkoi në Moskë në dhjetor 1956, pranë KQ të PKBS.

⁹ AQFA, Fondi 100/3, V.1957, D. 18. Gjatë bisedimeve për pikën 4 të protokollit, pala sovjetike propozoi shfrytëzimin të përkohshëm të bazave detare për Flotën Detare të BS. Delegacioni shqiptar në emër të qeverisë propozoi qëndrim e përhershëm të disa nëndetëseve të BS në portet shqiptar. Ky propozim u morr në konsideratë nga pala sovjetike.

shqiptaro-sovjetik, i cili do të merrej me hartimin e draftit të marrëveshjes ndërmjet të dy vendeve. Protokolli i këtyre bisedimeve u nënshkrua më 4 shkurt 1957 vetëm për pikën e parë nga mareshali i Bashkimit Sovjetik, Konjev dhe ministri i Mbrojtjes i RPSH, gjenerallejtënant Beqir Balluku¹⁰.

Pas kthimit nga Moska, duket se pika 4 e këtij protokolli mori përparësi. Më 7 shkurt të vitit 1957, ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku mori projektin e marrëveshjes dhe letrën që shoqëronte atë. Njëpërmjet kësaj të fundit, pala sovjetike kërkonte të dinte se cili do të ishte personi i autorizuar nga pala shqiptare për ta firmosur marrëveshjen. Ministri shqiptar i Mbrojtjes nxori urdhrin për krijimin e komisionit, i cili do të kryesohej nga gjeneralmajor Arif Hasko¹¹. Ky i fundit së bashku me përfaqësuesin e palës sovjetike zëvendësadmiralin Çursin¹² në datat 26 prill deri më datën 14 maj, u ngarkuan që të shqyrtonin mundësinë për vendosjen e anijeve luftarake dhe sigurimin e tyre në ujërat shqiptare. Më 12 maj, komisioni i përbashkët firmosi projekt marrëveshjen që kishte të bashkangjitura 11 lidhje e skema. Dislokimi i Batalionit të Fortifikimit më 23 maj 1957, me urdhër të zëvendësministrit të Mbrojtjes gjeneralmajor Petrit Dume, shënon fillimin e punimeve të Bazës Ushtarake Detare të Vlorës¹³.

Në takimin e 12 shtatorit 1957, që njihet si dita e nënshkrimit të marrëveshjes, për palën sovjetike firmosi admiral Fokin, ndërsa për palën shqiptare gjeneralmajor Arif Hasko. Kjo marrëveshje ishte e dyta në radhë e firmosur me këtë vend, duke filluar nga ajo e vitit 1949, por marrëveshja e parë që Shqipëria nënshkruante si vend anëtar i Traktatit të Varshavës. Në marrëveshje përmendej se, të dyja qeveritë e panë të udhës të përfundojnë krijimin e Bazës Ushtarake-Detare të Vlorës, “me qëllim mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë”¹⁴. Marrëveshja ka shtatë nene të ndara në disa pika. Në pikën 3 të nenit të parë thuhet qartë se po ta kërkojnë situatat dhe me miratimin e ministrave të mbrojtjes së RPSH dhe BS “mund të dislokohen përkohësisht trupat e Flotës Ushtarake Detare të BRSS”¹⁵. Ndërsa neni 3, pika 6 specifikonte se Bashkimi Sovjetik do ta furnizonte Shqipërinë me ndihma teknike e armatime pa shpërblim.

¹⁰ AQFA, Fondi 100/3, V.1957, D. 22, f.2. Kjo pikë parashikonte numrin e efektivëve të FA në kohë paqeje dhe kohë lufte

¹¹ AQFA, Fondi 100/3, V.1957, D. 22, f.1, Komisioni i palës shqiptare i kryesuar nga gjeneralmajor Arif Hasko kishte anëtarë: gjeneralmajor Nexhip Vinçani, kolonel Todi Naço, kolonel Spiro Shalsi, kap. Rangut të Dytë Abdi Mati, kolonel Ernest Jakova.

¹² AQFA, Fondi 100/3, V. 1957, D. 154, f.11. Komisioni i palës sovjetike i kryesuar nga zëvendës admiral Çursin kishte anëtarë: kapiten i Rangut të Parë S. Kostaninov, kolonel ing. V. Anfinov, ing kapiten i Dytë G. Kozirfev, ing. major F. Inogemciëf

¹³ AQFA, Fondi 100/1, V.1957, D. 31, f.1

¹⁴ AQFA, Fondi 100/3, V.1957, D. 20. f.1

¹⁵ Po aty... f.1.

Neni 3 i marrëveshjes prej 6 pikash bën një përcaktim të qartë të mënyrës se si do të merreshin në dorëzim anijet në tremujorin e parë të vitit 1958, pasi të ishte siguruar më parë gatishmëria e objekteve të domosdoshme të bazës. Për përdorimin operativ të nëndetësive në pikën 5 të këtij neni thuhet qartë se “do të kryhet sipas planeve të akorduara ndërmjet komandës sovjetike dhe asaj shqiptare”. Marrëveshja u nënshkrua për një afat 10-vjeçar. Ajo do të mbetej në fuqi për aq kohë sa njëra apo të dy palët nuk do të depozitonin brenda objeksione për ndërprerjen e saj, 6 muaj para afatit 10-vjeçar të përfundimit¹⁶.

Ushtria shqiptare mori një ndihmë të konsiderueshme ushtarake në sajë të kësaj marrëveshjeje. Mjafton të shohësh shtojcat e marrëveshjes dhe mund të kuptosh se një vëmendje e veçantë iu kushtua përforcimit të bregdetit të Adriatikut. Në shtojcën e parë të saj bie në sy se Shqipëria mori 4 nëndetëse të mesme, 4 gjuajtës nëndetësesh, të shoqëruara me anije ndihmëse, bazë lundruese për nëndetëset, dok lundrues (1 copë) etj. Shtojca 3 e marrëveshjes lidhet me masat që duhet të merreshin për sigurimin e lundrimit të anijeve luftarake dhe ndihmëse në ujërat territoriale të Shqipërisë, në afate kohore të përcaktuara. Bashkimi Sovjetik merrte përsipër të siguronte edhe pajisjet e lundrimit në periudhën 1957 -1958¹⁷. Krijimi i Bazës së Vlorës ishte një mjet lehtësimi për pozitën ushtarake të Bashkimit Sovjetik në Mesdhe dhe përgjigje direkte e tij ndaj Flotës së Gjashtë Amerikane, të dislokuar në brigjet italiane të Adriatikut.

Duhet të përmendim se pas futjes së Turqisë në NATO, ishte forcuar kontrolli turk mbi ngushticat e Bosforit e Dardaneleve, ndërsa ishte vështirësuar lëvizja e mjeteve detare të Bashkimit Sovjetik drejt deteve të jugut. Ngushticat turke mbeteshin të vetmet rrugë detare të kalimit të BS për në jug. Krijimi i Bazës së Vlorës ishte një kundërpërgjigje direkte e kërcënuese ndaj bllokut ushtarak rival të NATO, por edhe një rrezik më shumë për Shqipërinë, në rast konfrontimi me dashje apo pa dashje, ndërmjet të dy blloqeve më të mëdhenj të kohës së Luftës së Ftohtë. Këtë rrezik e vë në dukje atasheu ushtarak shqiptar në Moskë, Halim Ramohito, i cili shoqëronte mareshalin sovjetik Zhukov në vizitën e tij në Shqipëri në vitin 1957. Ramohito pohonte se “në mendimet e mareshalit nuk kalonin aspak rreziqet që mund t’i kanoseshin vendit tonë nga ndonjë sulm eventual i mundshëm, por (ai mendonte) vetëm për mundësinë e hegjemonisë së tyre nga ai drejtim strategjik¹⁸. Marrëveshja parashikonte një venddislokim jo të përhershëm të anijeve sovjetike në Shqipëri, por në realitet synohej më shumë. Mbështetur në kujtimet e atyre që kanë qenë aktorë të rëndësishëm të ngjarjeve, nënkuptohet qartazi se rusët “kishin rënë

¹⁶ AQFA ...Fondi 100/1, V.1957, D.154. f.2.

¹⁷ Po aty...shtojca 3.

¹⁸ Halim Ramohito, Në shërbim të atdheut tim, Grand Prind, Tiranë 2010, f.64.

në dashuri” me Bazën e Vlorës¹⁹.

Vetëm një muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes, Shqipërinë e vizitoi ministri i Mbrojtjes i Bashkimit Sovjetik, mareshali Zhukov. Bisedat e tij me udhëheqësit shqiptarë faktojnë se gjatë këtyre takimeve u hodhën bazat për nënshkrimin e marrëveshjes së dytë, e cila do të përfundonte në vitin 1959. Kjo marrëveshje shënonte fazën e dytë të zgjerimit të Bazës Detare Ushtarake të Vlorës dhe kthimin e saj në një bazë të Traktatit të Varshavës, duke e rritur kështu mundësinë e një konflikti potencial ndërmjet tij dhe NATO-s. Nga procesverbali i datës 24 tetor 1957 i mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe pikërisht nga diskutimet e Enver Hoxhës dhe raportimit të Beqir Ballukut, dalin qartë arsyet thelbësore që e shtynë regjimin komunist që të pranonte krijimin e një baze detare ushtarake, që do të kishte si efektiv një numër të madh ushtarakësh sovjetikë, pasi ushtrisë shqiptare i mungonte jo vetëm baza materiale, por edhe njerëzit e kualifikuar²⁰. “Minimalja, thuhej aty, është që në Shqipëri të ketë një divizion aeroplanësh dhe një regjiment bombarduesish që na mungon. Nevojat e ushtrisë sonë tani janë të shumta, ajo ka nevojë për njerëz dhe ajo që është kryesorja për njerëz të kualifikuar...”

Vizita e Zhukovit vlerësohej jo vetëm për rëndësinë e saj politike, në aspektin e forcimit të situatës së brendshme e ndërkombëtare, por sidomos për aspektin ushtarak të saj. Ajo “ka një rëndësi të madhe ushtarake, që ka të bëjë me forcimin e mbrojtjes së vendit tonë.”²¹ Ngjarjet e ndodhura në Poloni dhe në Hungari dhe klima e ashpër me fqinjët e bënin Enver Hoxhën të ndjehej i pasigurt, më tepër për vazhdimësinë e regjimit të tij, sesa për sovranitetin e vendit. Pikërisht në këto rrethana u pranua plani për ngritjen e bazës detare të Vlorës, i cili avancoi më tej gjatë bisedimeve me Zhukovin, kur u propozua për ta kthyer bazën luftarake detare të Vlorës, në bazë ushtarake detare më të fuqishme, për veprime kundër forcave ushtarako-detare të NATO-s në detin Mesdhe²². Në këtë mënyrë do të justifikoheshin edhe kërkesat për armatim e material ushtarakë të cilat nuk ishin të pakta. Marrëveshjet do të parashikonin deri edhe ndërtim aerodromesh.

Enver Hoxha kërkoi personalisht që, së bashku me mjetet e pajisjet ushtarake, të sillnin nga Bashkimi Sovjetik edhe specialistët përkatës, të cilët do të

¹⁹ H. Ramohito, F. Voshtina, M. Qorduka dhe ushtarakë ta tjerë që kanë shkruar kujtime për kohën kur Shqipëria ishte anëtare e TV ndajnë të njëjtin mendim, se sovjetikët shprehin një entuziazëm të lartë për gjirin e Vlorës.

²⁰ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D. 20, lista 1, f.2, Procesverbal i mbledhjes së BP të KQ të PPSH, datë 24 tetor 1957, Beqir Balluku dhe Enver Hoxha raportojnë për bisedimet e zhvilluara me marshallin Zhukov.

²¹ Po aty..., f.3

²² H. Kaba, E. Çeku, Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, Prishtinë 2001, f.176.

trajnonin kolegët e tyre shqiptarë. Këtë ai e lidhte ngushtë me objektivat e mbrojtjes së vendit, por edhe me aspektin propagandistik, duke e konsideruar një sukses të madh të politikës së tij, në shërbim të forcimit të gjendjes së brendshme të vendit. Enver Hoxha theksonte: “populli ynë do të shohë akoma më mirë se vendi ynë është i siguruar nga çdo sulm armik”²³. Militarizimin e vendit, armatimin e mirë të tij dhe ardhjen e avionëve e raketave, ai e shihte si mjet mbrojtës, në raport me rrezikun e rrëzimit nga pushtetit, duke e shitur mbrojtjen e vendit si një mbrojtje të regjimit të tij. Duhet të përmendim se politika e pandryshuar staliniste e udhëheqjes shqiptare pas kongresit të 20-të nuk ishte e mirëpritur nga udhëheqja e BS dhe krijimi i Bazës së Vlorës forconte disi imazhin e “grisur” të saj në sytë e popullit shqiptar. Kurse praninë e një numri të madh ushtarakësh sovjetikë e justifikonin me shprehjet se “sa shumë i do populli njerëzit sovjetik” dhe se “Shqipëria nuk është si Polonia”²⁴. Nga ana tjetër, Zhukovi, sipas pohimeve të atyre që e shoqëruan, e shprehu hapur entuziazmin për gjirin e Vlorës, pas vrojtimit që i bëri atij nga pika më e lartë e Karaburunit: “Ky është një gji i mrekullueshëm! Deti i Zi, ku ne kemi një pjesë të flotës sonë, është në fakt një liqen. Ta dislokojmë atë flotë që kemi atje, këtu, në këtë bazë...”²⁵ Rusët ishin të qartë në qëllimet e tyre për rritjen e hegjemonisë së tyre në Mesdhe, ndërsa për Enver Hoxhën, baza e Vlorës, krahas të tjerave shihej si një mjet shpëtimi nga frika e rrëzimit nga pushteti prej jugosllavëve, të cilët ishin afruar ndjeshëm me rusët në këtë kohë. Hoxha do të pohonte se “zgjidhja e përshtatshme e kësaj çështjeje, shprehet pozitivisht edhe në marrëdhëniet tona reciproke me Jugosllavinë, e cila do ta vlerësojë më shumë Shqipërinë”²⁶. Pra, ekzistenca e bazës detare të Traktatit të Varshavës shihej si një mjet për rritjen e prestigjit të regjimit komunist.

2. Marrëveshja e dytë, maj 1959

Pavarësisht nga përfitimet materiale duket se marrëveshja e vitit 1957 pati disa problematika. Sipas letrës së kryetarit të Këshillit të Ministrave, Mehmet Shehu, drejtuar N. Hrushovit më 7 maj 1958, në marrëveshjen e vitit 1957 “mbi krijimin e Bazës Detare Luftarake të Vlorës”, nuk ishin parashikuar sasi pajisjesh shumë të rëndësishme, mungesa e të cilave ndikonte negativisht në përgatitjen luftarake²⁷. Po kështu, kostoja ekonomike e Bazës ishte e shumë rëndë për buxhetin e varfër të shtetit shqiptar. Në këtë letër dhe jo në marrëveshjen e vitit 1957 del për herë të parë togfjalëshi “falas për ne”, pra, qeveria shqiptare shprehte bindjen dhe besimin se kërkesat e saj do të

²³ Po aty...Fondi 100/3, V.1957, D. 20. f.7

²⁴ Po aty...,f.7.

²⁵ Halim Ramohito, Në shërbim të atdheut tim, Grand Prid, Tiranë 2010, f.28

²⁶ H.Kaba, E. Çeku, Shqipëria... ruse, Prishtinë 2001, f.176.

²⁷ AQSH, Fondi 490, V. 1958, D 1132, Letër e Mehmet Shehut kryetar i Këshillit të Ministrave drejtuar Nikita Hrushovit

plotësoheshin falas nga qeveria sovjetike. Pikërisht ky togfjalësh që do të jetë pjesë e formulimit të nenit të dytë, të marrëveshjes së vitit 1959, do ta kthente Bazën e Vlorës, sipas përcaktimit të mareshalit Greçko, në “një mollë sherri”.

Më 4 maj 1959, ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, gjeneralkolonel Beqir Balluku do të merrte një telegram nga mareshali i Bashkimit Sovjetik gjeneral armate Antonov dhe bashkangjitur me të edhe projektin e marrëveshjes së dytë ndërmjet të dy qeverive, për “Fuqizimin e Mbrojtjes së Bazës Ushtarake të Detare në gjirin e Vlorës”²⁸. Vetë marrëveshja e përpiluar në dy gjuhë, shqip dhe rusisht, mban shënimin se ajo u përpilua në Tiranë më 3 maj 1959, me autorizimin e qeverisë shqiptare të përfaqësuar nga Beqir Balluku dhe të qeverisë së BS të përfaqësuar nga Malinovski. Duket se dokumenti kishte një pasaktësi, sepse ministri i mbrojtjes së BS, Rodon Malinovski kishte ardhur në vendin tonë, si pjesë e delegacionit zyrtar që shoqëroi Nikita Hrushovin²⁹.

Të dyja marrëveshjet e lartpërmendura ishin marrëveshje dypalëshe ndërmjet të dy qeverive. Madje sipas mendimit të Halim Ramohitos, pala sovjetike kishte këmbëngulur në mënyrë të vazhdueshme, që për problemet e Bazës së Vlorës, të mos flitej me vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës³⁰, e specifikuar kjo edhe në nenin 11 të marrëveshjes, pasi këtë marrëveshje ata e konsideronin si një lidhje të veçantë me palën shqiptare. Kjo shpjegohet me faktin se sovjetikët pothuajse të gjitha marrëveshjet i realizonin si marrëveshje dypalëshe dhe jo si marrëveshje shumëpalëshe dhe përgjithësisht vendimet që merrte nuk ishin vendime kolektive edhe pse propagandoheshin të tilla ato ishin në funksion të politikës së jashtme të BS dhe planeve ushtarake. E kundërta ndodhi kur situatë u tensionua, problem i bazës së Vlorës nuk u pa më si një problem mes BS dhe Shqipërisë, por si një problem i kësaj të fundit me Traktatin e Varshavës. Ekzistenca e bazës u përdor vazhdimisht nga regjimi komunist i kohës si një mjet mbrojtës nga sulmet e mundshme të imperializmit amerikan, por në formulimin e marrëveshjes së vitit 1959³¹, në nenin 3 të saj mbrojtja e gjithanshme e bazës, sigurimi i hyrjes dhe daljes së nëndetëseve në gjirin e Vlorës i lihej plotësisht në dorë palës shqiptare. Nëse në marrëveshje kjo do të lihej në dorë të forcave sovjetike, atëherë ky mund të konsiderohej një formë pushtimi (nga sovjetikët), që do të mund të sillte komplikime në rajon dhe binte ndesh me nenin 8 për të respektuar pavarësinë dhe sovranitetin e vendeve anëtare, si dhe mosndërhyrjen në punët e tyre të brendshme TV.³²

²⁸ AQFA, Fondi 100/3, V.1959, D. 247, f.7.

²⁹ Ana Lalaj, “Albanien und der Warschauer Pakt”, në: Der Warschauer Pakt, Von der Gründung bis zum Zusammenbruch 1955 bis 1991, Berlin: Ch. Links Verlag, 2009, f. 42

³⁰ H. Ramohito, Në shërbim...tim, Tiranë 2010, Grand Prind, f.21.

³¹ AQFA, Fondi 100/3, V.1959, D. 254, f.1.

³² Zëri i Popullit, 15 maj 1955. f.1, Teksti i Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndhimës Reciproke.

Pala sovjetike siguron bazën materiale dhe përdorimin e tyre sipas planeve të koordinuara mes komandës shqiptare dhe komandës sovjetike. Duke i vënë përballë marrëveshjen e shkruar në letër dhe kujtimet e atasheut ushtarak në Moskë, Halim Ramohito pohon se sovjetikët asnjëherë nuk i zbuluan palës shqiptare planet e tyre strategjike, në rast të një agresioni eventual karshi vendit tonë dhe se ata nuk thanë kurrë në atë periudhë se çfarë do të bënin në rast se eventualisht mund të sulmohej vendi ynë³³.

Neni i katërt i kësaj marrëveshje është një tjetër pikë e nxehtë debati në ditët e sotëm, i cili kërkon thellim të mëtejshëm në dokumente. Në këtë nen parashikohej që në bregdetin e RPSH të ndërtoheshin pozicione për kompleksin “Sopka”. Shërbimi në këtë kompleks do të bëhej nga ekuipazhet sovjetike, ndërsa përsa i përket përdorimit të kompleksit luftarak ai do të bëhej me marrëveshje midis komandës sovjetike dhe asaj shqiptare³⁴. Enver Hoxha gjatë fjalimit të tij në mitingun e kanalit të Çukës, me rastin e vizitës së N. Hrushovit në Shqipëri në maj 1959 do të pohonte se “ne raketa nuk kemi”, por duke qenë në dijeni të marrëveshjes, ai do të shtonte se “në rast se do të duhen ne do t’i vendosim ato, në rast se e kërkojnë situatat”³⁵. Në dosierë të ndryshëm të botuar në të përditshmet shqiptare pas viteve 2000, ku protagonistë janë ushtarakë shqiptarë që ishin efektivë të Bazës Detare të Vlorës, ose efektivë në Karaburun, është folur për një tentativë të sovjetikëve për ta kthyer Karaburunin në një bazë të armëve atomike. Edhe në librat me kujtime të këtyre personazheve gjejmë hipoteza të tilla, por ato ngelen vetëm hipoteza pa sjellë fakte konkrete³⁶. Kjo është e kuptueshme pasi nuk kishte asgjë të shkruar në lidhje me këtë plan, ose si pohojnë ata vetë planet e sovjetikëve nuk ishin të njohura për ta.

Mendojmë se vizita e Hrushovit në Butrint nuk ishte rastësishme. Ideja e hedhur në fjalimin e tij se interesave të popujve të Gadishullit të Ballkanit e të Adriatikut do t’u shërbente krijimi i një zone të lirë nga armatimi atomik lidhej ngushtë me atë çfarë po ndodhte në dy vendet fqinje bregdetare me Shqipërinë³⁷. Në këtë kohë me Greqinë po zhvilloheshin bisedime për krijimin e bazave të raketave. Në Itali gjithashtu. Edhe pse ishte për një politikë të bashkekzistencës paqësore, Hrushovi nuk mund ta humbiste rastin të përcillte mesazhin te rivalët e tij, se mundësia e krijimit të bazave me armatim atomik

³³ H. Ramohiton, Në shërbim...tim, Tiranë 2010, Grand Prind, f.31.

³⁴ “Sopka” ishte emri i koduar për raketat tokë –det, me rreze të mesme veprimi, që sipas specialistëve mbulonte me goditej gjithë zonën e Mesdheut.

³⁵ AQSH, Fondi 14 AP/OU. V.1959, dosja 15.

³⁶ H. Ramohito, Në shërbim...tim, Tiranë 2010, Grand Prind, f.30.

³⁷ H. Kaba, E. Çeku, Shqipëria... ruse, Prishtinë 2011, f.191, Letër e ambasadës së BRSS në RPSH, mbi konkluzionet e qëndrimit të delegacionit të partisë e qeverisë sovjetike kryesuar nga N. Hrushovi në Shqipëri.

ishte e hapur edhe në Shqipëri.

Edhe në nenin 5 gjejmë implikime që shkaktuan më pas konflikte në bazën detare të Vlorës, por edhe në marrëdhëniet ushtarake në përgjithësi, që patën si shkak të parë mosmarrëveshjet politike, të bëra të dukshme në vitet 60-61. Për pajisje të nevojshme, pjesë këmbimi dhe materiale të tjera që mungonin në RPSH “të sigurohen nga pala sovjetike në bazë të kërkesave të palës shqiptare, pa pagesë³⁸”. Në lidhje me këtë argument që është përdorur prej palës shqiptare, në lidhje me pronësinë e nëndetëseve, studiuesja Ana Lalaj thotë se pala shqiptare nuk kishte argumente të mjaftueshme juridike se ato i përkisnin asaj, bazuar vetëm mbi togfjalëshin “pa pagesë” dhe kjo ishte arsyeja që autorizoi largimin e 2/3 të tyre, duke përdorur sloganin “për hir të miqësisë së përjetshme që lidh popullin shqiptar me popullin sovjetik”³⁹.

Në të kundërt, mendon inxhinieri ushtarak Fatosh Voshtina, që e lidh pronësinë e këtyre anijeve me faktin se “nëndetëset dhe anijet e tjera luftarake të brigadës “40” që nga momenti i hyrjes në gjirin e Vlorës, pas ceremonisë do të mbajnë flamurin e RPSH gjatë periudhës derisa t’i dorëzohen për lundrim të vetmuar forcave dhe efektivit shqiptar”⁴⁰. Por ligjërisht nuk ka asnjë akt që të ketë realizuar këtë kalim pronësie të këtyre mjeteve, madje kalimi i tyre në përdorim nga ekuipazhet shqiptare do të bëhej në harkun kohor 1960-1962, kohë kur filluan edhe konfliktet e hapura politike.

Përfundime

Baza ushtarako-detare në gjirin e Vlorës u krijua nga BS si një pikëmbështetje e rëndësishme e organizatës së Traktatit të Varshavës⁴¹ dhe në mënyrë të veçantë si një pikë strategjike në Mesdhe që duhet t’i shërbente Bashkimit Sovjetik për vendqëndrimin dhe lundrimin e Flotës Nënujëse Detare, madje jo vetëm nga Baza e Vlorës, por edhe pika të tjera të mundshme, si p.sh., Butrinti në Sarandë⁴². Dy marrëveshjet ushtarake që u nënshkruan në këtë kuadër patën si anë pozitive armatosjen e forcave ushtarake të RPSH dhe kualifikimin e ushtarakëve shqiptarë pa asnjë shpenzim. Kjo mund të konsiderohet një arritje e madhe për regjimin komunist në kushtet e vështira ekonomike në të cilat ai ishte. Shpenzimet ruse për ndërtimin e bazës ushtarako-detare në gjirin e Vlorës llogariteshin në vlerën më shumë se 1 miliardë rubla⁴³ (këtu nuk

³⁸ AQFA, Fondi 100/3, V.1959, dosja 254, f.2.

³⁹ Shqiptarja.com, Dossier Prof. Dr. Ana Lalaj, 5 maj 2013.

⁴⁰ Fatosh Voshtina, Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike në bazën detare të Vlorës, Tiranë 2011, f.184.

⁴¹ AQSH, Fondi 490, V. 1961, Dosja 1149, f.5 Letër e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave të BRSS, A. Kosigin, datë 26 prill 1961.

⁴² Gjatë vizitës në Butrint, Sarandë N. Hrushovi ju drejtuar Malinovskit “Ky është një vend i mrekullueshëm për të bërë një bazë tjetër detare”.

⁴³ H. Ramohito, Në shërbim...tim, Tiranë 2010, Grand Prind, f.14.

është llogaritur kostoja e 12 nëndetëseve dhe anijeve të tjera luftarake dhe nënujësë dhe ndihmëse që po ashtu u përballuan nga qeveria sovjetike). Prania e ekuipazheve sovjetike në bazë padyshim stepi orekset e fqinjëve, sidomos ato të Greqisë.

Por krijimi i bazës e shndërroi Shqipërinë në një post të avancuar të mbrojtjes sovjetike e të Traktatit të Varshavës, duke e vënë atë përballë Flotës së Gjashtë Amerikane në Mesdhe. Raste e incidenteve të mundshme, sipas rrëfimeve të ushtarakëve shqiptarë që ishin në detyrë në atë periudhë, mund të ktheheshin në problem madhore e ndofta edhe në konfrontime. Në këtë këndvështrim, vendi ynë mund të bëhej arenë konflikti⁴⁴. Marrëveshjet e përmendura jo për shkak të ekuivokëve juridike, por për shkak të mosmarrëveshjeve ideologjike dhe interesave të momentit, u përdorën si pretekst nga palët për të ngjizur një konflikt, që do të çonte përfundimisht në daljen de facto, por jo de jure të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës.

Ato do të ndërpriteshin në mënyrë të njëanshme pa përfunduar afati 10-vjeçar, duke krijuar probleme të dukshme në furnizimin me armatim të ushtrisë shqiptare, si dhe mjete të tjera materiale, vështirësi që u kapërcyen me ndihmat ushtarake të siguruara nga partneri i ri ideologjik Kina.

Bibliografia:

Arkivat:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA)

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMJ)

Botime dokumentare:

Kaba H, Çeku E, Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946 -1962, Prishtinë, 2011

Literaturë histori-grafike:

Sminrnova, Nina, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, Ideart, Tiranë, 2004

Organe shtypi:

Shqiptarja.com, 2013

Panorama, 2003, 2010

Koha Jonë, 2006

⁴⁴ H. Ramohito, F. Voshtina, M. Qorduka (ushtarakë që kanë shkruar kujtime).

Tirana Observer, 2007

Ballkan, 2011

Telegraf, 2010, 2012

Standard, 2011

Shekulli, 2006

Kujtime:

Voshtina, Fatosh, Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike në Bazën Detare të Vlorës, Mediaprint, Tiranë 2011.

Ramohito, Halim , Në shërbim të atdheut tim, Grand Prind, Tiranë, 2011.

Hrushov, Nikita, Kujtime. Nuk jam gjykatës, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2005.

FAN NOLI PËR USHTRINË DHE XHANDARMËRINË SHQIPTARE

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi
Akademia e Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Shqipëria e viteve '20-të është objekt i pashtershëm studimi, veçanërisht në fushën e sigurisë. Nëse i referohemi veprës së Fan Nolit, kontributit të tij për pavarësinë, historinë, kulturën e letërsinë shqipe, në themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare, si i dëbuari i madh i 1924-s, nuk mund të lëmë pa përmendur tentativat për një shtet të së drejtës dhe me një vizion të qartë për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Qeveria dhe qeverisja e Nolit e vitit 1924 ishte një copëz pushteti i shkurtër në kohë për një Shqipëri të lirë, demokratike, të barabartë, të pakorruptuar, me besim në vetvete, e gatshme për të bashkëpunuar për fqinjësi të ndershme, që dëshiron të mbrojë parimet universale të drejtësisë, për të ndalur grykësinë njerëzore, e udhëhequr nga prijës të aftë dhe të besuar, që respektonin lirinë e besimit e diversitetin fetar, një Shqipëri për qytetarët e saj. Programi i qeverisë “Noli” përmbante në vetvete esencën e mendimit të përbashkët të intelektualëve demokratë, të diplomuar në universitetet më në zë të Evropës Perëndimore dhe SHBA, por edhe ushtarakëve progresistë e profesionistë shtatmadhorie të përgatitur në shkollat dhe akademitë më prestigjioze të kohës

Edhe pse dështoi Fan Noli nuk “i hodhi armët” dhe nuk e pati për “turp” dështimin, edhe pse ai shkëlqeu me veprën që u la shqiptarëve trashëgimi, megjithatë ai dështoi “në modelin e ri të krijimit të shtetit”.

Fjalët kyçe: Ushtri, polici, xhandarmëri, kryengritje, revolucion, triumf, dështim, rrëzim.

Hyrje

Fan Noli ishte njeri i të gjitha kohërave, që talentin dhe aftësinë e tij i vuri në shërbim të shqiptarëve për zbulimin dhe konsolidimin e identitetit kombëtar pas disa shekujsh shtypjeje dhe asimilimi kulturor. Energjitë e tij intelektuale e shpirtërore me një vullnet të paparë materializohen në thënien profetike se, “një popull pa vizion zhduket”, prandaj, idetë dhe vizioni i tij ishte Shqipëria e përparuar dhe demokratike, ndërtimi dhe siguria e shtetit, ngritja e ndërgjegjes kombëtare.

Qeveria dhe qeverisja e Nolit e vitit 1924 ishte një copëz pushteti i shkurtër në kohë për një Shqipëri të lirë, demokratike, të barabartë, të pakorruptuar, me besim në vetvete, e gatshme për të bashkëpunuar për fqinjësi të ndershme, që dëshiron të mbrojë parimet universale të drejtësisë, për të ndalur grykësinë njerëzore, e udhëhequr nga prijës të aftë dhe të besuar, që respektonin lirinë e besimit e diversitetin fetar, një Shqipëri për qytetarët e saj.

Qeveria e Nolit të gjitha ëndrrat i bazoi në fuqinë e pamjaftueshme ushtarake dhe të xhandarmërisë, që udhëhiqeshin nga nënkolonel Kasëm Qafëzezi, nënkolonel Rexhep Shala, Major Bajram Fevziu, Major Aqif Përmeti, që përfaqësonin nivelet më të larta të drejtimit në Ministrinë e Mbrojtjes e në Ministri të Brendshme, që fatkeqësisht kishin anësi politike.

Lidhshmëria dhe besimi tek ushtarakët si “krahu i djathtë i revolucionit”, i udhëhequr nga Noli, edhe pse me një veprimtari të kufizuar gjashtë mujore nuk e zbehu veprimtarinë e tij dhe tentativat për ngritjen e një shteti të së drejtës për kohën. Fakt është se kurorën e dafinave Nolit, ia ka vënë koha me triumfet dhe dështimet e tij dhe me gjurmët e pashlyeshme në interes të shqiptarëve. Noli me pikëpamjet mbi organizimin e shtetit, politikën e brendshme e të jashtme, mbi çështjet e ushtrisë, policisë, xhandarmërisë dhe sigurisë në tërësi i shtjelloi në shkrime e fjalime veçanërisht në vitet 1921-1924, por edhe më mbrapa. Ai luftoi që shteti të vinte në jetë parimet e demokracisë së përparuar, që ai tentoi ti implementonte edhe tek bashkëpunëtorët e tij duke treguar vëmendje për shtetin, sigurinë, diplomacinë, ekonominë, arsimin etj. Noli ishte zhvillues dhe bashkëpunues në ide e veprime, , por ndërtimi i shtetit dhe siguria e tij nuk mund të bëhej vetëm me dëshirë e vullnet. Kërkohej një shoqëri e arsimuar dhe integruar, dhe mbi të gjitha një siguri të brendshme dhe të jashtme të konsoliduar.

Armiqësia midis grupeve rivale shqiptare nuk ishte vetëm në foltoren parlamentare, por edhe me armë duke mbështetur përfshi armiqtë e Shqipërisë për të rrëzuar kryengritësit ushtarakë të veriut dhe të jugut të vendit, që zgjodhën marrjen e pushtetit sipas mënyrës së tyre, që shtypi i ditës e përcaktonte: “Kabineti Noli”, i dalë nga një kryengritje ushtarake. Ky kabinet ishte, i urtë, i matur, që përpiqej të mbyllte plagët e përçarjes, “është më i miri që mund të bëhej”¹.

Koncepti i Nolit për ushtrinë dhe policinë/xhandarmërinë u materializua në programin e qeverisë (programi i kabinetit)² që udhëhoqi për gjashtë muaj. Qeveria “Noli” erdhi në Tiranë me grykën e armëve dhe iku nën grykën e armëve, si dhe u bazua e mbështet fuqishëm tek ushtarakët. Qeveria e tij u rrëzua po nga ushtarakët, e krahut opozitar.

1. Ushtria dhe xhandarmëria në programin e qeverisjes së kryeministrit Noli

Shqipëria nuk kishte mundur të kishte qëndrueshmëri politike, që prej qeverisë së Sulejman Delvinës të vitit 1920. Vendi kishte ndryshuar 12 qeveri në katër vite. Prandaj dhe vitet 1920-1924 në Shqipëri flasin qartë për një rekord të paparë qeverish shqiptare në arenën politike evropiane. Secila prej tyre kishte për “armëroje”, ushtrinë³ dhe xhandarmërinë⁴, krahun e armatosur të mbrojtjes së brendshme dhe të jashtme. Në sfondin e intrigave politike, përfshi zgjedhjet e dhjetorit 1923⁵, asnjë palë nuk arriti shumicën e Parlamentin prej 102 vendesh, Pas zgjedhjeve të 27.12.1923 për Kuvendin Kushtetues⁶, Ahmet Zogu që kishte shumicën parlamentare me 44 deputetë krijoi qeverinë e re, 39 deputetë i përkisnin opozitës, ndërsa 19 ishin në grupin “të pavarur”. Humbja në zgjedhje, për opozitën ishte pamundësi edhe për të ardhmen.

¹ Gazeta “Shqiptari i Amerikës” (Shg75/6G), Organ i Vatrënëve Mbron të drejtat e popullit dhe idealet e shteteve të Perëndimit (Volumi II, Viti II i botimit), menager dhe përgatitës Hasan Bitincka, Sekretar Loni Nini; Editor Faik Konitza; Acting editor Loni Kristo; marrë sipas origjinalit në Bibliotekë Kombëtare, e martë 15 korrik 1924, no.111, faqe 2.

² Gazeta “Shqiptari i Amerikës” (Shg75/6G), “Çpallja dhe programi i kabinetit”, no.110, e martë 15.7.1924, no.110, faqe 2.

³ Ushtria është bashkësia e disa forcave (njësive të armatosura) nën një komandë. Sipas FESH, Tiranë, 1984.

⁴ Fjala “xhandarmëri” vjen nga frëngjishtja “gens d’armes”, që do të thotë “burra të armatosur”. Në kohët e Mesjetës edhe në ato moderne, ky term i referohej kavalerisë të armatosur rëndë, të cilët vinin prej “familje fisnike” dhe që shërbenin në ushtrinë franceze. Napoleon Bonoparti e organizoi xhandarmërinë vetëm katër muaj pas grushtit të shtetit dhe e shndroi për herë të parë në një forcë të armatosur për zonat rurale, atje ku policia nuk mund ta realizonte përsosmërisht detyrat. Sipas Michel de Weger, Res Militares, Volume.I, nr.2, Paris, 2011.

⁵ Analistët histografë shqiptarë gjykojnë se zgjedhjet parlamentare të 27.12.1923 ishin zgjedhjet e treta të mbajtura në Shqipëri, por ka qenë hera e fundit që u mbajtën zgjedhje të lira në Shqipëri, deri në vitin 1992.

⁶ Historia e popullit shqiptar, (në katër vëllime), Vëllimi III, Tiranë, Toena, 2007, faqe 216.

Qeverisja e shumicës përmes votës ishte gur themeli për një shtet të qëndrueshëm. Por që përpara zgjedhjeve ku rivaliteti politik u ashpërsua shumë me veprime që opozita i quante arbitrare, siç ishte orvatja e Kryeministrit për të shkarkuar Komandantin e Xhandarmërisë major Shefqet Korçën, tek i cili gjykohej se anonte nga opozita e Fan Nolit.

Kundërshtitë çuan në tërheqjen e kryeministrit dhe të lëshonte përkohësisht postin e ministrit të Brendshëm. Zgjedhjet në Shqipëri u organizuan me vrasje, plagosje, dhunim e kërcënim⁷. Dhuna lexonte manipulim aq sa deputeti i Korçës Faik Konica i dërgoi Asamblesë dorëheqjen nga SHBA, ndërsa vatanët⁸ do të shpreheshin: “një shumicë që ruan fabrikën sociale të vjetër që e ka lënë popullin në errësirë dhe varfëri”. Krahu ushtarak Ministria e Brendshme prej nga varej Xhandarmëria dhe Ministria e Luftës që kishte në vartësi ushtrinë, mbështesnin njëra qeverinë dhe tjetra opozitën⁹.

Konflikti politik u shndërrua në dhunë. Opozita vendos ta eliminojë fizikisht Zogun dhe më 23.2.1924, Beqir Bajram Valteri një i ri nga Mati, anëtar i organizatës “Bashkimi”, qëlloi me tri të shtëna në drejtim të kryeministrit tek shkallët e Asamblesë. Por atentati në Parlament ndaj Kryeministrit e ndërlikoi shumë situatën politike në Tiranë dhe ai pas dy ditësh më 25 shkurt 1924 dha dorëheqjen nga posti i Kryeministrit në emër të “stabiliteti politik dhe sigurisë së vendit”, duke sjellë një krizë të re qeverisjeje. Më 25 shkurt 1924, 29 opozitarë i paraqitën Këshillit të Lartë një deklaratë, që fliste për gjendjen kaotike në vend dhe rrugëdaljet, duke iu referuar “Xhandarmërisë, Ushtrisë dhe gjykatave”, që janë ngarkuar të mbajnë qetësinë e vendit”. Rrugëzgjdhja: “ndërrimi i qeverisë”¹⁰. “Këshilli i Naltë i Shtetit” nën presionin e opozitës, pas afro 6 javësh, më 30 mars 1924 ngarkoi Shefqet Bej Verlacin të formonte qeverinë e re, duke mos përfshirë Zogun në qeveri pas dy javësh, më 17.4.1924, pranoi t’i jepte asaj disa vende në qeverinë e tij, duke e paraqitur atë si qeveri koalicioni me kërkesën e “të pavarurve”. Luigj Gurakuqit iu dha posti i Ministrit të Financave, Dr. Fahri Reshitit (Gjilani) nga Kosova iu dha posti i Ministrit të Arsimit. Në parim u pranua që opozitës t’i jepej edhe posti i Ministrisë së Luftës. Opozita i pranoi postet, dhe në mbledhjen e parë të

⁷ Nga opozita noliane u vranë patrioti Adem Gjinishi, i zgjedhur në Kongresin e Lushnjës, ndërsa në Lushnjë u vra zgjedhësi i dytë Isuf Kazazi së bashku me shoqen. Po aty, faqe 216.

⁸ Shoqata “Vatra”, takimi i parë që bëri bashkë gjithë shqiptarët në SHBA, për të krijuar një federatë të vetme, u zhvillua në 24.12.1911 në Boston, edhe me pjesëmarrjen e shoqatës Besa-Besën. Në këto takime ishin të pranishëm: Fan Noli, Faik Konica, Kristo Floqi, Marko Adams, Paskal Aleksi etj., takime që vazhduan deri më 28.4.1912, kur dhe Vatra u regjistrua zyrtarisht. “Vatra” gjatë historisë së saj ka publikuar: “Dielli” & “The Adriatic Review”.

⁹ Fakt është se forcat e ushtrisë të komanduara nga Osman Gazepi qëndronin prapa qeverisë, ndërsa xhandarmëria nën komandë të Azis Çamit mbështesin opozitën; Historia e popullit shqiptar, (në katër vëllime), Vëllimi III, Tiranë, Toena, 2007, faqe 217-218.

¹⁰ Opozitarët që nënshkruan deklaratën ishin Fan Noli, Sulejman Delvina, Luigj Gurakuqi, Spiro G. Koleka, Aqif Pashë Elbasani, Avdni Rustemi etj. Historia e popullit shqiptar, (në katër vëllime), Vëllimi III, Tiranë, Toena, 2007, faqe 219.

Asamblesë lavdëruan qeverinë dhe qëllimet e larta atdhetare të kryeministrit. Por e vërteta flet ndryshe: opozita besonte se duke pasur në dorë këto dikastere, sidomos atë të luftës, në një qeveri pa Zogun me idenë e përmbysjes së situatës së pushtetit. Më 6.4.1924 dy turistë amerikanë gjatë kthimit me makinë në rrugën Tiranë-Shkodër u vranë në një pritë rreth 40 km larg nga Tirana pranë Mamurrasit¹¹. Më 20.4.1924, në një rrugë të Tiranës, Avni Rustemi deputet i opozitës në Asambleshën Kushtetuese dhe kryetar i Shoqërisë “Bashkimi” u plagos rëndë nga Isuf Reçi, një mullixhi dhe shërbëtor i vjetër i Esat Pashës dhe pas dy ditësh më 22.4.1924 ndërroi jetë. Lajmi u përhap me shpejtësi dhe situata u rëndua më tej. Në kushtet e mjegullës që shoqëroi krimin, opozita akuzoi qeverinë për këtë vrasje dhe nuk pranoi të marrë pjesë në punimet e Asamblesë Kushtetuese. Opozita vendosi që varrimi i Avni Rustemit të bëhej në Vlorë. Mbi varrin e tij, Fan Noli shpalli përpara turmës se gjendja ku kishte arritur Shqipëria nuk mund të zërthehej veçse me revolucion. Ali Këlcyra dhe Qazim Koculi kërkonin pa vonesë të rrëmbenin armët për kryengritje. Deviza e 1920-tës u ripërtëri më 1924: “Ja në fuqi... ja Shqipëria gurë e hi”, imituar këngën e Ali Asllanit për Luftën e Vlorës të 1920-ës: “Ja do bënet Vlora jonë (Shqipëri),/ Ja do bënet gur e hi..” Asamblistët e opozitës, regjenti Sotir Peci dhe ministri Luigj Garakuçi, pas ceremonisë së varrimit të Avni Rustemit nuk u kthyen në Tiranë, por qëndruan në Vlorë që të merreshin me organizimin e kryengritjes së armatosur. Në Vlorë u krijua edhe një Komision Administrativ i Përkohshëm nën drejtimin e Fan Nolit, si një “qeveri provizore”, ku Noli drejtonte punët e jashtme, Sulejman Delvina punët e brendshme, Kosta Paftali ato botore dhe Mustafa Tragjasi çështjet financiare. Ndërkohë që në gjithë vatrat e nxehta të vendit ushtarakët po merrnin fuqinë e ndërhyrjes së armatosur. Më 24 maj 1924, Bajram Curri filloi sulmin mbi Krumë dhe e mori atë më 26 maj 1924 kryengritësit vazhduan sulmin në Bytyç, Bicaj, Kalanë e Dodës, Dibër e Mat. Më 30 maj 1924 Rexhep Shala sulmoi godinën e prefekturës në Shkodër, e cila ra më 31 maj pas një qëndrese të forcave qeveritare ku u vra komandanti i xhandarmërisë kapiten Ferit Frashëri. Toger Ndok Gjelooshi ishte në krye të forcave sulmuese të rreth 180 shaljanëve¹². Organizata “Bashkimi” në Vlorë demonstroi gatishmërinë për kryengritje kundër qeverisë dhe u vendos që ushtria të përdoret për rrëzimin e qeverisë. Më 31 maj 1924, Iliaz Vrioni

¹¹ Turistët amerikanë të vrarë ishin G.B. de Long dhe R. L. Coleman, që ishte një ngjarje diskretituese, që sipas traditës shqiptare “të huajt dhe mysafirët gëzonin mbrojtjen e besës”. Valentina Duka, Historia e Shqipërisë, 1912-2000, Tiranë, shblu, 2007, faqe 144-145.

¹² Bashkë me Ferit Frashërin ishin 30 xhandarë nga jugu, 20 xhandarë mirditorë nën komandën e toger Luigj Shantojës. Pas një rrethimi dhe shkëmbimi zjarri, prefekti Abedin Nepravishta me 300 të rrethuarit u dorëzuan, pasi u vra qarkkomandanti i xhandarmërisë, kapiten Ferit Frashëri me tre xhandarë dhe dy ushtarë. Njësitë vullnetare të drejtuara nga Gjelooshi vijuan drejt jugut në Gjadër-kodrat e Lezhës, u shkëmbyen zjarr me trupat qeveritare të n/prefekturës së Lezhës dhe pas 13 të vdekurve e 6 të plagosurve, iu hap rruga për të hyrë në Tiranë. Ndok Gjelooshit gjatë qeverisjes së Nolit, ju dha grada kapiten i forcave kufitare dhe më tej prefekt i Shkodrës, por me triumfin e Legalitetit, u largua drejt Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, ku qe anëtar i grupit “Partia Republikane” të krijuar nga Rexhep Shala.

formoi qeverinë e re. Forcat e garnizonit të Përmetit, së bashku me vullnetarët e Skraparit të udhëhequr nga kapiten Riza Cerova iu drejtuan Beratit, i cili ra në duart e kryengritësve më 3 qershor 1924, pas dy ditë luftimesh. Ndërkohë, forcat e ardhura nga Vlora hynë në Fier dhe më pas në Lushnje ku u bashkuan me forcat e tjera që erdhën nga Berati. Më 5 qershor ra Peshkopia dhe më 9 qershor Kavaja. Qeveria e Iliaz Vrionit nga paniku u shpërngul në Durrës. Më 10 qershor 1924, forcat të ardhura nga Shkodra nën komandën e Ndok Gjeloshit, të prira nga deputeti Xhemal Bushati hynë në Tiranë, ndërkohë që Zogu nga Dibra shkoi në Beograd, ndërsa anëtarë të tjerë të qeverisë dhe asamblastët kishin ikur më parë për në Itali dhe Greqi. Garnizonet ushtarake me opozitën morën pushtetin e braktisur. Fan Noli u bë frymëzues dhe simboli i këtij “revolucionit”. Asambleja Kushtetuese u shpërnda vetvetiu, ndërsa nga Regjenca (Këshilli i Lartë) kishte mbetur vetëm Sotir Peci, sepse Gjon Çoba kishte dhënë dorëheqjen qysh me 24 maj 1924 dhe dy të tjerët Xhafer Ypi dhe Refik Toptani ishin larguar nga Shqipëria. Drejtues i veprimeve ushtarake në prefekturën e Kosovës dhe zonat e tjera verilindore u caktua Bajram Curri, për Shkodrën Rexhep Shala, për Shqipërinë e Jugut Kasëm Qafëzezi këshilltar ushtarak i Nolit¹³. Drejt Tiranës ishin rreth 7000 trupa, ndërkohë që Zogu u largua nga Tirana në veri të vendit me rreth 600 luftëtarë... që vlerësohet një “grusht i dobët shteti pa gjakderdhje, i organizuar nga dy regjimente të ushtrisë në Jug (Përmet) dhe në Veri (Shkodër)”, ku amerikanët japin 26 të vranë, 50 të plagosur. Më 10.6.1924 kryengritësit hynë në Tiranë¹⁴.

Fakt është se Noli si një njeri “pa kompromis për të vënë para idetë e tij ëndërronte që të sillte pak “Amerikë” në Ballkanin e trazuar nga qiejt e urrejtjes dhe dredhisë, nga masakrat dhe shpagimet e mërive të vjetra”¹⁵. Kështu që zgjedhja e kryeministrit, më 16.6.1924 u bë me short, duke u mbështetur në katër blloqe nga pesë shtyllat e kryengritjes: “ushtria, bejlerët, liberalët, progresistët dhe lobi shkodran”¹⁶. Në kushtet kur nuk kishte Parlament për postin e kryeministrit u përdor sistemi i shortit, ku ndërmjet kandidatave: Sulejman Delvina, Qazim Koculi e Fan Noli. Fati zgjodhi Fan Nolin dhe ai u bë kryeministër, ku krahas programit politik qeverisës u angazhua edhe me ngritjen e gjykatat politike ndaj rreth 170 kundërshtarëve politikë. Gjyqi dënoi me vdekje në mungesë dhe me konfiskim të pasurisë Ahmet Zogun, Shefqet Vërlacin, Iliaz Vrionin, Koço Kotën, Myfit bej Libohovën, Abdurrahman Dibrën, etj.

Programi qeverisës në qeverinë “Noli”:

Qeveria “Noli” u formua më 16.6.1924. Kjo qeveri është ndër më të voglat e kabineve qeveritare që janë ngritur ndonjëherë në 110 vjet shtet shqiptar

¹³ Valentina Duka, Historia e Shqipërisë, 1912-2000, Tiranë, shblu, 2007, faqe 146.

¹⁴ Po aty, faqe 147.

¹⁵ Dorian Koçi, Madhështia e Nolit, Flas shqip, Tiranë, më 6.1.2022.

¹⁶ Valentina Duka, Historia e Shqipërisë, 1912-2000, Tiranë, shblu, 2007, faqe 147-148.

e përbërë nga S. Delvina (ministër i Jashtëm), Rexhep Shala (ministër i Brendshëm), Kasëm Qafëzezi (ministër i Luftës), Qazim Koculi (ministër i Punëve Botrore), Luigj Gurakuqi (ministër i Financave), Stavro Vinjahu (ministër i Drejtësisë). Ministria e Arsimit iu la Bajram Currit, i cili ia la vendin e ministrit Niman Ferizit, por ky pasi u emërua prefekt në Berat në vend të tij u caktua Dr. Fahri Gjilani; ndërsa Xhemal Bushati u emërua ministër pa portofol¹⁷. Pra, një çereku i qeverisë ose 25 % e saj ishte ushtarakë.

Programi me njëzetë pika i qeverisë së Nolit për modernizimin dhe demokratizimin e Shqipërisë, përmbante: “Çarmatimin e përgjithshëm dhe pa përjashtim të popullsisë; rivendosjen e qetësisë, rregullit dhe pushtetit e ligjit; lartësimin e rolit të shtetit; “çrrënjosjen e feudalizmit, çlirim i popullit dhe vendosje definitive e demokracisë në Shqipëri”; reduktim të burokracisë, ulje e numrit të të punësuarve në administratën shtetërore, emërimin e tyre në bazë të aftësive, moralit e patriotizmit, sigurimi i të drejtave dhe detyrave të nëpunësit të shtetit nëpërmjet ligjit; organizim me kompetencë të komunave për të përmirësuar gjendjen e katundeve dhe të katundarëve; kursime në buxhet; ndryshim të sistemit të taksave, me synim që popullit të lehtësohet sa më shumë; lehtësira në hyrjen e kapitalit të huaj dhe mbrojtje e organizim të kapitalit të brendshëm; rritje të prestigjit të shtetit shqiptar në botën e jashtme; pavarësi të gjyqësorit dhe reforma radikale në legjislacion; organizim më të mirë të shëndetësisë dhe të arsimit; marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet, veçanërisht me fqinjët”¹⁸.

Programi i qeverisë së Nolit ngjalli shpresa tek populli, se Shqipëria do të shpëtonte nga gjendja e rëndë ekonomike dhe nga varfëria. Por programi ishte përtej fuqive reale të kësaj qeverie¹⁹.

Programi nolian ishte mjaft ambicioz, me të cilin “do të krenohej çdo demokrat perëndimor”, por i mungonin dy elementë thelbësorë përkrahja financiare dhe mbështetja e brendshme njerëzore. Kërkesa për ndihmë nga Lidhja e Kombeve²⁰ u refuzua ashtu sikurse ishte refuzuar edhe Zogut, por nga ana tjetër as nuk e njohën sepse kishte ardhur në pushtet në mënyrë jodemokratike. Edhe pse revolucioni solli në fuqi qeverinë më demokratike

¹⁷ Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, hartuar nga grup autorësh, Prizren, shtypshkronja “Sprint”, 2001, faqe 227.

¹⁸ Gazeta “Shqiptari i Amerikës”, publikuar në Korçë, Biblioteka Kombëtare, Nr: Shg 9/6G, Viti 1924, nr. 70 deri 140.

¹⁹ Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, hartuar nga grup autorësh, Prof. Dr. Hysni Myzyri redaktor përgjegjës Prizren, shtypshkronja “Sprint”, 2001, faqe 227.

²⁰ Kërkesa për ndihmë nga Lidhja e Kombeve shkonte në shumën 100 milionë frangash, me preteksin se Noli e kishte marrë pushtetin “në rrugë jo kushtetuese”, si dhe donte ta provonte se “qeveria mbështetej nga populli”. Rusia kishte përcaktuar Arkadi Krajevjeckin ambasador në Tiranë, dhe Noli do dërgonte në Moskë Kostantin Boshnjakun; por ditën që do paraqiste kredencialet ju kërkua të largohej nga Shqipëria ambasadori rus...”. Po aty, Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, 228-229.

në historinë e shtetit të pavarur shqiptar, problemet që trashëgonte vendi nuk mund të anashkaloheshin dhe nuk mund të kapërceheshin në një truall të “zëmtë ballkanik”

Qeveria nuk mundi të garantonte sigurinë kombëtare, sepse Jugosllavët provokonin me sulme zonën e Kelmendit, përfshi Vermoshin, ishin shtuar vrasjet, komunikimet ndërkrainore u ndërpre, përfshi edhe mos dërgimi i postës. Brenda ish-opozitës së vjetër filluan konflikte brenda grupimeve e grupeve të saj. Oficerët e grupit të Përmetit vendosën të bënin një puç për zëvendësimin e qeverisë së Nolit me një qeveri ushtarake por dështuan. Edhe po ta marrim me rezerva çfarë shkruante Sejfi Vllamasi ka probleme të mëdha në qeverisje. Qeveria e Nolit, që nuk kishte legjitimitetin e plotë nga pikëpamja e përfaqësimit, nuk mundi të sigurojë njohje të diplomacisë së kohës. Këtu mund të shtojmë edhe problemet që Nolit i hapi lidhja me Bolshevikët, duke e parë si “bolshevik” dhe si “komunist”, ndërkohë që Noli ishte i majtë por jo bolshevik, ishte i majtë, por jo komunist. Anglia, Franca, Italia dhe vendet e tjera të demokracive perëndimore nuk pranonin kontakt derisa në Shqipëri të zhvilloheshin zgjedhje që legjitimonin qeverinë me vullnetin e popullit. Ushtarakët e viteve '20-të synonin “shtet ligjor, rend e siguri...” Në kuadrin e sigurisë së brendshme dhe të jashtme të shtetit qeveria e Nolit mori masa për mobilizim nën armë të djelmohave shqiptarë Ministria e Luftës ndalonte daljen jashtë shtetit të djelmohave shqiptarë të datëlindjes 1899 deri 1905²¹. Kjo masë do të siguronte kontingjente të mjaftueshme, mobilizimit të ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm, një masë korrekte për kohën.

2. Ushtria dhe xhandarmëria, armë për sigurinë e brendshme dhe të jashtme të shtetit

Ngjarjet e viteve '20-të edhe shtypi shqiptar i kohës u ishte “qepur këmba-këmbës” ku vendin parësor pas çështjeve politike e zinin edhe çështjet e ushtrisë dhe xhandarmërisë. Noli ishte frymëzues i përplasjeve të ashpra dhe i pari që thërriti në kushtrim fshatarët e punëtorët për “të skuqur lumenjtë”²² dhe kjo nuk mund të bëhej veçse me revolucion me armë, ushtri, e xhandarmëri. Por nëse gjykojmë me mendje të ftohtë pas rreth një shekulli, zjarrin, në të vërtetë, nuk e kish nderur Fan Noli, po zemërimi i popullit të pakënaqur nga padrejtësitë e qeveritarëve Fan Noli u gjend përballë një misioni historik që kryesonte dhe të qeveriste, me qëllim që ta vinte Shqipërinë në rrugë të mbarë

²¹ Bazuar në shkresën që qeveria “Noli” Ministria e Mbrojtjes me nr. 2684 datë 4.7.1924, që ndalonte daljen jashtë vendit të djelmohave shqiptarë, BK, Fletore Zyrtare, Tiranë më 16 korrik 1924, nr.27, faqe 2.

²² Pikëpamjet e Nolit si frymëzues i përplasjeve të ashpra, shprehen tek “Anës lumenjve”: “...Dhe një zë vëngon nga lumi,/Më buçet më zgjon nga gjumi./Se mleti po gatitet./Se tirani lebetitet./Se pëlçet kërcet furtuna./Fryhet Vjosa./Derdhet Buna./Skuqet Semani dhe Drini./Ngruhuni dhe bjeruni./Korrini dhe shtypëni”.. Noli këtu poet dhe luftëtar. Fan Noli, Vepra, No.1, botuar nga Akademisë së Shkencave, Tiranë: Kombinati poligrafik, Shtypshkronja “8 Nëntori”, 1988, f 94-95.

të përparimit. Prandaj, pas masave të para administrative, Fan Noli i hyri punës për zbatimin e programit qeveritar, edhe pse ishte koshient se e prisnin një mal me detyra.²³ Këndvështrimi mbi situatën fillestare të kabinetit ishte se “Fan Noli... i dha frymë të vërtetë Lëvizjes Kombëtare dhe e ktheu si me magji opinionin e botës së huaj në favorin tonë. Shqipëri të kontrasteve nga më të larmishmet por mbi të gjitha të një prapambetje masive dhe mungese të arsimimit masiv, që do të vononte shumë edhe në qeveritë pasardhëse. Besimi popullor tek ushtria dhe Xhandarmëria më shumë si forcë policore ishte tek rikthimi i jetës dhe qetësisë publike.

Nënkolonel Ali Shefqeti e mori punën në dorë dhe bashkë me kryesekretarët e ministrive u formua një “qeveri e hëpërhëshme”, gjer sa të arrinte ushtria. Major Nazif Voshtina u emërua kumandar i xhandarmërisë në Tiranë.

Kush ishte në fakt struktura ushtarake dhe ajo e xhandarmës së vitit 1924?

Ushtria dhe xhandarmëria pati rol mjaft të rëndësishëm për misionin e rëndë që kishte përsipër për ruajtjen e tërësisë territoriale administrative si dhe për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në një kohë kur armiqësia dhe kontradiktat ishin mësuar të zgjidhej nën grykën e armëve. Reflektimi më i qartë ka qenë vetë programi qeverisës i Nolit që sigurisht fillon me “çarmatimin. Përgjithësisht Ushtria e kësaj periudhe ndoqi qëllime e interesa kombëtare. Megjithatë ngjarjet e zhvilluara në vend treguan se politika dhe vendimet e saj ndikonte jo pak në veprimtarinë e përditshmërisë së Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë shqiptare. Këto ndikime çuan edhe në konfrontime ushtarake të armatosura të dhjetorit të vitit 1924 si dhe në pengimet e procesit të riorganizimit dhe të reformimit të Ushtrisë Shqiptare²⁴. Qeverisja “Noli” lidhet me shumë data, ngjarje që në thelb kanë “revolucionin”, luftën, mbijetesën, identitetin, sakrificim për një ideal zhvillimi dhe progresi. Profesor Kristo Frashëri shprehej: “Ta kushtëzosh revolucionin me gjakderdhjen nuk është e drejtë. Profesori me gjakderdhjen lidhte kryengritjen, revoltën, grushtin e shtetit, por jo revolucionin, si përmbysje cilësore të rendit të vjetër drejt një rendi të ri politik, ekonomik, shoqëror...”²⁵, “Qeveria e Nolit ishte një qeveri e dështuar në fushën e zbatimit të revolucionit”²⁶.

Fan Noli ka qenë nga ata njerëz që të vërtetën ta thoshte në sy²⁷. Dhe kjo ishte pjesë e reflektimit për produktin e “revolucionit progresist dhe praktikave

²³ Nasho Jorgaqi “Fan Noli, kryeministër i qeverisë demokratike, 1924”, gazeta Telegraf, Tiranë, 18.9.2018.

²⁴ Zaho Golemi, Zhvillimet ushtarake shqiptare të fillimshkullit të kaluar, Revista Mbrojtja, nr.03/2008.

²⁵ Profesor Kristo Frashëri, Gazeta “Telegraf”, Qeveria Noli dhe roli i saj historik, Tiranë, 25.06.2014.

²⁶ Po aty, nga profesor Kristo Frashëri, 25 qershor 2014.

²⁷ Në vjershën e Nolit të shkruar më 1926 në Berlin ishte interesant dedikimi krahnor për gjithë hapësirën shqiptare: “Ore të gjorë harruam Vlorën./Se kjo punë lahet me gjak,/Dy shirit e një medalje,/Kësaj pune i vënë kapak”.

jo legale të dhunës për pushtet”, midis “tendencës moderne, liberale e demokratike dhe të kritikës për keqpërdorim të nocioneve demokratike”²⁸. Studiuesit janë të ndarë kur vlerësojnë “revolucionin”²⁹ / “kundërrevolucionin”, apo grusht shteti³⁰, edhe pse “shëronjës është vetëm koha”³¹. Më 1 korrik 1924, Noli ngeli për shqiptarët edhe me funksionet legjislative, ekzekutive dhe të Kryetarit të shtetit (Regjencës), ligjet propozoheshin nga Noli, dekretoheshin nga Noli dhe zbatoheshin nga Noli. Ndërkohë që për nga kapaciteti Prof. P. Xhufi e quan Nolin si “rilindasin e fundit”³². Nëse i referohemi Faik Konicës, ai thotë: “Gjykatorkja politike, që ka gjykatës disa njerëz me karakter, të kish patur për detyrë të zbulojë e të dënojë ata që për 4 vjet e shpunë Shqipërinë në buzë të varrit. gjykatores Politike i vunë për barrë të kërkojë “shkaktarët e vëllavrasjes”³³. Faktikisht vrasja e amerikanëve ishte një “mollë sherri” ndërmjet palëve³⁴. Nolianët si mërgimtarë nga vendi u vendosën në hotel “International”, në Brindisi. Këtu u bë edhe akti i fundit politik i Fan Nolit, ku ndërkohë që komunikonte me Luigj Gurakuqin fliste dhe për ushtarakët e xhandarët që e shoqëronin: “Gurakuq, ne kemi bërë shumë gabime... Me gjithë të metat e tij, pati guximin e me plot sinqeritet pranoi gabimin e bërë”³⁵.

²⁸ Noli apo Zogu Revolucion i debatueshem i vitit 1924 në Shqipëri, Publikuar nga portali shqiptar, “Shqiperia.com”, viti 2014. <https://www.shqiperia.com/Noli-apo-Zogu-Revolucion-i-debatueshem-i-vitit-1924-ne-Shqiperi.25660/>.

²⁹ Revolucioni (lat. revolutio - rikthim, kthesë, rrotullim, përmbyse) në sociologji, është një ndryshim rënësor i dhunshëm ose paqësor i jetës politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore të një vendi, kombi. Historianët që argumentojnë revolucionin janë Kristo Frashëri, Nasho Jorgaqi, Vehbi Bala, Arben Puto, Pëllumb Xhufi, Hamit Kaba, Shyqyri Hysi, Paskal Milo, Ksenofon Kristafi, Fatos Tarifa, Proletar Hasani, Shahin Leka, Dorian Koçi, B. Zotaj, M. Kasmi, etj.

³⁰ Grusht shteti ose puçi (gjer. Putsch-puç; fra. coup d'état-ku de ta; ose vetëm fra. Coup-ku) është emërtim për shkarkimin antikushtetues dhe të paligjshëm të autoriteteve qeveritare në një shtet, e që ndryshon nga revolucioni me atë se kryhet nga një pjesë e ekzekutivit, ose një organ shtetëror, zakonisht ushtria, xhandarmëria, policia dhe jo qytetarët e thjeshtë. Historianët që argumentojnë “grushtin e shtetit” nga ana e Nolit janë Teki Selenica, Eqrem Bej Vlora, Abaz Ermenji etj.

³¹ Sipas Veli Harshovës: “Koha ikën, dhe duke shkuar ndryshon, ribën dhe shkel ç’do gjë me çapin e saj të pavdekshëm”, publikuar në gazetën “Drita”, edhe pse sipas Profesor Shyqyri Hysi në Shqipëri në vitet ’20-të, publikoheshin edhe “Koha”, “Shkumbini”, “Gazeta e Korçës”, “Taraboshi”, “Dielli”, “Omonia”, “Fjala e Lirë”, “Besa Shqiptare”, “Shqiptari i Amerikës” etj.; Shyqyri Hysi, Gazeta Telegraf, Qëndrimi i gazetës “Drita” të Gjirokastrës për zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri në mars-prill 1921, Tiranë, më 23.4.1991.

³² Profesor Pëllumb Xhufi bazohet në veprën e tij poliedrike sepse historia e kishte përcaktuar ardhmërinë noliene, elitarit të kulturës shqiptare: “Fan Noli (6.1.1882-13.3.1965) ishte shkrimtar, studiues, diplomat, politikan, historian, orator, themeluesi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare”, ndër të rrallët shqiptarë që i shërbeu shqiptarëve në kaq shumë fusha.

³³ Kështu gjyqi për amerikanët që u vranë në Mamurras, mori fund dhe prokurori Ibrahim Dede, kërkoj të deklarohen fajtorë për krim Ahmet Zogu, Vesel Idrizi, Cul Sul Cana, Hasan Veli Keçi, Ali Qinami, Xhafer Taga. Sipas kryetari i Federatës “Vatra” Faik Konica, në një shënim botuar në “Dielli”, nr.304, publikuar më 9 shtator 1924.

³⁴ Kur gjyqi i amerikanëve që u vranë në Mamurras, mori fund, Prokurori kërkoj të deklarohen fajtorë për krim Ahmet Zogu, Vesel Idrizi, Cul Sul Cana, Hasan Veli Keçi, Ali Qinami dhe Xhafer Taga. Të njëjtën gjë bënë edhe grupimi tjetër kur erdhi në pushtet. Sipas gazetave “Besa Shqiptare”, “Shqiptari i Amerikës”, “Drita” etj.

³⁵ Sipas Vllamasi: “Noli rrojti mustaqet dhe mjekrën e tij madhështore, duke thënë: “Këtë borxh që ia pata Shqipërisë, po ia laj dhe nuk ia vlen barra qiranë për përpjekjet për një popull njëmilionësh...”. Sejfi Vllamasi, Ballafaqimet politike në Shqipëri (1897-1942), Tiranë, “Neraida”, 2000, faqe 391.

Noli e vuajti pasojën e “rënies” nga pushteti deri në fund të jetës së tij³⁶, pasi ai kurrë nuk mundi të kthehej në atdhe, edhe pse pas revolucionit jetoi edhe dyzet vite të tjera.

Ushtarakët dhe xhandarët shqiptarë në gjashtë muaj të qeverisjes së Nolit.

Ushtria dhe Xhandarmëria në vitet '20-të luajti një rol të rëndësishëm në funksionalitetin e shtetit, por në veçanti xhandarmëria me rolin e saj mjaft të ndjeshme për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike në Shqipëri, që në një farë mënyre luajti rolin e policimit në vend. Kështu xhandarmëria³⁷ pati një sërë personalitetesh të spikatur me integritet dhe personalitet, të arsimuar në lindje dhe në perëndim dhe që kishin një eksperiencë të konsiderueshme në drejtim, pavarësisht se shumica ishin me arsimim nga ish-Perandoria Osmane dhe një pakicë e arsimuar në Europë.

Me mosrealizimin e programit dhe qëllimeve ishte vetë Noli që po përgatiste “rikthimin e Zogut në pushtet”, por dhe me ndihmën e Beogradit dhe fuqive europiane që “Shqipëria të mos bëhej një vatër tensioni e bolshevizmit në Ballkan”.

Por qeveria e Nolit në njëzetë pika programi, do t'i duhej të realizonte 19 pika të rëndësishme për të ardhur tek pika e njëzetë, që ishin zgjedhjet e lira demokratike Edhe të besuar të drejtpërdrejtë dhe personalitete të kohës si Bajram Curri, Elez Isufi, Aqif Pashë Elbasani, Luigj Gurakuqi etj., që kërkonin monarki kushtetuese në vend të republikës po punonin për të penguar punën e programit. Këshilli i Lartë i Shtetit i detyruar nga kjo situatë, me kërkesë të Nolit nënshkroi një dekret për zgjedhjet e reja që duhet të mbaheshin nga 20 dhjetori deri më 20.1.1925. Ky kishte ngelur opsioni i vetëm midis dorëheqjes dhe zgjedhjeve³⁸. Më 13.12.1924, dy anëtar të Këshillit të Naltë që ishin jashtë vendit, Dr. Refik Toptani dhe Xhaferr Ypi, autorizuan Iljaz Vrionin, si Kryeministër legjitim, të organizonin operacionin e rikthimit të qeverisë legale në Tiranë. Në skenë dalin përsëri “bota e fuqisë ushtarake”. Gjithë përgatitjet për rrëzimin e qeverisë u bënë në Jugosllavi, duke “mos shpërdoruar mikpritjen”. Në Jugosllavi u organizua forca ushtarake dhe në Beograd Zogu bisedoi me mbretin Aleksandër dhe kryeministrin Pashiç si dhe vuri në dijeni ambasadorët e Anglisë, Francës e Italisë. Një dorë ushtarake për

³⁶ Fan Noli u shua më 13 mars 1965 në Fort Laurderdale, Florida të SHBA; sipas Nasho Jorgaqi, “Fan S.Noli. Jeta”. Shtëpia Botuese OMBRA GVG, Tiranë, 2005.

³⁷ Gjatë periudhës 1920-1924 Komandën e Përgjithëshme të Xhandarmërisë e drejtuan: nga 1913-janar 1914: Toger Meleq Frashëri, (që u vra në luftimet e marsit 1922 në Tiranë), nga maji- dhjetor 1920 major Mustafa Aranitasi; nga dhjetori 1920 - janar 1922 nënkolonel Ali Fehmi Kosturi; nga janari - mars 1922 major Meleq Frashëri; prill - gusht 1922 major Banush Hamdi; shtator 1922 - mars 1924 major Shefqet Korça; prill- qershor 1924; major Banush Hamdi; qershor - dhjetor 1924 major Aqif Përmeti. Historia e Ushtrisë Shqiptare (organizimi) Pjesa e parë (1912-1944), ShBU, Tiranë, 2000, faqe 165.

³⁸ Valentina Duka, Historia e Shqipërisë, 1912-2000, Tiranë, shblu, 2007, faqe 155.

kundërrevolucionarët ishin edhe 40 oficerët dhe 800 ushtarët të ushtrisë së bardhë ruse të gjeneral Vrangelit të marrë me pagesë, të cilët pas revolucionit të tetorit në Rusi më 1917 kishin emigruar në Jugosllavi³⁹. Zogu ishte përgatitur për gjashtë muaj për kthim me ushtri. Ushtria e tij përbëhej nga njëmijë trupa të rregullta të ushtrisë jugosllave, 1000 rezervistë rekrutë të rekrutuar nga krahinat jugosllave të banuara nga shqiptarë të veshur me kostumet karakteristike të vendlindjes, si dhe 500 matjanë, të cilët ishin larguar nga Shqipëria së bashku më të. Zogu pati mbështetjen e Greqisë, ku kishte vendosur disa prej kolonave të tij ushtarake⁴⁰. Zogu si komandant i përgjithshëm i operacionit dhe shpura politike afër tij, u angazhuan për të ndërgjegjësuar të gjithë faktorët influentë diplomatikë⁴¹ për këto hapa legjitimë, “të marrjes së pushtetit që jua kishin marrë”. Trupat pas një përgatitje të kujdesshme dhe të mirë organizuar, hynë nga disa drejtime në Shqipëri. Fan Noli më 18.12.1924 kërkoi nga qeveritë angleze, franceze, italiane dhe nga Lidhja e Kombeve që të ndërhynin, por ato nuk iu përgjigjën. Ministri i Mbrojtjes Kasëm Qafëzezi, nuk gjendej në detyrë dhe trupat ushtarake qeveritare ishin të çorganizuara, forcave të Zogut iu dha mundësi të përparonin me shpejtësi. Në këto rrethana, ku Qeveria e Nolit nuk bëri ndonjë reagim, forcat e Zogut hynë në Tiranë më 24.12.1924 duke i rikthyer legjitimitetin qeverisë së Iljaz Vrionit të dalë nga zgjedhjet e 27 dhjetorit 1923. Kjo datë ka hyrë në histori dhe është “pagëzuar” si dita e “Triumfit të Legalitetit”.

Analiza e faktorit ushtarak fokusohet në atë se një nga faktorët themeltarë të dështimit të Nolit ishte se komandantët e ushtrisë nuk iu bindën urdhrave, si pamundësi të mbajtjes së pushtetit të tij, por dhe nuk e dëshironin luftë vëllavrasëse për pushtet.

Në përfundim të kësaj çështjeje mund të themi se, 24 dhjetori 1924 shënoi fundin e “qeverisë Noli” dhe të grupimit të ushtarakëve e xhandarëve me të cilën kreu revolucionin për demokratizim të Shqipërisë. Tirana dhe gjithë vendi përjetuan “triumfin e legalitetit”, (edhe këta me anën e ushtarakëve dhe xhandarëve), ku Ahmet Zogu me atributet e ish-ministrit të Brendshëm dhe Komandant i Përgjithshëm të Operacionit morën masa të menjëhershme për rend e qetësi përmes një “gjendje të jashtëzakonshme”⁴². Ushtarakët u mbajtën larg politikës me ligj, ku u “eliminua roli i ushtarakut në politikë”. Riorganizimi i Fuqive të Armatosura, sjellja e specialistëve të huaj për organizimin e një

³⁹ Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, grup autorësh, Prizren, shtypshkronja “Sprint”, 2001, faqe 230.

⁴⁰ Po aty faqe 156.

⁴¹ Po aty, faqe 157.

⁴² Ndërkohë që zhvillimet ishin të vullshme sepse më 21 janar 1925 Shqipëria u shpall Republikë dhe më 31.1.1925 Zogu u shpall presidenti i parë i saj, që u shoqërua edhe me më shumë kompetenca si komandant i përgjithshëm i Operacionit. Bernd J. Fisher, “Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë: SHB “Çabej”, 1996, faqe 89.

xhandarmerie të fortë, futja e elementëve të milicisë, emërime⁴³ dhe gradime të reja⁴⁴, u morën në konsideratë projektet e ish-Ministrit të Luftës Ismail Haki Tatzati dhe austriaku Gustav Fon Myrdac⁴⁵. U përgatit organika e re me 113 oficerë (Grupi “A”) me grada të ndryshme në dispozicion të Fuqive Armate⁴⁶, grupi “B” që u nxorën në pension, dhe një grupim tjetër (Grupi “C” me 139 oficerë), të cilët ishin larguar së bashku me qeverinë e Fan Nolit⁴⁷. Fakt është që u morën përsëri në shërbim aktiv ushtarak disa oficerë në pension, por edhe ata që u kthyen nga jashtë pas amnistisë së përgjithshme. Nëse perifrazojmë Konicën për situatën e 1924, ai thoshte se “...nuk bëhet shtëpi e re me qereste të vjetër”. Megjithatë stabiliteti në vend qoftë edhe me prezencën e 18 përfaqësive të huaja⁴⁸ në vend përsëri shteti dhe funksionaliteti ngeli i krejtësisht i brishtë, sepse më 1924-ën nuk u ndeshën Noli me Zogun, por dy botë të kundërta demokracia dhe feudalizmi si dhe triumfi i së resë kërkon kushtet konkrete të zhvillimit dhe progresit shoqëror.

Përfundime

1. Parimi i përdorimit të forcës ushtarake e policore/xhandarmërisë më 1924 shkonte përtej sigurisë së brendshme dhe të jashtme të mbrojtjes së shtetit, ndërkohë që në fakt përdorej për mbrojtjen e pushtetit nga rrëmbimi i pushtetit e në këtë rast pushtimi i kryeqytetit. Noli me strukturat ushtarake dhe të xhandarmërisë në dispozicion nuk mundi të realizonte sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm të Shqipërisë.

2. Mosplotësimi i objektivave politikë çoi në shkatërrimin e karrierës së më shumë se 300 ushtarakëve (139 oficerëve), që ishin në poste drejtuese në Ministrinë e Luftës, në Ministrinë e Brendshme, në Shtabin Madhor të

⁴³ Komandant i Përgjithshëm i Fuqive Armate u caktua Major Xhemal Aranitasi (AQSH, f. Kryeministria, D. II-137, dt. 7.1.1925, f.1) kolonel G. Murdac si kryetar i Shtabit Madhor dhe organizator i Ushtrisë shqiptare që nga viti 1922.

⁴⁴ Gradimet u bënë për 34 oficerë madhorë: Major Gilardi, Major Xhemal Aranitasi, Kapiten i klasit I Preng Previzi, toger Muharrem Bajraktari, drejtori i shkollave ushtarake major Qamil Elbasani. AQSH, Kryeministria, D.II-137, dt. 7.1.1925, f.1.

⁴⁵ Në radhët e ushtrisë ndodheshin 108 oficerë aktivë, 2 nënkolonelë, 13 majorë, 15 kapitenë, 30 togerë e nëntogerë dhe 48 aspirantë; AQSH, fondi dokumentar: Kryeministria, D. II-137, dt. 7.1.1925.

⁴⁶ Grupi “A” me 113 oficerë përbëhej: 2 kolonelë, 3 n/kol, 8 majorë, 5 kapitenë kl.I, 8 kapitenë kl.II, 26 togerë, 34 nëntogerë, 27 aspirantë. U nxorën në pension: 1 nënkol (Ali Shefqet Shkupi), 5 majorë, 4 kapitenë KII, e kl.II, 1 toger, 1 nëntoger.

⁴⁷ Ndërtimi i një strukture të re ushtarake shqiptare vetëm disa ditë pas largimit të qeverisë “Fan Noli”, parashikoi një organikë me 144 oficerë, 152 nënoficerë, 2000 ushtarë dhe 164 kuaj, edhe pse në fakt ishte një barrë e rëndë për buxhetin e vogël financiar të Shqipërisë. Edhe pse në fakt kur nisi zbatimin u reduktua nga 18 kompani instruksioni në 9-të, si dhe 3 kompani mitraliere dhe 2 bateri artilerie (DPAQSH, f. “Kryeministria”, D II-137, viti 1925, faqe 134). Teki Selenica, Shqipëria në vitin 1937, Tiranë, 1938, faqe 99.

⁴⁸ Nga fondet arkivore të Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme: Në Shqipëri kishte 7 konsullata të Japonisë, Suedisë, Italisë, Hollandës, SHBA-së, Rumanisë dhe Greqisë; në Durrës 6 konsullata e Britanisë, Belgjikës, Rumanisë, Norvegjisë, Italisë dhe Francës; në Shkodër tre konsullata, në Vlorë 5 konsullata, në Gjirokastrë një dhe në Sarandë dy konsullata.

Ushtrisë, drejtues të Xhandarmërisë, që ishte një dëm i pariparueshëm për mungesë të kuadrit arsimor ushtarak brenda vendit, u shkatërrua një aset i periudhës së Ismail Qemalit, u keqpërdor nga politika për interesa të tyre dhe të idealizmit në të cilin besuan.

3. Aleks Buda, duke iu referuar vetë Nolit në parathënien për veprën e Fan Nolit thotë: *“kemi vrarë veten me dorën tonë”*⁴⁹, që në fakt ishte analiza noliiane e mëvonshme e situatës së vitit 1924 në Shqipëri dhe kjo erdhi pas vetëqortimit dhe çlirimit nga një varg iluzionesh dhe “qorrsokakët”, ndërkohë që Noli ka bërë autokritikë për disa veprime të kohës së tij. Edhe pse dështoi, Fan Noli nuk “i hodhi armët” dhe nuk e pati për “turp” dështimin, edhe pse ai shkëlqeu me veprën që u la shqiptarëve trashëgimi, megjithatë ai dështoi “në modelin e ri të krijimit të shtetit”. Me veprën si historian, thotë Profesor P. Xhufi, mund të themi se bën me turp edhe ndonjë historian “të rëndë”⁵⁰.

4. Trashëgimia ushtarake e forcave ushtarake të viteve 20-të pothuaj ishte ajo që mbledhi rreth vetes periudha e pavarësisë, si një trashëgimi nga ushtria osmane, por me aspirata për vendin e tyre, për kontribut për truallin e të parëve, edhe pse ushtria hezitohet të ngrihet u vu në dilemën e ekzistencës si dhe u “shkurtua për mungesë fondesh”, që ishin lojëra të rrezikshme dhe vinin në rrezik vetë ekzistencën e shtetit shqiptar⁵¹.

5. Programi i qeverisë “Noli” përmbante në vetvete esencën e mendimit të përbashkët të intelektualëve demokratë, të diplomuar në universitetet më në zë të Evropës Perëndimore dhe SHBA, por edhe ushtarakëve progresistë e profesionistë shtatmadhorie të përgatitur në shkollat dhe akademitë më prestigjioze të kohës. Mes figurave civile dhe ushtarake spikaste figura e 42-vjeçarit Fan Noli si më e kompletuara. Historia e kombeve njih shumë figura poliedrike të oxhaqeve të mëdha, të fisnikërive, me gjak e eshtra të ngjizura në memorien e kombeve, me popuj që kanë siguruar mbijetesën etj, por njih edhe shqiptarin që shkëlqeu në shumë drejtime dhe në bashkëpunim me ushtarakët, por nuk ishte një “rodhe” e pushtetit. Noli nuk mundi të realizojë programin në fushën e rendit e qetësisë, sepse qeveria nuk bëri çarmatimin e përgjithshëm të popullsisë, nuk dënoi shkaktarët e vëllavrasjes dhe as të godiste ata krerë që përdornin forcën, nuk vendosni drejtësi me organet e drejtësisë për vendosjen e shtetit ligjor si dhe shkaqe të tjera.

⁴⁹ Fan Noli, Vepra (seria e veprës), No.1, botuar nën kujdesin e Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1988, faqe 16.

⁵⁰ Veçanërisht kur flasim për “Historinë e Skënderbeut”, të vitit 1921 dhe të ripunuar e botuar më 1947 në atë masë sa që Aleks Buda e quante “Fan S. Noli - historian i Skënderbeut”. Noli, Fan. Vepra (seria)No. 4, Akademia e Shkencave, Tiranë: Kombinati poligrafik, Shtypshkronja “8 Nëntori” 1989, faqe 21.

⁵¹ “Hezitimi dhe kundërshtimi qëndronte në argumentin që vendi ishte i varfër dhe populli do të rëndohej nga shpenzimet për mbajtjen e tyre.”.AQSH, Fondi Parlamenti Shqiptar, (Bisedimet në Këshillin Kombëtar); Dosja 42, viti 1920, faqe151.

6. Lëvizja/revolucionari/kryengritja ushtarake e qershorit 1924, e udhëhequr nga elementë demokratikë e përparimtarë, ishte për shqiptarët një “shkollë politike dhe ushtarake”⁵², që vërtetoi mësimet të çmuara historike se nuk mund të luftohet me të njëjtat armë si me armikun e brendshëm edhe me armikun e jashtëm, dhe se bashkimi me armikun për marrjen e pushtetit është dhe mbetet definicioni i gabuar. Noli nuk mundi të sigurojë armët e duhura për të mbrojtur “revolucionin” dhe krijuar siguri.

Bibliografia:

1. AQSH, Fondi dok. 160, Komanda Ushtarake, Dosja II-15/2, Viti 1920, Faqe 104; Fondi Parlamenti Shqiptar, (Bisedimet në Këshillin Kombëtar); Dosja 42, viti 1920, faqe 151; Fondi Kryeministria, D. II-137, dt.7.1.1925, faqe 1.; Fondi Jashar Erëbara, nr. 23, Dosja nr.28, faqe 125.; Fondi: Parlamenti shqiptar, (Diskutimi i Hil Mosit), Viti 1920, Dosja 42, faqe 48.; Fondi “Bajram Curri”, nr. 418, dosja nr. 8/1, faqe 320-321.; Fondi dokumentar nr. 846, dosja nr. 48, faqe 9; Kryeministria, D II-137, viti 1925, faqe 134).
2. Noli, Fan. Vepra (seria)No.1,4, Akademia e Shkencave, Tiranë: Kombinati poligrafik, Shtypshkronja “8 Nëntori” 1988.
3. Biblioteka Kombëtare, Tiranë, Gazeta zyrtare nr.288 datë 16.12.1924, si dhe gjithë gazetat zyrtare të 06 - 12/1924.
4. Buletini Arkivor Ushtarak, AQFA, Tiranë, “Gentgrafik”, Mars (01/03) dhe Qershor (02/06) 2009.
5. Duka, Valentina. Historia e Shqipërisë, 1912-2000, Tiranë, shblu, 2007.
6. Fisher, Bernd J. “Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë: SHB “Çabej”, 1996.
7. Gazeta “Shqiptari i Amerikës” (Shg75/6G), “Kabineti i Ri”, no.110, e shtunë 21.6;15.7.1924, no.109...
8. Gazeta “Shqiptari i Amerikës”, publikuar në Korçë, Biblioteka Kombëtare, Nr.: Shg 9/6G, Viti 1924, nr. 70 deri 140.
9. Golemi Zaho, Historia e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe ushtarakëve madhorë”, Gazeta “Ushtria”, nëntor 2012.
10. Golemi, Zaho, Zhvillimet ushtarake shqiptare të fillim shekullit të kaluar, Revista Mbrojtja, Nr.03/2008.
11. Hasani, Proletar, Me fytyrë nga Perëndimi, Tiranë: Uegen, 2013.

⁵² Noli punoi fuqishëm dhe me energji të pashtershme pothuaj gjashtë dekada. Bazamentin e Statujës e hodhi vetë Shtatoren ju takon shqiptarëve ta ngrenë, për atë çka bëri për Shqipërinë e shqiptarët dhe mbi të gjitha eshtrat e tij meritojnë të prehen në Shqipëri. Z. Golemi, Zhvillimet ushtarake shqiptare të fillim shekullit XX, Rev.Mbrojtja, Nr.03/2008.

12. Historia e popullit shqiptar, (në katër vëllime), Vëllimi III, Tiranë: Toena, 2007.
13. Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, hartuar nga grup autorësh, Prizren, shtypshkronja “Sprint”, 2001.
14. Historia e Ushtrisë shqiptare, (Organizimi) pjesa e parë vitet 1912-1944, Shtëpia botuese e ushtrisë, Tiranë, 2000.
15. Jorgaqi, Nasho, Fan S.Noli. Jeta. Shtëpia Botuese OMBRA GVG. Tiranë, 2005. Jorgaqi, Nasho, Udhëtim me Fan Nolin, Tiranë 1994.; Jorgaqi, Nasho. Fan S.Noli, Letërkëmbimi i Fan Nolit, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë, 2012.
16. Karl von Klauzeviç, “Mbi Luftën” vëllimi. I-rë, Tiranë: SHBU, 1994.
17. Ligje, dekretligje e rregullore të vjetit 1925, Përmbledhje, Tiranë, 1938.
18. Lushaku, Hilë. Ministrat e Brendshëm 1912-2007, Vëllimi I, Tiranë: “Qendra për shtyp Chanimade”, 2009, faqe 297.
19. Michel de Weger, Res Militares, Volume.I, nr.2, Paris, 2011.
20. Montgomery, Bernard. “Fushëbeteja” (kujtime), Tiranë, 1994.
21. Proklamata drejtuar Popullit shqiptar (marrë sipas shtypit të ditës); Gazetat e shtypit në Shqipëri, janar 1925.
22. Puto, Arben. Demokracia e rrethuar, Tiranë 1990.
23. Qarkore nr.475 datë 27.12.1924, Fletore Zyrtare nr.1. datë 8 janar 1925.
24. Selenica, Teki. Shqipëria në vitin 1927, Tiranë, 1928, faqe 35.; Selenica, Teki. Shqipëria në vitin 1937, Tiranë, 1938.
25. Seria e publikimeve të periodikut të “Policimi dhe Siguria”, botim i QKSH-së në Akademinë e Sigurisë.
26. Seria e publikimeve të periodikut të “Revista Ushtarake”, botim i Komandës së Doktrinës në AFA.
27. Spahiu, Avni. Noli, jeta në Amerikë, Tiranë, 2007.
28. Shtylla, Behar. Fan Noli, siç e kam njohur. Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë, 1997.
29. Urdhri Mr.2 IV datë 6 janar 1925, Mbi formimin e Kabinetit, sipas Fletore Zyrtare, nr.1. datë 8 janar 1925.
30. Vendim nr. 355 i Asamblesë Kushtetuese, 2.2.1925. Fletore zyrtare nr.2., Tiranë, viti 1925.
31. Vllamasi, Sejfi. Ballafaqimet politike në Shqipëri (1897-1942): kujtime dhe vlerësime historike, Sh.B “Neraida”, 2000.

ABSTRACTS IN ENGLISH

“REVISTA USHTARAKE”, NR.1, MARCH, 2022

NATO 2022-2030 strategic vision scenarios, in the face of new threats (3R + 3V)

Msc. Colonel Hysni Gjergji

Head of Group at MSRI, AFA

Abstract

Up to 2013, NATO had defined the threats it would face, symbolizing them in 3R and meaning "Russia, Radicalism and Refugees." The year 2021 and the beginning of 2022 began with a frightening increase in the "R" threat from Russia, which on February 24 attacks a sovereign country such as Ukraine. The madness of a crazy system is being put into operation by a man unfortunately equipped with nuclear weapons and thankfully condemned by the entire democratic world without exception.

Threats identified and present in the world since 2019 turn out to be three more 3V viruses, such as: 1) Virus as a threat in cyberspace and artificial intelligence as part of it. 2) Covid-19 virus as the most dangerous biological threat to human life and 3) Electromagnetic waves that damage the central mental system and create other consequences on human health.

The first two "viral" threats have been identified as unconventional global borders. The first (V) appeared cyber virus which is invading cyberspace hitting the economy, technology, communication, defense, social life etc. In recent years, many NATO member and non-member states have recognized and accepted cyberspace as the 5th domain of the war on land, sea, air and space. Finally, in February 2022 in Ukraine, there were identified a host of Russian cyber attacks, targeting the banking system and the Ministry of Defense in Kiev as a prelude to the expected military attacks. The second threat (V) appeared in late 2019 and continues to take and threaten the lives of people around the world. This is the virus is COVID-19. Linguistically, the term "cyber virus" means "sick" and "dying" communication along with the economy, finance, defense, technology, production and every aspect of the material and social world. Similarly, biological (V) viruses are those that infect, threaten, and take the lives of humans and animals. These biological viruses inject their own code, as in the case of Covid 19, DNA or RNA into

a host cell of ours, as a means of reproduction. This code of conduct works similarly to cyber "V", which causes cell multiplication in many copies of the virus and eventually explodes to send new viruses everywhere to other cells in computers, databases, automation systems, etc.

The third threat (V) that has emerged, is that through the use of electromagnetic wave. This war is mainly of an unconventional nature and has begun to develop between the superpowers, mainly between the US and Russia. Microwave radiation attacks have begun in Cuba. The US embassy and CIA agents in Havana were targeted after the resumption of diplomatic relations between the "Obama" government and the Cuban government. Electromagnetic wave attacks cause various consequences, the most important: headaches, insomnia and memory loss. The first and most dramatic fact of this particular attack came in 2017, when some US diplomats, agents and officials of the US Embassy in Cuba reported hearing strange sounds, accompanied by a pile of fluid weakness known since then as "Havana Syndrome." It was accompanied by pressure to the head, fatigue, blurred vision, forgetfulness, anxiety and depression. 5G network and Chinese technology Huawei is presented as proven threat coming from electromagnetic waves and their use for espionage purposes by the Chinese government.

Keywords: threat, cyber attack, virus, Balkans, region, Russia, Eastern Europe, stability, Ukraine, NATO.

Climate change - a threat to security and their impact on military operations

Msc. Colonel Irela Nebiaj

Head of Group at MSRI, AFA

Abstract

This study topic addresses the meaning of the term "security environment" and the military approach to environmental security concepts, with a particular focus on understanding the security threats posed by climate change. It briefly describes climate change, its relationship to the security environment, and the impact of climate change on AF operations. Climate change poses a non-traditional threat to security and modern civilization. In addition to the non-traditional threat, the impacts of climate change are a "multiplier of threats", which affect the increase of security problems. In this regard, climate change is a growing threat to overall peace and security

and, as such, will become an increasingly important issue for the Armed Forces as well. Given the fact that our region is bordered by some areas more vulnerable to climate change, environmental degradation, lack of resources and population growth, the phenomenon of migration, economic challenges and cross-border issues in the region, along with political instability, will make our security system more vulnerable than ever before.

These phenomena can also have effects on our country and our Armed Forces, in terms of participation in economic development programs, crisis management, as well as in the way it performs its mission. The Armed Forces can be called upon more frequently to support civilian authorities and to provide humanitarian assistance and relief from the most frequent and intense natural disasters. These impacts increase the frequency, scale, and complexity of future defense missions, requiring higher costs of maintaining military equipment and affecting the effectiveness of troops and equipment. But military activities can also affect the environment. It is clear that military operations during wartime can cause large-scale environmental damage. But armies also exist in times of peace, so daily military life can carry ecological risks, and the Armed Forces must make efforts for "more ecological" solutions.

The main issues that will be addressed in this paper are: climate change; the impacts of climate change on security and the FA; increasing the role of the FA; military operations and environment, training, education and environmental awareness in the Armed Forces; NATO and climate security and finally some conclusions and recommendations.

Keywords: climate change, environment, FA, NATO, peace, emergency, epidemic, natural disaster, etc.

The right to public information and national security

Brigadier General Msc. Editson Zarka

Director of the Directorate of General Inspection, MoD

Abstract

The democratic developments and the Euro-Atlantic integration of our country have been accompanied by a series of reforms and raising of standards also in terms of public information from the security and defense structures. The dilemma of what information can be given to the public and what cannot, remains a dividing line, which is regulated by special laws and

bylaws. The experience of other western countries of NATO and the EU is a compass of orientation for our country as well. This is a process which develops and consolidates day by day. The closed nature of the work of security structures has made it difficult for the public to penetrate to obtain the information it needs. Often the structures of these institutions use as a protective barrier special laws, which have emerged for the protection of information. The Ministry of Defense and the Armed Forces have increasingly increased their capacity to handle requests for information, managing the various requests and complaints that come to its address in traditional and contemporary forms and methods. The opening of special portals as well as the creation of a network of information coordinators, in accordance with the law, has enabled their timely management and the promotion of structures for the provision of accurate information, given the limitations. The process of digitalization and addressing future requests electronically, requires further professionalism of the heads of structures, units and commands, as well as staff that deal directly with this process.

Keywords: public information, national security, transparency, MoD, Armed Forces, human rights, NATO, EU.

Development trends of new technologies and challenges in the operational environment

Lieutenant Colonel (R) Msc. Kanan Himaj
Specialist at MSRI, AFA

Abstract

In a future, dynamic and operational environment, characterized by the external influences of various public and private entities, involved in scientific and technological development, research and development of advanced technologies, the evolution of the political-military and economic situation, modern armies have to plan and carry out operations in many areas with the right dimensions for protection and security, in order to adapt and restore order in this already chaotic operational environment. Under these conditions, the Armed Forces must turn potential challenges into opportunities through foresight, risk-taking and initiative.

Foresight by scanning the horizon without knowing and analyzing emerging trends, anticipating technological changes, followed by early experimentation with new technologies, will allow any modern army to overcome the costs of

innovation, project the forces for rapid integration of new technology and develop a new infrastructure supporting them, enabling them to conduct multi-directional operations.

Initiatives to explore relatively new military fields, such as cyberspace, or even to link military, industry, and education will provide insights into emerging technologies that can be integrated into military operations. In this way, the combined effort of areas of interest (forecasting, risk-taking, and initiative) brings additional knowledge that the Armed Forces must manage to ensure success in the future operational environment.

Keywords: operating environment, challenges, technology, hybrid threats.

Security challenges and increased cooperation between state and non-state actors in the Western Balkans region

Brigadier General (R) Msc. Muhamet Buçpapa

Specialist at MSRI, AFA

Abstract

The challenges of regional security and the increase of cooperation between state and non-state actors in the Western Balkans region is an issue as much addressed as it is burdened by the weight of the unknowns that come mainly as a result of dynamics and unforeseen developments brought by the security environment today, in a region where there are still disputes and unresolved issues and where the interests and influences of third actors are becoming more and more present. These actors intertwined with influence on each other with camouflaged, hybrid and asymmetrical performances and goals increasingly shape the security environment and all aspects of life in socio-political, economic, technological, cultural, sports, religious as well as developments even in the military aspects.

Today more than ever security challenges are diverse, complex, intertwined and interdependent and with tremendous and challenging global, regional and national impact, keeping the security environment under constant dynamic pressure. Analyzes, debates or discussions of this nature addressed to the Balkan region and the Western region in particular, should be seen and evaluated with an impact or logical connection and alternated by the influence of geopolitical actors, not only regional, but also beyond with global impact.

The micro-region of the Western Balkans is a new geopolitical notion created after the fall of the Berlin Wall and the disintegration of the former Yugoslavia. The Western Balkans comprises six countries: Albania, Kosovo, Northern Macedonia, Montenegro, Bosnia and Herzegovina, Serbia and Croatia, already a member of the European Union. The Western Balkans is the only region today not integrated into the European Union despite the different approaches and efforts on this journey, on the other hand, three of the countries in the region are already members of NATO, Kosovo is with the military presence in the North Atlantic Alliance for 21 years, while the other two have not advanced in this direction.

Keywords: security, region, Western Balkans, cooperation, EU, threat, geopolitics, etc.

NATO 2030, united for a new era

Colonel Emeror Hajdarasi

Head of Department at DSF, AFA

Abstract

The security environment outside NATO's space has changed dramatically since 2010, when the latest NATO Strategic Concept was published. This concept recommended the realization of a strategic partnership with Russia, mentioned terrorism, but did not mention China. Substantial changes have taken place in NATO's security environment since then, which are likely to intensify over the next decade and require greater efforts in both political cohesion and alignment with NATO strategy. .

Threats and dangers such as terrorism, security challenges posed by pandemics, climate change and migratory flows continue to pose a major challenge to the Alliance. Changing some elements in power instruments such as cyber and space capabilities will continue to change the nature of the conflict. However, the main feature of the current security environment is the resurgence of geopolitical competition, the escalation of aggressive rivalries and disputes over the expansion of territories, the possession of resources and natural resources.

In the next decade, technological developments will play an increasing role in the security environment, both in systematic competition and in increasing cross-border security threats. Since the founding of NATO, the West has

been at the forefront of research and development in critical innovations for stability and security. But China and Russia are now allocating significant resources in this area in an effort to overcome the West. New technologies will change the nature of warfare and enable new forms of attack using high-tech weapons and hybrid operations. The population in the Euro-Atlantic area must be protected from new threats such as cyber threats, but also from other forms of hybrid warfare. NATO-backed states must therefore take measures to prevent and defend themselves from these modern war threats, but the basic resistance must lie within the societies of the respective states.

This article will follow in the next issue of the Journal, which addresses issues such as: NATO's political purpose for the 21st century; NATO's ways of reacting in the next decade, as well as Strengthening its political cohesion and unity.

Keywords: NATO 2030, security environment, cohesion, cyber threat, Russia, alliance, hybrid war, China.

Gray Zone War Gerasimov Doctrine

Msc. Roland Tashi

AISM

Abstract

The end of the Cold War sparked a wide-ranging debate on the transformation of the war by asking questions, commenting, arguing about the factors and reasons that influenced this change. Despite the attitudes and views of scholars in describing and analyzing the conflicts of the last thirty years, almost everyone advocates the idea that modern warfare does not resemble the industrial conflicts of World War II. In modern warfare, information and the informational dimension have a very important role, modern warfare is not a "regular" war in which sovereign states fight by confronting the organized alignment of their armies.

Russian General Valery Gerasimov, in 2013 published an article in the Russian Military-Industrial Courier, attracting international attention. Gerasimov wrote that "The joint, simultaneous use of propaganda with actions to

overthrow the political and social order of a state, enables it to be paralyzed within months or even days, thus remaining a victim of foreign intervention, chaos and civil war."

Two concepts stand out from the debates and descriptions of modern warfare: the Hybrid War (HW) and the Gray Zone War (GZW). Both of these definitions have common features in relation to the treatment of war and peace, but they also have important differences between them. The main problem is that these concepts have been used to describe Russian strategy, in fact none of them is part of the official doctrine. Following the invasion of Crimea in 2014 and Moscow's intervention in Syria in 2015, a major public debate has erupted over "Russia's new approach to hybrid warfare and new types of military operations."

Keywords: hybrid war, cold war, Gerasimov doctrine, conflict, gray areas, kinetic operations, etc.

European Union and the Eschatology of War The Case of Ukraine

PhD Malvina Tema

Specialist, Ministry of Defence of the Republic of Albania

Abstract

The EU is committed towards the values of peace, democracy, rule of law and respect of human rights, but the success in promoting these values nowadays, more than ever, is at a historical crossroad. This article discusses the dynamics related to the EU complex roles in association with Ukrainian paths, based on the premises of security policies and integration perspectives.

This analytic endeavour seeks to shed light mainly on the dynamics of the European Union's foreign policy -in a context of international co-operation related to changing 'security needs conditions' and humanitarian policy implications, -while being implemented in the EU's neighbours and also more extensively. Ukraine constitutes the current dilemma which questions the international system puzzle -and the EU role, -which is dependent on projections designated from perspectives outside the Union. In fact, the EU calls for the development of peace through diplomacy enabled by sustainable

governance, but also hoping to avoid threats to economic parameters, through the adoption of various strategies, mainly based on conditionality and soft power. In this light, there is an aim to question the effectiveness and limitations of the EU as a promoter of peace, democracy and good governance, through the 'agendas' for partner countries (in the East), with 'soft instruments of power', embedded in a mechanism of military distress.

It is difficult to point and label strategies of the EU in the international arena but it should be stated that, under actual conditions, although humanitarian intervention has never been -an impeccable and perfectly clear strategy for the EU, -it is particularly important to recognize the fact that in world of today, this element has an important and continuous/increasing role. In addition to traditional actors, the 21st century embraces the shaping of stateless/non-state actors, civil wars and new destructive threats, while facing various 'humanitarian dilemmas'. In many of the most complex humanitarian crises in the world, there is an overlap of humanitarian priorities, in conjunction with 'broader foreign policy objectives'. Military means mixed with political and humanitarian actions include difficult calculations to be made/realized, in relation to (polarized) actors, some of whom (may) act intermittently with 'actions' -in principle humanitarian.

Today, the EU is truly committed towards the values of peace, democracy, rule of law and respect for human rights, but success in promoting these values, steps through interdependence and still remains at question. For this reason, this article will present an effort for a general assessment of the role of the European Union's foreign policy, in relation to a situation of challenges, associated with security concerns and humanitarian needs -outside the EU.

Group cohesion and leadership

Prof. Assoc. Dr. Edmond Braneshi
Lecturer on Military Leadership, AFA

Abstract

Cohesion is a very important element to understand unity within the group, how it affects its members in routine and dedicated activities to accomplish tasks with specific weight within the fulfillment of objectives or mission of the organization. The functioning of a group is based on the distribution and

configuration of several elements, such as roles, norms and group cohesion. All of these elements act as “glue” that turns ordinary people into a group. But groups require a common identity, a structure and interdependence. Based on these variables, we must say that group cohesion is different. In sociology, social cohesion refers to the union that exists between members of a group who share ideas and have a sense of belonging, which allows them to carry out a common project or goal. Cohesion can be "conceived" in a group, located in the hierarchy of a relevant structure in a particular military or civilian organization.

In this context, the purpose of this paper is to explain what cohesion is and how it relates to mutual trust between members and overall group performance. The focus will be on cohesion in the small structures of the Armed Forces or, in other words military cohesion, the characteristics of a cohesive group, the role of strong ties and the relationships between members inside and outside the group to maintain sustainable cohesion.

Keywords: cohesion, group / unit, organization, relationship, spiritual value, human element, moral factor, characteristics, structure, relationship, factor, need, success, mission.

Evaluation method for CRC staff, in times of peace, crisis and conflict

Lieutenant Colonel Msc. Eduart Pllaha

Chief of Staff at the Control-Reporting Center, Air Force

Abstract

The Air Force Control-Reporting Center (CRC) is in the process of being modernized by implementing two important projects: “SIVHA-Integrated Airspace Surveillance System” and Ground-Air-Ground Communication System (G-A-G). To keep the pace with the projects, in addition to better acquisition and exploration of systems, we must consider other elements that affect the effectiveness of tasks, such as: training and coaching of staff, working conditions in it which is served by CRC staff, etc.

These elements will be addressed in this paper through an "evaluation model" that describes and analyzes the factors that affect the effective in times of

peace, crisis and war. This model can be applied at any level of command and control and provides accurate results for measuring combat effectiveness in times of crisis, training and education. To prepare this paper we have relied on materials published by the NATO Research and Technology Organization and the Department of Air Defense of the University of Defense in Brno, Czech Republic, AIRCOM Joint Air Power Competence Center, as well as many years of work experience as a member of this center (CRC).

Keywords: Control-Reporting Center (CRC), combat effectiveness, combat readiness model, NATINAMIDS, TACEVAL, training, coaching, individual behavior.

The role of Albania-Soviet Union military agreements of 1957 - 1959 in the institutionalization of the Albanian People's Army

Dr. Eva Smaçi

Vice Dean of the Faculty of Defense and Security, AFA

Abstract

This paper aims to analyze the two agreements of Albania with the Warsaw Pact (WP) in the context of the time when they were signed, as well as the consequences that came from their signing. During the ecplixation, I tried to answer questions such as: were the agreements worth to national interests and how much did they serve the defense of the country? What did Albania gain in terms of a poor country in the field of defense, referring to the lists of military equipment to fuel supplies, clothing and food? Realistically, were the agreements violated by both parties? Why were those agreements (especially the one of 1959) considered as a point of contention of the conflict and instruments for the non-return exclusion of Albania from the Warsaw Pact, etc.?

The documents used by the Albanian archives and, in particular, those brought by the Central Archive of the Armed Forces (CAAF) bring to this paper a new overview, which we believe is of interest to objectively assess the role played by these agreements in the identification of the Vlora Base as the only Soviet base in the Mediterranean during the Cold War years.

Keywords: Military agreement, Soviet Union, Vlora naval base, Cold War, Albania, Eastern Europe, Pashaliman.

Fan Noli for the Albanian army and gendarmerie

Prof. Assoc. Dr. Zaho Golemi

Security Academy

Abstract

Albania in the 1920s is an inexhaustible object of study, especially in the field of security. If we refer to the work of Fan Noli, his contribution to the independence, history, culture and literature of Albania, in the establishment of the Albanian Autocephalous Church, as the great deportee of 1924, we cannot leave without mentioning the attempts for a state of law and with a clear vision for security and defense issues.

Noli's government and governance of 1924 was a brief piece of power in time for a free, democratic, equal, uncorrupted Albania, self-confident, ready to cooperate for an honest neighborhood that wants to defend the principles universal justice, to stop human greed, led by capable and trusted leaders who respected freedom of religion and religious diversity, an Albania for its citizens. Noli's government program contained the essence of the common thinking of Democratic intellectuals, graduates of the most prestigious universities in Western Europe and the United States, but also progressive military and senior professionals trained in the most prestigious schools and academies of the time.

Although Fan Noli failed, he did not "lay down his arms" and was not "ashamed" of the failure, even though he excelled with the works inherited to Albanians, but he failed "in the new model of state creation".

Keywords: Army, police, gendarmerie, uprising, revolution, triumph, failure, downfall.

KUJTESË PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është organ teoriko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura, në interes të FARSH. Misioni i saj është promovimi i vlerave kërkimore, i zhvillimeve të reja dhe i debatit shkencor në FA. Tematika e saj trajton çështje me karakter teoriko-shkencor e analitik, në ndihmë të veprimtarisë së FA-ve, duke ofruar zgjidhje për çështjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivel strategjik, operacional dhe taktik, në vend, rajon e më gjerë.

Ftojmë studentët/kursantët, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FARSH të bëhen pjesë e shkrimeve në RU.

Në vijim, po japim disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët e shkrimeve.

Struktura e artikullit

Titulli. Të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere dhe të jetë fjali emërore.

Autori, bashkautori. Poshtë titullit vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe funksionin aktual i tij/saj.

Trajtesa e shkurtuar (Abstrakti). është një përmbledhje e shkurtër e artikullit. Ai tregon se për çfarë bëhet fjalë në një artikull, metodat që janë përdorur, rezultatet që janë fituar dhe çfarë impakti ka ky artikull. Mund të

themi se abstrakti shërben si reklamë e artikullit. Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht. Poshtë tij, gjenden fjalët kyçe, pra, fjalët më me rëndësi në artikull. Trajtesa nuk zëvendëson hyrjen e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes me rreth 3-4 paragrafë të shkurtër.

Përmbajtja ose pjesa kryesore e artikullit. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje, në varësi të tematikës që shtron. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “**Hyrja**”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të FA. Shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 8-10 faqe kompjuterike.

Formati. Faqja duhet të jetë e formatit A4; lloji i shkrimit: “Times New Roman”; madhësia e shkrimit 12. Kryeradha (paragrafi i ri) përcaktohet me pt 6 (hapësira midis paragrafëve). Teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele çështjesh kryesore. Duhet të shmangen tekstet e theksuara (*bold*) apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët (*italic*) dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura.

Grafikët, tabelat dhe fotot duhet të jenë të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Nëse një foto ose grafik është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Referencat dhe bibliografia. Çdo shkrim duhet të paraqitet me referenca (*footnote*), si dhe me bibliografinë përkatëse, e cila paraqet literaturën e shfrytëzuar. *Referencat* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare. Në to duhet të përfshihen: mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN/ISSN, *website-in* ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Shënim!

1. Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatohet rregullat e klasifikimit të informacionit.
2. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimet e as qëndrimet politike apo partiake.
3. Artikulli duhet të dërgohet i printuar, në adresën elektronike dhe/ose me CD.
4. Vlerësimi dhe miratimi i shkrimeve për botim në Revistën Ushtarake bëhet vetëm nga Këshilli Botues i RU.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Departamenti i Publikimeve Doktrinare
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri
Nr. Tel: 516 /1975, 516/ 1977